

---

Daljet në publik të  
Guvernatorit për vitin 2022

---

*Botuar nga:* © Banka e Shqipërisë

*Adresa:* Sheshi "Skënderbej", Nr. 1, Tiranë, Shqipëri  
*Tel.:* + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419401/2/3  
*Faks:* + 355 4 2419408  
*E-mail:* [public@bankofalbania.org](mailto:public@bankofalbania.org)  
*Printuar në:*  
*Printuar nga:*  
*ISBN:* 9789928262684

# **PËRMBAJTJA**

## **KAPITULLI I**

*Rizgjedhja dhe vizioni i Guvernatorit* 5

## **KAPITULLI II**

*Prezantime në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave* 17

## **KAPITULLI III**

*Konferenca për shtyp për vendimmarrjen e politikës monetare* 53

## **KAPITULLI IV**

*Konferenca për shtyp me Shefin e Misionit të FMN-së dhe Ministrin e Financave* 111

## **KAPITULLI V**

*Fjalime dhe prezantime në konferenca* 117

## **KAPITULLI VI**

*Intervista* 209

## **FOTO GALERI**

**232**



*Gent Sejko, Guvernator i Bankës së Shqipërisë, 2022*

---

# KAPITULLI I

## RIZGJEDHJA DHE VIZIONI I

### GUVERNATORIT

---

- Fjala e Guvernatorit Sejko në seancën dëgjimore të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave për rizgjedhjen e Guvernatorit, 23 shkurt 2022*

## **Rizgjedhja e Guvernatorit**

*Z. Gent Sejko u rizgjodh Guvernator i Bankës së Shqipërisë në datën 24 shkurt 2022 nga Kuvendi i Shqipërisë, në bazë të dekretit të Presidentit të Republikës së Shqipërisë. Ai u emërua për herë të parë në postin e Guvernatorit në shkurt të vitit 2015. Me një karrierë të gjatë në bankën qendrore dhe në sektorin bankar, Guvernatori Sejko ka fituar një përvojë të spikatur në fushën makroekonomike, ku ndër të tjera ka trajtuar çështje strategjike dhe praktike të politikave në fushat e: politikës monetare, mbikëqyrjes bankare, stabilitetit financiar, tregjeve ekonomike dhe financiare, kërkimit dhe procesit të integritit në Bashkimin Evropian.*



## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË SEANCËN DËGJIMORE TË KOMISIONIT TË EKONOMISË DHE FINANCAVE PËR RIZGJEDHJEN E GUVERNATORIT - 23 shkurt 2022 -**

*I nderuar zoti Kryetar,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj anëtarë të Komisionit,*

Ju falënderoj për këtë dëgjese publike, të organizuar në përgjigje të nominimit të kandidaturës sime për rinovimin e mandatit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë.

Që në fillim, më lejoni të theksoj se ndihem i nderuar nga besimi që Kuvendi i Shqipërisë më dha për të vazhduar më tej me kontributin tim në fushën e administrimit të jetës ekonomike dhe financiare të vendit, si anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë. Në të njëjtën frymë, gjej me vend të shtoj se kandidimi im për postin e Guvernatorit motivohet nga një shtysë e brendshme: ajo e përfundimit të procesit të transformimit rrënjësor të Bankës së Shqipërisë dhe shndërrimit të saj në një bankë qendrore moderne.

Në vizionin tim, Banka e Shqipërisë duhet të konvergojë në konturet e një banke qendrore moderne, e denjë për të qenë pjesë e sistemit evropian të bankave qendrore, e aftë të përballet me sfidat që kemi përpara në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë, në rrugën e modernizimit të gjithanshëm të sistemit financiar, në rrugën e integritimit evropian, si dhe në funksionin e saj si një partner i besueshëm i publikut shqiptar, i shoqërisë civile dhe i botës akademike.

***“Në vizionin tim, Banka e Shqipërisë duhet të konvergojë në konturet e një banke qendrore moderne, e denjë për të qenë pjesë e sistemit evropian të bankave qendrore, e aftë të përballet me sfidat që kemi përpara në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm të ekonomisë, në rrugën e modernizimit të gjithanshëm të sistemit financiar, në rrugën e integritimit evropian, si dhe në funksionin e saj si një partner i besueshëm i publikut shqiptar, i shoqërisë civile dhe i botës akademike.”***

*Të nderuar zonja dhe zotërinj,*

Si Guvernator i Bankës së Shqipërisë dhe Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës të saj gjatë shtatë viteve të shkuara, unë kam pasur nderin të shërbej në një nga funksionet më të larta publike të vendit. Gjatë kësaj periudhe, kam ideuar dhe mbikëqyrur zbatimin e një sërë reformash të rëndësishme, të cilat kanë prekur organizimin dhe aktivitetin e institucionit, ashtu edhe aftësinë dhe shkallën e përbushjes së detyrave tona ligjore dhe angazhimeve tona institucionale.

Në pamundësi kohore për të bërë një ekspozë të plotë të arritjeve të institucionit, por të cilat kanë marrë vlerësim maksimal gjatë këtyre viteve, nëpërmjet rezolutave vjetore të këtij Kuvendi të nderuar, më lejoni të fokusohem në disa nga drejtimet kryesore të punës sime.

Misioni kryesor i Bankës së Shqipërisë është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve, i interpretuar si një nivel mesatar inflacioni prej 3% në afatin e mesëm dhe të gjatë. Për përbushjen e tij, Banka e Shqipërisë ushtron në mënyrë ekskluzive dhe të pavarur funksionin e politikës monetare.

***“Gjatë mandatit të parë, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka bërë një hop të dukshëm cilësor. Kështu, në vitin 2015 ne kemi adoptuar një regjim të pastër të inflacionit të shënjestruar, çka përfaqëson dhe standardin e artë të fushës, duke ndërtuar infrastrukturën e nevojshme të analizës dhe parashikimit, duke përmirësuar kuadrin operacional të zbatimit të politikës, si dhe duke rritur transparencën e përmirësuar efektivitetin e komunikimit të saj me Kuvendin, publikun dhe grupet e interesit.”***

Gjatë mandatit të parë, politika monetare e Bankës së Shqipërisë ka bërë një hop të dukshëm cilësor. Kështu, në vitin 2015 ne kemi adoptuar një regjim të pastër të inflacionit të shënjestruar, çka përfaqëson dhe standardin e artë të fushës, duke ndërtuar infrastrukturën e nevojshme të analizës dhe parashikimit, duke përmirësuar kuadrin operacional të zbatimit të politikës, si dhe duke rritur transparencën dhe përmirësuar efektivitetin e komunikimit të saj me Kuvendin, publikun dhe grupet e interesit.

Rezultatet e këtij investimi janë të prekshme. Megjithëse ekonomia shqiptare është përballur me një sërë goditjesh negative, ku spikatin pasojat e krizës financiare globale, pasojat e krizës së borxhit sovran në Eurozonë, si dhe goditjet e tërmetit dhe të pandemisë, inflacioni nuk ka pësuar shmangie të forta nga objektivi, ndonëse është luhatur në kahun e poshtëm të tij. Stabiliteti monetar i vendit ilustron nga një nivel



mesatar inflacioni prej 1.8% gjatë periudhës së referencës, nga nivelet minimale historike të kostove të financimit të sektorit publik e privat, nga trendi rritës i kreditimit në lekë, si dhe nga qëndrueshmëria e kursit të këmbimit të monedhës kombëtare. Këta faktorë kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm në absorbimin e pasojave të goditjeve, në ruajtjen e ekuilibrave makrofinanciarë, si dhe në nxitjen e rimëkëmbjes ekonomike.

Në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, Banka e Shqipërisë ka bërë një transformim të gjithanshëm e rrënjësor. Gjatë mandatit tim të shkuar si Guvernator:

- Së pari, Banka e Shqipërisë ka zbatuar në mënyrë koherente e konsistente programin e reduktimit të kredive me probleme. Si pasojë e rishikimit të plotë të kuadrit ligjor e rregullator, raporti i kredive me probleme ka zbritur në nivelin aktual prej 5.4%, kundrejt pikut prej 25% në vitin 2014. Po aq i rëndësishëm, është fakti se rreziku i kreditit është ulur dhe oferta e kredisë është përmirësuar. Ky përmirësim është pasqyruar në rritjen me 10% të kredisë për sektorin privat gjatë vitit të shkuar, një periudhë kjo e cila përkoi dhe me pasojat e pandemisë.
- Së dyti, Banka e Shqipërisë ka iniciuar dhe zbatuar një plan masash për nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar. Ky plan masash synon si rritjen e qëndrueshmërisë financiare të sektorit bankar dhe të ekonomisë dhe transmetimin më të mirë të politikës monetare. Ai ka dhënë efekte pozitive, në drejtim të reduktimit rreth nivelit 50% të peshës së kredisë në valutë dhe të rritjes së interesit për ruajtjen e kursimeve në monedhën tonë kombëtare.
- Së treti, Banka e Shqipërisë ka administruar me sukses procesin e konsolidimit të sektorit bankar. Ky proces, i cili ka kërkuar një investim të madh kohe dhe energjie, ka synuar e arritur jo thjesht reduktimin e numrit të bankave tregtare (nga 16 në 12), por – mbi të gjitha – futjen në tregun lokal të aktorëve të rinj e të motivuar dhe rritjen e konkurrencës në të. Nga ky proces, vendi ka përfituar një sektor bankar më kompetitiv, më eficient dhe më të sigurt.
- Së fundi, Banka e Shqipërisë ka punuar për adoptimin e praktikave më të mira në fushën e rregullimit dhe të mbikëqyrjes bankare, duke synuar konvergimin me standardet e Eurozonës dhe duke u fokusuar në analizën dhe trajtimin e rreziqeve të mëdha. Në pasqyrim të kësaj pune, Banka e Shqipërisë është tashmë anëtare e kolegjeve mbikëqyrëse të bankave qendrore. Po ashtu, ne kemi një kuadër të plotë e funksional për ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, çka na vendos në pararojë të vendeve të rajonit.

Këto përpjekje kanë dhënë frytet e tyre. Sektori bankar shqiptar mori mbi vete një pjesë të madhe të faturës financiare të pandemisë dhe ofroi mbështetje të vazhduar financiare për bizneset dhe familjet. Po ashtu, ai diti ta ushtronte këtë funksion pa çënuar parametrat kryesorë të shëndetit të tij financiar: shkallën e likuiditetit, të përfitueshmërisë dhe të kapitalizimit. Tashmë, publiku gjen tek sistemi ynë bankar një destinacion të sigurt për ruajtjen e kursimeve të tij, biznesi gjen një burim fondesh, shërbimesh dhe konsulence, ndërsa ekonomia gjen një promotor zhvillimi dhe amortizues goditjesh.

Paralelisht me këto drejtime kryesore, Banka e Shqipërisë ka punuar dhe arritur suksese të prekshme edhe në fushat e tjera, ndër të cilat gjej me vend të evidentoj:

- Sistemin e pagesave, i cili tashmë po operon me një kuadër ligjor e rregullator në përputhje të plotë me standardet e BE-së dhe me një infrastrukturë pagesash në modernizim të vazhdueshëm. Këtu dua të veçoj miratimin e Ligjit të ri “Për sistemin e pagesave”, i cili transponon direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian dhe i hap rrugë shtimit të aktorëve dhe rritjes së eficiencës së tregut. Gjithashtu, në janar të këtij viti, Banka e Shqipërisë vuri në punë infrastrukturën e plotë për procesimin dhe shlyerjen e pagesave në euro brenda vendit. Ky zhvillim do të rezultojë në kosto më të ulëta dhe reduktim të ndjeshëm të kohës së realizimit të pagesave, me një përfitim të ndjeshëm për bizneset dhe familjet shqiptare.
- Administrimin me sukses të rezervës valutore të vendit, ku dua të nënvizoj se adoptimi i metodologjive bashkëkohore të vlerësimit të mjaftueshmërisë dhe administrimit të tyre, ka sjellë si rritjen e rezervës – nga niveli 2.2 miliardë euro në vitin 2014 në pothuaj 5 miliardë euro në vitin 2021, ashtu dhe ruajtjen e një profili të shëndetshëm të saj, në terma të likuiditetit dhe sigurisë. Po ashtu, gjej me vend të theksoj se niveli i kënaqshëm i rezervave tona valutore është një nga treguesit kryesorë që mbështet vlerësimin pozitiv për rrezikun e vendit në tregjet financiare ndërkombëtare.
- Procesin e integritetit evropian, në të cilin fushat direkte të përgjegjësisë së Bankës së Shqipërisë evidentohen si pikat më të afërta të kontaktit me legjisllacionin evropian, apo *Acquis Communautaire*.
- Administrimin e monedhës kombëtare, ku Banka e Shqipërisë ka siguruar furnizimin normal të tregut, edhe pse në prani të sfidave të konsiderueshme operationale të parashtruara nga pandemia. Gjithashtu, ne kemi rifreskuar të gjithë serinë e kartëmonedhave ekzistuese, proces i cili u mbyll në fillim të këtij viti me dy prerjet e fundit. Paralelisht me rifreskimin, në përgjigje të kërkesave të kohës

dhe të zhvillimeve ekonomike dhe financiare, seria është plotësuar edhe me kartëmonedhën e re, me vlerë nominale 10,000 Lekë. E gjithë seria e kartëmonedhave ka tashmë një dizajn bashkëkohor dhe përmbush standardet më të larta të sigurisë.

- Edukimin financiar, një investim ky i rëndësishëm për ndërgjegjësimin mbi administrimin e financave personale dhe rritjen e mirëqenies së shoqërisë.
- Komunikimin me publikun, ku Banka e Shqipërisë është tashmë një institucion jo vetëm më transparent, por edhe më i aksesueshëm nga publiku i gjerë. Komunikimi i rregullt i vendimeve dhe pikëpamjeve tona, organizimi apo pjesëmarrja në konferenca akademike, si dhe përmbushja në kohë e me rigorozitet e kërkesave për informacion, janë njohur dhe nga partnerët tanë të huaj. Më konkretisht, raporti më i fundit i Bankës Qendrore të Austrisë e vlerësoi nivelin dhe cilësinë e komunikimit me publikun të Bankës së Shqipërisë si më të mirin në rajon.

### *Të nderuar anëtarë të Komisionit,*

Me gjithë arritjet që listova më sipër, unë nuk e konsideroj misionin tim të mbyllur.

Duke parë nga e ardhmja, konstatoj se Banka e Shqipërisë ka ende shumë punë për të bërë në të gjitha drejtimet. Më lejoni të rendis shkurtimisht prioritetet e axhendës sime gjatë mandatit të dytë.

**Prioriteti i parë** ka të bëjë me politikën monetare dhe stabilitetin e çmimeve.

Si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, jam kujdesur e do të kujdesem që sasia dhe kostoja e parasë në ekonomi, të mundësojnë stabilitetin e çmimeve, rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies. Në kontekstin afatshkurtër, sfida kryesore do të jetë adresimi i presioneve inflacioniste që vijnë nga rritja e çmimeve në tregjet botërore. Në gjykimin tim, respektimi i mandatit ligjor të stabilitetit të çmimeve është një objektiv i panegociueshëm. Përmbushja me sukses e këtij mandati do të kërkojë hartimin e një politike monetare të kujdesshme dhe largpamëse. Në të njëjtën kohë, paralelisht me objektivin primar të saj, kjo politikë duhet të faktorizojë nevojën e

***“Prioriteti i parë ka të bëjë me politikën monetare dhe stabilitetin e çmimeve. Si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, jam kujdesur e do të kujdesem që sasia dhe kostoja e parasë në ekonomi, të mundësojnë stabilitetin e çmimeve, rritjen e qëndrueshme ekonomike dhe përmirësimin e mirëqenies.”***

mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike dhe të harmonizohet me procesin e konsolidimit fiskal, në interes të rritjes së qëndrueshmërisë fiskale dhe financiare të vendit. Në veçanti, bindja ime është se harmonizimi i kujdesshëm i politikave monetare dhe fiskale prodhon rezultatet më të mira ekonomike, si në terma të rritjes ashtu dhe të stabilitetit. Në një kontekst më afatgjatë, kuadri operacional i politikës monetare duhet të plotësohet me instrumente kontingjente, si ato të adoptuara nga bankat e mëdha qendrore. Ky objektivi ka si parakusht përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe zhvillimin e mëtejshëm të tregjeve financiare. Megjithatë, horizonti i ardhshëm shtatëvjeçar ofron një dimension kohor të mjaftueshëm për përmbushjen e tij.

**Prioriteti i dytë** ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe rregullimin bankar, në funksion të forcimit të mëtejshëm të stabilitetit financiar të vendit. Në këtë prizëm, objektivi i punës sime do të jetë:

***“Prioriteti i dytë ka të bëjë me mbikëqyrjen dhe rregullimin bankar, në funksion të forcimit të mëtejshëm të stabilitetit financiar të vendit, përmes:***

- krijimit të premisave për nxitjen e kreditimit të shëndetshëm të ekonomisë;***
- adoptimit të plotë të gjithë praktikave dhe standardeve relevante të Bazel II dhe Bazel III;***
- konvergimit të mëtejshëm me standardet evropiane dhe marrjes së certifikimeve të mëtejshme në fushën e mbikëqyrjes nga Banka Qendrore Evropiane;***
- riskanimit të plotë të sistemit tonë financiar...”***

- krijimi i të gjitha premisave për nxitjen e kreditimit të shëndetshëm të ekonomisë. Në gjykimin tim, oferta e kredisë bankare nuk duhet të jetë pengesë për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit, por procesi i kreditimit duhet të respektojë gjithnjë parametrat e nevojshëm të kujdesit, për ruajtjen e shëndetit të bankave dhe të vlerës së kursimeve të depozituara në to;
- adoptimi i plotë i gjithë praktikave dhe standardeve relevante të Bazel II dhe Bazel III;
- konvergimi i mëtejshëm me standardet evropiane dhe marrja e certifikimeve të mëtejshme në fushën e mbikëqyrjes nga Banka Qendrore Evropiane. Këto certifikime do të ulin kostot dhe do të rrisin eficiencën e operimit të sektorit tonë bankar;
- riskanimit i plotë i sistemit tonë financiar – në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe FMN-në (*Financial Sector Assessment Program*) – për të mundësuar identifikimin dhe korrektimin në kohë të dobësive të tij. Në veçanti, vëmendje e mëtejshme duhet ushtruar në:
  - o aktivitetin e institucioneve financiare jobanka dhe konvergimin e standardeve dhe praktikave të tyre rregullatore me ato të sektorit bankar. Kjo do të promovojë eficiencën e sistemit

financiar dhe konkurrencën e ndershme brenda dhe ndërmjet segmenteve të ndryshme të tij;

- o vënien në eficiencë të plotë të arkitekturës mbikëqyrëse të sistemit tonë financiar, duke filluar nga Grupi Këshillimor i Stabilitetit Financiar dhe duke vijuar me praktikatat e shkëmbimit të informacionit dhe të bashkëpunimit midis institucioneve të ndryshme rregullatore të tij;
- o vijimin e punës për reduktimin e përdorimit të monedhës së huaj në vend, duke synuar rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve publikë dhe privatë për rreziqet që ajo sjell, si dhe duke synuar forcimin e përgjigjes së institucioneve shqiptare.

**Prioriteti i tretë** do të jetë nxitja e formalizimit dhe rritja e edukimit dhe e përfshirjes financiare. Shkalla relativisht e lartë e informalitetit në ekonominë shqiptare sjell pasoja serioze negative, nëpërmjet cenimit të konkurrencës, frenimit të produktivitetit, rritjes së pasigurisë në marrëdhëniet tregtare e financiare, si dhe reduktimit të të ardhurave publike.

***“Prioriteti i tretë do të jetë nxitja e formalizimit dhe rritja e edukimit dhe e përfshirjes financiare. Shkalla relativisht e lartë e informalitetit në ekonominë shqiptare sjell pasoja serioze negative, nëpërmjet cenimit të konkurrencës, frenimit të produktivitetit, rritjes së pasigurisë në marrëdhëniet tregtare e financiare, si dhe reduktimit të të ardhurave publike.”***

Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë duhet të vijojë punën për rritjen e formalizimit të ekonomisë. Në gjykimin tim, ky proces duhet mbështetur nëpërmjet qasjes rregullatore ndaj aktiviteteve të paformalizuara, nëpërmjet plotësimit të infrastrukturës financiare e cila redukton kostot për aktivitetet formale, si dhe nëpërmjet bashkërendimit të punës me nismat e sektorit publik.

Në fushën e edukimit financiar, Banka e Shqipërisë duhet të luajë një rol kyç në hartimin dhe zbatimin e strategjive kombëtare që promovojnë rritjen e kulturës financiare në vend. Kjo kulturë duhet parë si një element esencial për rritjen e mirëqenies afatgjatë të shoqërisë.

Po ashtu, Banka e Shqipërisë duhet të vijojë të punojë për rritjen e përfshirjes financiare të popullsisë. Një pikënisje e këtij procesi është modernizimi i sistemit të pagesave dhe rritja e shkallës së përdorimit të pagesave elektronike, e më tej shfrytëzimi i kësaj porte për aksesin në shërbime financiare e shërbime pagesash që rrjedhimisht ndikojnë dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Po ashtu, duke qenë të ndërgjegjshëm për rolin dhe rëndësinë e reformave strukturore, Banka e Shqipërisë duhet të vijojë të kontribuojë – me këshilla dhe vëmendje publike – në shtyrjen përpara të tyre. Në gjykimin tim, këto reforma duhet të nxisin produktivitetin, të zhblokojnë potencialet e rritjes, si dhe të krijojnë premisa për një shpërndarje sa më të drejtë të fruteve të saj në shoqëri.

**Prioriteti i katërt** do të jetë mbështetja e integritimit evropian. Ndonëse hapja dhe shpejtësia e këtij procesi do të varet në një masë të madhe nga partnerët tanë evropianë, detyra jonë si autoritete shqiptare është të procedojmë pa asnjë vonesë dhe hezitim në të. Në këtë kontekst, mendoj se Banka e Shqipërisë duhet të vijojë të mbetet në rolin e paraprijësit të procesit duke ofruar shembullin e mirë dhe eksperiencën e saj dhe me autoritetet e tjera publike.

***“Prioriteti i katërt do të jetë mbështetja e integritimit evropian. Ndonëse hapja dhe shpejtësia e procesit varet në një masë të madhe nga partnerët tanë evropianë, detyra jonë si autoritete shqiptare është të procedojmë pa asnjë vonesë dhe hezitim në të. Në këtë kontekst, mendoj se Banka e Shqipërisë duhet të vijojë të mbetet në rolin e paraprijësit të procesit, duke ofruar shembullin e mirë dhe eksperiencën e saj dhe me autoritetet e tjera publike.”***

Së fundi, gjej me vend të theksoj se Banka e Shqipërisë ka qenë dhe duhet të mbetet një institucion i hapur dhe transparent. Përmirësimi i mëtejshëm i kësaj predispozite do të jetë dhe prioriteti i pestë i punës sime. Banka e Shqipërisë mund dhe duhet të zgjerojë më tej gamën e informacionit ekonomik që ajo publikon, si dhe të rrisë prezencën e saj në tryezat e diskutimit ekonomik.

*I nderuar zoti Kryetar,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj anëtarë të Komisionit,*

Duke parashtuar dhe motivuar kërkesën time për rinovimin e mandatit të Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, më lejoni t’ju siguroj se përvoja ime 30-vjeçare e punës në sektorin publik dhe privat të industrisë financiare, eksperiencën në funksione drejtuese, si dhe rezultatet e punës sime, përbëjnë një element garancie për përbushjen e detyrës.

Besimi i këtij Komisioni të nderuar do të shërbejë si një motivim më tepër në dhënien e kontributit tim për zhvillimin e Bankës së Shqipërisë.

*Ju faleminderit!*







---

# KAPITULLI II

## PREZANTIME NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCAVE

---

- *Fjala e Guvernatorit Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021 në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave , 11 maj 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021 në Kuvendin e Shqipërisë, 16 qershor 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko gjatë prezantimit të opinionit të Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin 2023, 4 nëntor 2022*

### **Prezantimet në Kuvend**

Banka e Shqipërisë është një institucion i pavarur, transparent dhe llogaridhënës. Procesi i llogaridhënies realizohet nëpërmjet një sërë instrumentesh, ku vendin më të rëndësishëm e zënë seancat dëgjimore të Guvernatorit në Komisionin Parlamentar të Ekonomisë dhe Financave dhe Kuvendin e Shqipërisë. Çdo vit, Guvernatori prezanton Raportin Vjetor të Bankës së Shqipërisë në këtë Komision dhe Parlament, duke iu përgjigjur edhe interesit të deputetëve për çështje të veçanta të lidhura me të. Nga viti 2015, Guvernatori prezanton në një seancë dëgjimore të dedikuar edhe opinionin e Bankës së Shqipërisë për pikat kryesore të projektbuxhetit të shtetit për vitin pasardhës. Sipas rastit, zhvillohen edhe seanca të veçanta dëgjimore mbi aktivitetin operacional të Bankës së Shqipërisë dhe sistemit bankar.



## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO GJATË PREZANTIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2021 NË KOMISIONIN E EKONOMISË DHE FINANCEVE - 11 maj 2022 -**

*Gjatë vitit 2021, Shqipëria pati rimbëkëmbje të shpejtë ekonomike.*

- *Rimbëkëmbja ishte me bazë të gjerë, duke pasqyruar rritjen e konsumit dhe të investimeve private, zgjerimin e eksporteve të mallrave e të shërbimeve, si dhe kontributin pozitiv të stimullit fiskal;*
- *Rimbëkëmbja u shoqërua me rritje të punësimit dhe të pagave, duke përmirësuar bilancet financiare të familjeve;*
- *Rimbëkëmbja ishte e plotë - ekonomia në tërësi ashtu dhe sektorët e saj individualë në veçanti, kanë tejkaluar nivelet e prodhimit dhe të të ardhurave që siguronin në periudhën para pandemisë dhe tërmetit të vitit 2019;*
- *Rimbëkëmbja pasqyroi kontributin pozitiv të të gjithë aktorëve ekonomikë; dhe*
- *Rimbëkëmbja u shoqërua me përmirësim të ekuilibrave ekonomikë e financiarë të vendit.*

*I nderuar zoti Kryetar,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,*

Në fillim, më lejoni t'ju falënderoj për vlerësimin që më dhatë, duke më besuar një mandat të dytë si Guvernator i Bankës së Shqipërisë. Ju siguroj se llogaridhënia dhe dialogu konstruktiv midis institucioneve tona do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Në fjalën time sot, do t'ju paraqes punën dhe rezultatet e Bankës së Shqipërisë gjatë vitit të shkuar, si në drejtim të përmbushjes së detyrave të saj ligjore, ashtu dhe në drejtim të respektimit të rezolutës së Kuvendit për veprimtarinë e Bankës së Shqipërisë për vitin 2020 dhe të jetësimit të angazhimeve të saj institucionale.

Megjithatë, duke përfituar nga kjo mundësi, dëshiroj të ndaj me ju edhe këndvështrimin tonë mbi sfidat me të cilat po përballemi në realitetin e

ri ekonomik, të shkaktuar nga sulmi ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës. Ky zhvillim ka sjellë një rritje galopante të çmimeve të produkteve bazë në tregjet botërore, duke shtrenjtuar kostot e jetesës së familjeve dhe duke rritur kostot e prodhimit të bizneseve. Për më tepër, konflikti i armatosur ka shtuar pasiguritë dhe ka krijuar pengesa të reja në zinxhirët e furnizimit, të cilët po ndikohen edhe nga kufizimet e vendosura rishtas ndaj valëve të reja të pandemisë në Azi.

Kjo goditje me ndikim të dyfishtë – në rritje për çmimet dhe në rënie për aktivitetin ekonomik – do të transmetohet edhe në ekonominë shqiptare. Ajo pritet të sjellë norma më të larta inflacioni dhe rritje më të ngadaltë ekonomike në Shqipëri krahasuar me vlerësimet tona përpara fillimit të luftës.

Megjithatë, trendi pozitiv i zhvillimit ekonomik të vendit pritet të mbetet i pacenuar në afatin e mesëm dhe të gjatë. Bazuar në informacionin aktual, ne presim që ekonomia të vijojë të rritet gjatë vitit 2022 dhe në vijim. Ky gjykim mbështetet në gjerësinë dhe fortësinë e burimeve të rritjes, në ekuilibrat e konsoliduar ekonomikë dhe financiarë, si dhe në vijimin e një miksi stimulues politikash monetare e fiskale. Nga ana tjetër, ne parashikojmë që inflacioni të mbetet në nivele relativisht të larta gjatë vitit 2022. Më tej, ai pritet të vijë në rënie gjatë vitit 2023, në linjë me reduktimin e pritur të presioneve në tregjet botërore, dhe të kthehet në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024.

Këto projeksione mbështeten në tre konsiderata të rëndësishme.

Së pari, ato supozojnë mospërshkallëzimin e konfliktit dhe vijimin e rritjes në partnerët tanë tregtarë.

Së dyti, ato faktorizojnë bazat solide në të cilat ndodhet ekonomia shqiptare pas rimëkëmbjes së gjithanshme të vitit 2021. Në mënyrë të përmbledhur, më lejoni të theksoj se ekonomia shqiptare e mbylli vitin 2021 me parametra të përmirësuar ekonomikë e financiarë. Vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit, punësimi u zgjerua dhe rritja e pagave u përshpejtua. Në tërësi, bilanci i sektorit privat u përmirësuan, stabiliteti monetar dhe financiar i vendit u konsolidua, dhe tregjet financiare funksionuan normalisht. Në veçanti, sektori bankar ruajti tregues të mirë likuiditeti, kapitalizimi dhe rentabiliteti.

Së treti, ato kërkojnë rishikimin e vazhdueshëm të miksit të politikave ekonomike. Në gjykimin e Bankës së Shqipërisë, këto politika duhet

të vijojnë të ofrojnë mbështetje për procesin e rimëkëmbjes, por pa parajgykuar për asnjë moment stabilitetin monetar e financiar të vendit. Ky stabilitet ka qenë dhe mbetet një parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies së shoqërisë.

Përmbushja e këtij objektivit sot, ndryshe nga më parë, kërkon adresimin e rreziqeve për rritjen e inflacionit.

Nisur nga sa më sipër, politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të vijojë të udhëhiqet nga respektimi i objektivit parësor të saj: ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në këtë frymë, ne vendosëm të rrisim normën bazë të interesit në muajin mars, duke e kthyer atë në nivelin e parapandemisë prej 1%.

***“Politika monetare e Bankës së Shqipërisë do të vijojë të udhëhiqet nga respektimi i objektivit parësor të saj: ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Në këtë frymë, ne vendosëm të rrisim normën bazë të interesit në muajin mars, duke e kthyer atë në nivelin e parapandemisë prej 1%.”***

Nga ana tjetër, politika fiskale duhet të vijojë të ofrojë mbështetje financiare për shtresat me të ardhura të ulëta të shoqërisë dhe për sektorët më të ekspozuar ndaj goditjes. Megjithatë, kjo mbështetje duhet të financohet nga të ardhurat shtesë të siguruara nga rritja e çmimeve dhe nga rishikimi i shpenzimeve joprioritare. Në këtë mënyrë, efektiviteti i ndërhyrjes nuk do të dëmtojë treguesit e borxhit publik.

### ***Të nderuar zonja dhe zotërinj,***

Konflikti ka shtuar pasiguritë për të ardhmen. Shkalla e ndikimit të tij do të varet nga kohëzgjatja e konfliktit dhe shtrëngimi potencial i sanksioneve ndaj Rusisë. Ne jemi të ndërgjegjshëm se rreziqet ndaj inflacionit janë të përqendruara për lart dhe ato ndaj rritjes ekonomike për poshtë.

Në këtë mjedis ekonomik kompleks, roli i politikave monetare dhe fiskale mbetet kritik. Banka e Shqipërisë do të vijojë të monitorojë ecurinë e inflacionit dhe nuk do të hezitojë të reagojë, në kohën dhe me forcën e duhur, për të garantuar stabilitetin monetar dhe financiar të vendit. Kursi i politikës monetare pritet të fillojë rrugën e normalizimit gradual gjatë vitit 2022. Ky qëndrim ofron një balancë të përshtatshme midis rrezikut të përshpejtimit të inflacionit dhe rrezikut të ngadalësimit të rritjes ekonomike.

Në vijim të fjalës sime do të ndalem shkurtimisht në drejtimet kryesore të punës sonë gjatë vitit 2021 dhe rezultatet e saj.

## **1. ECURIA EKONOMIKE DHE POLITIKA MONETARE E BANKËS SË SHQIPËRISË**

Ekonomia shqiptare u rimëkëmb me hapa të shpejtë gjatë vitit 2021. Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 8.5%, pas tkurrjes me 3.5% gjatë vitit 2020. Rritja e shpejtë ekonomike pasqyroj reduktimin e masave kufizuese, rritjen e besimit, përmirësimin e ambientit të huaj, si dhe stimujt monetarë dhe fiskalë. Këta faktorë i hapën rrugë zgjerimit të shpejtë të kërkesës për mallra e shërbime.

Rimëkëmbja e shpejtë ekonomike pati disa karakteristika, të cilat ilustruan fleksibilitetin e ekonomisë sonë dhe janë premisa inkurajuese për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë në vijim.

Më lejoni të ndalem në disa prej tyre:


- Rimëkëmbja ishte me bazë të gjerë. Në terma të kërkesës agregate, ajo pasqyroj rritjen e konsumit dhe të investimeve private, zgjerimin e eksporteve të mallrave e të shërbimeve, si dhe kontributin pozitiv të stimulit fiskal. Në terma sektorialë, ajo pasqyroj zgjerimin e të gjithë sektorëve të ekonomisë.
- Rimëkëmbja u shoqërua me rritje të punësimit dhe të pagave, duke përmirësuar bilancet financiare të familjeve. Rritja e punësimit mundësoi rënien e shkallës së papunësisë në 11.4% në fund të vitit, duke qëndruar pranë niveleve të parakrizës. Në reflektim të tyre, pagat njohën ritme të larta rritjeje, në thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë.
- Rimëkëmbja ishte e plotë. Si ekonomia në tërësi ashtu dhe sektorët e saj individualë në veçanti, kanë tejkaluar nivelet e prodhimit dhe të të ardhurave që siguronin në periudhën para pandemisë dhe tërmetit të vitit 2019. Ky zhvillim ilustron rikuperimin e shpejtë të kërkesës dhe ndikimin e pakët strukturor që këto goditje patën në strukturën prodhuese të ekonomisë.
- Rimëkëmbja pasqyroj kontributin pozitiv të të gjithë aktorëve ekonomikë. Së pari, përgjigjja e bizneseve dhe familjeve tregoi se ata gëzonin si bilance relativisht solide, ashtu edhe fleksibilitet e gatishmëri për t'iu rikthyer sjelljes së tyre normale ekonomike. Së

dyti, përgjigjja e autoriteteve publike ishte e shpejtë, e përshtatshme dhe efikase, çka lehtësoi barrën financiare të goditjes mbi bizneset dhe familjet shqiptare, duke i hapur rrugë rimëkëmbjes. Së treti, sektori bankar vijoi të financojë zgjerimin e konsumit dhe të investimeve, duke përmirësuar në të njëjtën kohë treguesit e tij të fitimit dhe të likuiditetit.

- Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, rimëkëmbja u shoqërua me përmirësim të ekuilibrave ekonomikë e financiarë të vendit. Pozicioni i huaj dhe ai fiskal i vendit u përmirësuan dhe treguesit kryesorë të shëndetit financiar u konsoliduan. Deficiti i llogarisë korrente zbriti në një nivel mesatar prej 7.7% të PBB-së gjatë vitit 2021, kundrejt nivelit 8.7% të regjistruar një vit më parë. Në sferën fiskale, kombinimi i rritjes ekonomike me rënien e deficitit buxhetor ndihmoi rënien e raportit të borxhit publik ndaj PBB-së në 73.2%, nga 74.5% të regjistruar në vitin 2020.

Rritja progresive e kërkesës për mallra e shërbime mundësoi rritjen e punësimit, të pagave dhe të marzheve të fitimit, duke u pasqyruar në një trend rritës të inflacionit në linjë me objektivin tonë. Inflacioni mesatar rezultoi në nivelin 2.0% në vitin 2021, kundrejt vlerës 1.6% të një viti më parë. Nga ana tjetër, rritja e shpejtë e çmimeve në tregun ndërkombëtar e shtyu inflacionin në nivelin 3.7% në muajin dhjetor 2021 dhe 5.7% në muajin mars 2022.

Grafik 1. Ecuria e inflacionit dhe norma bazë e interesit (në përqindje)



\*Logarituar duke përjashtuar dy vitet e fundit, si vite kur norma bazë u ul në nivele ekstremisht të ulëta.  
Burimi: INSTAT dhe BSH.

*Të nderuar zonja dhe zotërinj,*

Pa ju marrë shumë kohë, më lejoni të ndalem tek roli që ka luajtur Banka e Shqipërisë në procesin e rimëkëmbjes, si në drejtim të rritjes ekonomike, ashtu dhe në atë të ruajtjes së stabilitetit monetar e financiar.

Politika monetare vijoi të mbetet në kahun stimulues edhe gjatë vitit 2021. Norma bazë e interesit mbeti në nivelet e veta më të ulëta historike, prej 0.5%, ndërsa vëllimi i likuiditetit të injektuar në sistem u rrit. Paralelisht me to, Banka e Shqipërisë vijoi të orientojë tregun mbi kahun e politikës monetare në të ardhmen, duke reduktuar pasigurinë në tregjet financiare.

Kursi stimulues i politikës monetare siguroi një ambient me kosto të ulëta financimi dhe kushte të përshtatshme kreditimi. Tregjet financiare funksionuan normalisht dhe u karakterizuan nga likuiditet i bollshëm dhe prime të kontrolluara rreziku. Transmetimi efektiv i stimullit monetar ka mbajtur në nivele të ulëta normat e interesit të kredisë për sektorin privat dhe atë publik. Po ashtu, kursi i këmbimit ishte relativisht i qëndrueshëm, në pasqyrim të balancës së kërkesës dhe ofertës për valutë.


Ky ambient mundësoi një rritje të qëndrueshme të kredisë. Vëllimi i kredisë për sektorin privat u rrit mesatarisht me 8.4% gjatë vitit 2021 - norma më e lartë e rritjes prej vitit 2012.

Përtej rritjes së përgjithshme të portofolit, dinamikat e kreditimit mbartën sinjale të tjera pozitive. Së pari, rritja e portofolit të kredisë shkoi më së shumti për financimin e investimeve të bizneseve dhe për kredi hipotekare, duke sinjalizuar rritjen e investimeve të sektorit privat dhe një situatë në përmirësim të likuiditetit të tij. Së dyti, kredia në monedhën vendase vijoi të ruajë norma të larta rritjeje, duke u reflektuar në rritjen progresive të peshës së kredisë në lekë ndaj totalit. Ky zhvillim krijon premisa për një përcjellje më të mirë të stimullit monetar dhe një rezistencë më të lartë të sistemit bankar ndaj rreziqeve. Së treti, cilësia e portofolit të kredisë për sektorin privat erdhi drejt përmirësimit, sikundër ilustrohet nga rënia progresive e treguesit të kredisë me probleme.

***“Vlerësimet tona empirike tregojnë se kursi stimulues i politikës monetare ka kontribuar me rreth 1.3 pikë përqindje në rritjen ekonomike të vitit 2021.”***



*Grafik 2. Transmetimi i stimullit monetar në normat e interesit të kredive dhe ecuria e kredisë sipas monedhave*



\*Raportuar kredia e rregulluar për lëvizjet e kursit të këmbimit dhe kreditë e nxjerja jashtë bilancit  
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Vlerësimet tona empirike tregojnë se kursi stimulues i politikës monetare ka kontribuar me rreth 1.3 pikë përqindje në rritjen ekonomike të vitit 2021. Ky kontribut vjen si rezultat i normave të ulëta të interesit, i primeve të ulëta të rrezikut, i kreditimit të vazhdueshëm të ekonomisë dhe i rritjes së konkurrencës së eksporteve shqiptare. Njëpërmjet nxitjes së kërkesës agregate dhe shfrytëzimit më të mirë të potencialeve prodhuese, stimulu monetar ka kontribuar pozitivisht në stabilitetin e çmimeve.

Më lejoni tani të ndalem në çështjet e stabilitetit financiar dhe të mbikëqyrjes e rregullimit bankar.

## 2. MBIKËQYRJA BANKARE DHE STABILITETI FINANCIAR

Sistemi bankar u karakterizua nga një ecuri pozitive gjatë vitit 2021. Gjatë periudhës së pandemisë, sistemi bankar tregoi se ishte një partner serioz në mbështetjen e zhvillimit ekonomik të vendit, duke mbajtur përsipër një pjesë të barrës së kostove. Viti 2021 konfirmoi se ky sektor ka aftësi të larta rezistence, falë politikave makroprudenciale të Bankës së Shqipërisë, zbatimit të një kuadri të shëndoshë mbikëqyrjeje dhe përmirësimit të vazhdueshëm të sistemeve të kontrollit të bankave.

Veprimtaria financiare e sistemit bankar ishte e qëndrueshme, investimet e tyre janë zgjeruar, cilësia e portofolit të aktiveve është përmirësuar

dhe normat e fitimit kanë njohur rritje. Rezultati financiar ishte pozitiv dhe rreth 29% më i lartë nga një vit më parë; niveli i mjaftueshmërisë së kapitalit mbeti në nivelin 18% dhe ndjeshëm mbi limitin rregullator; dhe treguesi i kredive me probleme zbriti në 5.6% në fund të vitit, nga 8.1% një vit më parë, duke shënuar dhe normën më të ulët të dekadës së fundit. Ekspozimi i aktivitetit të sektorit bankar ndaj rreziqeve mbetet i kontrolluar. Ushtrimet e provës së rezistencës tregojnë se aftësia e sektorit bankar për të përballuar humbjet që burojnë nga materializimi i goditjeve të pafavorshme në sektorin real dhe financiar mbetet e fortë.

Tabelë 1. Tregues të aktivitetit të sistemit financiar

SISTEMI FINANCIAR	2021	SEKTORI BANKAR	2021	2020
Institucione financiare jobanka (% ndryshim vjetor)	8	Depozitat (% ndryshim vjetor)	11	8
Shoqëri sigurimi (% ndryshim vjetor)	4	Kredia (% ndryshim vjetor)	10	6
Shoqëri kursim-kreditit (% ndryshim vjetor)	10	Veprime me letrat me vlerë (% ndryshim vjetor)	21	19
Fonde pensioni (% ndryshim vjetor)	18	Rezultati neto (% ndryshim vjetor)	31	(12)
Fonde investimi (% ndryshim vjetor)	11	Kthimi nga aktivet (%)	1.3	1.1
Sektori bankar (% ndryshim vjetor)	12	Raporti i kredive me probleme (%)	5.6	8.1
Aktivitet e sistemit financiar (% ndaj PBB-së)	111	Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit (%)	18.0	18.7

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Këto rezultate pozitive nuk kanë ulur vëmendjen tonë ndaj forcimit të mbikëqyrjes së bankave dhe përmirësimit të kuadrit makroprudencial. Më poshtë, do të rendis shkurtimisht disa nga prioritetet e punës së Bankës së Shqipërisë në këtë drejtim.

**Çelja e procesit të ekuivalentimit të kuadrit tonë mbikëqyrës e rregullator me atë të BE-së.** Ky proces synon të certifikojë shkallën e konvergencës së kuadrit tonë rregullator dhe të praktikave tona mbikëqyrëse me ato të Bashkimit Evropian. Me asistencën teknike të ekspertëve ndërkombëtarë, gjatë vitit 2021 u krye një vlerësim i pavarur i kuadrit mbikëqyrës në vend, i cili konkludoi se Shqipëria gëzon një nivel të lartë ekuivalence me standardet e Bashkimit Evropian. Tashmë, Banka e Shqipërisë ka kërkuar pranë Komisionit Evropian nisjen e procesit formal të ekuivalencës.

**Zbatimi i rekomandimeve të Komitetit të MONEYVAL, në kuadër të masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.** Banka e Shqipërisë është e përfshirë në planin kombëtar të masave për parandalimin e pastrimit të parasë dhe të financimit të terrorizmit, duke pasur përgjegjësi për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe forcimin e efektivitetit të procesit mbikëqyrës. Në këtë kuadër, ajo ka vijuar inspektimet në vend për çështje që lidhen me parandalimin e pastrimit të

parave, me një fokus të veçantë në çështjet e financimit të terrorizmit dhe të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare. Inspektimet kanë targetuar bankat, subjektet financiare jobanka (SFJB) dhe zyrat e këmbimit valutor (ZKV).

### **Përmirësimi i kuadrit rregullator për rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e konsumatorit.**

Duke parë përshpejtimin e kreditimit të konsumatorëve, veçanërisht nga subjektet financiare jobanka, Banka e Shqipërisë ndërmori një iniciativë për forcimin e kuadrit rregullator për kreditë konsumatore, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga vendosja e normave të larta dhe të pajustificuara të interesit për këto kredi. Ndryshimet prezantojnë për herë të parë konceptin e një kufiri maksimal të lejuar të normës efektive të interesit dhe të penaltiteve që zbatohen për klientët

***“Banka e Shqipërisë ndërmori një iniciativë për forcimin e kuadrit rregullator për kreditë konsumatore të dhëna nga subjektet financiare jobanka, me qëllim mbrojtjen e konsumatorit nga vendosja e normave të larta dhe të pajustificuara të interesit për këto kredi. Ndryshimet prezantojnë për herë të parë konceptin e një kufiri maksimal të lejuar të normës efektive të interesit dhe të penaltiteve që zbatohen për klientët e kredive konsumatore.”***

e kredive konsumatore. Për realizimin e këtyre ndryshimeve, u ndoqën praktikat më të mira nga vendet e Bashkimit Evropian.

Ndryshime janë bërë edhe në kuadër të transparencës së produkteve bankare, ku me procesin gradual të zëvendësimit të referencës për normat e interesit të produkteve bankare, siç janë LIBOR, EURIBOR etj., bankat duhet të rrisin shkallën e informimit për huamarrësit. Ndryshimet e miratuara në rregulloren përkatëse, e konturojnë këtë informim me baza ligjore në marrëdhëniet kontraktore.

### **Përafrimi rregullator e metodologjik me standardet ndërkombëtare.**

Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për përmirësimin e kuadrit rregullator mbikëqyrës, me synim përafrimin e tij me *acquis* të BE-së, parimet e Komitetit të Bazelit dhe me praktikat më të mira të mbikëqyrjes bankare. Rishikimi i rregulloreve ka pasur në fokus përshtatjen me rregulloret më aktuale të BE-së, të cilat synojnë të vlerësojnë aftësitë për administrimin e likuiditetit të bankave; krijimin e shtesave në kapital për të mbrojtur bankat nga ekspozimet për rreziqe të ndryshme etj. Gjithashtu, një pjesë e rëndësishme e akteve nënligjore janë hartuar dhe miratuar për të plotësuar kuadrin rregullator për zbatimin e ligjit “Për shërbimet e pagesave” dhe atë për ligjin “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka, në Republikën e Shqipërisë”.

**Monitorimi rigoroz i sistemit financiar nëpërmjet inspektiveve në vend.** Inspektimet në vend kanë vijuar rregullisht, ku janë shtuar ekzaminimet e subjekteve financiare jobanka dhe të zyrave të këmbimit valutor. Fokusi i ekzaminimeve në banka ka qenë vlerësimi i administrimit të situatës së pandemisë dhe ndikimit në portofolin e kredisë. Bankat kanë ndjekur një qasje të kujdesshme në kreditim, të mbështetur në kriteret e caktuara për ofrimin e lehtësirave për klientë me probleme. Krahas fokusit kryesor tek rreziku i kredisë, ekzaminimet kanë vlerësuar dhe profilin e rreziqeve të tjera që lidhen me veprimtarinë bankare, si rreziku operacional dhe i teknologjisë së informacionit, rreziqe financiare etj., për të cilat janë dhënë rekomandimet përkatëse.

**Fuqizimi i aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme.** Gjatë vitit 2021 ka përfunduar hartimi i planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme të të gjitha bankave që operojnë në tregun shqiptar, si dhe janë identifikuar pengesat potenciale ndaj aftësisë për ndërhyrje të jashtëzakonshme. Në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të ndërhyrjes së jashtëzakonshme, janë përcaktuar dhe kërkesat minimale të instrumenteve që duhet të mbajnë bankat në çdo kohë, me qëllim mundësimin e zbatimit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

**Zhvillimi dhe zbatimi i politikës makroprudenciale në funksion të ruajtjes së stabilitetit financiar.** Gjatë vitit 2021, vijoi zbatimi i masave që synojnë uljen e përdorimit të valutave në veprimtarinë e sektorit bankar dhe zbatimi i shtesave makroprudenciale të kapitalit. Zhvillimet gjatë vitit nuk kanë kërkuar ndërhyrje me masa shtesë të natyrës makroprudenciale. Megjithatë, përdorimi i valutave mbetet ende në nivele të larta dhe kërkon vëmendje më të madhe nga autoritetet e tjera.

Krahas rolit të saj primar në ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar, Banka e Shqipërisë është përgjegjëse për një sërë detyrash e veprimtarish, të cilat, për hir të kohës, do të më duhet t'i përmend fare shkurt.

### **3. AKTIVITETE TË TJERA**

**Garantimi i sistemeve të pagesave të sigurta dhe efiente.** Banka e Shqipërisë operon dy sisteme pagesash në Lek: atë për pagesat me vlerë të vogël (AECH) dhe atë për pagesat me vlerë të madhe (AIPS). Të dy sistemet kanë treguar disponueshmëri maksimale dhe kanë funksionuar në mënyrë të sigurt, duke garantuar rrjedhjen e fondeve për ekonominë. Me synimin për të plotësuar dhe modernizuar infrastrukturën e pagesave

në vend, Banka e Shqipërisë ka përfunduar projektin për ofrimin e një sistemi të ri të shlyerjes së pagesave kombëtare në monedhën Euro për klientët e bankave – AIPS-Euro. Ky sistem ka filluar operimin në janar 2022, duke u mundësuar qytetarëve shqiptarë kryerjen e pagesave në Euro brenda vendit, me kosto shumë më të ulëta dhe në një afat kohor shumë më të shkurtër krahasuar me procesin e mëparshëm nëpërmjet bankave korrespondente. Gjithashtu, me qëllim rritjen e përfshirjes financiare dhe të përdorimit të pagesave elektronike, gjatë vitit 2021, u bë i mundur zbatimi i skemës së “Debitimit direkt”, e cila i krijon konsumatorëve fleksibilitet në kryerjen e pagesave për shërbimet utilitare nëpërmjet sistemit bankar.

Tabelë 2. Komisionet e aplikuara përpara dhe pas fillimit të operimit të sistemit AIPS EURO

	Deri në 24 janar 2022	Pas 24 Janar 2022	
	Pagesa në formë letër & (jo letër) elektronike	Pagesa në formë letër	Pagesa Elektronike
<b>TRANSFERTA NË NISJE ▶</b>			
MIN-Euro për transaksion	Max 30 Euro	Max 6 Euro	Max 3 Euro
Në % mbi vlerën	Max 3%	Max 0.2% deri 10,000 euro	Max 0.1% deri 10,000 euro
MAX -Euro për transaksion	Max 300 Euro	Max 50 Euro	Max 25 Euro
<b>TRANSFERTA NË MBËRRITJE ◀</b>			
MIN- Euro për transaksion	20.00	0	0
Në % mbi vlerën	0.2 %	0	0
MAX -Euro për transaksion	200.00	0	0
Komisioni i Swift-it MAX- Euro për transaksion	10.00	0	0

Burimi: Banka e Shqipërisë.


**Nxitja e pagesave elektronike dhe e përfshirjes financiare të popullsisë.** Numri i pagesave elektronike të kryera në vend u rrit me 29.5% gjatë vitit 2021. Rritja e tyre është ndihmuar nga ndryshimet rregullatore nëpërmjet ligjit “Për shërbimet e pagesave”, si dhe përmirësimet në infrastrukturë. Përdorimi i pagesave elektronike në vit për individë në moshë madhore arriti në nivelin 12.5 në fund të vitit 2021, kundrejt 4.3 në vitin 2017. Zhvillime pozitive janë shënuar dhe në zgjerimin e përqindjes së popullsisë, e cila zotëron një llogari pagesash. Në vitin 2021, rezultoi se rreth 69% e popullsisë në moshë madhore zotëron një llogari pagese, kundrejt vetëm 40% në vitin 2017.

**Përmirësimi i kuadrit rregullator të sistemeve të pagesave në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.** Gjatë vitit 2021 është hartuar projektligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, në përputhje me direktivat e BE-së. Miratimi i tij ofron shërbime financiare bazike për individët e pambuluar me shërbime bankare, pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit dhe historikut të aftësisë paguese.

**Emetimi i kartëmonedhës.** Siguria fizike e saj dhe miradministrimi i parasë fizike përbën një drejtim tjetër të rëndësishëm të veprimtarisë sonë. Në këtë drejtim, në qershor 2021, u nënshkrua me BQE-në një marrëveshje për mbrojtjen e kartëmonedhës Euro nga falsifikimi, duke e bërë kështu Bankën e Shqipërisë pjesë integrale të procesit evropian në luftën kundër falsifikimit të kartëmonedhave.

Po ashtu, ne kemi plotësuar të gjithë serinë tonë të re të kartëmonedhave, të përbërë nga 6 prerje. Në dhjetor 2021 u hodhën në qarkullim edhe dy prerjet e fundit të kësaj serie, ato 500 dhe 2,000 Lekë, ndërkohë që në qershor 2021, tregut i ishte shtuar edhe kartëmonedha me prerjen më të madhe në vlerën 10,000 Lekë, e cila përbën edhe një risi në procesin e prodhimit të parasë sonë. Kartëmonedhat e serisë së re janë dizajnuar dhe prodhuar me teknologjinë më të fundit të fushës dhe janë të pajisura me elemente bashkëkohore dhe të sofistikuar sigurie.

**Grafik 3. Statistika të kartëmonedhave të falsifikuara**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Përbushja e detyrimeve institucionale në kuadër të integritimit evropian.** Banka e Shqipërisë ka një rol esencial në arritjen e qëllimit kombëtar për aderimin në Bashkimin Evropian. Ajo është udhëheqëse në një kapitull të përputhshmërisë së legjislacionit, ndërsa është anëtare e grupeve të punës për kapituj të tjerë. Banka e Shqipërisë ka realizuar miratimin e akteve nënligjore të parashikuara në Planin Kombëtar të Integritimit Evropian dhe ka përfshirë në prioritetet e punës së saj rekomandimet e Komisionit Evropian.

**Rritja e komunikimit, transparencës dhe llogaridhënies.** Banka e Shqipërisë mbetet një institucion i hapur, i gatshëm të komunikojë me transparencë vendimet e saj dhe të përgjigjet me seriozitet për veprimtarinë e vet. Gjatë vitit 2021 ka vijuar komunikimi fizik dhe virtual me median, akademikë, publikun e gjerë dhe palë të interesuara. Vitet e fundit, Banka e Shqipërisë ka marrë përgjegjësi publike për ndërmarrjen e fushatave për edukimin financiar. Në bashkëpunim edhe me Shoqatën e Bankave, janë kryer disa aktivitete, me qëllim rritjen e njohurive financiare të publikut dhe rritjen e ndërgjegjësimit për financat personale.

Paralelisht me to, Banka e Shqipërisë ka shënuar progres të mëtjshëm në fushën e administrimit të rezervës valutore, në fushën e kërkimit shkencor, në proceset e mbledhjes, hartimit dhe raportimit të statistikave, si dhe në drejtim të forcimit të qeverisjes së institucionit. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka përbushur rekomandimet e lëna nga Kuvendi i Shqipërisë për aktivitetin e saj gjatë vitit 2020.

Një informacion të gjerë mbi këto çështje do ta gjeni të detajuar në faqet e Raportit Vjetor 2021.

### ***Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,***

Duke ju falënderuar për vëmendjen, më lejoni të theksoj se Banka e Shqipërisë ka qenë dhe mbetet e angazhuar për respektimin e detyrave të saj ligjore, për adresimin e sfidave të rritjes, si dhe për ndërtimin e një dialogu konstruktiv me të gjithë aktorët dhe faktorët e jetës ekonomike dhe sociale.

Kuvendi i Shqipërisë dhe publiku shqiptar do të gjejë të ne një partner serioz në rrugën e zhvillimit të vendit.

***Ju faleminderit!***





## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO GJATË PREZANTIMIT TË RAPORTIT VJETOR TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR VITIN 2021 NË KUVENDIN E SHQIPËRISË - 16 qershor 2022 -**

*E nderuar zonja Kryetare e Kuvendit,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,*

Dëshiroj ta filloj prezantimin e Raportit Vjetor duke shprehur konsideratën time më të lartë për Kuvendin e Shqipërisë. Në këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë, raportimi përpara këtij institucioni është një detyrim jo vetëm ligjor, por edhe moral. Si një element kyç i transparencës dhe llogaridhënies, ky raportim i shërben rritjes së përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë në sytë e publikut. Gjithashtu, ky raportim mundëson prezantimin e këndvështrimit të Bankës së Shqipërisë mbi situatën ekonomike dhe financiare në vend dhe sfidat e së ardhmes, duke ndihmuar dialogun konstruktiv midis institucioneve tona.

***“Si një element kyç i transparencës dhe llogaridhënies, ky raportim i shërben rritjes së përgjegjshmërisë dhe besueshmërisë së Bankës së Shqipërisë në sytë e publikut. Gjithashtu, ky raportim mundëson prezantimin e këndvështrimit të Bankës së Shqipërisë mbi situatën ekonomike dhe financiare në vend dhe sfidat e së ardhmes, duke ndihmuar dialogun konstruktiv midis institucioneve tona.”***

*Të nderuar zonja e zotërinj deputetë,*

Më lejoni t’ju paraqes në vazhdim një ekspozitë të punës dhe rezultateve tona gjatë vitit të shkuar.

Kryefjala e zhvillimeve ekonomike të vitit 2021 ishte rimëkëmbja dhe konsolidimi. Aktiviteti ekonomik në vend shënoi një rikuperim të shpejtë e të gjithanshëm, ndërsa treguesit kryesorë të shëndetit ekonomik e financiar u konsoliduan.


Sipas të dhënave zyrtare, vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit me 8.5% kundrejt vitit paraardhës, duke tejkaluar nivelin e regjistruar përpara tërmetit e pandemisë. Rritja ekonomike ishte me bazë të gjerë. Ajo pasqyroi rimëkëmbjen e shpejtë të konsumit familjar, të investimeve private, si dhe të eksporteve të mallrave e shërbimeve. Për më tepër, frytet e kësaj rimëkëmbjeje ishin të pranishme në thuajse të gjithë sektorët

dhe degët kryesore të ekonomisë. Rikuperimi i gjithanshëm i kërkesës gjeneroi më shumë të ardhura për bizneset dhe familjet shqiptare, duke përmirësuar bilancet e tyre financiare dhe duke rritur qëndrueshmërinë e burimeve të rritjes.

Rimëkëmbja ekonomike solli rritje të punësimit, të pagave dhe të marzheve të fitimit, çka u materializua në rritje të presioneve të brendshme inflacioniste. Për rrjedhojë, inflacioni shënoi një rritje graduale gjatë vitit të shkuar, ndonëse ai vijoi të mbetet nën objektiv. Rimëkëmbja u shoqërua me konsolidim të ekuilibrave ekonomikë e financiarë.

Pozicioni i jashtëm ekonomik dhe financiar i vendit erdhi në përmirësim. Deficiti i llogarisë korrente zbriti në 7.7% të PBB-së gjatë vitit 2021, kundrejt nivelit 8.7% të regjistruar një vit më parë. Po ashtu, borxhi i huaj i vendit shënoi rënie. Në planin fiskal, rritja ekonomike dhe rënia e deficitit buxhetor sollën reduktimin në 73.2% të raportit të borxhit publik ndaj PBB-së, nga niveli 74.5% i regjistruar në vitin 2020. Paralelisht me këto zhvillime, stabiliteti monetar dhe financiar i vendit erdhi në konsolidim. Tregjet financiare operuan të qeta, kursi i këmbimit u shfaq i qëndrueshëm, dhe kushtet e kreditimit u përmirësuan. Gjithashtu, sistemi bankar pati një ecuri pozitive gjatë vitit 2021. Ndërmjetësimi financiar erdhi në rritje, ndërsa treguesit e kapitalizimit, të likuiditetit dhe të përfitueshmërisë, u përmirësuan dhe ishin ndjeshëm mbi kërkesat tona rregullatore. Ekspozimi i aktivitetit të sektorit bankar ndaj rreziqeve është i kontrolluar, ndërsa ushtrimet e provës së rezistencës sugjerojnë se aftësia e tij për të përballuar goditje shfaqet e lartë.

**Grafik 4. Borxhi publik në përqindje të PBB-së majtas, dhe rritja reale ekonomike, djathtas**



Burimi: FMN, WEO October 2021 database, MFE, INSTAT.

Kjo tablo pozitive zhvillimesh ka pasqyruar jo vetëm fundamentet relativisht solide të ekonomisë shqiptare dhe fleksibilitetin e sektorit privat të ekonomisë, por edhe reagimin e koordinuar, në kohën dhe me instrumentet e duhura, të politikës fiskale, monetare e financiare.

Duke u ndalur te puna e Bankës së Shqipërisë, më duhet të theksoj se politika jonë monetare vijoi të mbetet në kahun stimules gjatë vitit 2021. Ky qëndrim i shërbeu si përmbushjes së objektivit tonë të primar, atij të stabilitetit të çmimeve, ashtu dhe nxitjes së rimëkëmbjes ekonomike. Në terma më konkretë, ne ruajtëm normën bazë të interesit në nivelet minimale historike, plotësuam nevojat e tregut me likuiditet, si dhe vijum të orientojmë tregun mbi kahun e politikës monetare në të ardhmen. Politika jonë monetare siguroi një ambient me kosto të ulëta financimi, kushte të përshtatshme kreditimi dhe kurs të qëndrueshëm këmbimi. Ajo mbajti në kontroll kostot financiare të sektorit privat dhe mundësoi një rritje të shpejtë e të qëndrueshme të kreditimit, duke ndihmuar zgjerimin e konsumit dhe të investimeve në ekonomi. Vlerësimet tona tregojnë se stimuli monetar kontribuoi me rreth 1.3 pikë përqindje në rritjen ekonomike të vitit 2021 dhe ndihmoi forcimin e stabilitetit të çmimeve, në linjë me objektivin tonë të inflacionit.

Në koordinim me stimulin monetar, Banka e Shqipërisë vijoi të ruajë masat stimuluese makroprudenciale, masa të cilat mbështetën ristrukturimin e kredive për klientët në nevojë, edhe gjatë tremujorit të parë të vitit 2021. Më tej, me konsolidimin e kreditit dhe të rimëkëmbjes ekonomike, fokusi ynë mbikëqyrës e rregullator u orientua drejt fuqizimit të stabilitetit financiar.

Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë intensifikoi punën për përafrimin e mëtejshëm rregullator e metodologjik me *acquis* të BE-së, parimet e Komitetit të Bazelit dhe me praktikat më të mira të mbikëqyrjes bankare. Po ashtu, gjatë vitit 2021, Banka e Shqipërisë zhvilloi më tej kuadrin, objektivat dhe instrumentet e ndërhyrjes makroprudenciale, si dhe fuqizoi kapacitetet e saj për ndërhyrje të jashtëzakonshme, duke përfunduar planet individuale të ndërhyrjes dhe duke përcaktuar kërkesat minimale mbi instrumentet që duhet të mbajnë bankat për të mundësuar zbatimin e ndërhyrjes. Këto aksione shtojnë rrjetat e sigurisë në sistemin financiar dhe fuqizojnë kapacitetet tona institucionale për garantimin e stabilitetit financiar.

Paralelisht me to, ne i kemi kushtuar një vëmendje të veçantë përmirësimit të kuadrit rregullator për rritjen e transparencës dhe mbrojtjen e konsumatorit. Në këtë kontekst, ne kemi forcuar kuadrin rregullator për kreditë konsumatore të dhëna nga institucione financiare jobanka, me qëllim kufizimin sasior të normave të interesit dhe të komisioneve të aplikuara për këto kredi. Këto ndryshime janë bazuar tërësisht në praktikat më të mira të ndjekura nga vendet e Bashkimit Evropian.

Po ashtu, ne kemi vijuar monitorimin rigoroz të sistemit financiar. Inspektimet në vend kanë vijuar rregullisht, duke shtuar ekzaminimet e subjekteve financiare jobanka dhe të zyrave të këmbimit valutor. Fokusi i tyre ka qenë vlerësimi i administrimit të situatës së pandemisë dhe ndikimit në portofolin e kredisë, si dhe rreziqeve të tjera që lidhen me veprimtarinë bankare.

Tabelë 3. Numri i ekzaminimeve sipas viteve dhe sipas tematikës

Inspektime të kryera në subjekte	Rreziku Strategjik	Rreziku Organizativ	Rreziku Kredisë	Rreziku i Likuiditetit	Rreziku i Normës së Interesit	Rreziku i Tregut	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit	Rreziku Operacional	Rreziku Reputacional	Përfshueshmëria	Kopërti
2018	8	10	9	8	8	8	9	8	28*	9	8
2019	13	13	16	13	13	14	13	13	14	13	15
2020	2	8	15	11	2	5	5	5	88**	2	6
2021	7	7	12	7	7	7	8	8	109***	6	6

\* Në vitin 2018 janë kryer ekzaminime në 28 zyra të këmbimit valutor për rrezikun reputacional. 10 inspektime për këtë rrezik janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

\*\* Në vitin 2020 janë kryer ekzaminime në 74 zyra të këmbimit valutor për rrezikun reputacional dhe 14 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka. Ndër këto, ekzaminimet për 2 banka, 1 institucion financiar jobankë dhe 1 zyrë këmbimi valutor, për këtë rrezik, janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe ekzaminimet për 3 banka janë kryer në bashkëpunim me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

\*\*\*Në vitin 2021 janë kryer ekzaminime në 90 zyra të këmbimit valutor për rrezikun reputacional dhe 19 ekzaminimet e tjera për këtë rrezik janë kryer në banka dhe institucione financiare jobanka. Ndër këto, ekzaminimet për 2 banka, 6 institucione financiar jobankë dhe 1 zyrë këmbimi valutor, për këtë rrezik, janë kryer në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Së fundi, Banka e Shqipërisë i ka kushtuar një kujdes të posaçëm zbatimit të rekomandimeve të Komitetit të MONEYVAL, në kuadër të masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Ne kemi vijuar punën për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe forcimin e efektivitetit të procesit mbikëqyrës, nëpërmjet inspektimeve të vazhdueshme për çështje që lidhen me parandalimin e pastrimit të parave, me një fokus të veçantë çështjet e financimit të terrorizmit dhe të zbatimit të sanksioneve ndërkombëtare. Inspektimet kanë targetuar si bankat, dhe subjektet financiare jobanka dhe zyrat e këmbimit valutor. Si rezultat i punës së bërë në të gjitha këto drejtime, raporti i fundit i MONEYVAL për vitin 2021 konstaton progresin e bërë nga Banka e Shqipërisë në drejtim të luftës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke vlerësuar si "gjërësisht të adresuara" rekomandimet e lëna mbi rregullat dhe mbikëqyrjen e institucioneve financiare.

Nga ana tjetër, Banka e Shqipërisë ka iniciuar tashmë procesin e ekuivalentimit të kuadrit tonë mbikëqyrës e rregullator me atë të Bashkimit Evropian, duke i hapur rrugën uljes së mëtejshme të kostove të ndërmjetësimit dhe një ambienti më të përshtatshëm për kreditimin në vend. Pas rezultateve mjaft inkurajuese të një vlerësimi të pavarur, të bërë nga një agjenci e specializuar e huaj, ne kemi kërkuar pranë Komisionit Evropian nisjen e procesit formal të ekuivalencës.


Paralelisht me mbikëqyrjen dhe rregullimin e sektorit bankar, Banka e Shqipërisë ka punuar edhe për nxitjen e zhvillimit dhe sofistikimit të tregjeve financiare shqiptare. Në këtë drejtim, gjej me vend të evidentoj punën e bërë për:

- garantimin e sistemeve të pagesave të sigurta dhe eficiente, si dhe zgjerimin e infrastrukturës ekzistuese me një sistem të ri të shlyerjes të pagesave kombëtare në monedhën euro për klientët e bankave. Ky sistem mundëson kryerjen e pagesave në euro brenda vendit, me kosto shumë më të ulëta dhe në një afat kohor shumë më të shkurtër krahasuar me procesin e mëparshëm;
- nxitjen e pagesave elektronike dhe rritjen e përfshirjes financiare të popullsisë. Numri i pagesave elektronike të kryera në vend u rrit ndjeshëm gjatë vitit 2021, i nxitur nga ndryshimet rregullatore në ligjin "Për shërbimet e pagesave" dhe përmirësimet në infrastrukturë; dhe
- përmirësimin e kuadrit rregullator të sistemeve të pagesave në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian. Gjatë vitit 2021 është hartuar projektligji "Për llogarinë e pagesave me shërbime

bazike”, në përputhje me Direktivat e BE-së. Miratimi i tij ofron shërbime financiare bazike për individët e pa mbuluar me shërbime bankare, pavarësisht nivelit të të ardhurave, statusit të punësimit, apo historikut të aftësisë paguese.

Në ilustrim të rezultateve të punës sonë, por dhe të progresit që vetë sektori bankar ka bërë në drejtim të digjitalizimit, përdorimi i instrumenteve elektronike të pagesave u rrit me rreth 30%, vëllimi i pagesave “home banking” u rrit me rreth 25%, ndërsa numri i llogarive të aksesueshme në distancë u rrit me 31% gjatë vitit 2021. Zhvillimet e pagesave elektronike kanë kontribuar në përmbushjen e objektivave sasiore të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël. Përdorimi i pagesave elektronike për frymë arriti në nivelin 12.5 nga 10 pagesa që është objektivi i kësaj strategjie. Gjithashtu, në vitin 2021 rezultoi se rreth 69% e popullsisë në moshë madhore zotëron një llogari pagese, duke iu afruar ndjeshëm objektivit prej 70% të vendosur në strategji.

*Grafik 5. Ecuria e përqindjes së llogarive home-banking ndaj totalit të llogarive, dhe ecuria e raportit të përdorimit të llogarive të aksesueshme nga interneti\**



\*Raporti i përdorimit tregon sa përdoret mesatarisht një llogari me akses nga interneti për kryerje transaksionesh.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahas përmbushjes së rolit të saj primar, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për jetësimin e një sërë detyrash dhe angazhimesh të tjera institucionale, si dhe për respektimin e rekomandimeve të lëna në rezolutën e Kuvendit.

Në mënyrë të përmbledhur, më lejoni të theksoj se në përmbushje të funksionit të saj si emetuese e parasë, Banka e Shqipërisë ka

përmirësuar vazhdimisht cilësinë e monedhës shqiptare. Gjatë vitit 2021, ne përfunduam shtypjen e të gjitha prerjeve të serisë së re të kartëmonedhave, si dhe për herë të parë hodhëm në qarkullim prerjen me vlerë 10,000 Lekë. Ky proces u shoqërua me një fushatë të gjerë edukuese mbi kartëmonedhat shqiptare. Po ashtu, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për përmirësimin e administrimit të rezervës valutore, e cila tashmë mbështetet në një proces të konsoliduar rregullator dhe profesional, ku objektivi kryesor është garantimi i likuiditetit dhe i sigurisë së saj.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka bërë progres të mëtejshëm në:

- përbushjen e detyrimeve institucionale në kuadër të integritimit evropian, ku Banka e Shqipërisë ka një rol kyç në përafrimin e legjisllacionit dhe infrastrukturës institucionale të sistemit financiar me standardet e BE-së;
- rritjen e komunikimit, transparencës dhe llogaridhënies, duke i shërbyer angazhimit tonë për ta kthyer Bankën e Shqipërisë në një institucion të hapur dhe të besueshëm për publikun;
- nxitjen e edukimit financiar, si një element esencial për rritjen e mirëqenies afatgjatë të shoqërisë;
- fushën e kërkimit shkencor, si një parakusht i hartimit të politikave sa më efektive të rritjes e zhvillimit;
- si dhe në proceset e mbledhjes, hartimit dhe raportimit të statistikave, në mbështetje të një vendimmarrjeje sa më efikase, si në sektorin publik dhe në atë privat.

Të gjitha këto ndryshime janë nxitur e mbështetur nga forcimi i qeverisjes së institucionit dhe investimi i vazhdueshëm në ngritjen profesionale të stafit, në mënyrë që të jemi gjithnjë të aftë të përballemi me sfidat e kohës.

Një informacion të gjerë mbi këto çështje do ta gjeni të detajuar në faqet e Raportit.

### ***Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,***

Duke përfituar nga ky komunikim publik, nuk mund të le pa evidentuar edhe sfidën aktuale me të cilën po përballet ekonomia shqiptare, si pasojë e rritjes së çmimeve në tregjet botërore. Kjo goditje nuk ka kursyer asnjë ekonomi, jo vetëm në nivel evropian por dhe në nivel botëror.

Rritja e shpejtë e çmimeve të energjisë, të ushqimeve dhe të produkteve bazë në tregjet botërore, ka shtrenjtuar kostot e jetesës së familjeve dhe ka rritur kostot e prodhimit të bizneseve. Po ashtu, paqartësia mbi kohëzgjatjen dhe pasojat e konfliktit të armatosur, ka shtuar pasigurinë në tregjet financiare dhe ka krijuar pengesa të reja në zinxhirët e furnizimit. Kjo goditje ka filluar të transmetohet edhe në ekonominë shqiptare.

Inflacioni në vend dhe në botë po regjistron nivelet më të larta të dy dekadave të fundit dhe projeksionet aktuale sugjerojnë se pasojat e kësaj goditjeje do të jenë të ndjeshme edhe gjatë vitit në vazhdim.

Banka e Shqipërisë është në monitorim të vazhdueshëm të situatës. Bazuar në informacionin aktual dhe analizat tona, Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia shqiptare ka premisa të mjaftueshme për t'i rezistuar goditjes dhe për të shmangur recesionin.

Në këto rrethana, fokusi i politikave ekonomike duhet të orientohet drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, si një parakusht për stabilitetin financiar të vendit dhe për rritje të qëndrueshme e afatgjatë, dhe në ndihmën ndaj shtresave më në nevojë. Ky fokus do të kërkojë rishikimin në vazhdimësi të përshtatshmërisë së qëndrimit të politikës monetare, si dhe ruajtjen e fleksibilitetit buxhetor për të adresuar kontingjencat e mundshme në drejtim të lehtësimit të kostove sociale, pa dëmtuar qëndrueshmërinë afatgjatë të borxhit publik.

***“Banka e Shqipërisë gjykon se ekonomia shqiptare ka premisa të mjaftueshme për t'i rezistuar goditjes dhe për të shmangur recesionin. Në këto rrethana, fokusi i politikave ekonomike duhet të orientohet drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, si një parakusht për stabilitetin financiar të vendit dhe për rritje të qëndrueshme e afatgjatë, dhe në ndihmën ndaj shtresave më në nevojë.”***

Me tejkalimin e kësaj goditjeje, fokusi ynë duhet të orientohet dhe njëherë drejt ndërmarrjes së reformave të nevojshme strukturore të cilat do të çlirojnë potencialet prodhuese të vendit dhe do të ndihmojnë në rritjen më të shpejtë të mirëqenies së shoqërisë.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, më lejoni të theksoj se Banka e Shqipërisë ka qenë dhe mbetet e angazhuar për respektimin e detyrave të saj ligjore dhe për adresimin e sfidave të zhvillimit të vendit.

***Ju faleminderit!***



# **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO GJATË PREZANTIMIT TË OPINIONIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË PËR PROJEKTBUXHETIN 2023 - 4 nëntor 2022 -**

*I nderuar zoti Kryetar i Komisionit,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj Deputetë,*

Më lejoni, si gjithnjë, ta filloj fjalën time duke ju falënderuar për ftesën për t'u paraqitur para këtij Komisioni dhe për të dhënë opinionin e Bankës së Shqipërisë mbi Projektbuxhetin e vitit 2023.

Banka e Shqipërisë e ka vlerësuar gjithnjë rëndësinë që ka procesi i diskutimeve publike për miratimin e Buxhetit, proces i cili përfshin si aktorë institucionalë ashtu dhe grupe interesi. Ky proces është një instrument i rëndësishëm për hartimin e një buxheti sa më optimal dhe për ndërtimin e një konsensusi sa më të gjerë rreth tij. Në këtë kontekst, si institucion i mandatuar për ruajtjen e stabilitetit monetar dhe financiar të vendit, si dhe në rolin e këshilltarit financiar të qeverisë, dëshiroj të ndaj me ju këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë mbi çështjet kryesore të projektbuxhetit për vitin 2023.

Duke qëndruar brenda kornizave ligjore të mandatit dhe detyrave tona, si dhe duke respektuar fushën tonë të ekspertizës, opinionin në vijim do të përqendrohet në tre tema kryesore.

- Së pari, do të paraqes këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë mbi kahun e politikës fiskale, kah i cili orienton edhe treguesit kryesorë të projektbuxhetit në fushën e deficitit buxhetor, të të ardhurave dhe të shpenzimeve publike.
- Së dyti, do të ndalem në disa aspekte strukturore të buxhetit dhe të politikës tatimore, aspekte të cilat ndikojnë efektivitetin e politikës fiskale dhe fleksibilitetin e financave publike në përballimin e goditjeve.

***“Projektbuxheti i vitit 2023 dhe Relacioni shoqërues i tij shënojnë një hap përpara në drejtim të rritjes së transparencës, si dhe në drejtim të forcimit të kuadrit analitik, për identifikimin e dobësive strukturore të ekonomisë shqiptare dhe vlerësimin e rreziqeve mbi financat publike.”***

- Së treti, do të rendis disa sugjerime të Bankës të Shqipërisë, të cilat synojnë rritjen e qëndrueshmërisë afatgjatë të financave publike.

Përpara se të filloj më në detaje, më lejoni të theksoj se Projektbuxheti i vitit 2023 dhe Relacioni shoqëruar i tij shënojnë një hap përpara në drejtim të rritjes së transparencës, si dhe në drejtim të forcimit të kuadrit analitik, për identifikimin e dobësive strukturore të ekonomisë shqiptare dhe vlerësimin e rreziqeve mbi financat publike. Sa më sipër, ne inkurajojmë vazhdimin e punës në këtë drejtim, duke synuar një integrim gjithnjë e më të mirë të analizës së resurseve financiare në dispozicion dhe të objektivave prioritarë të zhvillimit, për të mundësuar një alokim sa më optimal të fondeve publike në ekonomi.

Në vazhdim, do të ndalem në vlerësimin e kahut të politikës fiskale të propozuar në projektbuxhet.

## 1. KONTEKSTI MAKROEKONOMIK DHE POLITIKA FISKALE

Projektbuxheti i vitit 2023 merr jetë në kushtet e një sfide madhore, sfidë e cila ka prekur si ekonominë botërore dhe atë shqiptare.

Sikundër jeni në dijeni, sulmi ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës dhe sanksionet që e pasuan atë, u shoqëruan me një goditje të paprecedentë oferte. Çmimet e larta të ushqimeve, të naftës, të energjisë dhe të lëndëve të para në tregjet botërore, u pasqyruan në një rritje progresive të inflacionit në Shqipëri, duke shënuar vlerën 8.1% në muajin shtator. Analizat tona sugjerojnë se goditja fillestare nga ambienti i huaj ka filluar të transmetohet në strukturën e kostove të prodhimit në vend dhe në pritjet e operatorëve të brendshëm të ekonomisë për të ardhmen, duke

rrezikuar të përkthehet në një periudhë të gjatë me inflacion të lartë.

***“Banka e Shqipërisë gjykon se zgjerimi dhe forcimi i presioneve inflacioniste përbën rrezikun kryesor për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit. Një nivel i lartë dhe i qëndrueshëm inflacioni dëmton stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit, i cili ka qenë dhe mbetet një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror.”***

Banka e Shqipërisë gjykon se zgjerimi dhe forcimi i presioneve inflacioniste përbën rrezikun kryesor për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit. Një nivel i lartë dhe i qëndrueshëm inflacioni dëmton stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit, i cili ka qenë dhe mbetet një parakusht i domosdoshëm për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror. Paralelisht me


të, një nivel i lartë dhe i qëndrueshëm inflacioni redukton investimet afatgjata, godet disproportionalisht shtresat me të ardhura të pakta të shoqërisë, rrit pasigurinë e bizneseve dhe familjeve, si dhe dëmton kohezionin social.

Për këtë arsye, prioriteti aktual i politikave ekonomike duhet të jetë marrja e masave për garantimin e stabilitetit të çmimeve, në një kohë sa më të shpejtë dhe me një kosto sa më të arsyeshme. Po për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ka filluar normalizimin e qëndrimit të politikës monetare, duke rritur gradualisht normën bazë të interesit dhe duke sinjalizuar vullnetin tonë për vazhdimin e këtij procesi, deri në momentin kur kushtet monetare e financiare do të jenë të përshtatshme për respektimin e objektivit tonë të inflacionit.

Megjithatë, teoria dhe praktika botërore sugjerojnë se efektiviteti i politikave ekonomike është më i madh kur këto politika janë konsistente dhe koherente me njëra-tjetrën. Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë vlerëson pozitivisht angazhimin për konsolidim fiskal, angazhim i cili përbën dhe mesazhin kryesor të projektbuxhetit të vitit 2023. Në një këndvështrim të përgjithshëm, konsolidimi fiskal merr formën e reduktimit të deficitit buxhetor, – nga niveli 3.3% i PBB-së i pritur për vitin 2022 në nivelin 2.6% të PBB-së për vitin 2023, si dhe formën e përmirësimit të balancës primare, – nga një deficit prej 1.3% i PBB-së i pritur për vitin 2022 në një suficit prej 0.2% të PBB-së për vitin 2023.

**Grafik 6.**


*Impulsi fiskal mbeti në territor negativ...*



*Shënime: Ndryshimi i raportit të balancës primare për 12 muaj ndaj PBB-së, nga një vit më parë. Vlerat pozitive të kësaj treguesi tregojnë që politika fiskale ka qenë lehtësuese, ndërsa ato negative politikë fiskale konsoliduese.*

*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë; Iloqaritje të DPM-së.*

*... si pasojë e vlerave të larta të suficitit buxhetor të shënuara përgjatë vitit*



*Shënime: Deficiti buxhetor ndaj PBB-së. Llogaritjet bazohen në flukse tremujore. Vlerat pozitive tregojnë deficit, e ato negative suficit buxhetor.*

*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

Banka e Shqipërisë gjykon se ky konsolidim do të japë efekte pozitive për ekonominë dhe tregjet financiare shqiptare.

- Së pari, ai sinjalizon vullnetin e Qeverisë Shqiptare për ruajtjen e shëndetit afatgjatë të financave publike, duke rritur besueshmërinë e tyre në sytë e investitorëve vendas e të huaj dhe duke kontrolluar kostot afatgjata të financimit të borxhit publik.
- Së dyti, ky konsolidim fiskal redukton nevojat për huamarrje të sektorit publik në tregun e brendshëm financiar, duke lehtësuar kostot e financimit të sektorit privat.
- Së treti, ai redukton nevojën për normalizim të shpejtë e të fortë të qëndrimit të politikës monetare, duke ofruar një ndarje më të mirë të barrës së axhustimit me realitetin e ri, midis sektorit publik e atij privat.

Sa më sipër, në prizmin e sfidave që kemi përpara, Banka e Shqipërisë gjykon se konsolidimi fiskal dhe normalizimi i qëndrimit të politikës monetare përbën kombinimin më të mirë të mundshëm të politikave ekonomike. Ky kombinim mundëson kthimin e inflacionit në objektiv brenda gjysmës së parë të vitit 2024, si dhe nuk cenon premiset e rritjes ekonomike.

***“Banka e Shqipërisë gjykon se konsolidimi fiskal dhe normalizimi i qëndrimit të politikës monetare përbën kombinimin më të mirë të mundshëm të politikave ekonomike. Ky kombinim mundëson kthimin e inflacionit në objektiv brenda gjysmës së parë të vitit 2024, si dhe nuk cenon premiset e rritjes ekonomike.”***

Projeksionet tona sugjerojnë se rritja ekonomike e vendit do të mbetet në territor pozitiv edhe gjatë viteve të ardhshme. Ndonëse ambienti i huaj mbetet sfidues dhe rritja ekonomike në vend pritet të vijë në ngadalësim në afatin e shkurtër, reduktimi i inflacionit, rënia e pasigurisë dhe stabilizimi i kushteve financiare, do të mundësojnë një përshpejtim të ritmit të rritjes në afatin e mesëm e të gjatë. Rritja e ekonomisë shqiptare pritet të mbështetet

nga kërkesa e brendshme për mallra e shërbime, nga bilancet e shëndosha financiare të sektorit privat, nga ruajtja e ritmeve pozitive të kredisë bankare, si dhe nga vijimi i trendit rritës së të ardhurave nga turizmi.

Bazuar në sa më sipër, Banka e Shqipërisë gjykon se kuadri makroekonomik i parashikuar në projektbuxhet është realist dhe

konsistent, si me trendet aktuale të zhvillimit të vendit ashtu edhe me kahun e pritur të politikave monetare e fiskale.

Megjithatë, nisur nga rëndësia që ka konsolidimi fiskal, si dhe në prani të pasigurive të shtuara në parashikim, Banka e Shqipërisë gjykon se ky proces duhet të ketë vëmendje të vazhdueshme dhe të mbrohet nga skenarët e rrezikut.

Në një këndvështrim më të detajuar, Banka e Shqipërisë konstaton se konsolidimi fiskal i vitit 2023 bazohet në:

- rritjen e peshës së të ardhurave tatimore ndaj PBB-së;
- rritjen e moderuar të peshës së shpenzimeve për personelin, për fondet speciale dhe për buxhetin lokal, ndaj PBB-së;
- alokimin e fondeve shtesë për mbulimin e shpenzimeve për interesa;
- ruajtjen e pandryshuar të peshës së investimeve publike ndaj PBB-së; si dhe,
- reduktimin e subvencioneve për sektorin e energjisë.

Në kahun e të ardhurave, projektbuxheti i vitit 2023 parashikon të ardhura buxhetore në nivelin e 632 miliardë lekëve, ose 29% të PBB-së, me rritje rreth 9% kundrejt nivelit të pritur për vitin 2022. Ky parashikim faktorizon rritjen e pritur të vëllimit të aktivitetit ekonomik në vend, masat e reja fiskale, si dhe përfitimet që priten të vijnë nga përmirësimi i eficiencës së administratës tatimore dhe doganore. Më konkretisht, rritja e vëllimit nominal të aktivitetit ekonomik pritet të sjellë rreth 22 miliardë lekë të ardhura shtesë në buxhet, masat e reja fiskale pritet të sjellin rreth 15 miliardë lekë, ndërsa përmirësimi i eficiencës pritet të sjellë rreth 8 miliardë lekë. Banka e Shqipërisë gjykon se projeksioni qendror i të ardhurave totale është i pranueshëm, ndonëse ai mbetet në kahun e sipërm të pritjeve tona.

Në kahun e shpenzimeve, projektbuxheti i vitit 2023 parashikon shpenzime publike në nivelin e 687 miliardë lekëve, ose 31.6% të PBB-së. Ky parashikim faktorizon rritjen e pagave e të pensioneve, rritjen e kostos së shërbimit të borxhit, ruajtjen e një ritmi të lartë shpenzimesh kapitale dhe reduktimin e ndjeshëm të subvencioneve për sektorin e energjisë, në dukje të bazuar në përmirësimin e pritur të prodhimit vendas dhe reduktimin e çmimeve në tregun ndërkombëtar.

Në parim, Banka e Shqipërisë mbështet një proces konsolidimi të udhëhequr nga rritja e të ardhurave buxhetore. Ky aksion, i bazuar në

reduktimin e vazhdueshëm të informalitetit dhe reduktimin e përjashtimeve tatimore, nxit konkurrencën dhe eficiencën në ekonomi. Po ashtu, ai ruan hapësirat për shpenzime publike, aq të nevojshme për një vend në zhvillim dhe proces konvergjence me standardet e Bashkimit Evropian si Shqipëria. Në të njëjtën kohë, ne mbështesim një rritje të kontrolluar të shpenzimeve korrente në afatin e shkurtër, për të adresuar – në mënyrë të targetuar – goditjen që inflacioni sjell mbi shtresat më të varfra të shoqërisë.

Megjithatë, Banka e Shqipërisë konstaton se balanca e rreziqeve në Buxhet qëndron në kahun e zgjerimit të deficitit. Këto rreziqe burojnë nga rreziqet e kahut të poshtëm mbi rritjen ekonomike dhe realizimin e nivelit të parashikuar të të ardhurave, si dhe nga pasiguritë në parashikim që sjell shkalla e përmirësimit të eficiencës tatimore dhe shkalla e përmirësimit të balanceve të sektorit energjetik.

Për të adresuar këto rreziqe, Banka e Shqipërisë sugjeron:

- shtimin e fondeve të kontingjencës në buxhet, duke synuar rritjen e eficiencës operacionale dhe zbatimin prioritar të planit të shpenzimeve;
- monitorimin në vazhdimësi të ecurisë së bilancit financiar të sektorit energjetik shqiptar dhe ndërhyrjen në kohë për të shmangur kostot potenciale që mund të vijnë nga çmimet e larta në tregjet e huaja apo situata e prodhimit të brendshëm;
- monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së të ardhurave dhe të planit të investimeve publike, për të marrë në kohë masa, të cilat synojnë kontrollin e deficitit buxhetor në vlerat e programuara.

Të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë, më lejoni tani të kaloj në pikën e dytë të opinionionit tonë.

## **2. MBI RITJEN E EFEKTIVITETIT DHE RUAJTJEN E FLEKSIBILITETIT TË FINANCEVE PUBLIKE**

Efektiviteti dhe fleksibiliteti i politikës fiskale janë dy tipare mjaft të dëshirueshme të financave publike.

Efektiviteti i politikës fiskale nënkupton vendosjen e një balance të drejtë midis funksionit të saj rishpërndarës, pra instrumenteve fiskale, të cilat zbutin pabarazinë sociale dhe mbrojnë shtresat në nevojë,

dhe funksionit të saj si nxitës i zhvillimit ekonomik. Fleksibiliteti i financave publike nënkupton aftësinë e tyre për të përballuar goditje të paparashikuara, pa shkaktuar rritje drastike taksash apo shkurtime masive shpenzimesh.

Në këtë këndvështrim, një rëndësi primare merr si kuadri tatimor ashtu edhe struktura e shpenzimeve të buxhetit dhe ritmi i realizimit të tyre gjatë vitit.

**“...ne mbështesim përpjekjet e qeverisë për rritjen e formalizimit, duke vlerësuar se përfitimet afatgjata të këtij procesi i tejkalojnë kostot afatshkurtra. Në të njëjtën kohë, ne inkurajojmë përshejtimin e hapave për adoptimin e një strategjie afatmesme të të ardhurave publike.”**

Në drejtim të kuadrit tatimor, Banka e Shqipërisë ka theksuar në vazhdimësi nevojën e rritjes së qëndrueshmërisë dhe parashikueshmërisë së tij. Paralelisht me të, thjeshtimi e standardizimi i kuadrit tatimor, si dhe reduktimi i informalitetit, do të ndihmonin rritjen e përgjithshme të efektivitetit të financave publike.

Nisur nga sa më sipër, ne mbështesim përpjekjet e qeverisë për rritjen e formalizimit, duke vlerësuar se përfitimet afatgjata të këtij procesi i tejkalojnë kostot afatshkurtra. Në të njëjtën kohë, ne inkurajojmë përshejtimin e hapave për adoptimin e një strategjie afatmesme të të ardhurave publike. Kjo strategji duhet të shërbejë si ankorë dhe udhërrëfyes i sistemit tonë tatimor, duke rivlerësuar prioritetet dhe instrumentet e këtij sistemi dhe duke rritur parashikueshmërinë e tij në afatin e mesëm dhe të gjatë.


Në një aspekt më të veçantë, Banka e Shqipërisë kërkon rishikimin e një ndryshimi të propozuar në projektligjin “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, ndryshim i cili synon të revokojë përmirësimet e bëra në legjisllacionin tatimor për trajtimin kontabël të kredive të humbura dhe për përfshirjen e tyre në listën e shpenzimeve të zbritshme. Këto përmirësime ishin një element i rëndësishëm i Strategjisë Kombëtare për Reduktimin e Kredive me Probleme, strategji e cila u miratua nga Qeveria Shqiptare dhe Banka e Shqipërisë në vitin 2015. Kjo strategji ishte thelbësore për reduktimin e ndjeshëm të nivelit të kredive me probleme në sektorin bankar dhe për ruajtjen e këtyre kredive në nivele të ulëta në të ardhmen.

Në drejtim të strukturës së shpenzimeve, Banka e Shqipërisë gjykon se ruajtja e një raporti të drejtë midis shpenzimeve korrente dhe atyre kapitale është esenciale për efektivitetin dhe fleksibilitetin e financave publike. Më konkretisht, për vende në zhvillim si Shqipëria, nevoja për investime kapitale është e evidente për të përmirësuar stokun e kapitalit

fizik që mbështet zhvillimin e vendit dhe procesin e konvergjencës së tij me standardet e Bashkimit Evropian. Po ashtu, ruajtja e një balance korrente pozitive rrit fleksibilitetin në përballimin e goditjeve, për sa kohë investimet publike kanë një shkallë më të lartë diskrecionariteti në realizimin e tyre krahasuar me shpenzimet korrente.


**Grafik 7.**

*Realizimi i shpenzimeve ishte disi më i lartë se në gjysmën e parë të vitit*



*Shënime: Kompozimi i rritjes së shpenzimeve sipas tremujorëve.  
Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

*Investimet vijojnë të mbeten më të ulëta nga një vit më parë*



*Shënime: Rritja vjetore, në %, e zërave kryesorë të shpenzimeve, sipas tremujorëve.  
Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

Sa më sipër, ne gjykojmë se një nga aspektet pozitive të financave publike shqiptare është niveli i lartë i investimeve dhe bilanci korrent strukturor pozitiv i tyre. Më konkretisht, shpenzimet kapitale të pesë viteve të fundit kanë qëndruar në nivelin mesatar prej 5.5% të PBB-së, duke përbërë mesatarisht 18% të shpenzimeve të përgjithshme publike. Po kështu, këto shpenzime kanë qenë mesatarisht 50% më të larta se deficitit buxhetor, duke treguar një nivel relativisht të lartë përgjegjshmërie fiskale në këtë drejtim.

Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë gjen me vend të theksojë rëndësinë e ruajtjes së hapësirave aktuale për investime publike në strukturën e Buxheitit. Kjo kërkon vëmendje në drejtim të kontrollit të shpenzimeve korrente në afatin e mesëm e të gjatë, nëpërmjet rritjes së tyre në linjë me përmirësimet strukturore në bazën e të ardhurave publike dhe në luftën ndaj informalitetit.

Duke qëndruar përsëri në çështjen e efektivitetit, Banka e Shqipërisë vazhdon të përsërisë thirrjen për një shpërndarje më të mirë kohore të shpenzimeve gjatë vitit dhe uljen e përqendrimit të tyre në tremujorin e



katërt. Ky fenomen, i përsëritur dhe i diktuar në masën më të madhe nga ritmi jo i njëtrajtshëm i realizimit të investimeve, krijon luhajtje të panevojshme në tregun e brendshëm financiar dhe redukton efektivitetin e shpenzimeve publike.

Të nderuar zonja dhe zotërinj, më lejoni tani të kaloj shkurtimisht në pikën e tretë e të fundit.

### **3. MBI RRIJTEN E QËNDRUESHMËRISË AFATGJATË TË FINANCAVE PUBLIKE**

Qëndrueshmëria afatgjatë e financave publike është – në një këndvështrim specifik – tipari kryesor i vlerësimit të politikës fiskale. Kjo qëndrueshmëri shërben si garanci finale për stabilitetin ekonomik e financiar të vendit, ajo dikton primet e rrezikut të ekonomisë dhe ndikon kostot e financimit të sektorit publik e privat.

Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë e vlerëson pozitivisht reduktimin e parashikuar të borxhit publik në projektbuxhetin e vitit të ardhshëm, nga niveli 68.8% i PBB-së i pritur për vitin 2022, në nivelin 67.5% të PBB-së për vitin 2023. Gjithashtu, ne vlerësojmë pozitivisht adoptimin e një dispozite shtesë në Ligjin Organik të Buxhetit, dispozitë e cila kërkon ruajtjen e një balance primare pozitive në çdo vit fiskal, si garanci për reduktimin e qëndrueshëm të borxhit publik.

Paralelisht me të, në interes të ruajtjes dhe konsolidimit të qëndrueshmërisë së financave publike, Banka e Shqipërisë gjen me vend të përsërisë dhe sugjerimet e rekomandimet e mëposhtme.

#### ***Mbi deficitet e krijuara nga skema e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore***

Projektbuxheti i vitit 2023 parashikon se shpenzimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore përbëjnë afërsisht 1/3 e shpenzimeve të buxhetit. Po ashtu, deficitet e këtyre skemave priten rreth nivelit 4.2% të PBB-së, duke qenë rreth 60% më të lartë se deficitet e përgjithshëm buxhetor.

Skemat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore vijojnë të përbëjnë një barrë të ndjeshme për financat e shtetit. Në këtë kontekst, duke pasur parasysh dhe trendet e pafavorshme demografike, Banka e Shqipërisë

sugjeron rishikimin periodik të skemës së pensioneve, atë të sigurimeve shëndetësore dhe skemat e tjera të sigurimeve sociale, me synim ruajtjen e këtyre skemave në trajektore të qëndrueshme dhe të përballeshme për buxhetin e shtetit.

### ***Mbi administrimin e Programeve të Partneritetit Publik - Privat***

Programet e partneritetit Publik – Privat (PPP) mbartin rreziqe potenciale për financat publike. Në këtë kontekst, Banka e Shqipërisë mirëpret rritjen e vëmendjes në projektbuxhet ndaj rreziqeve potenciale që mund të vijnë nga PPP-të. Po ashtu, ne mirëpresim fuqizimin e rolit të

Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në shqyrtimin paraprak të këtyre projekteve dhe monitorimin e vazhdueshëm të tyre.

***“Banka e Shqipërisë sugjeron përfshirjen e tavaneve ligjore afatgjata mbi vlerën e përgjithshme të kontraktuar të PPP-ve. Ky rregullim do të ishte një element plotësues i kontrollit të nivelit të rrezikut potencial që PPP-të mund të kenë mbi shëndetin e financave publike.”***

Megjithatë, në linjë dhe me qëndrimet tona të mëparshme, Banka e Shqipërisë sugjeron:

- përfshirjen e tavaneve ligjore afatgjata mbi vlerën e përgjithshme të kontraktuar të PPP-ve. Ky rregullim do të ishte një element plotësues i kontrollit të nivelit të rrezikut potencial që PPP-të mund të kenë mbi shëndetin e financave publike;
- integrimin e procesit të kontraktimit dhe përzgjedhjes së PPP-ve me programin strategjik të investimeve, sikundër janë identifikuar në programet afatgjata të zhvillimit të vendit;
- së fundi, përmirësimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të njësive që administrojnë vlerësimin, kontraktimin dhe monitorimin e këtyre projekteve, sidomos sa i takon detyrimeve ligjore dhe financiare që ato i ngarkojnë Buxhetit.

***I nderuar zoti Kryetar i Komisionit,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj,  
Ju faleminderit për vëmendjen!***





---

# KAPITULLI III

## KONFERENCA PËR SHTYP PËR VENDIMMARRJEN E POLITIKËS MONETARE

---

- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare, 2 shkurt 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare, 23 mars 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare, 4 maj 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare, 6 korrik 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare, 3 gusht 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare, 5 tetor 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare, 2 nëntor 2022*
- *Fjala e Guvernatorit Sejko në konferencën për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare, 21 dhjetor 2022*

### **Konferencat për shtyp për vendimarrjen e politikës monetare**

*Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë zhvillon 15 mbledhje në vit, nga të cilat 8 i dedikohen vendimarrjes së politikës monetare. Politika monetare hartohet në funksion të objektivit kryesor të Bankës së Shqipërisë - arritjes dhe ruajtjes së stabilitetit të çmimeve. Pas çdo mbledhjeje, në orën 16:00, Guvernatori i shpjegon publikut në prani të medias në një konferencë për shtyp vendimin e marrë nga Këshilli Mbikëqyrës mbi qëndrimin e politikës monetare dhe analizën e përdorur në mbështetje të këtij vendimi. Në fund të konferencës, Guvernatori i përgjigjet edhe pyetjeve të ngritura nga gazetarët pjesëmarrës.*



## **BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 0.5% -2 shkurt 2022-**

- *Aktiviteti ekonomik është zgjeruar me ritme të shpejta dhe të qëndrueshme.*
- *Inflacioni u përshpejtua në tremujorin e katërt.*
- *Parashikimet për të ardhmen janë pozitive.*
- *Kthimi i qëndrueshëm i inflacionit në objektivin 3% parashikohet brenda vitit 2023.*


*Të nderuar përfaqësues të medias,*

Sot, në datën 2 shkurt 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i marrë në analizë tregoi zgjerimin e shpejtë e të qëndrueshëm të aktivitetit të brendshëm ekonomik gjatë gjysmës së dytë të vitit të kaluar dhe përshpejtimin e inflacionit në tremujorin e katërt. Rritja e inflacionit është shkaktuar si nga faktorë të qëndrueshëm, të lidhur me rritjen progresive të kërkesës, të punësimit dhe të pagave, ashtu edhe nga faktorë tranzitorë, të lidhur me rritjen e shpejtë të çmimeve në tregjet ndërkombëtare.

Projeksionet tona sugjerojnë rritje të mëtjshme të ekonomisë në vitet në vazhdim. Norma e inflacionit pritet të mbetet mbi objektivin tonë prej 3% gjatë vitit aktual, si pasojë e çmimeve të larta në tregjet ndërkombëtare. Këto goditje kanë rezultuar më të forta dhe të qëndrueshme se vlerësimet tona fillestare. Megjithatë, ndikimi i tyre në inflacion pritet të vijë drejt shuarjes graduale gjatë vitit 2022. Më tej, inflacioni pritet të kthehet në mënyrë të qëndrueshme në objektiv gjatë vitit 2023, në pasqyrim të balancimit të kërkesës me ofertën dhe të rritjes së punësimit dhe pagave në linjë me produktivitetin.

Grafik 8. Norma bazë e interesit, shkurt 2022



Burimi: INSTAT, llogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Në këtë kontekst, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare mbetet i përshtatshëm. Në gjykimin e Këshillit, niveli aktual i stimulit monetar i shërben respektimit të objektivit tonë të inflacionit, ndihmon rimëkëmbjen e mëtejshme të ekonomisë shqiptare, si dhe ruan një balancë të drejtë midis rreziqeve që çmimet e larta në tregjet ndërkombëtare mund të kenë mbi nivelin e çmimeve dhe aktivitetit ekonomik në vend.

Në vijim, më lejoni të sqaroj më në detaje konkluzionet kryesore të Raportit Tremujor, pritjet tona për të ardhmen, si dhe arsyet që motivuan vendimin e sotëm.


Informacioni i ri i muajve të fundit ka qenë përgjithësisht në përputhje me pritjet tona, ndonëse goditjet e ofertës po provohen të jenë më të forta dhe më të qëndrueshme se vlerësimet fillestare.

Në nivel global, rimëkëmbja e ekonomive nga goditja e pandemisë është e fortë, por e pabarabartë midis vendeve. Po ashtu, ajo vazhdon të karakterizohet nga probleme në zinxhirët e furnizimit dhe mungesa në fuqinë punëtore. Kërkesa e fortë për mallra e shërbime, kufizimet në ofertë dhe çmimet e larta të energjisë elektrike kanë shtyrë lart inflacionin global. Në këtë kontekst, perspektiva e politikës monetare globale është drejt normalizimit, çka është reflektuar edhe në sjelljen e tregjeve financiare ndërkombëtare.




Grafik 9.

*Norma e inflacionit tejkaloi objektivin e Bankës së Shqipërisë në tremujorin e katërt*



Burimi: INSTAT, Ilogaritje të Bankës së Shqipërisë.

*Ecuria e tij pasqyroj inflacionin e rritur të çmimeve të artikujve ushqimorë dhe të mallrave energjettike*



Burimi: INSTAT, Ilogaritje të Bankës së Shqipërisë.

Inflacioni në vend shënoi një rritje të shpejtë gjatë tremujorit të katërt, duke arritur vlerën 3.7% në muajin dhjetor. Inflacioni është i pranishëm në çmimet e thuajse të gjithë artikujve të shportës së konsumit, çmimet e të cilëve përcaktohen lirisht në treg. Megjithatë, përsheptimi i tij në tremujorin e katërt u diktua nga rritja e çmimeve të ushqimeve të përpunuara dhe të naftës.


Në terma makroekonomikë, rritja e shpejtë e inflacionit në tremujorin e katërt pasqyroj si veprimin gradual e të qëndrueshëm të faktorëve të kërkesës, ashtu dhe ndikimin e fortë – por tranzitor – të goditjeve të ofertës. Nga njëra anë, rritja e vazhduar e kërkesës për mallra e shërbime, është shoqëruar me rritje të punësimit dhe të pagave, si dhe forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Kjo ecuri është pasqyruar në trendin rritës të inflacionit bazë gjatë vitit 2021. Nga ana tjetër, rritja e fortë e çmimeve të ushqimeve, të lëndëve energjetike, të kostove të transportit dhe të mallrave bazë në tregjet botërore, ka pasur një ndikim të konsiderueshëm në rritjen e inflacionit në tremujorin e katërt.

Aktiviteti i brendshëm ekonomik po zgjerohet me ritme relativisht solide. Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 10.4% gjatë tre tremujorëve të parë të vitit. Informacioni i disponuar sinjalizon një zgjerim të mëtejshëm të saj në tremujorin e katërt. Analizat tona tregojnë se vëllimi i aktivitetit ekonomik në vend ka kaluar tashmë nivelin e tij të para-tërmetit e para-pandemisë, si në nivel agregat dhe në nivel sektorial, duke ilustruar rimëkëmbjen e shpejtë të kërkesës dhe ndikimin


e pakët strukturor që këto goditje kanë lënë në strukturën prodhuese të ekonomisë. Në tërësi, bilanci e sektorit privat mbeten të shëndetshme, sikundër ilustron nga rritja e depozitave dhe rënia e kredive me probleme, ndërsa ecuria e besimit të biznesit është konsistente me një zgjerim të mëtejshëm të prodhimit.

**Grafik 10.**

*Rritja ekonomike është ngadalësuar krahasuar me tremujorin e mëparshëm, ndikuar edhe nga efekti më i zbutur bazë* *Të gjithë sektorët kanë tejkaluar nivelet e vlerës së shtuar të parapandemisë*



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.



Shënim: Vlera e shtuar e sektorëve të ekonomisë, e rregulluar sezonalisht, dhe e kthyer në indeks me bazë tremujorin e tretë 2019. Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rimëkëmbja e kërkesës agregate pasqyroi reduktimin e kufizimeve, përmirësimin e besimit, përmirësimin e ekonomive partnere dhe mbështetjen e vazhduar me politika ekonomike stimuluese. Profili i rritjes evidenton zgjerimin e konsumit dhe investimeve private, të shpenzimeve publike dhe të eksporteve neto. Në veçanti, rritja e shpejtë e eksporteve në tremujorin e tretë të vitit 2021 u diktua nga përmirësimi i aktivitetit të turizmit.

Rritja e ekonomisë ka sjellë përmirësimin e treguesve të tregut të punës. Si punësimi dhe shkalla e pjesëmarrjes në forcën e aftë për punë kanë ardhur në rritje, ndërkohë që norma e papunësisë zbriti në 11.3% në tremujorin e tretë. Paralelisht me to, paga mesatare u rrit me 6.9% në nivel ekonomie dhe me rreth 8% për sektorin privat.


Stimuli monetar e fiskal ka dhënë një mbështetje të rëndësishme në procesin e rimëkëmbjes, si në terma të rritjes ekonomike ashtu dhe në ruajtjen e stabilitetit monetar e financiar.

Politika monetare stimuluese ka kontribuar nëpërmjet uljes së kostos së huamarrjes dhe rritjes së kreditimit në ekonomi. Normat e interesit të

kredisë për bizneset dhe individët kanë mbetur në nivele të ulëta dhe kursi i këmbimit të lekut ndaj valutave kryesore ka qenë i qëndrueshëm.


**Grafik 11.**

*Kredia për sektorin privat ka shënuar rritje të lartë në tremujorin e katërt*



*Shënime: Të dhënat përfaqësojnë ndryshimet vjetore (%) të kredisë sipas monedhës.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

*Rritja e kredisë në tremujorin e katërt është mbështetur njësoj si nga kreditimi i individëve dhe bizneseve*



*Shënime: Të dhënat përfaqësojnë ndryshimet vjetore në kredisë për sektorin privat sipas qëllimit të përdorimit.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.*


Kushtet e favorshme financiare, rritja e kërkesës dhe përmirësimi i kushteve jofinanciare të ofertës kanë nxitur zgjerimin e portofolit të kredisë për sektorin privat. Ky portofol shënoi një rritje mesatare rreth nivelit 9.9% gjatë tremujorit të katërt, çka përbën dhe vlerën më të lartë të këtij treguesi prej vitit 2011. Kredia bankare i ka shërbyer financimit të konsumit e të investimeve dhe mbulimit të nevojave për likuiditet, si të bizneseve dhe të familjeve. Kredia në lekë ka mbajtur ritme relativisht të larta rritjeje, duke pasqyruar efektivitetin e politikës monetare dhe duke zbutur rreziqet e kursit të këmbimit në stabilitetin financiar.

Trendet aktuale dhe faktorët mbështetës të kredisë sugjerojnë një ecuri të mirë të saj edhe në të ardhmen. Këto pritje mbështeten nga kërkesa e lartë, bilancet e shëndosha të sektorit bankar, kushtet e lehtësuara të kreditimit dhe, në veçanti, ulja e rrezikut të kreditit, sikundër ilustron nga rënia e mëtejshme – në nivelin 5.65% – e raportit të kredive me probleme në fund të dhjetorit 2021.

Politika fiskale ka dhënë një kontribut pozitiv në rritjen e kërkesës agregate gjatë vitit 2021, nëpërmjet rritjes së investimeve dhe konsumit publik. Megjithatë, stimuli fiskal ka ardhur në zbehje gjatë tremujorit të katërt, në pasqyrim të ngadalësimit të shpenzimeve dhe të rritjes së shpejtë të të ardhurave buxhetore.

Grafik 12.


*Impulsi fiskal mbeti në terren negativ...*



*Shënime: Ndryshimi i raportit të deficitit primar për 12 muaj ndaj PBB-së, nga një vit më parë. Vlerat pozitive tregojnë se politika fiskale ka gjeneruar impuls të shtuar në ekonomi.*

*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe llogaritje të DPM-së.*

*... si pasojë e një deficiti më të ulët krahasuar me një vit më parë*



*Shënime: Deficiti buxhetor ndaj PBB-së. Llogaritjet bazohen në flukse tregumjore. Vlerat pozitive tregojnë deficit e ato negative sufitit buxhetor.*

*Burimi: Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*

Stimuli fiskal pritet të reduktohet gjatë viteve në vijim. Buxheti i vitit 2022 sugjeron se politika fiskale ka marrë një kthesë drejt normalizimit në vitin 2022, ndërkohë që ritmi i konsolidimit të financave publike pritet të përshpejtohet në vitet në vijim. Banka e Shqipërisë gjykon se rritja e qëndrueshmërisë së rimëkëmbjes ekonomike e bën të domosdoshëm kthimin e vëmendjes drejt reduktimit të borxhit publik. Ky kurs ndihmon sekuencimin e duhur të procesit të normalizimit të politikave ekonomike dhe rrit qëndrueshmërinë fiskale në afatin e gjatë.

Projeksionet tona për të ardhmen mbeten pozitive. Ekonomia shqiptare parashikohet të ndjekë një trajektore rritëse gjatë viteve në vijim. Rritja e aktivitetit pritet të mbështetet si nga kërkesa e brendshme dhe nga ajo e huaj, duke pasqyruar kushtet e favorshme të financimit, përmirësimin e besimit dhe të balanceve të sektorit privat, si dhe rritjen e kërkesës në ekonomitë partnere. Përkundrejt niveleve të larta të vitit 2021, normat e rritjes ekonomike pritet të vijnë në reduktim gjatë vitit 2022 e në vazhdim. Megjithatë, zgjerimi i kërkesës pritet të jetë i mjaftueshëm për të siguruar rritje të punësimit në linjë me ofertën e tregut dhe rritje të pagave në linjë me objektivin tonë të inflacionit. Po ashtu, Banka e Shqipërisë vlerëson se zgjerimi i kërkesës për mallra e shërbime do të mundësojë rritjen e pothuajse të gjithë sektorëve të ekonomisë, ndonëse disa prej tyre do të përballen me kosto të rritura për produktet bazë dhe ato energjetike.

Inflacioni pritet të qëndrojë mbi objektivin tonë gjatë vitit 2022, në pasqyrim të goditjes që vjen nga çmimet e rritura në tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, kjo goditje pritet të ketë efekte të përkohshme. Analizat tona dhe të institucioneve ndërkombëtare sugjerojnë se tregjet do të normalizohen gjatë gjashtëmuorit të parë të këtij viti dhe se efekti i goditjeve të huaja në inflacionin shqiptar do të vijë në rënie.

Inflacioni parashikohet të kthehet në mënyrë të qëndrueshme në objektivin 3%, duke filluar nga viti 2023. Kthimi dhe stabilizimi i inflacionit rreth objektivit do të mbështetet nga reduktimi i goditjeve të ofertës dhe nga balancimi i mirë i kërkesës dhe ofertës në ekonominë shqiptare.

Megjithatë, balanca e rreziqeve rreth inflacionit mbetet e zhvendosur për lart. Rreziqet e kahut të sipërm burojnë kryesisht nga mundësia e një rritjeje më të shpejtë apo më të gjatë në kohë të çmimeve në tregjet ndërkombëtare, një trupëzim i tyre tek pritjet inflacioniste, si dhe një ritëm më i ngadaltë i konsolidimit fiskal. Rreziqet e kahut të poshtëm lidhen me një ndikim të mundshëm negativ të pandemisë në aktivitetin ekonomik.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm për mbështetjen e ekonomisë dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2023.

Për këtë arsye, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të lërë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 0.5%;
- të lërë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe të kredive njëditore, respektivisht në nivelet 0.1% dhe 0.9%.

Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se materializimi i skenarit bazë – ai i konsolidimit të mëtejshëm të rimëkëmbjes, i vijimit të rritjes graduale të presioneve të brendshme inflacioniste dhe i frenimit të goditjeve të ofertës – do të kërkojë normalizimin gradual të politikës monetare gjatë vitit 2022. Ky normalizim pritet të fillojë në muajt në vijim dhe të vijojë në mënyrë graduale gjatë horizontit afatmesëm. Nëpërmjet tij, Banka e Shqipërisë do të synojë respektimin e objektivit tonë të inflacionit dhe do të krijojë premisa për një rritje më të qëndrueshme ekonomike në afatin e mesëm e të gjatë.

Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se materializimi i skenarëve të rrezikut do të kërkojë një rishikim të qëndrimit të politikës monetare, në

formën e përshejtimit të procesit të normalizimit të politikës monetare apo të shtyrjes në kohë të tij.

Në çdo rast, Këshilli Mbikëqyrës vëren se qëndrimi i politikës monetare do të jetë tërësisht në linjë me respektimin e objektivit tonë të inflacionit në afatin e mesëm dhe do të ofrojë mbështetjen e duhur për konsolidimin e rimëkëmbjes ekonomike.

***“Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se materializimi i skenarit bazë – ai i konsolidimit të mëtejshëm të rimëkëmbjes, i vijimit të rritjes graduale të presioneve të brendshme inflacioniste dhe i frenimit të goditjeve të ofertës – do të kërkojë normalizimin gradual të politikës monetare gjatë vitit 2022. Ky normalizim pritet të fillojë në muajt në vijim dhe të vijojë në mënyrë graduale gjatë horizontit afatmesëm.”***

## **BANKA E SHQIPËRISË RRIËT NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 1.0% -23 mars 2022-**

- *Ekonomia botërore po përballlet dhe do të vijojë të përballlet me çmime të larta të ushqimeve, të lëndëve të para dhe të produkteve bazë.*
- *Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi rritje në tremujorin e parë.*
- *Përkundrejt kësaj situatë, ekonomia shqiptare ka shfaqur shenja të qarta rimëkëmbjeje.*
- *Politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë ka gjeneruar tregje financiare të stabilizuara, norma të ulëta interesi dhe kushte të favorshme financimi.*

### *Të nderuar përfaqësues të medias,*

Sot, në datën 23 mars 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.

Diskutimet e Këshillit u përqendruan në ndikimin që do të ketë në ekonominë shqiptare sulmi ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës. Sanksionet e vëna ndaj Rusisë dhe rritja e volatilitetit dhe e pasigurisë në tregjet ndërkombëtare kanë gjeneruar një realitet ekonomik të ri dhe sfidues. Ky realitet dikton rishikimin e projeksioneve tona të mëparshme dhe rivlerësimin e përshtatshmërisë së qëndrimit të politikës monetare.

Tensioni gjeopolitik do të japë një goditje të dyfishtë - direkte nga kahu i ofertës dhe indirekte nga kahu i kërkesës – mbi ekonominë shqiptare. Megjithatë, bazuar në analizat dhe projeksionet aktuale, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet gjatë vitit 2022 e në vazhdim. Ky gjykim mbështetet në gjerësinë dhe fortësinë e burimeve të rritjes, në supozimin e mospërshkallëzimit të mëtejshëm të konfliktit, si dhe atë të vijimit të një miksi stimulues politikash monetare e fiskale. Nga ana tjetër, Këshilli Mbikëqyrës vlerëson se inflacioni do të qëndrojë mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë gjatë pjesës më të madhe të dy viteve në vijim.

*Grafik 13. Norma bazë e interesit, mars 2022*



*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të përshtatë nivelin e stimullit monetar në ekonomi. Kjo përshtatje synon të krijojë kushtet e nevojshme monetare për respektimin e objektivit tonë të inflacionit, për ruajtjen e stabilitetit financiar, si dhe për rritjen e qëndrueshme dhe aftatgjatë të ekonomisë dhe të punësimit në Shqipëri.

Në vijim, më lejoni të sqaroj më në detaje konkluzionet kryesore të Raportit, pritjet tona për të ardhmen, si dhe arsyet që motivuan vendimin e sotëm.

Informacioni i ri i disponuar sugjeron se ekonomia botërore po përballet dhe do të vijojë të përballet me çmime të larta të ushqimeve, të lëndëve të para dhe të produkteve bazë. Këto goditje do të transmetohen edhe në Shqipëri.

Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi rritje në tremujorin e parë. Sipas të dhënave të INSTAT-it, ky inflacion regjistroi nivelet 3.7% dhe 3.9%, respektivisht në muajt janar dhe shkurt. Ndonëse të dhënat e plota zyrtare mungojnë, informacioni i disponuar tregon një rritje të mëtejshme të çmimeve në muajin mars.


Ecuria e inflacionit në Shqipëri është ndikuar nga rritja e çmimeve të artikujve ushqimorë, të naftës dhe të kostove të prodhimit e të transportit. Në terma makroekonomikë, trendi rritës i inflacionit pasqyron rritjen



e shpejtë dhe të qëndrueshme të kërkesës, rritjen e pagave dhe të punësimit, si dhe rritjen e shpejtë të çmimeve në tregjet ndërkombëtare gjatë dy tremujorëve të fundit. Këto të fundit kanë qenë të larta gjatë gjysmës së dytë të vitit të shkuar dhe janë vënë nën presion të shtuar nga tensioni gjeopolitik që shoqëron konfliktin në Ukrainë.


Grafik 14.

*Inflacioni vjetor në Shqipëri vijoi në trajektoren rritëse, për shkak të presioneve të forta që vijnë nga faktorët e ofertës globale*



Burimi: INSTAT, llogaritje të BSH-së.

*Situata e pandemisë dhe së fundmi ajo gjeopolitike janë duke shkaktuar rritje të paparashikuara të inflacionit*



Burimi: INSTAT, llogaritje të BSH-së.

Ecuria e mëtejshme e çmimeve do të përcaktohet nga intensiteti dhe kohëzgjatja e këtij konflikti, nga ndikimi që ai do të ketë mbi çmimet dhe tregtinë ndërkombëtare, si dhe nga qëndrueshmëria e rritjes ekonomike në vend.

Të dhënat që vijnë nga tregjet e huaja sinjalizojnë se çmimet në tregjet ndërkombëtare do të vijojnë të mbeten të larta gjatë viteve 2022 dhe 2023. Këto çmime të larta do të gërryejnë fuqinë blerëse të familjeve dhe do të shoqërohen me ngadalësim të ritmit të rritjes në rang botëror. Për rrjedhojë, projeksionet globale të inflacionit për dy vitet në vijim janë riparë për lart, ndërsa projeksionet e rritjes ekonomike janë riparë për poshtë. Po ashtu, pjesa më e madhe e bankave qendrore kanë përsheptuar planet e tyre të normalizimit të qëndrimit të politikës monetare.

Përkundrajt kësaj situatë, ekonomia shqiptare ka shfaqur shenja të qarta rimëkëmbjeje. Informacioni i disponuar tregon se aktiviteti ekonomik ka


tejkalar nivelin e regjistruar përpara tërmetit e pandemisë në tremujorin e parë të vitit të shkuar. Po ashtu, ky informacion sugjeron se momenti pozitiv i rritjes është mbartur dhe në dy muajt e parë të vitit aktual.

Rritja ekonomike ka pasur një bazë të gjerë. Ajo pasqyron zgjerimin e thuasje të gjithë sektorëve të ekonomisë dhe përbërësve të kërkesës agregate. Në terma makroekonomikë, ajo është ushqyer nga përmirësimi i besimit, nga rritja e kërkesës së huaj, nga ambienti i favorshëm monetar dhe financiar, si dhe nga stimuli fiskal i dy viteve të fundit.

Politika monetare stimuluese e Bankës së Shqipërisë ka gjeneruar tregje financiare të stabilizuara, norma të ulëta interesi dhe kushte të favorshme financimi. Kredia për sektorin privat u rrit me 11.8% në muajin shkurt, duke ilustruar një mbështetje në rritje me fonde, të konsumit dhe investimeve. Trendi rritës i kreditimit është ndikuar si nga rritja e kërkesës së biznesit dhe të familjeve, ashtu dhe nga politikat e favorshme të kreditimit të aplikuara nga sektori bankar. Ky sektor vijon të karakterizohet nga bilance likuide e të shëndetshme dhe rënie e kredive me probleme.


### Grafik 15.

*Yield-et në tregun primar janë shfaqur të qëndrueshëm dhe ndryshimet minimale kanë anuar kryesisht në kahun rënës*



*Shënim: të dhënat tregojnë normat e interesit (mesatare mujore) të bonove edhe obligacioneve shtetërore të emetuara në treg.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

*Kurba e yield-eve nuk ka ndryshuar qenësisht nga muaji dhjetor dhe është më e ulët se një vit më parë*



*Shënim: të dhënat tregojnë norma interesi (mesatare mujore) të titujve të borxhit të qeverisë, sipas maturiteteve të ndryshme të llogaritura sipas modelit Nelson Siegel.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Vlerësimet tona sugjerojnë se kërkesa agregate po gjeneron një shfrytëzim thuasje të plotë të kapitalit dhe të punës. Rritja ekonomike është pasqyruar në rritje graduale të punësimit dhe përshejtim të ritmit të

rritjes së pagave. Në veçanti, të dhënat e INSTAT-it tregojnë se punësimi u rrit me 2.1% në terma vjetorë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021, ndërsa paga në sektorin privat u rrit me 10.2%. Norma e lartë e rritjes së pagave sugjeron se tregu i punës karakterizohet nga hapësira të pakta të pashfrytëzuara.

Përditësimi i parashikimeve afatmesme tregon se ekonomia shqiptare do të vuajë pasojat e goditjes. Rritja e çmimeve në tregjet botërore dhe reduktimi i kërkesës së huaj, do të shoqërohen me norma më të larta inflacioni dhe rritje më të ngadaltë ekonomike krahasuar me vlerësimet tona të mëparshme.

Megjithatë, vlerësimet e skenarit bazë sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet gjatë vitit 2022 dhe në afatin e mesëm. Po ashtu, projeksionet tona tregojnë se rritja ekonomike do të mbetet në territor pozitiv edhe në rast se goditja rezulton më e fortë se vlerësimet aktuale.

Nga ana tjetër, goditjet e ofertës dhe qëndrueshmëria e kërkesës së brendshme pritet të pasqyrohen në norma më të larta inflacioni. Sipas skenarit bazë të parashikimeve, inflacioni do të luhetet rreth nivelit 5-6% për pjesën e mbetur të vitit 2022. Më tej, me qetësimin e pritur të tregjeve ndërkombëtare, inflacioni pritet të vijë në rënie gjatë vitit 2023 dhe të kthehet në objektiv në tremujorin e fundit të tij.

Në konsistencë me parashikimet e mësipërme dhe komunikimet e tij të mëparshme, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë e vlerësoi të nevojshme përshtatjen e qëndrimit të politikës monetare me kushtet e reja ekonomike.

Politika jonë monetare ka qenë në pozita tejet stimuluese gjatë dy viteve të fundit. Ajo ka synuar nxitjen e kërkesës agregate gjatë pandemisë, si një parakusht për respektimin e objektivit tonë të inflacionit. Kjo politikë ka rezultuar e suksesshme në misionin e saj.

Megjithatë, goditja aktuale e ofertës dhe fortësia e kërkesës agregate, rrezikojnë të cenojnë objektivin tonë të stabilitetit të çmimeve në afatin e mesëm.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi:

- rritjen me 0.5 pikë përqindje të normës bazë së interesit, nga niveli 0.5% në nivelin 1.0%.

- mbajtjen e normës së interesit të depozitës njëditore, në nivelin aktual prej 0.1%;
- rritjen e normës së interesit të kredisë njëditore, nga niveli 0.9% në nivelin 1.9%.

Këshilli Mbikëqyrës vëren se – edhe pas kësaj lëvizjeje – qëndrimi i politikës monetare vijon të jetë stimulues për rritjen e ekonomisë, të punësimit dhe të pagave. Në realitetin e ri, ky qëndrim ofron një balancë më të mirë midis rrezikut të përshpejtimit të inflacionit dhe rrezikut të dëmtimit të rimëkëmbjes ekonomike.

Duke gjykuar mbi informacionin aktual, normalizimi i qëndrimit të politikës monetare do të jetë një proces gradual dhe i mbështetur në informacionin e ri.

Megjithatë, Këshilli Mbikëqyrës vëren se balanca e rreziqeve mbi inflacionin mbetet në kahun e sipërm. Për këtë arsye, ai do të monitorojë në vazhdimësi reagimin e ekonomisë shqiptare ndaj kësaj goditjeje dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për respektimin e objektivit të stabilitetit të çmimeve në afatin e mesëm.

***“Këshilli Mbikëqyrës vëren se balanca e rreziqeve mbi inflacionin mbetet në kahun e sipërm. Për këtë arsye, ai do të monitorojë në vazhdimësi reagimin e ekonomisë shqiptare ndaj kësaj goditjeje dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për respektimin e objektivit të stabilitetit të çmimeve në afatin e mesëm.”***

## **BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 1.0% -4 maj 2022-**

- *Ekonomia botërore dhe ajo shqiptare vijojnë të jenë subjekt i goditjes së shkaktuar nga konflikti në Ukrainë.*
- *Goditjet e ofertës do të jenë më të forta dhe më të qëndrueshme në kohë se vlerësimet tona të mëparshme.*
- *Këshilli Mbikëqyrës vëren se ekonomia shqiptare do të ruajë stabilitetin e saj monetar dhe financiar.*

### *Të nderuar përfaqësues të medias,*


Sot, në datën 4 maj 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare.

Ekonomia botërore dhe ajo shqiptare vijojnë të jenë subjekt i goditjes së shkaktuar nga konflikti në Ukrainë. Kjo goditje ka rritur çmimet e ushqimeve, të lëndëve të para dhe të atyre energjetike, ka shtuar pasiguritë në agjentët ekonomikë, dhe ka filluar të pasqyrohet në kushte më të shtrënguara financimi. Si pasojë e këtij kompleksi faktorësh, inflacioni ka pësuar një rritje të ndjeshme, ndërsa rritja ekonomike ka shfaqur shenja ngadalësimi.

Informacioni i ri i marrë në analizë sugjeron se goditjet e ofertës do të jenë më të forta dhe më të qëndrueshme në kohë se vlerësimet tona të mëparshme. Për rrjedhojë, inflacioni pritet të qëndrojë më gjatë mbi objektivin e Bankës së Shqipërisë, ndërsa ritmi i rritjes ekonomike – ndonëse pozitiv – do të jetë më i ulët se pritjet tona të fillimvitit.

Megjithatë, Këshilli Mbikëqyrës vëren se ekonomia shqiptare do të ruajë stabilitetin e saj monetar dhe financiar. Ky parashikim faktorizon pritjet tona për mospërshkallëzimin e konfliktit, për reduktimin e presioneve në tregjet botërore gjatë vitit të ardhshëm dhe për vijimin e rritjes ekonomike në partnerët tanë tregtarë. Gjithashtu, ai kërkon normalizimin gradual të politikës monetare në horizontin afatmesëm.

*Grafik 16. Norma bazë e interesit, maj 2022*



*Burimi: Banka e Shqipërisë.*


Duke gjykuar mbi sa më sipër, në mbledhjen e sotme, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mos ndryshojë qëndrimin e politikës monetare.

Në vijim, më lejoni të sqaroj më në detaje konkluzionet kryesore të Raportit Tremujor, pritjet tona për të ardhmen, si dhe arsytet që motivuan vendimin e sotëm.

Informacioni i ri i marrë në analizë tregoi se presionet inflacioniste në tregjet botërore rezultuan më të forta dhe më të qëndrueshme sesa pritjet tona në fillim të vitit. Konflikti në Ukrainë dhe sanksionet e vendosura ndaj Rusisë sollën ndërprerje të reja në zinxhirët globalë të prodhimit e të shpërndarjes dhe shtuan pasiguritë për të ardhmen. Ato u pasuan nga një rritje e fortë e çmimeve në tregjet botërore dhe lëvizje agresive të bankave qendrore në drejtim të shtrëngimit të qëndrimit të politikës monetare.

Inflacioni në vend u rrit gjatë tremujorit të parë të vitit, duke shënuar nivelin mesatar prej 4.4%. Rritja e tij ishte veçanërisht e shpejtë në muajin mars, kur inflacioni kërceu në 5.7%. Në pjesën më të madhe, rritja e inflacionit u shkaktua nga goditjet e ofertës, të ardhura nga rritja e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës. Megjithatë, paralelisht me to, trendi rritës i inflacionit ka pasqyruar edhe rimëkëmbjen e shpejtë ekonomike gjatë vitit të shkuar, rritjen e punësimit dhe të pagave, si dhe tendencën në rritje të pritjeve për inflacionin.

Grafik 17 Ecuria e çmimeve të lëndëve bazë në tregjet ndërkombëtare dhe parashikimet për to



Burimi: Indekset e çmimeve të lëndëve të para, Banka Botërore, EIA, Banka e Shqipërisë.

Zgjerimi i kërkesës agregate dhe përmirësimi i tregut të punës kanë gjeneruar presione të shtuara inflacioniste nga ekonomia vendase. Sipas Institutit të Statistikave, prodhimi i brendshëm bruto u rrit me 8.5% gjatë vitit 2021, duke tejkaluar nivelet e regjistruara para tërmetit dhe pandemisë. Rritja ekonomike u mbështet nga zgjerimi i konsumit, i investimeve dhe i eksporteve.

Rritja e kërkesës për mallra e shërbime ka nxitur rritjen e punësimit, të pagave dhe të kostove të prodhimit. Rritja e punësimit solli rënien në 11.4% të normës së papunësisë në fund të vitit 2021 dhe u pasqyrua në një rritje të shpejtë të pagave në dy tremujorët e fundit të vitit të shkuar. Përmirësimi i tregut të punës do të ndihmojë në amortizimin e një pjese të goditjes që vjen nga çmimet e larta, por përkthehet dhe në presione më të qëndrueshme në kohë mbi inflacionin.


Në terma makroekonomikë, zgjerimi i kërkesës agregate është mbështetur nga lehtësimi i masave kufizuese për kontrollin e pandemisë, përmirësimi i besimit, rritja e kërkesës së huaj, si dhe nga politikat stimuluese monetare e fiskale.

Në veçanti, stimuli i fortë monetar i dy viteve të fundit ka mbështetur rimëkëmbjen e ekonomisë nga goditjet e tërmetit dhe pandemisë. Politika monetare stimuluese ka gjeneruar një ambient financiar të qetë, të karakterizuar nga likuiditeti i bollshëm, kosto të ulëta kreditimi dhe kurs

i qëndrueshëm këmbimi. Krahas këtyre faktorëve, shëndeti i mirë i sektorit bankar dhe kërkesa e lartë për fonde, kanë mbështetur rritjen e qëndrueshme të kredisë. Në muajin mars, portofoli i kredisë për sektorin privat u rrit me 12.8%, duke plotësuar nevojat e familjeve dhe të bizneseve për konsum, investime dhe kapital qarkullues.

Rritja e normës bazë të interesit gjatë muajit mars ka pasur një transmetim të shpejtë në segmentet afatshkurtra të tregut monetar. Ajo ka favorizuar një ankorim më të mirë të pritjeve për inflacionin, si dhe ka ndihmuar stabilizimin e presioneve mbi kursin e këmbimit. Megjithatë, efekti i saj në çmimet e depozitave e të kredive bankare nuk është shfaqur ende i plotë.

*Grafik 18. Pritjet për inflacionin pas një viti të bizneseve dhe të konsumatorëve*



*Shënime: Ndryshime vjetore në përqindje.  
Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.*

Ekspozimi ynë direkt ndaj vendeve të përfshira në konflikt është relativisht i ulët. Megjithatë, lufta në Ukrainë ka zbehur perspektivën e rritjes globale dhe veçanërisht atë të ekonomive evropiane, si dhe ka shtuar presionet inflacioniste.

Përditësimi i parashikimeve tona të skenarit bazë sugjeron se inflacioni në vend do të mbetet në nivele relativisht të larta gjatë periudhës në vijim. Çmimet e larta në tregjet botërore, kërkesa e rritur agregate, si dhe dinamikat e tregjeve të punës, pritet ta mbajnë inflacionin pranë niveleve aktuale gjatë vitit 2022. Më tej, ai pritet të vijë në rënie graduale gjatë vitit 2023 dhe të kthehet në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024.



Përkundrajt kësaj ecurie, ekonomia shqiptare pritet të vijojë rritjen gjatë horizontit afatmesëm. Rritja ekonomike do të vijojë të mbështetet nga kushtet ende të favorshme të financimit, nga bilancet e shëndosha financiare të sektorit real dhe financiar, si dhe nga vijimi i rritjes së eksporteve. Megjithatë, ritmi i rritjes pritet të jetë më i ngadaltë krahasuar me parashikimet e fillimvitit.

Balanca e rreziqeve rreth këtyre parashikimeve mbetet e zhvendosur për lart në rastin e inflacionit dhe për poshtë në rastin e rritjes ekonomike. Ajo pasqyron pasiguritë e rritura që ka shkaktuar konflikti në Ukrainë në tregjet e produkteve, të faktorëve të prodhimit dhe ato financiare.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vlerësoi se qëndrimi aktual i politikës monetare është i përshtatshëm për përmbushjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve në afatin e mesëm dhe për mbështetjen e rimëkëmbjes ekonomike.

Për këtë arsye, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 1.0%;
- të mbajë të pandryshuara normat e interesit të depozitave dhe të kredive njëditore, respektivisht në nivelin 0.1% dhe 1.9%.

Në gjykimin e Këshillit, niveli aktual i stimulit monetar ofron balancën e duhur midis rrezikut të përshpejtimit të inflacionit dhe rrezikut të ngadalësimit të rritjes ekonomike.

Megjithatë, Këshilli Mbikëqyrës do të monitorojë me kujdes dinamikën e inflacionit dhe mbetet i gatshëm të ndërhyjë në kohën dhe me forcën e duhur për të garantuar respektimin e objektivit të tij të stabilitetit të çmimeve.

Në gjykimin e Këshillit, respektimi i këtij objektivit do të kërkojë normalizimin e qëndrimit të politikës monetare në afatin e mesëm. Në përputhje me parashikimet e skenarit bazë, ky normalizim do të marrë formën e një procesi gradual gjatë dy viteve të ardhshme. Megjithatë, nisur nga nivelet tejet të ulëta të normave të interesit në vend, politika monetare do të vijojë të mbetet në pozita stimuluese gjatë gjithë kësaj periudhe. Në të kundërt, materializimi i skenarëve të rrezikut mund të shkaktojë devijime nga ky skenar.

Në çdo rast, qëndrimi i politikës monetare do të udhëhiqet nga informacioni i ri dhe nevoja për respektimin e objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve.

***“Këshilli Mbikëqyrës do të monitorojë me kujdes dinamikën e inflacionit dhe mbetet i gatshëm të ndërhyjë në kohën dhe me forcën e duhur për të garantuar respektimin e objektivit të tij të stabilitetit të çmimeve.”***

## **BANKA E SHQIPËRISË RRIË NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 1.25% - 6 korrik 2022 -**


- *Baza e presioneve inflacioniste ka ardhur në zgjerim.*
- *Prodhimi i brendshëm bruto u rrit me pothuaj 6% në tremujorin e parë të vitit.*
- *Përditësimi i parashikimeve tona sipas skenarit bazë sugjeron se ekonomia shqiptare do të vijojë të shënojë rritje solide në horizontin afatmesëm.*
- *Balanca e reziqeve mbi inflacionin vijon të mbetet në kahun e sipërm.*

*Të nderuar përfaqësues të medias,*

Sot, në datën 6 korrik 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i marrë në analizë vijon të ilustrojë ndikimin që konflikti ushtarak në Ukrainë ka mbi ekonominë botërore dhe atë shqiptare. Rritja e çmimeve të produkteve, shtyrëngimi i kushteve financiare dhe rritja e pasigurisë, kanë sjellë një rritje të fortë të inflacionit dhe kanë filluar të frenojnë ritmet e rritjes ekonomike.

*Grafik 19. Norma bazë e interesit, korrik 2022*



*Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Rifreskimi i analizës dhe përditësimi i projeksioneve tona sugjerojnë se inflacioni në vend do të vijojë të mbetet i lartë gjatë vitit 2022. Ky inflacion pasqyron – në masën më të madhe – efektet direkte të goditjes së ofertës që vjen nga tregjet ndërkombëtare. Megjithatë, pasojat e kësaj goditjeje rrezikojnë të forcohen dhe të zgjaten në kohë, si pasojë e kërkesës relativisht solide për mallra e shërbime në vend.


Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës gjykoj se rritja e inflacionit është rreziku kryesor që kërcënon rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit. Sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të vijojë procesin e normalizimit të politikës monetare. Ky normalizim synon të krijojë kushte monetare të përshtatshme për kontrollin e inflacionit në horizontin afatmesëm dhe sinjalizon vullnetin tonë për respektimin e objektivit të stabilitetit të çmimeve.

Në vijim, do të prezantoj vendimin e sotëm dhe të shpjegoj më në detaje arsyet që e motivuan atë.

Inflacioni shënoi rritje në muajt prill e maj, duke regjistruar respektivisht vlerat 6.2% dhe 6.7%. Këto nivele ishin në kahun e sipërm të pritjeve tona.

Baza e presioneve inflacioniste ka ardhur në zgjerim. Ndonëse dinamika e inflacionit në këta dy muaj pasqyroj kryesisht rritjen e çmimeve të ushqimeve dhe të lëndëve energjetike, kjo rritje është e pranishme në pjesën më të madhe të artikujve të shportës.

*Grafik 20. Grupi i mallrave ushqimore të përpunuara dhe mallrave energjetike ritën ndjeshëm ndikimin në inflacion*



Burimi: INSTAT llnarrtita të Rankës së Shrinëricë



Zhvillimet financiare në vend vijojnë të karakterizohen nga prime të kontrolluara rreziku, likuiditet i bollshëm, kurs i qëndrueshëm këmbimi dhe kredi në rritje. Stimuli ynë monetar është përcjellë në norma të ulëta interesi për financimin e sektorit privat. Paralelisht me të, rritja e kërkesës për kredi dhe bilancet e shëndetshme të sektorit bankar, janë përkthyer në rritje të qëndrueshme të kreditimit. Rritja vjetore e kredisë për sektorin privat është forcuar më tej, duke shënuar vlerën 13.8% në muajin maj. Kjo rritje ishte e pranishme si në segmentin e bizneseve dhe në atë të individëve, duke i shërbyer si financimit të konsumit dhe investimeve ashtu dhe nevojave për kapital qarkullues.

Ecuria e ekonomisë në periudhën vijuese mbetet subjekt i sfidave serioze. Rritja e çmimeve në tregjet botërore, shtrëngimi i kushteve financiare dhe ngadalësimi i prituri të ekonomisë në Eurozonë, si dhe frenimi i fuqisë blerëse të familjeve, do të kenë një ndikim me kah të kundërt mbi ecurinë e inflacionit dhe të rritjes ekonomike në vend.

Megjithatë, përditësimi i parashikimeve tona sipas skenarit bazë sugjeron se ekonomia shqiptare do të vijojë të shënojë rritje solide në horizontin afatmesëm. Ritmi i rritjes ekonomike do të vijë në ngadalësim kundrejt atij të shënuar në tremujorin e parë të vitit, por ai do të jetë i mjaftueshëm për të ruajtur shëndetin e balanceve të familjeve dhe bizneseve shqiptare.

Nga ana tjetër, inflacioni do të vijojë të mbetet i lartë në tremujorët në vijim. Projektionet e skenarit bazë sugjerojnë se norma e inflacionit do të kulmojë jo shumë larg nivelit aktual në tremujorin e tretë të vitit aktual dhe do të vijë në rënie graduale gjatë tremujorëve në vijim. Kjo trajektore pritet ta sjellë inflacionin në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024.

Projektionet e skenarit bazë parashikojnë një normalizim gradual të politikës monetare në periudhën në vijim. Shpejtësia e normalizimit do të synojë një harmonizim sa më të mirë të intensitetit të stimulit monetar me intensitetin e presioneve afatmesme inflacioniste.

Balanca e rreziqeve mbi inflacionin vijon të mbetet në kahun e sipërm. Në veçanti, goditjet e forta shpesh të ofertës apo shfaqja e efekteve zinxhir të rrethit të dytë, do të forcojnë më tej presionet inflacioniste. Në të kundërt, një ecuri më negative ekonomike e partnerëve tanë tregtarë apo një zgjidhje e shpejtë e konfliktit në Ukrainë do të reduktonte presionet inflacioniste.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vlerësoi se nivelet e larta të presioneve inflacioniste janë rreziku primar mbi rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

Për këtë arsye, në respektim të objektivit tonë të stabilitetit të çmimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të rrisë me 0.25 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, nga niveli 1.0% në nivelin 1.25%;
- të rrisë me 0.35 pikë përqindjeje normën e interesit të kredisë njëditore, nga niveli 1.9% në nivelin 2.25%; si dhe
- të rrisë me 0.15 pikë përqindjeje normën e interesit të depozitës njëditore, nga niveli 0.1% në nivelin 0.25%.

Në gjykimin e Këshillit, normalizimi i politikës monetare do të krijojë kushte më të përshtatshme për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda horizontit afatmesëm. Në të njëjtën kohë, ky normalizim nuk do të cenojë premisat e rritjes ekonomike në këtë horizont.

Po ashtu, Këshilli Mbikëqyrës thekson se materializimi i projeksioneve të skenarit bazë do të kërkojë vijimin e ciklit normalizues të politikës monetare edhe në tremujorët në vazhdim. Në këtë skenar, shpejtësia e normalizimit do të jetë graduale, por në çdo rast e mjaftueshme për të respektuar objektivin tonë afatmesëm të inflacionit.

Këshilli Mbikëqyrës do të monitorojë me kujdes dinamikën e presioneve inflacioniste në periudhën në vijim. Ai mbetet i gatshëm të ndërhyjë, në kohën dhe me forcën e duhur, për të garantuar stabilitetin e çmimeve në vend.

***“Këshilli Mbikëqyrës thekson se materializimi i projeksioneve të skenarit bazë do të kërkojë vijimin e ciklit normalizues të politikës monetare edhe në tremujorët në vazhdim. Në këtë skenar, shpejtësia e normalizimit do të jetë graduale, por në çdo rast e mjaftueshme për të respektuar objektivin tonë afatmesëm të inflacionit.”***





## **BANKA E SHQIPËRISË RRIËT NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 1.75% - 3 gusht 2022 -**


- Presionet inflacioniste janë më të gjera dhe më të forta se vlerësimet tona të mëparshme.
- Këshilli Mbikëqyrës vendosi të vijojë procesin e normalizimit të politikës monetare.
- Ky normalizim është i nevojshëm për kontrollin e presioneve inflacioniste dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda një horizonti kohor afatmesëm.

*Të nderuar përfaqësues të medias,*

Sot, në datën 3 gusht 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i marrë në analizë sugjeron se presionet inflacioniste janë më të gjera dhe më të forta se vlerësimet tona të mëparshme. Ky gjykim pasqyron rritjen e shpejtë të çmimeve në tregjet botërore, si dhe kërkesën e lartë e të qëndrueshme për mallra e shërbime në vend.

*Grafik 22. Norma bazë e interesit, gusht 2022*



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të vijojë procesin e normalizimit të politikës monetare. Ky normalizim është i nevojshëm për kontrollin e presioneve inflacioniste dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda një horizonti kohor afatmesëm. Në këtë mënyrë, politika monetare do të ndihmojë ruajtjen e stabilitetit të brendshëm monetar dhe financiar dhe do të krijojë kushte të përshtatshme për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë shqiptare.


Çmimet e konsumit shënuan rritje të mëtejshme në tremujorin e dytë. Inflacioni shënoi rritje progresive gjatë kësaj periudhe, duke kulmuar në nivelin 7.4% në muajin qershor.

Baza e presioneve inflacioniste ka ardhur në zgjerim. Rritja e inflacionit pasqyroi kryesisht çmimet më të larta të artikujve ushqimorë, të naftës dhe të transportit. Megjithatë, rritja e çmimeve ishte e çmimesh në një kategori të gjerë produktesh, duke ilustruar përcjelljen e goditjeve të ofertës edhe në çmimet e artikujve të tjerë të shportës.

Trendi rritës i inflacionit ka pasqyruar, në masën më të madhe, ndikimin e goditjeve të ofertës së huaj. Megjithatë, përcjellja e tyre në ekonominë shqiptare është favorizuar nga kërkesa relativisht e lartë për mallra e shërbime, dhe nga rishikimi për lart i pritjeve për inflacionin. Ecuria e inflacionit në të ardhmen do të varet nga dinamikat dhe ndërveprimi i këtyre faktorëve.


### Grafik 23.

*Normat e larta dhe të vazhdueshme të inflacionit kanë nxitur përshejtimin e normalizimit të politikës monetare*



Shënime: Normat bazë të interesit për bankat kryesore të mëdha me ndikim në tregjet ndërkombëtare.  
Burimi: Bankat qendrore.

*Pritjet për rritje të njëpasnjëshme të normave bazë të interesit kanë sjellë rritje të yield-ëve*



Shënime: Yield-et e titujve 10-vjeçarë të qeverive.  
Burimi: Investing.

Ambienti i jashtëm vazhdon të mbetet sfidues. Konflikti në Ukrainë dhe sanksionet e vendosura ndaj Rusisë kanë sjellë një rritje të shpejtë të çmimeve në tregjet botërore dhe kanë filluar të pasqyrohen në ngadalësim të ritmeve të rritjes ekonomike. Paralelisht me të, kushtet financiare kanë ardhur në shtërëngim teksa bankat qendrore kanë rritur normat bazë të interesit dhe pasiguria e agjentëve ekonomikë dhe financiarë mbetet e lartë. Projektionet për Eurozonën sugjerojnë se inflacioni do të kulmojë në gjysmën e dytë të vitit aktual, por balanca e rreziqeve qëndron në kahun e sipërm.

Përkundrejt këtyre zhvillimeve, ekonomia shqiptare ka pasur një ecuri relativisht solide në gjysmën e parë të vitit. Vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit me 6% në tremujorin e parë të vitit dhe treguesit indirektë sugjerojnë rritje të mëtejshme në tremujorin e dytë. Kjo ecuri pasqyron bilancet e shëndosha financiare të biznesit dhe familjeve, fleksibilitetin operacional të sektorit privat, si dhe rezistencën e sistemit financiar shqiptar ndaj goditjeve.

Rritja ekonomike është diktuar nga zgjerimi i konsumit familjar, i investimeve të sektorit privat, si dhe i eksportit të mallrave dhe shërbimeve. Nga ana tjetër, rritja e çmimeve në tregjet ndërkombëtare ka sjellë rritjen e faturës së importeve, ndërsa politika fiskale ka pasur një natyrë konsoliduese.

Zgjerimi i kërkesës agregate është mbështetur nga kushtet e favorshme të financimit në vend. Kursi stimulues i politikës monetare ka krijuar një ambient financiar me norma të ulëta interesi, likuiditet të bollshëm dhe prime të kontrolluara rreziku. Kërkesa e brendshme për kredi vijon të mbetet e lartë, ndërsa sektori bankar vijon të ofrojë kushte e terma të favorshëm kreditimi. Për rrjedhojë, rritja e kredisë për sektorin privat regjistroi vlerën 13.8% në muajin qershor, duke ruajtur trendin pozitiv të shfaqur gjatë vitit të shkuar. Në të njëjtën kohë, cilësia e portofolit të kredisë vijon të mbetet e shëndetshme, sikundër ilustrohet edhe nga treguesi i kredive me probleme i cili mbetet në nivelet më të ulëta të dekadës së fundit.

Paralelisht me këto zhvillime, kursi i këmbimit të lekut ndaj euros ka shfaqur tendenca forcimi gjatë dy muajve të fundit. Ky forcim pasqyron hyrjet e larta valutore në përgjigje të sezonit të mirë turistik dhe ndihmon në zbutjen e një pjese të goditjes së ofertës që vjen nga tregu i huaj.

Grafik 24.


*Leku është mbiçmuar ndaj euros dhe ka vijuar të nënçmohet ndaj dollarit amerikan*



Shënim: Të dhënat tregojnë ecurinë ditore të kursit të këmbimit të lekut kundrejt euros edhe dollarit amerikan.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Balanca e presioneve mbi kursin eur/lek anon në kahun mbiçmues*



Shënim: Të dhënat paraqesin treguesin e anshmërisë për mbiçmim/nënçmim, për më shumë, shiko shënim 8.

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Zgjerimi i kërkesës ka sjellë një shfrytëzim më të mirë të potencialit prodhues. Në veçanti, tregu i punës vijon të karakterizohet nga rritje e punësimit, rënie e papunësisë dhe rritje e shpejtë e pagave në sektorin privat, ndërsa bizneset raportojnë një përdorim më të lartë të kapaciteteve prodhuese. Këto zhvillime japin sinjale inkurajuese për vijimin e rritjes ekonomike në periudhën në vazhdim.

Projeksionet e skenarit bazë sugjerojnë se rritja ekonomike do të mbetet në territor pozitiv gjatë horizontit afatmesëm. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik do të vijojë të mbështetet nga rritja e kërkesës së brendshme e të huaj dhe të ushqehet nga bilancet e shëndetshme financiare të ekonomisë, rritja e punësimit, e pagave dhe e kredisë.

Inflacioni parashikohet të qëndrojë në nivele të larta gjatë vitit 2022 dhe të reduktohet më tej. Në mungesë të goditjeve të reja, stabilizimi i çmimeve jashtë pritit të lehtësojë presionet mbi inflacionin në vend. Në të njëjtën kohë, normalizimi i politikës sonë monetare do të krijojë kushte më të përshtatshme financiare për rritjen e qëndrueshme të ekonomisë dhe reduktimin e inflacionit. Inflacioni parashikohet të kthehet në objektivin tonë 3% në gjysmën e parë të vitit 2024.

Këto projeksione vijojnë të mbeten subjekt i pasigurive të larta. Në veçanti, rreziqet mbi inflacionin qëndrojnë në kahun e sipërm, kurse ato për rritjen ekonomike në kahun e poshtëm.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vazhdon të vlerësojë se nivelet e larta të presioneve inflacioniste janë rreziku primar mbi rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

Për këtë arsye, në respektim të objektivit të stabilitetit të çmimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të rrisë me 0.5 pikë përqindjeje normën bazë të interesit, nga niveli 1.25% në nivelin 1.75%;
- të rrisë me 0.5 pikë përqindjeje normën e interesit të kredisë njëditore, nga niveli 2.25% në nivelin 2.75%;
- të rrisë me 0.5 pikë përqindjeje normën e interesit të depozitës njëditore, nga niveli 0.25% në nivelin 0.75%.

Në gjykimin e Këshillit, normalizimi i politikës monetare do të krijojë kushte më të përshtatshme për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda horizontit afatmesëm. Në të njëjtën kohë, politika monetare do të vijojë të mbetet në kahun akomodues gjatë gjithë procesit të normalizimit dhe nuk do të cenojë premisat e rritjes ekonomike.

Këshilli Mbikëqyrës thekson se materializimi i projeksioneve të skenarit bazë do të kërkojë vijimin e ciklit normalizues të politikës monetare edhe në tremujorët në vazhdim. Në këtë skenar, shpejtësia e normalizimit do të jetë graduale, por në çdo rast e mjaftueshme për të respektuar objektivin tonë afatmesëm të inflacionit.

Këshilli Mbikëqyrës do të monitorojë me kujdes dinamikën e presioneve inflacioniste në periudhën në vijim. Ai mbetet i gatshëm të ndërhyjë në kohën dhe me forcën e duhur për të garantuar stabilitetin e çmimeve në vend.

***“Këshilli Mbikëqyrës thekson se materializimi i projeksioneve të skenarit bazë do të kërkojë vijimin e ciklit normalizues të politikës monetare edhe në tremujorët në vazhdim. Në këtë skenar, shpejtësia e normalizimit do të jetë graduale, por në çdo rast e mjaftueshme për të respektuar objektivin tonë afatmesëm të inflacionit.”***



## BANKA E SHQIPËRISË RRIËT NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 2.25%

- 5 tetor 2022 -


- Goditjet e ofertës dhe rritja e pasigurisë në tregjet botërore, po transmetohen në rritje të inflacionit dhe ngadalësim të ritmit të rritjes ekonomike në vend.
- Rritja e shpejtë e çmimeve mbetet rreziku kryesor për stabilitetin monetar e financiar të vendit dhe për rritjen e qëndrueshme e afatgjatë të tij.
- Ekonomia shqiptare vijoi rritjen në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022, ndonëse ritmet e saj u ngadalësuan ndjeshëm në tremujorin e dytë.

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sot, më 5 tetor 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare.

Informacioni i ri i marrë në analizë sugjeron se goditjet e ofertës dhe rritja e pasigurisë në tregjet botërore, po transmetohen në rritje të inflacionit dhe ngadalësim të ritmit të rritjes ekonomike në vend. Në veçanti, presionet e huaja inflacioniste vlerësohen të jenë më të forta e më të qëndrueshme se vlerësimet tona të mëparshme. Po ashtu, kërkesa në rritje për mallra e shërbime në vend, tregu dinamik i punës dhe pritjet për norma të larta inflacioni, po lehtësojnë përhapjen e tyre në ekonominë shqiptare.

Grafik 25. Norma bazë e interesit, tetor 2022




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se rritja e shpejtë e çmimeve mbetet treziku kryesor për stabilitetin monetar e financiar të vendit dhe për rritjen e qëndrueshme e afatgjatë të tij.

Në këto rrethana, Këshilli vendosi të vijojë normalizimin e qëndrimit të politikës monetare. Ky normalizim synon të krijojë kushtet e nevojshme për kthimin gradual të inflacionit në objektiv, brenda një horizonti kohor të arsyeshëm dhe me kosto sa më të ulëta për aktivitetin e brendshëm ekonomik.

Në vijim, do t'ju njoh me vendimin e politikës monetare dhe do t'ju shpjegoj më në detaje arsyet e tij.

**Grafik 26. Grupi i mallrave ushqimore të përpunuara dhe shërbimeve ritën ndjeshëm ndikimin në inflacion**



Burimi: INSTAT, llogaritje të BSH-së.

Inflacioni u rrit më tej në muajt korrik e gusht, duke shënuar vlerat respektive prej 7.5% dhe 8.0%. Kontributi kryesor në inflacion vijon të vijë nga rritja e shpejtë e çmimeve të ushqimeve dhe të naftës. Megjithatë, tendenca e rritjes së çmimeve po bëhet prezente në një gamë gjithnjë e më të gjërë mallrash dhe shërbimesh.

Forcimi dhe zgjerimi i presioneve inflacioniste pasqyron si rritjen e përshpejtuar të çmimeve në tregun global ashtu edhe intensifikimin e presioneve të brendshme. Lufta në Ukrainë përkeqësoi problemet ekzistuese të ofertës globale dhe shkaktoi probleme të reja, kryesisht në tregjet e ushqimeve bazë, të lëndëve energjetike dhe të lëndëve bazë.




Si rezultat, çmimet e këtyre produkteve u rritën shpejt në tregjet globale dhe në vendin tonë. Paralelisht me to, rritja e kërkesës agregate në vend ka mbështetur zgjerimin e punësimit dhe të pagave dhe ka shtuar presionet e brendshme inflacioniste.

Ekonomia shqiptare vijoi rritjen në gjashtëmuorin e parë të vitit 2022, ndonëse ritmet e saj u ngadalësuan ndjeshëm në tremujorin e dytë. Sipas të dhënave të INSTAT-it, rritja ekonomike zbriti në nivelin 2.2%, nga 6.5% në tremujorin e parë. Reduktimi i rritjes pasqyroi, në masën më të madhe, ngadalësimin e shpejtë të aktivitetit në sektorin e ndërtimit dhe të industrisë. Megjithatë, shenja të ngadalësimit ishin të pranishme edhe në sektorë të tjerë të ekonomisë.


**Grafik 27.**

*Rritja ekonomike u ngadalësua ndjeshëm gjatë tremujorit të dytë të vitit 2022*



Burimi: INSTAT dhe Banka e Shqipërisë.

*Ngadalësimi i rritjes lidhet kryesisht me tkurrjen në terma vjetorë të kontributit të aktivitetit prodhues*



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në këndvështrimin makroekonomik, ky ngadalësim pasqyroi si veprimin e efektit bazë, ashtu dhe efektin negativ të kostove të larta dhe të rritjes së pasigurisë. Këta faktorë sollën frenimin e ritmit të rritjes së eksporteve dhe të investimeve të sektorit privat, tkurrjen e shpenzimeve të sektorit publik, si dhe rritjen e shpejtë të importit të mallrave e shërbimeve. Përkundrejt tyre, konsumi familjar vijoi të shënojë norma të qëndrueshme rritjeje.

Në një këndvështrim më afatgjatë, trendi rritës i kërkesës për mallra e shërbime ka sjellë një shfrytëzim gjithnjë e më të plotë të kapaciteteve prodhuese në vend. Kjo tendencë është veçanërisht prezente në tregun e punës, ku shkalla e papunësisë zbriti në minimumin historik prej 11.1%

në tremujorin e dytë. Rritja e kërkesës për punë dhe mungesa e fuqisë punëtore po ushtrojnë presione rritëse mbi pagat në sektorin privat. Kjo ecuri siguron mbështetje për të ardhurat e familjeve shqiptare në periudhën në vazhdim, por është edhe premisë për një qëndrueshmëri më të gjatë në kohë të presioneve inflacioniste.

Ambienti i brendshëm monetar vijon të mbetet stimulues, ndërsa tregjet financiare shqiptare vijojnë të jenë të qeta. Rritja e normës bazë të interesit po transmetohet në tregun financiar, por normat e interesit janë ende stimuluese dhe pranë niveleve të ulëta historike. Nga ana tjetër, kursi i këmbimit të lekut mbetet në pozita të forta ndaj monedhës evropiane, duke ndihmuar absorbimin e një pjese të goditjes së ofertës që vjen nga tregu i huaj.

**Grafik 28. Normat e interesit për kredinë në lekë janë rritur lehtas për bizneset, ndërkohë që për individët rritja është më e theksuar**



*Shënim: të dhënat tregojnë normat e interesit mujor të kredisë së re në lekë në %; mesatare rrethjuese 6-mujore.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Kredia bankare ka vijuar të financojë konsumin dhe investimet, në reflektim të kërkesës së lartë, të kushteve ende të favorshme të financimit, si dhe të shëndetit të mirë të sektorit bankar. Kredia për sektorin privat u rrit me 13.7% në muajin gusht, duke vijuar trendin e viteve të fundit. Rritja e saj ka vijuar të jetë e pranishme si tek bizneset dhe tek individët, për qëllime investimi dhe shpenzimi, si në monedhën lek ashtu edhe në valutë. Krahas trendit rritës të kredisë dhe diversifikimit të saj, cilësia e portofolit mbetet e mirë sikurse ilustron nga treguesi i kredive me probleme, i cili mbetet në nivele të ulëta.

Përditësimi i parashikimeve rikonfirmon vlerësimet tona të mëparshme se inflacioni do të kthehet në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024. Në terma të dinamikës kohore, inflacioni pritet të mbetet i lartë në dy tremujorët në vazhdim dhe të nisë rënien në periudhën pasuese.

Ky parashikim faktorizon pritjet për zbutjen progresive të presioneve inflacioniste në ambientin e huaj. Gjithashtu, ai kërkon normalizimin e qëndrimit të politikës monetare, për të siguruar kontrollin e efekteve të rëndësishme të dytë në ekonominë vendase.

Nga ana tjetër, përditësimi i parashikimeve sugjeron se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet në horizontin afatmesëm, ndonëse ritmi i rritjes do të jetë disi më i ulët. Përkeqësimi i perspektivës ekonomike në Evropë, ndikimi negativ që çmimet e larta kanë në fuqinë blerëse të familjeve, si dhe reduktimi i stimulit fiskal, pritet të ngadalësojnë konsumin familjar dhe investimet e bizneseve në vijim. Nga ana tjetër, niveli i lartë i depozitave, rritja e punësimit dhe e pagave, rritja e kredisë bankare dhe paketat e rezistencës sociale pritet të sigurojnë mbështetje për bilancet e sektorit privat.

Informacioni i disponuar sugjeron se balanca e rreziqeve mbi inflacionin qëndron në kahun e sipërm, ndërsa balanca e rreziqeve mbi rritjen ekonomike qëndron në kahun e poshtëm. Në veçanti, lufta në Ukrainë është burim kryesor i pasigurisë dhe përshkallëzimi i konfliktit mund të çojë në çmime më të larta të mallrave, ndërprerje të zinxhirëve të furnizimit dhe rritje më të ulët ose edhe negative ekonomike rajonale dhe evropiane.

Duke gjykuar mbi sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të rrisë me 0.5 pikë përqindje normën bazë të interesit, duke e çuar atë në nivelin 2.25%;
- të rrisë me 0.5 pikë përqindje normën e interesit të depozitës njëditore, duke e çuar atë në nivelin 1.25%;
- të rrisë me 0.5 pikë përqindje normën e interesit të kredisë njëditore, duke e çuar atë në nivelin 3.25%.

Në gjykimin e Këshillit, normalizimi gradual i qëndrimit të politikës monetare, nga pozicioni tejte stimuluses i saj në trajtat aktuale në një pozicion më neutral, është një masë e domosdoshme për respektimin e objektivit tonë të inflacionit të çmimeve. Në këtë këndvështrim, ky normalizim i shërben stabilitetit të përgjithshëm ekonomik dhe financiar

të vendit, rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë dhe përmirësimit të mirëqenies sociale.

Në konsistencë me komunikimet e kaluara dhe me parashikimet tona afatmesme, Këshilli Mbikëqyrës thekson se cikli normalizues i politikës monetare do të vijojë edhe në tremujorët në vazhdim. Në çdo rast, shpejtësia e normalizimit do të jetë në përputhje me të dhënat e reja dhe e mjaftueshme për të respektuar objektivin tonë afatmesëm të inflacionit.

Këshilli Mbikëqyrës do të monitorojë me kujdes situatën për të vlerësuar në kohë implikimet për ecurinë e inflacionit dhe për të identifikuar në kohë masat e nevojshme për administrimin efektiv të saj.

***“Këshilli Mbikëqyrës thekson se cikli normalizues i politikës monetare do të vijojë edhe në tremujorët në vazhdim. Në çdo rast, shpejtësia e normalizimit do të jetë në përputhje me të dhënat e reja dhe e mjaftueshme për të respektuar objektivin tonë afatmesëm të inflacionit.”***

## BANKA E SHQIPËRISË RRIËT NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 2.75%

- 2 nëntor 2022 -


- Pasaajat e goditjes së huaj të ofertës në ekonominë shqiptare po bëhen gjithnjë e më të dukshme.
- Presionet inflacioniste po vijnë në rritje dhe baza e tyre shfaqet në zgjerim
- Këshilli Mbikëqyrës vendosi të vijojë procesin e normalizimit të qëndrimit të politikës monetare.
- Ky normalizim është i nevojshëm për kontrollin e presioneve inflacioniste dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2024.

*Të nderuar përfaqësues të medias,*

Sot, në datën 2 nëntor 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin Tremujor të Politikës Monetare. Ky Raport konstaton se pasajaat e goditjes së ofertës të huaj në ekonominë shqiptare po bëhen gjithnjë e më të dukshme.

Në veçanti, analiza e informacionit të disponuar sugjeron se presionet inflacioniste po vijnë në rritje dhe baza e tyre shfaqet në zgjerim. Ky gjykim bazohet në vijimin e pranisë së çmimeve të larta në tregjet botërore, kërkesën relativisht të qëndrueshme për mallra e shërbime në vend, shfrytëzimin në rritje të kapaciteteve prodhuese, si dhe në rritjen e nivelit të pritur të inflacionit nga agjentët ekonomikë.

*Grafik 29. Norma bazë e interesit, nëntor 2022*



Burimi: Banka e Shqipërisë.


Në këto rrethana, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të vijojë procesin e normalizimit të qëndrimit të politikës monetare. Ky normalizim është i nevojshëm për kontrollin e presioneve inflacioniste dhe kthimin e inflacionit në objektiv brenda vitit 2024. Në këtë mënyrë, Banka e Shqipërisë do të ndihmojë ruajtjen e stabilitetit të brendshëm monetar dhe financiar dhe do të krijojë kushte të përshtatshme për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë shqiptare.

Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi rritje të mëtejshme në tremujorin e tretë. Ky inflacion regjistroi një vlerë mesatare prej 7.9% gjatë tremujorit, duke shfaqur dhe rritje progresive gjatë tij.

Në këndvështrimin e shportës së konsumit, rritja e inflacionit pasqyroi – në masën më të madhe – rritjen e çmimit të ushqimeve, të naftës dhe të kostove të transportit. Këta grup-artikuj gjeneruan rreth 80% të inflacionit total në tremujorin e tretë. Megjithatë, rritja e çmimeve ka filluar të jetë e pranishme në pjesën më të madhe të shportës, përfshi edhe ata artikuj pjesa më e madhe e vlerës së shtuar të të cilëve krijohet në vend. Kjo ecuri sugjeron rritjen e njëkohshme të bazës dhe të intensitetit të presioneve inflacioniste.


**Grafik 30.**

*Kontributi i shtuar i inflacionit bazë drejtoi rritjen e inflacionit total*



Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e Bankës së Shqipërisë.

*Kontributi i brendshëm ishte mbizotërues në formimin e inflacionit total*



Burimi: INSTAT dhe vlerësimet e Bankës së Shqipërisë.

Në këndvështrimin makroekonomik, rritja e inflacionit pasqyron – në masën më të madhe – presionet e forta që vijnë nga ambienti i huaj, por dhe një kontribut në rritje nga ambienti i brendshëm. Rritja e presioneve të brendshme inflacioniste pasqyron veprimin e tre faktorëve.

Së pari, pozicioni i mirë ciklik i ekonomisë shqiptare, pozicioni i cili buron nga kërkesa e qëndrueshme për mallra e shërbime dhe nënkupton një shfrytëzim të lartë të kapaciteteve të brendshme prodhuese, është shoqëruar me rritje të shpejtë të pagave. Së dyti, çmimet e larta të lëndëve të para, të naftës dhe të energjisë, sjellin një rritje të mëtejshme të kostove të brendshme të prodhimit. Së treti, rritja e inflacionit të pritur ndikon në rritjen e çmimeve të kontratave të së ardhmes.

Edhe përballë këtyre goditjeve, ekonomia shqiptare ka vijuar të rritet gjatë vitit 2022. Sipas të dhënave të INSTAT-it, ekonomia shqiptare u rrit me 2.2% në tremujorin e dytë. Të dhënat e tërthorta sugjerojnë se rritja ekonomike ka vijuar të mbetet në territor pozitiv edhe në tremujorin e tretë. Ajo u mbështet nga zgjerimi i konsumit privat dhe i eksportit të mallrave e të shërbimeve. Kjo ecuri u pasqyrua në zgjerimin e sektorit të shërbimeve, të bujqësisë dhe të degëve të caktuara të sektorit të industrisë, si dhe në rritjen e mëtejshme të punësimit dhe të pagave në sektorin privat. Këto të fundit shënuan një rritje vjetore prej 11.9% në tremujorin e dytë, duke ilustruar si kërkesën solide për punë ashtu edhe rënien e vazhdueshme të normës së papunësisë.


Zgjerimi i aktivitetit ekonomik ka vijuar të mbështetet nga një ambient financiar stimulues, ndonëse intensiteti i stimulit monetar ka ardhur drejt reduktimit. Tregjet financiare në vend vijnë të jenë të qeta, likuiditeti në to është i mjaftueshëm për plotësimin e nevojave të ekonomisë, normat e interesit janë ende akomoduese, ndërsa kursi i këmbimit vijon të shfaqet i fortë dhe i qëndrueshëm. Ky ambient financiar ka mundësuar ruajtjen e ritmeve të rritjes së kredisë për sektorin privat. Në muajin shtator, ky portofol regjistroi një rritje vjetore prej 13.9%, duke mbuluar nevojat për fonde – në lekë e në valutë – të bizneseve dhe familjeve shqiptare.

Megjithatë, ritmi i rritjes së ekonomisë ka ardhur në ngadalësim pas tremujorit të parë. Ky ngadalësim pasqyron efektet negative që burojnë nga nivelet e larta të inflacionit, në vend dhe në botë. Ndër të tjera, këto efekte shfaqen në formën e rritjes së pasigurisë së bizneseve, të shtrëngimit të detyruar të kushteve të financimit, të tkurrjes së fuqisë blerëse të familjeve, si dhe të shtrenjimit të faturës së importit të ekonomisë shqiptare.

Projeksionet tona të skenarit bazë për dy vitet e ardhshme, sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet dhe presionet inflacioniste do të vijnë në reduktim.


**Grafik 31.**

*Kredia për sektorin privat ka shfaqur norma të larta rritjeje, ku përmirësimi i normave të rritjes së kredisë në monedhë të huaja ka kompensuar ngadalësimin e asaj në lekë*



*Shënime: Të dhënat përfaqësojnë ndryshimet vjetore (%) të kredisë të pastruar nga lëvizjet e kursit dhe nxjerjet nga bilanci.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

*Rritja e shpejtë e kredisë është mbështetur nga zgjerimi i kredisë për bizneset për të mbuluar nevojat për likuiditet*



*Shënime: Të dhënat përfaqësojnë ndryshimin vjetor të KSP dhe kontributet e kredisë sipas qëllimit të përdorimit.  
Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Inflacioni pritet të mbetet i lartë në tremujorin e katërt të vitit aktual, por të reduktohet progresivisht gjatë vitit 2023 dhe të kthehet në objektiv në tremujorin e dytë të vitit 2024. Ky projektion mbetet i kushtëzuar nga vijimi i procesit të normalizimit të qëndrimit të politikës monetare. Gjithashtu, ai faktorizon pritjet tona për stabilizimin e çmimeve në tregjet e huaja dhe për zgjerimin e mëtejshëm të aktivitetit ekonomik në vend.

Rritja ekonomike e vendit pritet të mbetet në territor pozitiv, ndonëse ritmi i rritjes do të vijë në ngadalësim në afatin e shkurtër dhe do të përshpejtohet në afatin e mesëm. Rritja ekonomike do të vijojë të ushqehet nga bilanci i shëndosha të bizneseve dhe familjeve, nga zgjerimi i mëtejshëm i eksporteve shqiptare, si dhe nga ulja e pasigurisë në përgjigje të reduktimit të pritjes së inflacionit. Po ashtu, zgjerimi i aktivitetit ekonomik do të vijojë të përfitojë nga një ambient i qëndrueshëm monetar dhe financiar. Në veçanti, bilanci financiar i shëndosha dhe likuide të sektorit bankar japin garanci se ky sektor do të vijojë të mbështesë me fonde bizneset dhe familjet shqiptare, duke ndihmuar si zgjerimin e konsumit dhe të investimeve ashtu edhe mbulimin e nevojave të përkohshme për likuiditet.

Megjithatë, Banka e Shqipërisë thekson se ambienti i përgjithshëm mbetet sfidues dhe projektionet për të ardhmen rrethohen nga pasiguri të shtuara. Këto pasiguri qëndrojnë në kahun e sipërm për inflacionin dhe në kahun e poshtëm për rritjen ekonomike.



Bazuar në sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë rikonfirmoi gjykimin e tij se presionet e larta inflacioniste mbeten rreziku kryesor mbi rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

Për këtë arsye, në respektim të objektivit të stabilitetit të çmimeve, Këshilli Mbikëqyrës vendosi:

- të rrisë me 0.5 pikë përqindje normën bazë të interesit, nga niveli 2.25% në nivelin 2.75%;
- të rrisë me 0.5 pikë përqindje normën e interesit të kredisë njëditore, nga niveli 3.25% në nivelin 3.75%;
- të rrisë me 0.5 pikë përqindje normën e interesit të depozitës njëditore, nga niveli 1.25% në nivelin 1.75%.

Në gjykimin e Këshillit, normalizimi gradual i qëndrimit të politikës monetare, nga pozicioni ende stimulues i saj në trajtat aktuale në një pozicion më neutral, është një masë e domosdoshme për respektimin e objektivit tonë të inflacionit të çmimeve. Në këtë këndvështrim, ky normalizim i shërben stabilitetit të përgjithshëm ekonomik dhe financiar të vendit, rritjes së qëndrueshme dhe afatgjatë, dhe përmirësimit të mirëqenies sociale.

Në konsistencë me komunikimet e kaluara dhe me parashikimet tona afatmesme, Këshilli Mbikëqyrës thekson se cikli normalizues i politikës monetare do të vijojë edhe në të ardhmen e afërt. Në çdo rast, shpejtësia e normalizimit do të jetë në përputhje me të dhënat e reja dhe e mjaftueshme për të respektuar objektivin tonë afatmesëm të inflacionit. Këshilli Mbikëqyrës do të monitorojë me kujdes situatën për të vlerësuar në kohë implikimet për ecurinë e inflacionit dhe për të identifikuar në kohë masat e nevojshme për administrimin efektiv të saj.

***“Këshilli Mbikëqyrës thekson se cikli normalizues i politikës monetare do të vijojë edhe në të ardhmen e afërt. Në çdo rast, shpejtësia e normalizimit do të jetë në përputhje me të dhënat e reja dhe e mjaftueshme për të respektuar objektivin tonë afatmesëm të inflacionit.”***



## **BANKA E SHQIPËRISË MBAN TË PANDRYSHUAR NORMËN BAZË TË INTERESIT NË NIVELIN 2.75% - 21 dhjetor 2022 -**

- *Efeki i goditjes së huaj vijon të jetë prezent në ekonominë shqiptare.*
- *Inflacioni do të kthehet në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024.*
- *Normalizimi i deritanishëm i qëndrimit të politikës monetare ka kontribuar në zbutjen e presioneve inflacioniste.*
- *Aktiviteti ekonomik ka vijuar të rritet në gjysmën e dytë të vitit.*

### *Të nderuar përfaqësues të medias,*


Sot, në datën 21 dhjetor 2022, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë mori në shqyrtim dhe miratoi Raportin e Ndërmjetëm të Politikës Monetare për tremujorin e katërt.

Këshilli Mbikëqyrës konstatoi se efekti i goditjes së huaj vijon të jetë prezent në ekonominë shqiptare. Megjithatë, trajektorja e inflacionit duket se ka shënuar një kthesë drejt reduktimit në tremujorin e katërt, ndërsa aktiviteti ekonomik vijon të jetë nën presionin e çmimeve të rritura dhe të pasigurisë së shtuar.

Përditësimi i parashikimeve për të ardhmen sugjeron se inflacioni do të kthehet në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024. Po ashtu, ekonomia shqiptare pritet të rritet në të ardhmen, ndonëse ritmi i rritjes pritet të vijë në ngadalësim në afatin e shkurtër dhe të rritet drejt potencialit në afatin e mesëm.

Këshilli Mbikëqyrës vlerësoi se normalizimi i deritanishëm i qëndrimit të politikës monetare ka kontribuar në zbutjen e presioneve inflacioniste, nëpërmjet kontrollit të pritjeve për inflacionin, reduktimit të pasigurisë dhe ruajtjes së stabilitetit në tregjet financiare, si dhe garantimit të qëndrueshmërisë së monedhës tonë kombëtare.

Grafik 32. Norma bazë e interesit, dhjetor 2022



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Mbështetur në këto konsiderata, në mbledhjen e sotme, Këshilli Mbikëqyrës vendosi të mos ndryshojë qëndrimin e politikës monetare. Ky vendim faktorizon reduktimin e inflacionit brenda dhe jashtë vendit në muajin nëntor, si dhe na mundëson një rivlerësim të shpejtësisë së normalizimit të qëndrimit të politikës monetare, në funksion të respektimit të objektivit të stabilitetit të çmimeve dhe të ruajtjes së ritmeve pozitive të rritjes ekonomike.


Në vijim, do të sqaroj më në detaje vendimin e sotëm dhe arsyet që e motivuan.

Inflacioni i çmimeve të konsumit shënoi një rritje të lehtë në muajin tetor dhe një reduktim të moderuar në muajin nëntor. Normat respektive të inflacionit në këta dy muaj ishin 8.3% dhe 7.9%.

Në këndvështrimin e shportës së konsumit, ecuria e inflacionit në këta dy muaj u përcaktua nga rënia e çmimit të naftës dhe të kostove të transportit, si dhe nga luhatje në kahe të kundërta të çmimeve të artikujve ushqimorë. Inflacioni i artikujve të tjerë të shportës shfaq luhatje më të pakta. Gjithsesi, me përjashtim të çmimit të energjisë elektrike, norma e inflacionit të thujtë të gjithë artikujve të shportës mbetet në nivele të larta historike dhe shfaq shenja të qarta ndikimi nga goditja e huaj.

Grafik 33.

*Inflacioni në Shqipëri ngadalësoi ritmet ritëse, si pasojë e rënies të presioneve të përgjithshme inflacioniste.*




— Inflacioni vjetor  
— Inflacioni mes. me bazë vjetore  
— Objektiv

Burimi: INSTAT, llogaritje të BSH-së.

Shënim: Norma e inflacionit është ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (publikuar nga INSTAT)

*Rënia e kosteve në përgjithësi, veçanërisht e atyre të transportit, shkaktoi rënie globale të inflacionit.*



— Shqipëria — Vendet e rajonit — BE

Burimi: INSTAT, llogaritje të BSH-së.

Shënim: Normat e inflacionit janë ndryshime vjetore, në përqindje.

Në këndvështrimin makroekonomik, ecuria e inflacionit u përcaktua nga reduktimi i efektit direkt të inflacionit të importuar. Ky fenomen ishte i pranishëm dhe në ecurinë e inflacionit të partnerëve tanë kryesorë tregtarë. Megjithatë, përtej efektit direkt, niveli i lartë i inflacionit vazhdon të ushqehet nga transmetimi i tyre në koston e mallrave dhe shërbimeve, si dhe nga kërkesa relativisht e qëndrueshme për mallra e shërbime në vend, e cila siguron një shkallë të lartë të shfrytëzimit të kapaciteteve, veçanërisht në tregun e punës.

Analiza e informacionit të disponuar sugjeron se aktiviteti ekonomik ka vijuar të rritet në gjysmën e dytë të vitit. Megjithatë, në ngjashmëri me tremujorin e dytë, ritmi i rritjes ekonomike ka shfaqur shenja ngadalësimi, si pasojë e pasigurive për të ardhmen, e rritjes së kostove të prodhimit dhe e reduktimit të kërkesës së huaj. Këto pasoja janë shfaqur në formën e shtrenjtimit të faturës së importeve, si dhe të një ecurie më të ngadaltë të investimeve private e publike.

Përkundrejt tyre, tregu i punës në tremujorin e tretë shfaqti një ecuri mjaft pozitive. Punësimi në ekonomi u rrit me 4.2% në terma vjetorë, norma e papunësisë zbriti në minimumin e ri historik prej 10.6%, ndërkohë që paga mesatare në sektorin privat shënoi një rritje vjetore prej 12.4%. Kjo ecuri dëshmon se kërkesa agregate në vend mbetet solide, e mjaftueshme për të gjeneruar rritje punësimi dhe pagash. Ajo ilustron, po ashtu, faktin se bazat e rritjes ekonomike të vendit janë relativisht të shëndetshme.

*Grafik 34. Rritja e vazhduar e punësimit ka nxitur rënie të mëtejshme në normës së papunësisë në nivele edhe më të ulëta historike*



Burimi: INSTAT dhe vlerësime të Bankës së Shqipërisë.

Tregjet financiare vazhdojnë të jenë të qeta. Kursi i këmbimit të lekut ndaj euros ka pasur tendenca forcimi, ndërsa transmetimi i normalizimit të qëndrimit të politikës monetare, si në vend ashtu edhe në Eurozonë, po shfaqet gjithnjë e më i plotë. Megjithatë, edhe pse normat e interesit të produkteve kryesore financiare - depozitave, kredive dhe letrave me vlerë të qeverisë - kanë ardhur në rritje, ato vijojnë të mbeten akomoduese për rritjen. Në përgjigje të tyre, kredia vjetore vijon të shfaqë flukse mujore pozitive, ndonëse ritmi i rritjes ishte në ngadalësim gjatë muajit tetor. Në të njëjtën kohë, cilësia e portofolit të kredisë është e kënaqshme dhe shfaq tendenca përmirësimi.

Projeksionet tona të skenarit bazë, sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet dhe presionet inflacioniste do të vijnë në reduktim gjatë dy viteve të ardhshme.

Inflacioni pritet të shënojë një pikë kthese gjatë tremujorit të katërt të vitit 2022, të reduktohet progresivisht gjatë vitit 2023 dhe të kthehet në objektiv në tremujorin e dytë të vitit 2024. Ky parashikim bazohet në reduktimin e pritit të inflacionit në ambientin botëror, në reduktimin progresiv të efekteve të rrethit të dytë në vend, si dhe në ruajtjen e normave pozitive të rritjes ekonomike gjatë periudhës në vijim. Rritja ekonomike pritet të mbetet e moderuar edhe në gjysmën e parë të vitit të ardhshëm dhe të konvergojë gradualisht drejt normave të saj historike

në periudhën në vijim, duke ofruar një raport më të balancuar midis kërkesës dhe ofertës në vend.

Përditësimi i projeksioneve për të ardhmen ka konfirmuar pritjet tona të mëparshme. Megjithatë, ky përditësim ka sugjeruar nevojën e një normalizimi më gradual të qëndrimit të politikës monetare.

Bazuar në sa më sipër, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë vendosi:

- të mbajë të pandryshuar normën bazë të interesit, në nivelin 2.75%;
- të mbajë të pandryshuar normën e interesit të kredisë njëditore, në nivelin 3.75%;
- të mbajë të pandryshuar normën e interesit të depozitës njëditore, në nivelin 1.75%.

Këshilli Mbikëqyrës rikonfirmon gjykimin e tij se presionet e larta inflacioniste mbeten rreziku kryesor mbi rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit. Gjithashtu, ai thekson se, bazuar në informacionin aktual, normalizimi i mëtejshëm i qëndrimit të politikës monetare mbetet një masë e nevojshme për respektimin e objektivit tonë të inflacionit të çmimeve. Ky normalizim bëhet edhe më i nevojshëm, në prani të një balance rreziku për inflacionin, e cila qëndron ende në kahun e sipërm.

Në linjë me komunikimet e mëparshme, Këshilli Mbikëqyrës thekson se shpejtësia dhe intensiteti i këtij normalizimi ka qenë dhe do të mbetet një proces i udhëhequr nga të dhënat e reja. Qëndrimi i politikës monetare do të synojë të sigurojë kushtet e nevojshme për respektimin e objektivit të stabilitetit të çmimeve në afatin e mesëm, duke u kujdesur në të njëjtën kohë të minimizojë ndikimin e tyre në frenimin e aktivitetit ekonomik.

Këshilli Mbikëqyrës do të monitorojë me kujdes situatën, për të vlerësuar në vazhdimësi ecurinë e presioneve inflacioniste dhe për të identifikuar në kohë masat e nevojshme për arritjen e objektivit.

***“Këshilli Mbikëqyrës rikonfirmon gjykimin e tij se presionet e larta inflacioniste mbeten rreziku kryesor mbi rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit. Gjithashtu, ai thekson se, bazuar në informacionin aktual, normalizimi i mëtejshëm i qëndrimit të politikës monetare mbetet një masë e nevojshme për respektimin e objektivit tonë të inflacionit të çmimeve.”***

### *Të nderuar përfaqësues të medias,*

Duke përfituar nga ky komunikim publik, i cili është dhe i fundit për vitin 2022, dëshiroj që – në respekt të traditës – të bëj dhe një pasqyrë të shkurtër të punës së Bankës së Shqipërisë gjatë vitit që lamë pas.

Sikundër është bërë tashmë prezente, ky ishte një tjetër vit sfidues për ekonominë shqiptare, në nivel makro dhe mikroekonomik, për stabilitetin monetar e financiar, si dhe për vendimmarrësit e sektorit publik dhe privat. Si autoriteti monetar i vendit, si një institucion kyç në ruajtjen e stabilitetit financiar, në zhvillimin e tregut financiar dhe në përmirësimin e sistemit të pagesave, si dhe si një institucion kushtetues i ngarkuar me një sërë funksionesh të cilat promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit, Banka e Shqipërisë ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në përballimin e këtyre sfidave.


Në vijim, do të rendis disa prej drejtimeve kryesore të punës sonë.

Së pari, ne kemi iniciuar një cikël normalizimi të qëndrimit të politikës monetare gjatë vitit 2022, duke e rritur normën bazë të interesit nga minimumi historik prej 0.5% në fillim të vitit, në nivelin 2.75% në fund të tij. Ky aksion i politikës sonë monetare ishte i ngjashëm me atë të të gjitha bankave të tjera qendrore, anembanë globit. Ai u motivua nga goditja e fortë dhe e paprecedentë e çmimeve në tregun e huaj, goditje e cila buroi nga agresioni i papritur ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës dhe e cila kërcënoi stabilitetin e çmimeve kudo në botë.

Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare ishte një proces i nevojshëm dhe i kujdesshëm, sepse krijon premisat e domosdoshme për respektimin e objektivit tonë të inflacionit, çka është dhe mbetet jo vetëm mandati ynë ligjor por edhe kontributi më i mirë që ne mund të japim për rritjen ekonomike dhe për mirëqenien shoqërore në afatin e mesëm dhe të gjatë. Historia e ekonomisë na mëson se periudhat me inflacion të lartë shoqërohen me rritje të ulët e të luhatshme ekonomike, me më pak vende pune të krijuara dhe me paga e të ardhura më të ulëta për një pjesë të madhe të shoqërisë. Në të njëjtën kohë, ky normalizim ka qenë një proces i kujdesshëm, i udhëhequr gjithnjë nga analiza e kujdesshme e informacionit të ri, duke synuar që masat e nevojshme monetare për kontrollin e inflacionit të kenë një kosto sa më të ulët mbi aktivitetin ekonomik. Kjo filozofi do të udhëheqë vendimmarrjen tonë të politikës monetare edhe gjatë vitit të ardhshëm.



Së dyti, ne kemi kontribuar në ofrimin e një sistemi financiar të shëndoshë dhe efikas, nëpërmjet forcimit të kuadrit ligjor e rregullator, nëpërmjet mbikëqyrjes së kujdesshme të veprimtarisë bankare dhe bashkëpunimit intensiv me autoritetet homologe, si dhe nëpërmjet luftës ndaj pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Paralelisht me to, gjatë vitit 2022, ne përditësuam ciklin vjetor të planeve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme dhe administruam me kujdes Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, fond i cili ka ardhur në rritje të vazhdueshme dhe ofron një garanci shtesë për përballimin e goditjeve financiare.




Paralelisht me punën tonë, konstatoj me kënaqësi se bankat shqiptare gëzojnë rezerva të mira kapitali, likuiditeti dhe norma të ulëta të kredive me probleme; këto të fundit zbritën në 5% në muajin tetor, niveli më i ulët historik. Po ashtu, testet tona të rezistencës tregojnë se sistemi bankar është, në tërësi, rezistent ndaj goditjeve edhe më ekstreme, dhe i aftë të mbështesë ekonominë.

Së treti, ne kemi ofruar sisteme moderne eficiente për kryerjen e pagesave dhe kemi plotësuar kërkesat e ekonomisë për para fizike, duke forcuar besimin në sistemin tonë monetar e financiar. Falë një pune disa-vjeçare, përfshirja financiare e popullsisë dhe përdorimi i instrumenteve elektronike të pagesave ka ardhur në rritje, sikurse dëshmohet nga numri

më i lartë i shqiptarëve me llogari bankare dhe i pagesave elektronike. Ndërkohë, operacionalizimi i sistemit të shlyerjes së pagesave në Euro brenda vendit ka reduktuar ndjeshëm kostot dhe i ka kursyer shqiptarëve rreth 10 milionë euro.


**Grafik 35. Ecuria e numrit dhe vlerës së transaksioneve për klientët, të procesuara në sistemin AIPS EURO**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjithashtu, gjatë vitit 2022, ne plotësuam serinë e kartëmonedhave të reja me dy prerjet e fundit, respektivisht me ato 500 dhe 2000 Lekë.

**Grafik 36. Ecuria e rezervës valutore**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Së katërti, ne kemi vijuar punën për administrimin e rezervës valutore të Shqipërisë, duke respektuar kriteret më të mira në fushën e likuiditetit dhe të sigurisë. Në aspektin operacional, dëshiroj të përmend gjithashtu masat që kemi marrë për një pjesëmarrje më të gjerë të individëve në ankandet e letrave me vlerë të qeverisë, duke reduktuar luhatjet në tregjet financiare dhe duke mundësuar një përcjellje më të mirë të politikës monetare në tregje.

Së pesti, ne kemi kontribuar aktivisht në procesin e integritit evropian, si dhe kemi forcuar dialogun me partnerët vendas dhe huaj. Hapja e negociatave në korrik 2022 shënoi jo vetëm një hap të rëndësishëm në progresin e vendit drejt rrugës së anëtarësimit, por kërkoi një angazhim më intensiv në këtë drejtim, angazhim të cilit Banka e Shqipërisë iu përgjigj në kohë dhe me cilësi. Sipas Raport-Progressit të fundit të Komisionit Evropian, Banka e Shqipërisë vlerësohet si një institucion i pavarur financiarisht, me instrumente, kompetencë dhe kapacitete të mjaftueshme administrative për të hartuar e zbatuar një politikë monetare efikase. Edhe në të ardhmen, ne do të vazhdojmë të kontribuojmë me përgjegjshmëri në procesin e integritit të vendit, si një aspiratë e kahershme e jona. Po ashtu, gjatë vitit ne kemi bashkëpunuar me Bankën Botërore dhe partnerë të tjerë institucionalë për ngritjen e dy strategjive të rëndësishme në nivel kombëtar: Strategjinë për Ndryshimet Klimatike në Sistemin Bankar dhe atë për Edukimin dhe Përfshirjen Financiare.

Së fundi, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë ka punuar dhe shënuar progres në të gjitha sferat e tjera të aktivitetit të saj: statistikatat financiare, komunikimin me publikun dhe aktorët ekonomikë e shoqërorë, edukimin financiar, kërkimin shkencor, etj.

Përbushja e objektivave dhe rezultatet e punës sonë janë orientuar dhe mbështetur nga një vendimmarrje e kujdesshme, koherente dhe profesionale nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë. Kjo vendimmarrje ka jetësuar misionin, vizionin dhe vlerat e Bankës, sikurse shpalosen në Strategjinë Afatmesme të Zhvillimit të Bankës së Shqipërisë. Në veprimtarinë e tij, Këshilli është informuar rregullisht nga hallkat e kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin e respektimit korrekt të ligjit dhe të akteve të tjera që rregullojnë veprimtarinë e përditshme të institucionit.

Në përfundim, më lejoni t'ju siguroj se Banka e Shqipërisë ka qenë dhe do të mbetet një institucion i investuar në përmirësimin e gjithanshëm të punës dhe në përvetësimin e standardeve më të mira të bankingut

qendror. Mjedisi global dhe ai i brendshëm mbeten sfidues, por ne do të jemi vigjilentë ndaj zhvillimeve të reja për të garantuar përmbushjen e detyrave tona ligjore, në interes të mirëqenies së shtetasve shqiptarë.

*Ju uroj të gjithëve një vit të mbarë!*

***“Banka e Shqipërisë ka qenë dhe do të mbetet një institucion i investuar në përmirësimin e gjithanshëm të punës dhe në përvetësimin e standardeve më të mira të bankingut qendror. Mjedisi global dhe ai i brendshëm mbeten sfidues, por ne do të jemi vigjilentë ndaj zhvillimeve të reja për të garantuar përmbushjen e detyrave tona ligjore, në interes të mirëqenies së shtetasve shqiptarë.”***





---

# KAPITULLI IV

## KONFERENCA PËR SHTYP ME SHEFEN E MISIONIT TË FMN-SË DHE MINISTREN E FINANCAVE DHE EKONOMISË

---

- *Fjala e Governorit Sejko në konferencën e përbashkët për shtyp online me Shefen e Misionit të FMN-së dhe Ministren e Financave dhe Ekonomisë, 10 tetor 2022*

### **Konferencat për shtyp me Shefen e Misionit të FMN-së dhe Ministren e Financave dhe Ekonomisë**

*Në kuadër të konsultimeve për Artikullin IV të neneve të marrëveshjes me FMN, misionet e Fondit vizitojnë Shqipërinë dhe kryejnë takime me përfaqësuesit e institucioneve kryesore të vendit për të diskutuar mbi ecurinë makroekonomike dhe zhvillimet më të fundit të Shqipërisë. Në përfundim të çdo vizite të misionit, organizohet një konferencë e përbashkët për shtyp e Governorit të Bankës së Shqipërisë, Shefes së Misionit të FMN-së dhe Ministres së Financave dhe Ekonomisë.*





## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË KONFERENCËN PËR SHTYP ME SHEFEN E MISIONIT TË FMN-SË DHE MINISTREN E FINANCIVE DHE EKONOMISË**

**- 10 tetor 2022 -**

Të nderuar përfaqësues të medias,

Sikundër jeni në dijeni, gjatë dy javëve të fundit, Banka e Shqipërisë dhe autoritetet shqiptare kanë qenë të angazhuara në diskutime intensive me misionin e FMN-së, të kryera në kuadër të Artikullit IV. Këto diskutime kanë pasur në fokus të tyre si sfidat aktuale me të cilat përballlet ekonomia shqiptare, ashtu edhe reformat strukturore, të cilat do të mundësonin një zhvillim më të shpejtë dhe më të qëndrueshëm të vendit në planin afatgjatë.

Duke përfituar nga rasti, më lejoni – në radhë të parë – të falënderoj Misionin e FMN-së për shkëmbimin e hapur të pikëpamjeve dhe diskutimet e frytshme dhe transparente. Në tërësi, konstatoj se Banka e Shqipërisë dhe FMN-ja kanë ndarë opinione të ngjashme mbi sfidat e zhvillimit që kemi përpara.

Rritja e shpejtë e çmimeve në tregjet botërore, pas sulmit ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës, i ka përballur ekonominë dhe shoqëritë e të gjithë vendeve të globit, përfshirë dhe Shqipërinë, me sfida serioze ekonomike e sociale.

Inflacioni në vend shënoi vlerën 8% në muajin gusht, duke shfaqur një rritje të shpejtë dhe duke pasur një bazë të gjerë. Sikundër e kemi theksuar dhe më parë, në gjykimin tonë, inflacioni i lartë përbën kërcënimin kryesor mbi stabilitetin makroekonomik dhe mbi rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit. Ky inflacion gërryen fuqinë blerëse të familjeve, rrit pasigurinë për të ardhmen në çdo qelizë të ekonomisë, nxit volatilitetin në tregjet financiare dhe dëmton perspektivat afatgjata të zhvillimit.

***“Banka e Shqipërisë është angazhuar në normalizimin gradual të politikës monetare. Ky normalizim është një proces simetrik me atë të ndërmarrë nga të gjitha ato banka qendrore, në rajon dhe në botë, të cilat po përballen me fenomenin e inflacionit të lartë.”***

Për këtë arsye, fokusi prioritar i politikave ekonomike duhet të jetë marrja e masave të koordinuara për zbutjen e kostove të inflacionit dhe kontrollin e kthimin e tij në objektiv, në një periudhë sa më të shpejtë dhe me kosto sa më të ulëta.

Bazuar në këto konsiderata, Banka e Shqipërisë është angazhuar në normalizimin gradual të politikës monetare. Ky normalizim është një proces simetrik me atë të ndërmarrë nga të gjitha ato banka qendrore, në rajon dhe në botë, të cilat po përballen me fenomenin e inflacionit të lartë. Ai nënkupton një rritje progresive të normës bazë të interesit, duke ndryshuar gradualisht natyrën e qëndrimit të politikës monetare, nga pozicioni aktual, i cili ka qenë dhe mbetet stimulues, drejt një pozicioni më neutral që ofron një mbështetje më të qëndrueshme për rritjen afatgjatë të vendit.

Gjatë bisedimeve të dy javëve të fundit, kemi konstatuar me kënaqësi se ky këndvështrim i yni ndahet edhe nga Misioni i FMN-së dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

Projeksionet tona për të ardhmen sugjerojnë se inflacioni do të vijojë të mbetet në nivele të larta edhe gjatë dy tremujorëve në vijim. Më tej, stabilizimi i çmimeve në tregjet e huaja dhe normalizimi i qëndrimit të politikës monetare do të indukojnë një reduktim progresiv të inflacionit, deri në kthimin e tij në objektiv në gjysmën e parë të vitit 2024.

***“Projeksionet tona sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet përgjatë horizontit afatmesëm. Ndonëse aktiviteti ekonomik do të vuajë pasojat negative të inflacionit, rritja ekonomike e vendit pritet të mbetet në territor pozitiv. Rritja ekonomike do të vijojë të përfitojë nga stabiliteti i përgjithshëm ekonomik dhe financiar i vendit, nga bilancet e shëndosha të bizneseve dhe familjeve, si dhe nga vijimi i mbështetjes me kredi e instrumente pagese nga sektori bankar.”***

Paralelisht me të, projeksionet tona sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet përgjatë horizontit afatmesëm. Ndonëse aktiviteti ekonomik do të vuajë pasojat negative të inflacionit, rritja ekonomike e vendit pritet të mbetet në territor pozitiv.

Rritja ekonomike do të vijojë të përfitojë nga stabiliteti i përgjithshëm ekonomik dhe financiar i vendit, nga bilancet e shëndosha të bizneseve dhe familjeve, si dhe nga vijimi i mbështetjes me kredi e instrumente pagese nga sektori bankar.

Në këtë kontekst, gjej me vend të theksoj se sektori bankar shqiptar paraqitet i shëndetshëm, likuid dhe i mirëkapitalizuar. Reformat e vazhdueshme që kemi ndërmarrë në vitet e fundit kanë dhënë frytet e veta. Konsolidimi i sektorit bankar, përmirësimi i ambientit të kredisë, zhvillimi i gjithanshëm i tregjeve financiare dhe i sistemeve të pagesave, si dhe nismat për nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare, kanë sjellë përmirësime të dukshme cilësore në qëndrueshmërinë dhe eficiencën e sektorit bankar. Kredia për sektorin privat ka shënuar një përmirësim progresiv të normës së rritjes, duke kulmuar në nivelin 13.7%, në muajin gusht. Gjithashtu, ajo shfaq një mbulim të mirë të nevojave të biznesit e të familjeve për financim afatgjatë apo për mjete likuide. Rritja e qëndrueshme e kredisë, si dhe cilësia në rritje e portofolit të saj, janë indikatorë të rëndësishëm të mbështetjes që ky sektor ka dhënë dhe po jep në procesin e rimëkëmbjes së vendit.

Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të punojë intensivisht në drejtim të rregullimit dhe mbikëqyrjes së kujdesshme të aktivitetit bankar, të zhvillimit të tregjeve financiare dhe të sistemeve të pagesave, të promovimit të stabilitetit financiar të vendit, si dhe të rritjes së shkallës së edukimit dhe të përfshirjes financiare të publikut. Ndonëse sfidat që kemi përpara nuk mungojnë, jam i bindur se industria bankare do të vijojë të jetë një partner i besueshëm i biznesit dhe familjeve shqiptare.

Në përfundim, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë mbështet dhe inkurajon ruajtjen e vëmendjes drejt reformave strukturore. Tashmë kjo agjendë reformash gjen një ankorë të fortë në procesin e negociatave që po zhvillojmë në kuadër të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Investimi i vazhdueshëm në reforma që nxisin dhe inkurajojnë stabilitetin makroekonomik të vendit, përmirësimin e klimës së biznesit, rritjen e eficiencës dhe të konkurrueshmërisë, përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, si dhe zhvillimin e gjithanshëm të infrastrukturës, është rruga e vetme drejt një progresi më të shpejtë ekonomik dhe social.

***“Investimi i vazhdueshëm në reforma që nxisin dhe inkurajojnë stabilitetin makroekonomik të vendit, përmirësimin e klimës së biznesit, rritjen e eficiencës dhe të konkurrueshmërisë, përmirësimin e kapaciteteve njerëzore dhe institucionale, si dhe zhvillimin e gjithanshëm të infrastrukturës, është rruga e vetme drejt një progresi më të shpejtë ekonomik dhe social.”***



---

# KAPITULLI V

## FJALIME DHE PREZANTIME NË KONFERENCA

---

- *Fjala e Governorit Sejko në aktivitetin “Kreditimi dhe Financimi i Bujqësisë Shqiptare”, 26 janar 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në Ceremoninë Kremtuese të Javës së Parasë, 24 mars 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në Prezantinën e Raportit të Tranzicionit të BERZH 2021-2022, 5 prill 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në Ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së huasë për programin e BERZH-it për mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit në vend (AATSF) midis BERZH-it dhe ProCredit Bank Albania, 11 prill 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, 11 qershor 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në Forumin “Digjitalizimi kundrejt parasë fizike” të organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, 14 qershor 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në ceremoninë e promovimit të librit: “Drejt një krize të re”, 5 korrik 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në samitin e vendeve të rajonit me temë: “Politika Monetare në një mjedis inflacioni”, Bečići, Mal i Zi, 1 tetor 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në Konferencën Vjetore të Bankës së Shqipërisë, 27 tetor 2022*
- *Fjala e Governorit Sejko në mbledhjen VIII të Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave, 9 nëntor 2022*
- *Fjala përshëndetëse e Governorit Sejko në Asamblenë e Përgjithshme të Dhomës Amerikane të Tregtisë, 17 nëntor 2022*
- *Fjala e Governorit në Mbrëmjen e Vitit të Ri të Shoqatës Shqiptare të Bankave, 15 Dhjetor 2022*
- *Fjala e Governorit të Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko, në takimin me gazetarë, analistë dhe drejtues të medias, 20 dhjetor 2022*

### **Konferenca dhe seminare**

Banka e Shqipërisë organizon një sërë aktivitetesh publike, konferenca, seminare apo tryeza diskutimi për të trajtuar çështje të rëndësishme të bankingut qendror dhe të ekonomisë me rëndësi të veçantë për Bankën e Shqipërisë. Përveç këtyre, Governori i Bankës së Shqipërisë merr pjesë dhe në shumë aktivitete të tjera të organizuara nga institucionet kryesore në vend, institucionet ndërkombëtare financiare dhe bankat qendrore. Gjatë këtyre pjesëmarrjeve, Governori prezanton vlerësime dhe analiza të detajuara të Bankës së Shqipërisë si dhe opinionin e tij për zhvillimet ekonomiko-financiare dhe rolin e Bankës së Shqipërisë në këto zhvillime, eksperiencën e saj me politikën monetare dhe ruajtjen e stabilitetit financiar të vendit, si dhe sfidat e Bankës së Shqipërisë në çështje të ndryshme.



## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË AKTIVITETIN “KREDITIMI DHE FINANCIMI I BUJQËSISË SHQIPTARE”**

**-26 janar 2022-**

*I nderuar Zoti Kryeministër,  
Të nderuara Zonja Ministre,  
E nderuara zonja Drejtuese e BERZH-it për Shqipërinë,  
Të dashur miq e kolegë,*

Në radhë të parë, më lejoni t’ju falënderoj për ftesën për të marrë pjesë në këtë eveniment, të dizenuar për të diskutuar mbi problemet e kreditimit të sektorit bujqësor në vend dhe për të prezantuar nismën mbi mekanizmin lehtësues të financimit të agrobiznesit dhe turizmit shqiptar. Banka e Shqipërisë ka mirëpritur në vazhdimësi dialogun transparent e konstruktiv midis autoriteteve publike, sektorit privat, industrisë bankare dhe partnerëve ndërkombëtarë, për të adresuar çështje të cilat i shërbejnë zhbllokimit të potencialit zhvillimor të vendit dhe rritjes së mirëqenies së tij.

Në veçanti, më lejoni të evidentoj faktin se – me gjithë progresin e dukshëm të bërë gjatë viteve të fundit – sektori bujqësor shqiptar në tërësi dhe degët e lidhura me të: agroturizmi dhe agrobiznesi, janë ende larg shfrytëzimit të plotë të resurseve dhe mundësive që ato zotërojnë.

Për ta ilustruar me shifra, thuajse gjysma e popullsisë në Shqipëri banon në zona rurale dhe sektori bujqësor punëson rreth 1/3 e forcës punëtore të vendit. Megjithatë, ky sektor gjeneron diçka më pak se 20% të vlerës së shtuar në ekonomi, ndërsa produktiviteti i fuqisë punëtore të angazhuar në bujqësi dhe të ardhurat e tyre për frymë janë sa gjysma e degëve të tjera të ekonomisë.

Në këndvështrimin tim, është e qartë se zhvillimi i qëndrueshëm dhe i balancuar i vendit kërkon një vëmendje më të madhe për sektorin bujqësor, në interes jo vetëm të përmirësimit të strukturës prodhuese, por edhe të rritjes së mirëqenies së popullsisë rurale dhe të promovimit të barazisë sociale.

Problemet e zhvillimit të sektorit bujqësor janë të shumta e komplekse. Në një masë të madhe, ato qëndrojnë jashtë sferës së ekspertizës e

kompetencës së Bankës së Shqipërisë. Megjithatë, jam i bindur se tema e diskutimit të sotëm - mbështetja me fonde dhe kredi e sektorit bujqësor, meriton të ketë një vëmendje më të madhe nga sektori bankar.

Aktualisht, sektori bujqësor përfiton vetëm 1.7% të financimit që bankat ofrojnë për biznesin privat. Ky raport nuk ka ndryshuar në dekadën e fundit, me gjithë risitë që ka ofruar sistemi bankar për tregun e kredidhënies, dhe mbetet larg nevojave reale të sektorit.

Problemet specifike të kreditimit të sektorit bujqësor janë evidentuar me kohë dhe një pjesë e tyre mbeten ende relevante. Megjithatë, mendoj se disa prej tyre janë drejt adresimit, ndërsa pengesat e tjera duhet të jenë pjesë e një vlerësimi kritik dhe zgjidhja e tyre duhet të jetë pjesë integrale e axhendave tona të punës në të ardhmen.

Më konkretisht, arsyeja e parë e nivelit të ulët të kreditimit ka të bëjë me rrezikun e lartë, real e të perceptuar, që ka investimi në bujqësi. Megjithatë, ky rrezik mendoj se është drejt reduktimit. Nga njëra anë, përmirësimi i infrastrukturës mbështetëse të prodhimit bujqësor, përmirësimi i rrjetit rrugor dhe konsolidimi i zinxhirit të tregtisë që sjell produktet në tregje, përmirëson modelin e biznesit të këtij sektori. Nga ana tjetër, promovimi i agroturizmit dhe mbështetja e agrobiznesit rrit zinxhirin e vlerës së shtuar dhe rentabilitetin e investimit në bujqësi.

Në këtë kontekst, dëshiroj të përsëris skemën e mekanizmit lehtësues të agrobiznesit, skemë e cila përfshin kontributin e përbashkët të Qeverisë Shqiptare dhe të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Kjo skemë ofron një kontribut të qenësishëm, rreth nivelit të 150 milionë eurove, si në formën e kredive direkte dhe në atë të mbështetjes me garanci për kreditim. Duke përgëzuar përgjigjen pozitive që sektori bankar i ka dhënë kësaj skeme, ku tashmë katër banka janë pjesë e saj, dëshiroj të inkurajoj dhe bankat e tjera drejt adoptimit të një përqasjeje më pozitive ndaj këtij sektori.


Gjithashtu, gjej me vend të theksoj se përvoja botërore sugjeron se reduktimi i rrezikut në bujqësi mund të adresohet edhe nëpërmjet promovimit të skemave të sigurimit privat, të cilat duhet të jenë në të ardhmen pjesë integrale e këtij ekuacioni.

Arsyeja e dytë e nivelit të ulët të kreditimit në bujqësi ka të bëjë me fragmentarizimin e tokës bujqësore, i cili pengon gjenerimin e ekonomive



të shkallës, ul produktivitetin e sektorit dhe redukton atraktivitetin e tij për industrinë bankare. Për ilustrim, duke iu referuar të dhënave të Komisionit Evropian, një fermë tipike shqiptare zotëron mesatarisht 1.2 hektarë tokë, krahasuar me një mesatare prej rreth 14 hektarë në Evropë. Në të njëjtën kohë, sipas të dhënave të INSTAT-it, rreth 99.6% e bizneseve bujqësore punësojnë nga një deri në katër të punësuar, një raport ky dukshëm më i lartë se mesatarja e sektorëve të tjerë të ekonomisë.

Grafik 37. Ecuria e tregut të punës (majtas) dhe punësimi sipas sektorëve (djathtas)



Burimi: INSTAT.

Në këtë kontekst, larg emocioneve negative që mund të ngjallë memoria e kooperativave inefficente të kohës së komunizmit, mendoj se ka nevojë për një ndërgjegjësim më të madh të fermerit shqiptar për krijimin e partneriteteve dhe skemave kolektive të ndarjes së rrezikut, të bazuara në iniciativën e lirë dhe interesat e përbashkëta. Këto partneritete përmirësojnë aksesin e fermerëve në kredi dhe shanset e tyre për sukses.

Arsyeja e tretë e nivelit të ulët të kreditimit në bujqësi ka të bëjë me mungesën e një kolaterali të shëndoshë. Në shumë raste, titulli i pronësisë mungon ose vlera e tij është e ulët përkundrejt nevojave për financim.

Skemat e garancisë sovrane ofrojnë një zgjidhje të përshtatshme – në afatin e shkurtër e të mesëm – për zbutjen e këtij problemi. Megjithatë, adresimi i tij në afatin e gjatë do të kërkojë më shumë vëmendje nga autoritetet lokale.

*Të nderuar përfaqësues të sektorit bankar,*

***“Banka e Shqipërisë gjykon se ka ardhur koha që sektori bankar të rrisë vëmendjen ndaj sektorit bujqësor. Shqipëria gëzon rreth 24% të territorit të saj si tokë bujqësore, si dhe ofron mundësi ende të pashfrytëzuara plotësisht në fushën e agroturizmit dhe të agrobiznesit.”***

Banka e Shqipërisë gjykon se ka ardhur koha që sektori bankar të rrisë vëmendjen ndaj sektorit bujqësor. Shqipëria gëzon rreth 24% të territorit të saj si tokë bujqësore dhe ofron mundësi ende të pashfrytëzuara plotësisht në fushën e agroturizmit dhe të agrobiznesit.

Ky potencial duhet parë si një mundësi e përbashkët rritjeje e bujqësisë dhe e industrisë bankare, si dhe si një mundësi për të diversifikuar burimet e rrezikut të kredisë në bilancet tuaja.

Përmirësimet e vazhdueshme strukturore, modernizimi i bujqësisë dhe rritja e produktivitetit, mbështetja në rritje e me fonde dhe vëmendje publike, ofrojnë një realitet të ri në sektorin bujqësor. Përtej tyre, procesi i konvergencës me Bashkimin Evropian ofron oportunitete shtesë.

Në këtë kontekst, pa cenuar treguesit e tij të shëndetit, jam i bindur se sektori bankar do të dijë të pozicionohet si një agjent mbështetës zhvillimi. Ky sektor duhet të rrisë vëmendjen dhe kapacitetet e tij financuese, analizuese dhe këshilluese, duke përmbushur misionin e tij në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

*Ju faleminderit!*

## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË CEREMONINË KREMTUESE TË JAVËS SË PARASË**

**- 24 mars 2022 -**

*E nderuar zj. Ministre e Arsimit dhe Sportit,  
I nderuar z. Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave,  
Të nderuar nxënës e mësues, miq dhe kolegë bankierë,*

Me kënaqësi ju uroj mirëseardhjen në ceremoninë kremtuese të Javës Globale të Parasë për vitin 2022, një fushatë që prej më shumë se një dekade, bën bashkë nxënës, studentë, mësues e bankierë. Çdo fund marsi, me bashkëpunimin e Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe falë mbështetjes tepër të vyer të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, Banka e Shqipërisë organizon aktivitete edukative dhe ndërgjegjësuese për grupmoshat e nxënësve të arsimit parauniversitar dhe atij universitar.

Vitin e kaluar, për shkak të gjendjes së vështirë të sjellë nga pandemia COVID-19, ceremonia e çeljes dhe të gjitha aktivitetet e programuara në kuadër të Javës së Parasë, u organizuan virtualisht, duke iu përmbajtur protokollit për distancimin social. Pavarësisht se edhe në këto kushte, programi u realizua me sukses, prezenca fizike e pjesëmarrësve i bën aktivitetet tona edukative edhe më produktive. Për këtë arsye, jam tepër i kënaqur që këtë vit po i rikthehem normalitetit, duke ju mirëpritur si zakonisht në hollin tonë historik, në mjediset e Muzeut të Bankës së Shqipërisë.

Java Globale e Parasë është tashmë e njohur për publikun shqiptar dhe veçanërisht për të rinjtë. Ajo është një nismë ndërkombëtare e Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), e cila synon ndërgjegjësimin e brezit të ri për të qenë qytetarë të përgjegjshëm financiarisht në të ardhmen. Në këtë kuadër, çdo vit, në javën e fundit të muajit mars, bankat qendrore, agjencitë shtetërore, institucionet financiare dhe organizata të shoqërisë civile në mbarë botën organizojnë Javën e Parasë.

Me një pjesëmarrje përherë në rritje, që nga fillimi i saj, Java Globale e Parasë është organizuar në 176 vende të botës dhe ka përfshirë në aktivitetet e ndryshme mbi 53 milionë fëmijë dhe të rinj. Tema ndërkombëtare e përzgjedhur nga organizatorët për këtë vit është "Tregohu i zgjuar me paranë, ndërto të ardhmen tënde!". Ajo nënvizon

rëndësinë e një përjasjeje të kujdesshme e proaktive ndaj parasë, si premisë për një të ardhme të sigurt e të begatë, duke qenë i pajisur me njohuritë dhe aftësitë e duhura për një treg financiar gjithnjë e më të digjitalizuar dhe novator.

***“Me angazhimet tona në fushën e edukimit financiar në këtë dekadë, Banka e Shqipërisë ka dëshmuar se e konsideron edukimin financiar të publikut, si pjesë integrale të detyrave të saj institucionale, pasi vetëm nëpërmjet tij është e mundur mirëqenia e qëndrueshme dhe mbrojtja e shëndetit financiar të secilit, edhe në raste situatash kritike.”***

Me angazhimet tona në fushën e edukimit financiar në këtë dekadë, Banka e Shqipërisë ka dëshmuar se e konsideron edukimin financiar të publikut, si pjesë integrale të detyrave të saj institucionale, pasi vetëm nëpërmjet tij është e mundur mirëqenia e qëndrueshme dhe mbrojtja e shëndetit financiar të secilit, edhe në raste situatash kritike. Ngjarjet e jashtëzakonshme të viteve të fundit kanë nxjerr më në pah nevojën për kultivimin e kulturës financiare, si pjesë e formimit të përgjithshëm të gjithsecilit.

Pandemia COVID-19 si dhe zhvillimet e fundit në Ukrainë, ngjarje këto që e goditën në mënyrë të njëpasnjëshme gjendjen e ekuilibrit në çdo fushë të jetës në mbarë botën, përfshirë ekonominë e financat, përbëjnë sfida jo vetëm për menaxherët e financave publike, por edhe për ata të financave familjare e personale, pra për të gjithë ne. Ky realitet “i ri” për shekullin XXI, ka tronditur tregjet financiare dhe tensionet në rritje gjeopolitike po vijojnë të sjellin pasoja që mund të variojnë nga relativisht të kufizuara në shumë serioze.

Sot pothuajse të gjitha ekonomitë botërore po përballen me goditje të papritura, që kanë shkaktuar kriza të vështira dhe komplekse. Pas një periudhe dyvjeçare të pandemisë dhe masave të jashtëzakonshme të ndërmarra nga autoritetet qeveritare dhe financiare, lufta në Ukrainë dha një goditje të re. Të gjitha këto, së bashku me sanksionet e vendosura, godiën zinxhirët globalë të prodhimit dhe furnizimit si dhe besimin e publikut, duke dhënë një efekt të menjëhershëm në rritjen e çmimeve të produkteve bazë, si nafta dhe gazi, ushqimet etj. Kjo shkaktoi një zinxhir pasojash, duke sjellë rritjen e menjëhershme dhe të fortë të inflacionit në ekonomitë mbarëbotërore, përfshirë sigurisht edhe atë shqiptare. Sa më sipër, do të kenë ndikime direkte dhe indirekte mbi ekuilibrat ekonomikë e financiarë që do të kërkojnë kohë dhe ndërhyrje të qenësishme të autoriteteve.

Si përgjigje, politikëbërësit, qeveritë dhe bankat qendrore në mbarë botën kanë nxituar të aktivizojnë një sërë masash për të zbutur efektin e këtyre goditjeve të njëpasnjëshme dhe të fuqishme në ekonomi. Paketat ndihmëse, kontrollet mbi çmimet dhe ndërhyrjet e politikës monetare kanë bërë të mundur dhe kanë lehtësuar goditjet, si dhe kanë mbajtur nën kontroll pritshmëritë negative të publikut. Në të njëjtën frymë, as Shqipëria nuk ka mbetur e pandikuar apo indiferente. Masat e marra për kontrollin e çmimeve dhe ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë kanë qetësuar tregjet e energjisë dhe ato të kursit të këmbimit.

Natyrisht, ngjarjet e lartpërmendura nuk prekin vetëm të tashmen por edhe të ardhmen, duke rritur pasiguritë dhe pritshmëritë negative. Përgjigjja më e mirë për të luftuar pasigurinë është edukimi. Sot më shumë se dje duhet të kuptojmë drejt rëndësinë e kulturës financiare, e cila na ndihmon në jetën e përditshme jo vetëm për vendimmarrjet të mirinformuara, por edhe për të kuptuar dhe reaguar saktë ndaj mesazheve të politikëbërësve. Rrjedhimisht, politikatat ndihmuese të ndërmarra do të jenë më efektive dhe do të mbështesin edhe më shumë zbutjen e goditjeve negative.

Duke qenë të vetëdijshëm dhe duke bërë zgjedhjet e duhura financiare, gjithsecili prej nesh, banka, institucione, biznese, familje por edhe individë, mund të luajmë një rol të rëndësishëm në përbalimin e pasojave të situatave të jashtëzakonshme që bota po përjeton. Kjo fushatë edukuese e Javës së Parasë, është një rast i shkëlqyer për të risjellë në vëmendje disa mesazhe që Banka e Shqipërisë i ka trajtuar gjërësisht, duke i kthyer në pjesë të rëndësishme të përpjekjeve për përbushjen e objektivave dhe ruajtjen e stabilitetit ekonomik e financiar. Do të përmbledh sa më sipër në tre mesazhe kryesore që sot, për shkak të situatës gjeopolitike dhe financiare, bëhen edhe më kuptimplota.

Dua të ndalem fillimisht dhe të ritheksoj rëndësinë e madhe që ka përdorimi i monedhës kombëtare kundrejt atyre të huaja. Leku luan një rol kryesor dhe të drejtpërdrejtë në përcimin e efekteve pozitive të politikës monetare në ekonominë tonë. Sa më i lartë përdorimi i Lekut, aq më e madhe pjesa e ekonomisë mbi të cilën ndihen efektet e politikave të bankës tonë qendrore. Për më tepër, përdorimi i monedhës vendase ndihmon

***“Leku luan një rol kryesor dhe të drejtpërdrejtë në përcimin e efekteve pozitive të politikës monetare në ekonominë tonë. Sa më i lartë përdorimi i Lekut, aq më e madhe pjesa e ekonomisë mbi të cilën ndihen efektet e politikave të bankës tonë qendrore.”***

në amortizimin e goditjeve që vijnë nga sektori i jashtëm përmes minimizimit të goditjeve në të ardhura, konsum dhe në investime etj. Përdorimi i gjerë i monedhave të huaja krahas asaj kombëtare ka ndikime të rëndësishme negative, jo vetëm për efektivitetin e politikave ekonomike, por dhe për stabilitetin financiar.

Veçanërisht në këto kohë, kur zhvillimet globale, paqartësia dhe ndryshimi i kursit të politikës monetare mund të shkaktojnë rreziqe shtesë mbi kursin e këmbimit. Këto rreziqe destabilizojnë dhe ekspozojnë bilancet e sektorit privat, ndaj luhatjeve të kursit. E thënë më thjesht, sa më pak të përdorësh valutën e huaj, aq më pak i ekspozuar je ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, i cili sot është edhe më i lartë. Qëndrueshmëria e institucioneve financiare, bizneseve dhe familjeve kontribuon në përcimin e politikës monetare dhe stabilitetit makroekonomik.

Së dyti, dua të ritheksoj rëndësinë e rritjes dhe promovimit të kulturës financiare si kundërpërgjigje ndaj informalitetit. Ky objektivi nuk i përket vetëm bankës qendrore, por të gjithë agjentëve të ekonomisë, institucioneve edukuese dhe medias, në mënyrë që të rrisim vetëdijen dhe aftësitë financiare të publikut. Këto përpjekje të përbashkëta përveçse rrisin eficiencën e politikës monetare, ndikojnë drejtpërdrejt edhe në përfshirjen financiare të popullsisë. Kjo do të thotë rritje e numrit të përdoruesve të shërbimeve dhe produkteve financiare më të sigurta dhe me kosto më të ulëta që sjellin rritjen e aksesit në burime financiare, dhe rrjedhimisht rritjen e mundësive, të ardhurave dhe cilësisë së jetës.

Tregjet formale janë e vetmja mundësi që publiku dhe agjentët ekonomikë të përfitojnë drejtpërsëdrejti dhe në kohë reale nga politikat e ndërmarra nga qeveria dhe banka qendrore. Efektet e këtyre politikave materializohen në instrumentet dhe produktet financiare të tregut formal. Suksesi i masave të Bankës së Shqipërisë dhe qeverisë gjatë pandemisë janë një shembull recent i përfitimeve nga pjesëmarrja në tregjet formale. Gjithashtu, rritja e formalizimit dhe përfshirjes financiare e bën më të lehtë e eficiente edhe përpjekjen e qeverisë për zbatimin e politikave të ndihmës gjatë krizave.

Së treti, dua të tërheq vëmendjen tek pabarazia shoqërore dhe efekti që situata aktuale ka për thellimin e saj. Krizat, veçanërisht pandemitë e luftërat, prekin më shumë dhe më shpejt shtresat e varfra, që janë njëkohësisht edhe shtresat me nivelin më të ulët të edukimit dhe përfshirjes financiare. Për këto arsye, Banka e Shqipërisë e ka shndërruar kulturën dhe përfshirjen financiare në një prej objektivave të rëndësishëm të

mandatit të saj. Ne jemi proaktivë jo vetëm në zhvillimin e tregut dhe infrastrukturës së produkteve financiare, por edhe në rritjen e njohurive mbi këto produkte dhe kulturën financiare në përgjithësi. Është e domosdoshme që individët me të ardhura minimale të mund të kenë akses dhe të përfitojnë nga produktet bazë bankare, të tilla si llogaritë rrjedhëse. Banka e Shqipërisë, përmes ndryshimeve ligjore dhe institucionale ka krijuar mundësinë që produktet bazë financiare të përfitohen nga individët pa kosto apo me kosto minimale. Si rezultat, shumë shpejt do të ketë alternativa më të lira dhe më të shpejta që do të konkurrojnë produktet ekzistuese financiare.

***“Banka e Shqipërisë, përmes ndryshimeve ligjore dhe institucionale ka krijuar mundësinë që produktet bazë financiare të përfitohen nga individët pa kosto apo me kosto minimale. Si rezultat, shumë shpejt do të ketë alternativa më të lira dhe më të shpejta që do të konkurrojnë produktet ekzistuese financiare.”***

Njëkohësisht, kompanitë që do të hyjnë në këto tregje novatore do të kenë mundësi më të mira fitimi. E vetmja kosto për të njohur dhe përfituar nga këto produkte është edukimi. Dhe në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë mbetet aktori kryesor për përhapjen dhe zbatimin e strategjive kombëtare të edukimit dhe përfshirjes financiare. Në këtë kuadër, Banka e Shqipërisë po punon me partnerë kombëtarë por edhe me partnerë të rëndësishëm ndërkombëtarë, si Banka Botërore dhe EBRD, përvoja e gjatë e të cilëve na dëshmon se ndreqja dhe zvogëlimi i pabarazisë shoqërore dhe ekonomike është një ndërmarrje e vështirë, që zgjat në kohë.

Megjithatë, rritja e kulturës financiare, duke përhapur njohuri të tilla si: hartimi i buxhetit, miradministrimi efektiv i tij, njohja e rreziqeve dhe shmangia e investimeve të gabuara, mund të ndikojë në zbutjen e plagëve që këto trazira sjellin në jetën e më të varfërve dhe sigurisht të gjithsecilit, në çfarëdolloj shtrese shoqërore dhe situatë financiare që gjendet për momentin.

Duke u rikthyer tek ajo për të cilën jemi mbledhur, kremtimi i Javës së Parasë 2022, jam i lumtur të konstatoj interesin gjithmonë e në rritje të të rinjve dhe mësuesve e profesorëve të tyre në aktivitetet tona edukuese. Jemi të befashuar me interesin e veçantë të universiteteve për temat e ditës dhe ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare, si dhe numrin e madh të projekteve, videove dhe vizatimeve që nxënësit e arsimit parauniversitar kanë dërguar pranë nesh. Disa prej tyre do të mund t'i shohim dhe

shpërblejmë sot, megjithatë theksojmë se pjesëmarrja dhe angazhimi i të gjithë pjesëmarrësve ka qenë mbresëlënës.

***“Banka e Shqipërisë si institucion qendror edhe në këto fusha, është e gatshme dhe e angazhuar të bashkëpunojë me çdo institucion që synon rritjen e cilësisë së kulturës dhe përfshirjes financiare të publikut.”***

Për ta mbyllur, dëshiroj të falënderoj të gjithë pjesëmarrësit dhe bashkëpunëtorët e Bankës së Shqipërisë në iniciativat dhe programet e saj edukuese, dhe përkatësisht për Javën Globale të Parasë. Jemi mirënjohës që në këtë javë, si pjesëmarrës, ju jeni bërë partnerë të bankës qendrore, duke na u bashkuar në punën tonë për të përballuar sfida të rëndësishme për shoqërinë. Jemi gjithashtu të ndërgjegjshëm që tematika të tilla si përqasja e kujdesshme e proaktive ndaj botës së financave, janë parakusht për një të ardhme të sigurt e të begatë, dhe pjesëmarrja gjithmonë e në rritje në aktivitete të tilla të përvitshme nuk mund se vetëm të na bëjë optimistë për këtë brez të ri të ndërgjegjësuar dhe të interesuar për t’u edukuar më mirë. Banka e Shqipërisë si institucion qendror edhe në këto fusha, është e gatshme dhe e angazhuar të bashkëpunojë me çdo institucion që synon rritjen e cilësisë së kulturës dhe përfshirjes financiare të publikut.

***Ju falënderoj për zëmërisht për kontributin tuaj dhe ju uroj të gjithë pjesëmarrësve suksese!***



## **FJALA E GVERNATORIT SEJKO NË PREZANTIMIN E RAPORTIT TË TRANZICIONIT TË BERZH-IT 2021-2022**

**- 5 prill 2022 -**

*E nderuar zonja Solovova,  
I nderuar zoti Plekhanov,  
Të nderuar miq e të ftuar,*

Si çdo vit, është kënaqësi e veçantë të mikpres prezantimin në Shqipëri të “Raportit të Tranzicionit 2021-2022”, të përgatitur nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Ky Raport mbetet një moment i rëndësishëm diskutimi dhe reflektimi mbi sfidat që kanë përpara ekonomitë e rajonit, në drejtim të konvergencës me standardet e Bashkimit Evropian dhe të rritjes së qëndrueshme e afatgjatë të mirëqenies së tyre.

Mbajtja e këtij takimi me prani fizike përcjell një mesazh të rëndësishëm. Ekonomia botërore po le pas ditët më të këqija dhe pasojat më të rënda të pandemisë me të cilën ajo është përballur gjatë dy viteve të fundit. Megjithatë, në horizontin tonë si politikëbërës – por edhe në përditshmërinë e jetës ekonomike të çdo biznesi dhe familjeje – është shfaqur një sfidë e re. Sulmi ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës dhe sanksionet e vendosura, kanë sjellë një rritje të shpejtë të çmimeve të ushqimeve, të naftës, të produkteve energjetike dhe të lëndëve të para, në tregjet ndërkombëtare. Ndonëse pasiguria është e konsiderueshme, informacioni i disponuar sugjeron se këto çmime do të vijojnë të mbeten të larta, të paktën dhe gjatë pjesës së mbetur të vitit 2022.

***“Raporti i Tranzicionit të BERZH mbetet një moment i rëndësishëm diskutimi dhe reflektimi mbi sfidat që kanë përpara ekonomitë e rajonit, në drejtim të konvergencës me standardet e Bashkimit Evropian dhe të rritjes së qëndrueshme e afatgjatë të mirëqenies së tyre.”***

Duke përfituar nga ky komunikim publik, dhe përpara se të ndalem në mesazhet kryesore të Raportit të Tranzicionit, më lejoni të shtjelloj shkurtimisht këndvështrimin e Bankës së Shqipërisë mbi ndikimin e pritur të kësaj goditjeje dhe masat që autoritetet publike e sektori privat duhet të marrin për përbalimin e saj.

Sikundër e theksova, Shqipëria dhe rajoni po përballen me një realitet të ri çmimesh dhe pasigurie në tregjet botërore. Si ekonomi të vogla dhe të hapura, ne nuk mund t'u shpëtojmë pasojave të këtij realiteti. Në vija të përgjithshme, ekonomia shqiptare do të përballlet me kosto shtesë për familjet, bizneset dhe bilanci e sektorit publik, për një horizont jo të shkurtër kohor.

Çfarë do të thotë kjo për ekonominë shqiptare?

- Së pari, aspekti negativ. Bazuar në informacionin aktual, projeksionet tona sugjerojnë se inflacioni pritet të qëndrojë mbi objektiv për pjesën më të madhe të dy viteve të ardhshme. Në të njëjtën kohë, marzhet e fitimit të biznesit do të vihen nën presion dhe kostot e shërbimit të borxhit do të rriten.
- Së dyti, aspekti pozitiv. Edhe në prani të kësaj goditjeje, projeksionet tona sugjerojnë se vëllimi i aktivitetit ekonomik në vend do të shënojë rritje gjatë vitit 2022. Ky parashikim faktorizon – nga njëra anë – supozimin e mospërshkallëzimit të konfliktit dhe – nga ana tjetër – momentin pozitiv me të cilin ekonomia shqiptare hyri në vitin 2022, gjerësinë dhe fortësinë e burimeve të rritjes, si dhe vazhdimin e një miksi stimulues politikash monetare dhe fiskale.

Në këtë kontekst, fokusi i autoriteteve publike duhet të jetë i dyfishtë. Së pari, politikat ekonomike duhet të mbrojnë nga pasojat e goditjes shtresat më në nevojë të shoqërisë dhe segmentet më të brishta të ekonomisë. Ky objektiv duhet të përmbushet nëpërmjet një ndërhyrjeje të përkohshme dhe të kujdesshme të politikës fiskale, e cila, në çdo rast, duhet të synojë në maksimumin e mundshëm, të mos përkthehet në rritje të fortë të borxhit publik. Së dyti, rreziku që goditja fillestare e ofertës të

transmetohet në kosto dhe të përkthehet në pritje për inflacion të lartë në të ardhmen, dikton nevojën e përshtatjes së qëndrimit të politikave ekonomike. Për këtë arsye, autoritetet publike duhet të ribalancojnë objektivin e mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike me rrezikun e dëmtimit të stabilitetit monetar dhe financiar të vendit.

***“Rritja gjatë muajit të kaluar e normës bazë të interesit sinjalizon vullnetin e Bankës së Shqipërisë për të ruajtur stabilitetin e çmimeve në vend. Rikalibrimi i qëndrimit të politikës monetare synon të minimizojë pasojat që goditja e çmimeve do të ketë mbi koston e jetesës, mbi kursin e këmbimit dhe mbi shëndetin e sektorit bankar në afatin e mesëm dhe të gjatë.”***

Në vizionin tonë, ekuilibri ekonomik dhe financiar është një parakusht i domosdoshëm për rritje të qëndrueshme.

Në këtë kontekst, rritja gjatë muajit të kaluar e normës bazë të interesit sinjalizon vullnetin e Bankës së Shqipërisë për të ruajtur stabilitetin e çmimeve në vend. Rikalibrimi i qëndrimit të politikës monetare synon të minimizojë pasojat që goditja e çmimeve do të ketë mbi koston e jetesës, mbi kursin e këmbimit dhe mbi shëndetin e sektorit bankar në afatin e mesëm dhe të gjatë. Në të njëjtën kohë, është e rëndësishme të theksohet se, edhe pas kësaj lëvizjeje, qëndrimi i politikës sonë monetare vijon të mbetet stimulues për rritjen e konsumit dhe të investimeve në vend.

Paralelisht me autoritetet publike, edhe operatorët e sektorit privat duhet të marrin masa për minimizimin e pasojave të goditjes. Biznesi shqiptar duhet të rrisë vëmendjen ndaj kostove operacionale në përgjithësi dhe eficiencës energjitike në veçanti. Në të njëjtën kohë, gjej me vend të theksoj se ekspozimi direkt i ekonomisë shqiptare ndaj vendeve në konflikt ka qenë dhe vijon të mbetet i kufizuar. Kjo do të thotë se – në prani të një ambienti të qëndrueshëm ekonomik dhe financiar – perspektivat e rritjes ekonomike në afatin e mesëm dhe të gjatë mbeten solide.

### *Të nderuar të ftuar,*

Eksperiencia jonë me krizat e dy viteve të fundit ka ilustruar se suksesi në përballimin e goditjeve nuk është produkt i rastësisë. Përkundrazi, ai pasqyron progresin e bërë me reformat strukturore, shkallën e zhvillimit dhe sofistikimit të sektorit privat, si dhe reagimin proaktiv të politikave ekonomike.

Me kënaqësi konstatoj se Raporti i Tranzicionit që do të prezantohet sot i bën jetonë të tre këtyre momenteve.

***“Eksperiencia jonë me krizat e dy viteve të fundit ka ilustruar se suksesi në përballimin e goditjeve nuk është produkt i rastësisë. Përkundrazi, ai pasqyron progresin e bërë me reformat strukturore, shkallën e zhvillimit dhe sofistikimit të sektorit privat, si dhe reagimin proaktiv të politikave ekonomike.”***

Raporti evidenton progres të mëtjeshëm, ndonëse gradual, të reformave strukturore në Shqipëri dhe në vendet e rajonit. Ky është një zhvillim inkurajues, për vetë faktin se progresi ka ndodhur gjatë dy viteve në të cilat vëmendja dhe energjitë kryesore kanë qenë të përqendruara në tejkalimin e pasojave të pandemisë. Në të njëjtën kohë, raporti thekson se vendet e rajonit kanë bërë progres të qenësishëm në zhvillimin e tregut financiar, me reforma specifike që kanë përmirësuar infrastrukturën e tregut, kornizën ligjore e rregullatore, diversifikimin e instrumenteve financiare, si dhe thellësinë e tregut. Avancimi i reformave të tregut financiar, si dhe

i atyre që mundësojnë krijimin e një tregu funksional kapitalesh, është i domosdoshëm për të rritur diversifikimin e instrumenteve të financimit dhe përbën një potencial ende të pashfrytëzuar për ekonominë tona.

Lajtmotivi i Raportit të Tranzicionit për këtë vit është digjitalizimi. Përballja me pandeminë përshpejtoi trendin e nisur të digjitalizimit të shumë aspekteve të jetës dhe të punës. Përfitimet nga digjitalizimi, në terma të rritjes së eficiencës e të produktivitetit, por edhe të rritjes së aksesit në financë, janë të mirëdokumentuara. Raporti vë në dukje se ky proces ishte edhe më i shpejtë në rajonin tonë, duke kontribuar në rritjen e konkurrueshmërisë, në ruajtjen e vendeve të punës përgjatë pandemisë dhe në shtimin e tyre pas hapjes së ekonomive.

***“... është punuar për nxitjen e përdorimit më të madh të teknologjisë në sistemin e pagesave, për përmirësimin dhe forcimin e kuadrit rregullator për institucionet e pagesave elektronike, si dhe për mbrojtjen e konsumatorit dhe huamarrësit.”***

Banka e Shqipërisë ka vlerësuar dhe inkurajuar që herët aplikimin e teknologjisë së informacionit dhe digjitalizimit në sistemin financiar. Në këtë drejtim, është punuar për nxitjen e përdorimit më të madh të teknologjisë në sistemin e pagesave, për përmirësimin dhe forcimin e kuadrit rregullator për institucionet e pagesave elektronike, si dhe për mbrojtjen e konsumatorit dhe huamarrësit.

Për të nxitur më tej rritjen e aftësive teknologjike e për të përfituar nga dividendi teknologjik i lidhur me të, mendoj se autoritetet rajonale dhe shqiptare duhet të vazhdojnë zbatimin e reformave specifike strukturore, të cilat synojnë:

- mbështetjen e digjitalizimit dhe të inovacionit teknologjik, si një instrument për rritjen e produktivitetit dhe të konkurrueshmërisë, me anë të forcimit të edukimit dhe aftësive digjitale, rritjes së infrastrukturës digjitale dhe të shërbimeve online, si dhe incentivizimin e kompanive për të investuar në teknologji të reja e për të shtuar trajnimin e forcës së punës;
- zhvillimin e mëtejshëm të tregut financiar dhe promovimin e tregut të kapitaleve, si një instrument për mbështetjen e bizneseve të reja e inovative, për diversifikimin e burimeve të financimit dhe për ndarjen e rrezikut financiar të sipërmarrësve;
- vijimin e reformave strukturore me synim rritjen e konkurrueshmërisë, përmirësimin e qeverisjes, adoptimin e politikave publike të gjelbra, rritjen e gjithëpërfshirjes në proceset ekonomike, forcimin

e qëndrueshmërisë së ekonomisë dhe përshpejtimin e integritimit në tregjet rajonale e më gjerë.

Në tërësi, këto reforma duhet të synojnë krijimin e kushteve të favorshme institucionale e ligjore në mbështetje të adoptimit të zhvillimeve teknologjike dhe të krijimit të teknologjive të reja.

***Të nderuar pjesëmarrës,***

Raporti i Tranzicionit i ka konsoliduar kredencialet e veta si një dokument profesional dhe largpamës. Edhe Raporti i këtij viti nuk bën përjashtim. Ai na ndihmon të gjithëve, vendimmarrës, akademikë, studiues apo operatorë të sektorit privat, të bëjmë një diagnozë të plotë të progresit dhe rrugës e sfidave që kemi përpara në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies.

Ju falenderoj të gjithëve për pjesëmarrjen dhe ju ftoj të kontribuoni me diskutimet tuaja në shtjellimin e mëtejshëm të mesazheve të tij.

***Ju faleminderit!***



**FJALA E GUVERNATORIT SEJKO  
NË CEREMONINË E NËNSHKRIMIT  
TË MARRËVESHJES SË HUASË  
PËR PROGRAMIN E BERZH-IT PËR  
MBËSHTETJEN E AGROBIZNESIT DHE  
TURIZMIT NË VEND (AATSF) MIDIS BERZH-  
IT DHE PROCREDIT BANK ALBANIA  
- 11 prill 2022 -**

*E nderuara zonja Presidente e BERZH-it,  
Të nderuara Zonja Ministre,  
I nderuar përfaqësues i Delegacionit të Bashkimit Evropian,  
Të nderuar përfaqësues të Bankës ProCredit,  
Të dashur miq e kolegë,*

Banka e Shqipërisë ka kënaqësinë të hapë dyert e saj sot për ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes midis Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Bankës ProCredit, për përdorimin e instrumentit të ndarjes së rrezikut në kuadër të Programit për Mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit në Shqipëri.

Nën ombrellën e këtij programi, BERZH, Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Shqipërisë, në partneritet me sektorin financiar, po rritin aksesin në financim për kompanitë operuese në këta sektorë, duke adresuar kështu një nga sfidat kryesore për zhvillimin e tyre.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për vështirësitë që ka financimi i kompanive në fushën e agrobiznesit dhe të turizmit, të cilat, në pjesën dërrmuese janë të organizuara si sipërmarrje të vogla dhe të mesme. Por, gjithashtu, të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për potencialin e madh të këtyre kompanive, si krijues vlere, si promotorë punësimi dhe si burim inovacioni. Të gjithë këta janë ingredientë të rëndësishëm për një recetë të suksesshme për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë sonë.

***“Instrumentet e garancisë dhe të ndarjes së rrezikut lehtësojnë barrën e bankave në terma të rrezikut dhe më tej ndihmojnë në shtrimin e rrugës drejt financimit të qëndrueshëm të këtyre sektorëve.”***

Për këtë arsye, e konsideroj tejet të rëndësishme dhe frytdhënëse ndërmarrjen e programeve të tilla, të cilat mundësojnë jo vetëm disponibilitet fondesh, por edhe rrisin kapacitetin analizues, vlerësues dhe më tej financues të sektorit bankar. Instrumentet e garancisë dhe të ndarjes së rrezikut lehtësojnë barrën e bankave në terma të rrezikut dhe më tej ndihmojnë në shtrimin e rrugës drejt financimit të qëndrueshëm të këtyre sektorëve.

Unë e kam thënë edhe më parë se çdo përpjekje për të rritur aksesin në financim duhet parë si një mundësi e përbashkët për rritje, si nga sektori real, ashtu edhe nga industria bankare. Prandaj, do të vazhdoj të inkurajoj industrinë bankare për një angazhim më të madh, por të kujdesshëm, tek sektorët potencialë të vendit.

Nënshkrimi i marrëveshjes sot është një hap përpara në këtë drejtim. BERZH-i ka vënë në dispozicion një fond deri më 100 milionë euro për financim dhe për lehtësira për ndarjen e rrezikut, të cilat do të mundësojnë një investim shtesë prej 80 milionë eurosh nga institucionet financiare pjesëmarrëse. Nga ana e saj, qeveria shqiptare ka vendosur në dispozicion deri në 36 milionë euro për të mbështetur këtë program nëpërmjet mbulimit të riskut për humbjet e para në harkun kohor të 3 viteve. Prej fillimit të programit në vitin 2016, më shumë se 6,100 ndërmarrje të vogla e të mesme në fushën e agrobiznesit kanë përfituar kredi në vlerën 70 milionë euro.

***“Falë kësaj mbështetjeje, ne jemi në gjendje të arrijmë rezultate të zhvillimit të qëndrueshëm e të bëjmë një ndryshim të vërtetë në jetën e njerëzve.”***

Unë gjej rastin të falënderoj në veçanti partnerët tanë ndërkombëtarë, BERZH-in dhe BE-në, për mbështetjen konkrete me investime financiare në fusha kyçe të ekonomisë. Falë kësaj mbështetjeje, ne jemi në gjendje të arrijmë rezultate të zhvillimit të qëndrueshëm e të bëjmë një ndryshim të vërtetë në jetën e njerëzve.



## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË KONFERENCËN SHKENCORE NDËRKOMBËTARE TË ORGANIZUAR NGA FAKULTETI I EKONOMISË, UNIVERSITETI I TIRANËS - 11 qershor 2022 -**

*Të nderuar pjesëmarrës,*

Është kënaqësi e veçantë të jem sot me ju, për të përshëndetur konferencën dhe për të diskutuar së bashku zhvillimet më të fundit në tregjet globale, si dhe efektet që ato kanë mbi ekonominë dhe politikën monetare të Bankës së Shqipërisë.

Përpara se të mbaj fjalën time, më lejoni fillimisht t'ju shpreh organizatorëve mirënjohjen time për mundësimin e kësaj konference. Në këtë 65-vjetor të rëndësishëm të Fakultetit të Ekonomisë, Banka e Shqipërisë dhe çdo institucion tjetër i vendit, misioni i të cilit ndërthuret me atë të fakultetit, duhet të jetë krenar që ndan me të një pjesë të rëndësishme të historisë së tij.

Ky fakultet është institucioni më i vjetër i edukimit ekonomik në Shqipëri, duke pasur një ndikim të rëndësishëm në mirëqenien dhe identitetin e shqiptarëve. Gjatë historisë së tij, nga këta auditorë kanë dalë ekonomistët më të mirë të vendit, të cilët kanë kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e politikave ekonomike e financiare të Shqipërisë. Për këtë arsye, them me bindje se historia e zhvillimit akademik të këtij fakulteti është edhe historia e zhvillimit ekonomik të vendit.

***“Gjatë historisë së tij, nga këta auditorë kanë dalë ekonomistët më të mirë të vendit, të cilët kanë kontribuar në mënyrë domethënëse në zhvillimin e politikave ekonomike e financiare të Shqipërisë.”***

*Të nderuar pjesëmarrës,*

Tema e zgjedhur është sa aktuale aq dhe largpamëse. Zhvillimet ekonomike e financiare të dekadës së fundit, por veçanërisht goditjet me të cilat jemi përballur gjatë dy viteve të fundit, kanë sjellë ndryshime të mëdha për bankingun qendror dhe, në veçanti, për politikën monetare dhe mbikëqyrjen e rregullimin bankar.

Duke përfituar nga kjo ftesë, sot dëshiroj të ndaj me ju vizionin e Bankës së Shqipërisë mbi sfidat e të ardhmes dhe ndikimin që ato do të kenë në objektivat, strategjitë dhe instrumentet që bankat qendrore do të ndjekin e përdorin në të ardhmen.

Për të qenë sa më i plotë dhe konciz në diskutimin tim, dëshiroj ta orientoj atë në tre drejtime kryesore: (i) së pari, dua të ndaj me ju stadin aktual të zhvillimit të politikës monetare në Bankën e Shqipërisë, dhe ndërthurjen e saj me mbikëqyrjen e rregullimin bankar; (ii) së dyti, do të ndalem në eksperiencën tonë me dy krizat financiare të dekadës paraardhëse, për të evidentuar si ato kanë konturuar zhvillimin në kohë të mendimit dhe metodës së veprimit të Bankës së Shqipërisë; dhe (iii) së treti, do të nënvizoj shkurtimisht rolin e Bankës së Shqipërisë dhe kontributin e saj në stabilitetin makroekonomik në vitet e fundit. Në mbyllje do të ndalem shkurtimisht në mësimet e nxjerra dhe sfidat për të ardhmen.

## 1. BANKA E SHQIPËRISË SI PROMOTOR STABILITETI DHE ZHVILLIMI

Banka e Shqipërisë është autoriteti monetar i Republikës së Shqipërisë.

***“Qëndrueshmëria e çmimeve është një parakusht për përmbushjen e tre funksioneve klasike të parasë: atij të mjetit të këmbimit, të ruajtësit të vlerës dhe të njësisë së krahasimit, apo të kontabilizimit.”***

Në përputhje me praktikën më të mira botërore, mandati ligjor parësor i saj është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Ky mandat bazohet në një konsensus të gjerë akademik e praktik, sipas të cilit kontributi më i qenësishëm që mund të japë një bankë qendrore për rritjen e qëndrueshme të standardit të jetesës është ruajtja e stabilitetit të çmimeve. Qëndrueshmëria e çmimeve është një parakusht për përmbushjen e tre funksioneve klasike të parasë: atij të mjetit të këmbimit, të ruajtësit të vlerës dhe të njësisë së krahasimit, apo të kontabilizimit. Në këtë mënyrë, një ambient monetar i qëndrueshëm ndihmon ekonominë, bizneset dhe familjet, të planifikojnë me besueshmëri të ardhurat, konsumin, investimet dhe kursimet, duke rritur transparencën e sistemit ekonomik dhe eficiencën e shpërndarjes së burimeve. Në praktikë, stabiliteti i çmimeve në Shqipëri përkufizohet si një objektiv numerik i inflacionit në nivelin 3%.

Megjithatë, arritja e këtij objektiwi nuk është e mundur pa pasur njëkohësisht një sistem bankar e financiar të stabilizuar, të qëndrueshëm dhe eficient. Po ashtu, eksperiencia botërore tregon se një ambient

monetar i qëndrueshëm është një kusht i nevojshëm, por jo i mjaftueshëm për të pasur një sistem financiar të qëndrueshëm dhe të aftë të kryejë me eficiencë detyrat e tij të ndërmjetësuesit financiar dhe të ofruesit të instrumenteve të pagesës. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ka adoptuar edhe një sërë objektivash dytësorë, të cilët synojnë funksionimin normal të sektorit bankar dhe të tregjeve të parasë. Përbushja e këtyre objektivave kontribuon në promovimin e stabilitetit financiar të vendit dhe ofron instrumentin e dytë me të cilin bankat qendrore ndihmojnë rritjen e mirëqenies afatgjatë të shoqërisë.

Regjimi i politikës monetare të adoptuar nga Banka e Shqipërisë është ai i shënjestrimit të inflacionit. Ky regjim, i aplikuar gjerësisht nga bankat qendrore, ka tre elemente esenciale.

- Së pari, ai nënkupton që banka qendrore përdor të gjithë informacionin relevant të disponuar për vlerësimin e balancës së presioneve inflacioniste. Një kurbë Filipsi tipike për një ekonomi të vogël e të hapur si Shqipëria, e shikon këtë balancë si funksion i tre përbërësve: pozicionit ciklik të ekonomisë; presioneve mbi çmimet që vijnë nga tregu i huaj; dhe, pritjeve pjesërisht racionale të agjentëve ekonomikë për inflacionin. Në praktikë, ky informacion përkthehet në projeksione mbi ecurinë e çmimeve në horizontin afatmesëm, çka i mundëson bankës qendrore të evidentojë shmangiet e mundshme të inflacionit nga objektivi dhe të marrë në kohë masat përkatëse.
- Së dyti, shënjestrimi i inflacionit nënkupton që banka qendrore ndërhyt në sistemin financiar me instrumente indirekte, të cilat operojnë në përputhje me logjikën e tregut. Në praktikë, bankat qendrore përcaktojnë nivelin e normës bazë të interesit, i cili orienton më tej të gjithë spektrin e normave të interesit në të gjithë gamën e instrumenteve të tregut financiar.
- Së treti, ai nënkupton që kursi i këmbimit është i lirë dhe luhet në përputhje me raportet e kërkesës dhe ofertës për valutë. Kjo i mundëson politikës monetare të fokusohet tërësisht në përbushjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve, duke i ofruar njëkohësisht ekonomisë një instrument për amortizimin e goditjeve që mund të vijnë nga ambienti i jashtëm.

Përtej këtyre elementeve klasike, Banka e Shqipërisë aplikon një regjim fleksibël të inflacionit të shënjestruar. Kjo do të thotë se, në vlerësimin e përshtatshmërisë së qëndrimit të politikës monetare, Banka e Shqipërisë mban parasysh edhe pozicionin ciklik të ekonomisë dhe se funksioni i

reagimit të politikës monetare i jep një peshë të caktuar edhe zbutjes së cikleve të biznesit, natyrisht pa paragjykuar për asnjë moment respektimin e stabilitetit të çmimeve.

Në përputhje me këto tipare, Banka e Shqipërisë ka marrë një angazhim publik për të ndjekur një politikë monetare konsistente dhe të qëndrueshme. Angazhimi për konsistencë kërkon që qëndrimi i politikës sonë monetare të jetë, në çdo kohë, ai i duhuri për përmbushjen e objektivit tonë të inflacionit brenda një horizonti kohor afatmesëm. Angazhimi për qëndrueshmëri kërkon që politika jonë monetare të faktorizojë dhe elementet e rrezikut e të pasigurisë, të cilat janë të pandashme në procesin e parashikimit ekonomik dhe gjithnjë prezente në funksionimin e tregjeve financiare.

***“Strategjia e Bankës së Shqipërisë për përmbushjen e objektivit të inflacionit bazohet jo vetëm në praktikatat më të mira të bankingut qendror, por edhe në realitetin që ofron shkalla e zhvillimit të ekonomisë dhe të tregjeve financiare shqiptare.”***

Duke u ndalur te elementi i fundit, dëshiroj të theksoj se strategjia e Bankës së Shqipërisë për përmbushjen e objektivit të inflacionit bazohet jo vetëm në praktikatat më të mira të bankingut qendror, por edhe në realitetin që ofron shkalla e zhvillimit të ekonomisë dhe të tregjeve financiare shqiptare. Për këtë arsye, ne i kushtojmë një rëndësi të veçantë si vlerësimit të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, ashtu edhe stabilitetit të sistemit bankar e atij financiar.

Si mbikëqyrës e rregullator i aktivitetit bankar, dominimi i sistemit bankar në ekonominë shqiptare i jep Bankës së Shqipërisë një perspektivë unike mbi mekanizmin e transmetimit të politikës monetare dhe ndërthurjen e saj me rregullimin bankar apo – me fjalë të tjera – politikën makroprudenciale.

Ndonëse ndërthurja efiçente e politikës monetare me atë makroprudenciale mbetet një fushë e cila nuk ka ende një konsensus të qartë akademik e praktik, eksperiencia jonë e dekadës së fundit na ka ofruar disa mësimet të rëndësishme.

Kriza globale financiare dhe kriza e borxhit në Eurozonë ishin kamberë zgjimi për nevojën e një vlerësimi më të plotë të ndërlidhjes së stabilitetit monetar me atë financiar. Këto kriza nxorën në pah rëndësinë që ka një sistem bankar e financiar i qëndrueshëm për stabilitetin dhe zhvillimin e përgjithshëm të vendit. Deri përpara këtyre dy krizave, filozofia e

menaxhimit ekonomik u udhëhoq nga një supozim i heshtur se stabiliteti monetar ishte, në vetvete, një kusht i mjaftueshëm për stabilitetin e përgjithshëm ekonomik e financiar të vendit. Tregjet financiare u supozuan të ishin efikase dhe të vetërregulluara, çka nënkuptonte mungesën e krizave financiare sistemike. Kriza financiare e vitit 2008 shkaktoi një tronditje të madhe financiare dhe e përmbysi këtë konsensus. Bilancet e rënduara të sektorit bankar, rritja e pasigurisë dhe ndërprerja e qarkullimit të flukseve financiare, penguan transmetimin normal të politikës monetare.

Në vendet e zhvilluara, bankat qendrore reagueshin fuqishëm për të mbështetur ekonominë dhe stabilitetin e sistemit financiar. Normat shkuan shpejt në zero, e madje në territor negativ. Megjithatë, problemet e mekanizmit të transmetimit i detyruan ato të adoptonin e aplikonin instrumente jokonvencionale të politikës monetare. Lehtësimi sasior dhe ai i kreditit rivendosën, deri në një farë mase, qarkullimin e likuiditetit në ekonomi, duke anashkaluar ndërmjetësit financiarë – bankat dhe tregun e kapitaleve. Megjithatë, ai rezultoi në një zgjerim të shpejtë të bilancit të bankave qendrore dhe i shtyu ato në një fushë të paeksploruar të politikës monetare.

Nga ana tjetër, shkalla e ulët e zhvillimit të tregjeve financiare e bëri të papërshtatshëm përdorimin e këtij instrumenti, në Shqipëri dhe në vendet e rajonit. Në këto rrethana, vëmendja jonë u përqendrua në identifikimin e pasojave të goditjes në sektorin bankar dhe hartimin e strategjive të masave për adresimin sa më të shpejtë të tyre.

## **2. MËSIMET E NXJERRA NGA DY KRIZAT FINANCIARE TË FUNDVITEVE '00 DHE FILLIMVITEVE '10**

Shqipëria dhe vendet e Ballkanit Perëndimor përjetuan një dekadë rritjeje të shpejtë e të qëndrueshme në vigjilje të krizës financiare globale. Liberalizimi ekonomik i fillimviteve '90, integrimi në rritje me ekonominë dhe tregjet e zhvilluara të Bashkimit Evropian, rritja e shpejtë e produktivitetit, si pasojë e futjes së kapitalit dhe ekspertizës së huaj, si dhe reformat e gjithanshme strukturore e institucionale, e vunë rajonin në një trajektore të shpejtë zhvillimi. Në tërësi, ekonominë e

***“Ndonëse Shqipëria dhe vendet e rajonit kishin një ekspozim relativisht të ulët ekonomik dhe financiar ndaj SHBA-ve - vendit të origjinës së krizës - pasojat e saj u ndjenë të forta në rajon.”***

rajonit e lanë pas statusin e ekonomive në nevojë dhe fituan statusin e ekonomive në zhvillim, me perspektiva solide rritjeje dhe konvergjence në Bashkimin Evropian.

Kriza financiare globale ndryshoi thuajse gjithçka. Ndonëse Shqipëria dhe vendet e rajonit kishin një ekspozim relativisht të ulët ekonomik dhe financiar ndaj SHBA-ve - vendit të origjinës së krizës - pasojat e saj u ndjenë të forta në rajon.

Shtërngimi i kushteve financiare globale dhe reduktimi i kërkesës së huaj, u kombinuan me një sërë dobësish që kishte modeli ynë i zhvillimit ekonomik dhe financiar. Shumë shpejt, kjo goditje fillestare u pasua nga kriza e borxhit sovran në Eurozonë. Kjo goditje ishte po aq serioze dhe e qëndrueshme sa kriza financiare globale. Në veçanti, ajo solli një rrjedhje të shpejtë kapitali bankar e fondesh financiare jashtë rajonit, çka vështirësoi reagimin e politikëbërësve për administrimin e pasojave të krizës.

Në mënyrë të përmbledhur, pasoja e këtyre goditjeve ishin bilancet e rënduara financiare për sektorin publik dhe privat, si dhe një dekadë ku ritmi i rritjes ekonomike thuajse u përgjysmua në krahasim me periudhën përpara krizës, ndërsa inflacioni qëndroi poshtë objektivave të bankave qendrore.

### ***Tiparet e zhvillimit në Shqipëri e rajon, që intensifikuan pasojat e goditjes dhe sfidat me të cilat u përballëm***

Së pari, modeli i rritjes ekonomike u orientua dukshëm drejt konsumit e investimeve të brendshme, e në veçanti investimeve në sektorin e ndërtimit rezidencial. Ky model inkurajoi një strukturë ekonomike jokonkurruese. Ai rezultoi në mbialokim të resurseve ekonomike dhe financiare në sektorin e ndërtimit dhe në rritje të pajustificuar të çmimeve të aseteve. Përballja me realitetin pas dy krizave të shkuara financiare solli njohjen e rolit të reformave strukturore, si promotori kryesor i zhvillimit të qëndrueshëm e afatgjatë të vendit, por kërkoi dhe kohë për marrjen e fryteve të tyre. Gjithashtu, nga këndvështrimi i bankës qendrore, ai solli në vëmendje rolin e madh që kanë çmimet e aseteve si tregues të zhbalancimeve ekonomike, implikimet e tyre për stabilitetin financiar, si dhe kohën e gjatë që kërkon adresimi i tyre.

Së dyti, rritja e shpejtë ekonomike u ushqye nga flukset e huaja financiare, të ndërmjetësuara përgjithësisht nga sektori bankar. Ky

proces u lehtësua nga pesha e madhe e kapitalit bankar me origjinë nga vendet e Bashkimit Evropian në rajon, si dhe nga struktura e incentivave dhe e modelit të biznesit të tyre. Brenda sektorit bankar, pasojat më serioze të krizës u manifestuan në formën e rritjes së kredive me probleme, sidomos në segmentin e kredive në valutë, dhe në formën e uljes së vëmendjes së bankave evropiane ndaj rajonit. Në veçanti, niveli i lartë i kredive me probleme në segmentin e huamarrësve në valutë të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit, kufizoi shkallën e lirisë së veprimit të politikës monetare dhe frenoi përdorimin e kursit të këmbimit si absorbues goditjeje.

Këto problematika sollën funksionimin jooptimal të mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Për adresimin e tyre, Banka e Shqipërisë u angazhua në programe gjithëpërfshirëse masash për:

- uljen e kredive me probleme dhe përmirësimin e mjedisit të kreditit. Ndër të tjera, një vëmendje e veçantë i është dedikuar përmirësimit të sistemeve të administrimit të rrezikut brenda vetë bankave tregtare;
- konsolidimin e sektorit bankar, duke zëvendësuar një pjesë të grupeve bankare të huaja, të cilat rishikuan – në mënyrë të detyruar ose jo – strategjitë e tyre të ekspansionit në rajon, me investitorë të rinj e të motivuar;
- reduktimin e përdorimit të monedhës euro në sektorin financiar. Ky aksion synon uljen e përdorimit të panevojshëm të euros, si në kursim dhe në kreditim, e sidomos në segmentin e kredimarrësve të pambrojtur nga rreziku i kursit të këmbimit.

***“Banka e Shqipërisë u angazhua në programe gjithëpërfshirëse masash për:  
• uljen e kredive me probleme;  
• konsolidimin e sektorit bankar;  
• reduktimin e përdorimit të monedhës euro në sektorin financiar.”***

Së treti, zhbilancimet në sektorin financiar u inkurajuan nga pamundësia e rregullatorëve lokalë për të disiplinuar plotësisht sasinë dhe destinacionin e flukseve hyrëse financiare, si dhe nga mungesa e vëmendjes së rregullatorëve të huaj ndaj këtyre zhvillimeve. Për rrjedhojë, në periudhën pas krizave, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një program të plotë konvergjence të kuadrit të saj mbikëqyrës e rregullator me kërkesat e Komitetit të Bazelit dhe standardet e Bashkimit Evropian. Si dëshmi e punës sonë, një vlerësim i pavarur i kryer gjatë vitit të shkuar konstatoi një shkallë të lartë konvergjence midis kuadrit rregullator e praktikave tona mbikëqyrëse me ato të Bashkimit Evropian. Paralelisht me to, ne

kemi intensifikuar dialogun me mbikëqyrësit e huaj, për të evidentuar në kohë problemet dhe për të ndërtuar – aty ku është e mundur – strategji të përbashkëta ndërhyrjeje.

Së katërti, Shqipëria hyri në krizën financiare globale me një nga nivelet më të larta të borxhit publik në rajon. Ky tipar, si dhe rritja e skajshme e kostove të financimit në tregjet e huaja gjatë periudhës në vijim, zvogëluan hapësirat për një stimul fiskal kundërciklik. Kjo pengesë solli në vëmendje rëndësinë që ka një nivel i ulët dhe i kontrolluar i borxhit publik në drejtim si të ruajtjes së hapësirës fiskale për reagim, ashtu dhe të qëndrueshmërisë së përgjithshme të sistemit financiar.

***“Nga tre instrumentet e mundshme të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi - politikës monetare, politikës makroprudenciale dhe politikës fiskale - barra e përballimit të kostove të dy krizave financiare të dekadës paraardhëse ra vetëm mbi politikën monetare.”***

Në këtë kontekst, nga tre instrumentet e mundshme të ndërhyrjes së shtetit në ekonomi - politikës monetare, politikës makroprudenciale dhe politikës fiskale - barra e përballimit të kostove të dy krizave financiare të dekadës paraardhëse ra vetëm mbi politikën monetare. Për më tepër, kjo politikë pati hapësirë të kufizuar veprimi, për shkak të pasojave negative që një stimul i fortë monetar mund të kishte në stabilitetin financiar, si dhe u përball me një

mekanizëm joplotësisht funksional transmetimi.

Ndërsa këto probleme zgjatën në kohë pasojat e goditjes, gjej me vend të theksoj se Shqipëria dhe Banka e Shqipërisë nuk humbën kohë në drejtim të identifikimit të tyre dhe të reagimit institucional.

Zbatimi në kohë dhe me energji i këtyre reformave ka sjellë rritjen e qëndrueshmërisë së sektorit bankar ndaj goditjeve dhe përmirësimin e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare, duke ndihmuar dukshëm reagimin tonë në dy krizat pasuese.

### **3. BANKA E SHQIPËRISË PËRBALLË PANDEMISË DHE GODITJEVE TË OFERTËS**

Pandemia dhe pushtimi rus i Ukrainës janë ndër goditjet më serioze të dekadave të fundit. Ndonëse këto dy ngjarje përbëjnë goditje diametralisht të kundërta – e para ishte në rezultante një goditje kërkesë,



ndërsa e dyta një goditje e pastër oferte - intensiteti i tyre testoi dhe vijon të testojë fort ekuilibrat ekonomikë dhe financiarë të vendit. Fatmirësisht, në raport me dy goditjet paraardhëse, ne ishim të përgatitur.

Përgjigjia në sferën ekonomike e autoriteteve publike gjatë periudhës së pandemisë është një shembull suksesi. Situata kërkonte një reagim të shpejtë, të kalibruar dhe të koordinuar, duke synuar si amortizimin e pasojat e goditjes në afat të shkurtër ashtu dhe minimizimin e dëmit mbi potencialin prodhues të vendit në afatin e gjatë. Kjo e fundit nënkupton minimizimin e falimentimeve masive të bizneseve, reduktimin e largimeve afatgjata nga puna, dhe, mbi të gjitha, ruajtjen e stabilitetit të përgjithshëm ekonomik dhe financiar të vendit.

Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë masash monetare, makroprudenciale, mbikëqyrëse dhe operationale, të cilat synuan ruajtjen e likuiditetit në tregjet financiare, uljen e kostove të huamarrjes dhe ruajtjen e një fluksi të pandërprerë të kreditimit dhe të shërbimeve financiare. Reagimi ynë i menjëhershëm dhe shumëdimensional mundësoi: (i) uljen e kostos së huadhënies dhe mbështetjen e vazhduar të familjeve dhe bizneseve shqiptare me kredi bankare; (ii) ruajtjen e një sistemi bankar likuid, të mirëkapitalizuar dhe me praktika të shëndosha për administrimin e rreziqeve; dhe (iii) reduktimin e pasigurisë dhe rritjen e besimit në të ardhmen. Rimëkëmbja e ekonomisë gjatë vitit 2021 ishte solide, burimet e rritjes ishin me bazë të gjerë, ashtu si edhe faktorët mbështetës së saj, ku veçojmë mjedisin e qëndrueshëm monetar dhe financiar.

***“Banka e Shqipërisë ndërmori një paketë masash monetare, makroprudenciale, mbikëqyrëse dhe operationale, të cilat synuan ruajtjen e likuiditetit në tregjet financiare, uljen e kostove të huamarrjes dhe ruajtjen e një fluksi të pandërprerë të kreditimit dhe të shërbimeve financiare.”***

Në gjykimin tim, suksesi i dedikohet disa faktorëve:

- së pari, ne ishim të përgatitur. Mësimet e nxjerra pas krizës globale financiare dhe krizës së borxheve sovraane evropiane na shërbyen për të reduktuar dobësitë strukturore të ekonomisë, për të forcuar sektorin financiar dhe për të rritur qëndrueshmërinë e tij ndaj goditjeve;
- së dyti, përgjigjia e politikave ishte proporcionale me kompleksitetin e situatës, e shpejtë në kohë dhe e koordinuar. Ne aktivizuar një gamë të gjerë instrumentesh, në përmasa të paprecedenta.

Stimuli monetar u zbatua njëkohësisht me stimuj fiskalë – fondet e garancisë sovrane – dhe me lehtësime të targetuara rregullatore e makroprudenciale;

- së treti, përgjigjja dhe koordinimi i politikave globale ndihmuan në kufizimin e shtrirjes së rënies ekonomike. Institucionet financiare ndërkombëtare dhe organizatat e institucionet e BE-së morën një rol aktiv në nxitjen e koordinimit të politikave globale. Për ne politikëbërësit e rajonit, kjo siguroi mbështetjen ndërkombëtare për politikën ekspansioniste në vend dhe ndihmoi në rritjen e hapësirës së veprimit.

Megjithatë, sfidat mbeten aktuale. Lufta në Ukrainë ka sjellë një rritje të shpejtë të inflacionit kudo në botë. Në përgjigje të tij, Banka e Shqipërisë ndërmoi një hap të parë drejt normalizimit të politikës monetare në muajin mars, duke rritur me 0.5 pikë përqindjeje normën bazë të interesit. Në të njëjtën kohë, ne kemi sinjalizuar vullnetin dhe gatishmërinë tonë për të ndërmarrë çdo masë monetare të nevojshme për të shmangur transmetimin e kësaj goditjeje në pritje për inflacion të lartë në të ardhmen. Komunikimi ynë transparent i ka shërbyer qartësisht të publikut mbi kahun e veprimit të politikës monetare dhe ka ndihmuar në kontrollin e pritjeve për inflacionin në tregjet financiare.

#### **4. NË VEND TË KONKLIZIONEVE**

Në mbyllje të fjalës sime, më lejoni të ndaj me ju disa mësimet të dala nga eksperiencia e Bankës së Shqipërisë përballë sfidave në vite.

Stabiliteti i çmimeve është një parakusht i domosdoshëm për rritje të qëndrueshme e afatgjatë të vendit dhe të mirëqenies së shoqërisë. Në vijë të përgjithshme, ky stabilitet duhet të jetë objektivi i vetëm legjitim i politikës monetare. Megjithatë, fokusi te stabiliteti i çmimeve nuk duhet ta shmangë vëmendjen e bankës qendrore nga burime të tjera dobësish e rreziqesh. Në veçanti, stabiliteti financiar duhet të jetë një objektivi tjetër komplementar i bankave qendrore, për sa kohë ai bën të mundur stabilitetin e çmimeve dhe mundëson shpërndarjen eficiente të fondeve në ekonomi.

Adoptimi i një kuadri modern të politikës monetare është esencial për suksesin e saj. Ndër të tjera, ky kuadër duhet të jetë transparent në objektivat e tij, gjithëpërfshirës në gamën e informacionit të përdorur, konsistent në vendimmarrje dhe fleksibël në kuadrin operacional të

përdorur. Në veçanti, eksperiencia e fundit ka treguar se bankat qendrore duhet t'i kushtojnë vëmendje edhe instrumenteve jokonvencionale të politikës monetare, si lehtësimi sasior apo ai i kreditit. Megjithatë, këto instrumente duhet të trajtohen si opsione të fundit në radhë, dhe përdorimi i tyre duhet të jetë i kushtëzuar nga shkalla e zhvillimit dhe e sofistikimit të tregjeve financiare.

Sa i takon stabilitetin financiar, kjo sferë e aktivitetit të bankave qendrore duhet të adoptojë – ashtu si politika monetare – një përqsasje të orientuar nga e ardhmja dhe një qëndrim proaktiv. Në veçanti, megjithëse roli ynë si mbikëqyrës e rregullator nuk mund e nuk duhet të jetë garantimi i shëndetit të çdo ndërmjetësi financiar, dobësitë sistematike që përbëjnë premisa për kriza financiare e ekonomike, duhen evidentuar dhe trajtuar në kohë.

Paralelisht me to, eksperiencat e fundit kanë treguar se politika fiskale ka një rol të pazëvendësueshëm në përballimin e goditjeve të forta ekonomike e financiare. Pavarësisht fuqisë dhe kompleksitetit të instrumenteve që disponon banka qendrore, ajo nuk mund të përballojë e vetme dhe me efikasitet të plotë, goditjet me të cilat përballen ekonomitë e vogla dhe të hapura. Për këtë arsye, shëndeti i financave publike duhet parë si një tregues i rëndësishëm i aftësisë së vendit për përballimin e krizave.

Në vija të përgjithshme, këto konsiderata do të përcaktojnë filozofinë e mendimit e të veprimit të Bankës së Shqipërisë në të ardhmen. Megjithatë, gjej me vend të theksoj se një bankë qendrore e përgjegjshme nuk duhet të mjaftohet me studimin e së shkuarës për ta përdorur si udhërrëfyes për të ardhmen. Sfidat e reja që përvijohen në horizont, si inovacioni financiar, ngrohja globale, plakja e popullsisë apo dhe ndryshimi i modelit të biznesit, si pasojë e tensioneve gjeopolitike, duhet të kenë vëmendjen e duhur.

***“Një bankë qendrore e përgjegjshme nuk duhet të mjaftohet me studimin e së shkuarës për ta përdorur si udhërrëfyes për të ardhmen. Sfidat e reja që përvijohen në horizont, si inovacioni financiar, ngrohja globale, plakja e popullsisë apo dhe ndryshimi i modelit të biznesit, si pasojë e tensioneve gjeopolitike, duhet të kenë vëmendjen e duhur.”***

Jam i bindur se punimet e kësaj konference do të hedhin më shumë dritë mbi çështjet dhe sfidat që unë preka.

*Ju faleminderit!*



## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË FORUMIN “DIGJITALIZIMI KUNDREJT PARASË FIZIKE” TË ORGANIZUAR NGA SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE**

**- 14 qershor 2022 -**

*I nderuar z. Zëvendëskryeministër Ahmetaj,  
E nderuar zj. Ministre e Financave Ibrahimaj,  
I nderuar z. Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave,  
Të nderuar pjesëmarrës,*

Është një kënaqësi e veçantë të marr pjesë në këtë Forum që vjen natyrshëm si një hap i mëtejshëm dhe rrjedhojë logjike e diskutimeve dhe tryezave të përbashkëta në lidhje me digjitalizimin e shërbimeve financiare.

Dëshiroj të theksoj se mbështetja dhe nxitja e pagesave elektronike, si në eksperiencat ndërkombëtare ashtu edhe në kontekstin shqiptar, janë parë si një nga mekanizmat më efikas dhe të fuqishëm drejt nxitjes së përfshirjes financiare dhe formalizimit të mëtejshëm të ekonomisë.

Në këto kushte, pavarësisht diskutimeve dhe nevojave për ndërveprim dhe zhvillim nga aktorët, duket sikur objektivat dhe synimet po konvergojnë gjithnjë e më shumë, dhe sinergjia e krijuar sigurisht do të ndikojë në një përfshirje të arritjes së objektivave të caktuar.

Në këtë kuadër, vlen të theksohet se Banka e Shqipërisë ka vendosur tashmë një shtrat efektiv për krijimin e një revolucioni digjital në tregun e pagesave, nëpërmjet kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi, i cili mund të konsiderohet pararojë dhe në kontekstin e Bashkimit Evropian. Ndërkohë në nivel rajonal, Shqipëria është vendi i parë që ka miratuar kuadrin ligjor e rregullativ dhe po nxit zbatimin e “open banking” në treg.

***“Banka e Shqipërisë ka vendosur tashmë një shtrat efektiv për krijimin e një revolucioni digjital në tregun e pagesave, nëpërmjet kuadrit ligjor e rregullativ në fuqi, i cili mund të konsiderohet pararojë dhe në kontekstin e Bashkimit Evropian.”***

Këtu do dëshiroja të ndalesha dhe të shpjegoja se koncepti i “open banking” nënkupton krijimin e zhvillimeve teknologjike, me qëllim që

informacioni i klientëve të bankave të jetë i hapur ndaj palëve të treta. Në këtë drejtim, duhet të kuptojmë që pavarësisht digjitalizimit të dëshiruar nga të gjithë ne këtu, ky zhvillim kërkon investime dhe rregullime mjaft komplekse, të cilat do promovojnë inovacionin në një ambient që do të garantojë siguri maksimale. Duke marrë parasysh se nevoja për krijimin e një ambienti tejet prudent bëhet akoma më domethënëse në rastin e Shqipërisë, ku edukimi dhe përfshirja financiare janë relativisht të ulëta, nevoja për hedhjen e hapave të sigurt nga ana e aktorëve të tregut është shumë e rëndësishme.

Përtej "open banking" dhe ridimensionimit të tregut nëpërmjet prezantimit të aktorëve dhe shërbimeve të reja, dua të përmend se janë ndërmarrë edhe një sërë masash rregullative dhe zhvillimesh infrastrukturore, të cilat kanë në fokus pikërisht nxitjen e pagesave elektronike në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël. Vlen të theksohet se me masat e ndërmarra deri më tani, objektivat e parashikuar në strategji për vitin 2023 janë arritur në mënyrë të kënaqshme që në vitin 2021.

Ky sigurisht është një kontribut i një game të gjerë aktorësh, ku veçanërisht bankat, por dhe institucionet, kanë luajtur rol kyç. Në këtë drejtim, dëshiroj të theksoj se tregu është ndërgjegjësuar dhe është i vetëdijshëm se digjitalizimi është e ardhmja, jo vetëm si rrjedhojë e revolucionit teknologjik që po ndodh në çdo fushë të jetës, por edhe nga pikëpamja e zhvillimit strategjik të tyre, në kuadër të minimizimit të kostove e rreziqeve të mbartura nga praktikat tradicionale, dhe njëkohësisht të rritjes së produktivitetit efektiv.

Pa dashur të përsëris deklaratat e mëparshme, e konsideroj me vlerë të theksoj se të gjithë aktorët e tregut duhen parë si bashkëpunëtorët tanë strategjikë, të cilët me mënyrën e tyre gjithnjë kanë kontribuar në përfshirjen financiare dhe promovimin e shërbimeve të pagesave elektronike. Nëse deri pak vite më parë, pagesa e faturave utilitare, e gjobave, pagesave e tatimeve, doganave dhe sigurimeve shoqërore nëpërmjet internetit dhe celularit dukej një utopi, sot këto shërbime po gjejnë gjithnjë e më shumë përdorim nga publiku i gjerë.

Për ta materializuar në shifra këtë zhvillim, vlen të përmendet se në vitin 2012, rreth 96% e transfertave incioheshin në letër në sportelet e bankave, ndërkohë që sot rreth 50% e transfertave procesohen në distancë. Nëse në llogaritje përfshijmë dhe pagesat me kartë, rezulton se 79% e pagesave dhe transfertave kryhen në distancë dhe vetëm 21%

në degët e bankave. Në këtë këndvështrim, vlerësoj se bankat mbeten të angazhuara për të akomoduar edhe nevojat e platformës e-Albania, si në kushtet ekzistuese, ashtu edhe pas krijimit të “open banking”. Harmonizimi dhe koordinimi kësaj platforme dhe atyre të sistemit bankar, si dhe dhënia e prioritetit zhvillimeve të nevojshme që kërkohen në lidhje me to, do të sjellë jo vetëm një lehtësim dhe ndërveprim më efikas, por dhe shtim të sinergjisë midis të gjitha palëve të përfshira në këto procese.

Megjithatë, të gjitha këto zhvillime sigurisht që nuk mund të kishin ndodhur nëse nga ana e një sërë institucionesh dhe kompanish shtetërore nuk do të ishin kryer zhvillime teknologjike, të cilat mundësojnë ndërveprimin midis tyre dhe bankave. Procesi i fiskalizimit vlerësohet si një zhvillim mjaft i rëndësishëm, si nga pikëpamja e formalizimit të ekonomisë, ashtu edhe në kuadër të krijimit të parakushteve të nevojshme që bizneset të ofrojnë mjete elektronike për pagesa. Kjo, duke filluar që nga mundësia e përdorimit të kodit QR në pagesën e faturave apo dhe çdo instrumenti tjetër elektronik që mund të përdorë infrastrukturën teknologjike të krijuar, deri tek fleksibiliteti që krijon legjisllacioni për kryerjen e transfertave me vlerë të madhe, nëpërmjet kanaleve bankare.

Nga ana tjetër, krijimi i një “depozitari qendror” të të dhënave biometrike të popullsisë, të cilat mund të përdoren si elemente sigurie në komunikimin edhe autentifikimin në distancë, është një zhvillim mjaft pozitiv për digjitalizimin e shërbimeve bankare. Për më tepër, zhvillimi i nënshkrimit elektronik dhe përmirësimi i legjisllacionit për nënshkrimin e kontratave në distancë është gjithashtu një masë mbështetëse në këtë drejtim.

Pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, duhet të jemi të ndërgjegjshëm që mbetet ende punë për t’u bërë. Në radhë të parë, vlerësoj se, nga ana e bankave dhe jobankave, është i nevojshëm angazhimi për zbatimin në praktikë të të gjitha risive të synuara nga ligji “Për shërbimet e pagesave”. Gjithashtu, është e nevojshme të shihen dhe të vlerësohen mundësitë e zhvillimeve infrastrukturore të parashikuara në strategji, të cilat do të sjellin një efikasitet të shtuar në procesimin e pagesave dhe transfertave, si Instant Payments apo SWITCH-i kombëtar.

Për t’i mbështetur të gjitha këto zhvillime, Banka e Shqipërisë është duke punuar për përmirësimin dhe përditësimin (upgrade) e sistemeve të operuara prej saj, me qëllim akomodimin e kërkesave të tregut. Gjithashtu, vëmendje i kemi kushtuar dhe hartimit të kuadrit ligjor për krijimin e llogarisë bazike, kuadër ky i cili synon të nxisë më tej përfshirjen

***“Një theks i veçantë duhet vendosur mbi problematikat e hasura nga hapja e llogarive dhe nënshkrimi i kontratave në distancë, të cilat janë parakusht i nevojshëm për digjitalizimin e shërbimeve.”***

financiare të popullsisë. Vlerësojmë se miratimi i këtij ligji dhe zbatimi i tij nga tregu është tepër i rëndësishëm sa i përket digjitalizimit të shërbimeve financiare, por edhe atyre qeveritare.

Megjithatë, krahas nxitjes së përfshirjes financiare dhe digjitalizimit të shërbimeve, edukimi financiar është një element shumë i rëndësishëm për materializimin e masave dhe arritjen e objektivave të synuar. Në këtë këndvështrim, mendoj se është shumë e rëndësishme që të gjithë së bashku të bashkërendojmë veprimet dhe të intensifikojmë bashkëpunimin, në kuadër të nxitjes së edukimit financiar si një reformë kombëtare.

Përveç sa më sipër, me rëndësi mbetet edhe kapërcimi i çdo problematike të identifikuar gjatë këtyre viteve nga zbatimi i inovacioneve të përmendura më parë. Një theks i veçantë duhet vendosur mbi problematikat e hasura nga hapja e llogarive dhe nënshkrimi i kontratave në distancë, të cilat janë parakusht i nevojshëm për digjitalizimin e shërbimeve.

Pavarësisht parashikimeve ligjore e rregullative në lidhje me këto çështje, zbatimi në praktikë ka dëshmuar se mbar problematika të karakterit teknik. Për këtë qëllim, do të inkurajonim bashkëpunimin e gjithë institucioneve dhe aktorëve të tregut për të tejkaluar problematikat që mund të lindin në lidhje me: parandalimin e pastrimit të parave; nënshkrimin elektronik; lidhjen e kontratave në distancë; promovimin e përdorimit të dokumenteve elektronike dhe informacioneve të nevojshme gjatë aplikimeve të qytetarëve pranë bankave. Të gjitha këto do të lehtësonin më tej digjitalizimin, jo vetëm të pagesave, por dhe të shërbimeve të tjera, si huadhënia dhe investimet, duke kontribuar ndjeshëm në objektivin e përbashkët të formalizimit dhe rritjes së qëndrueshme të ekonomisë.

Gjithashtu, vlerësoj se duke hulumtuar eksperiencat e fqinjëve tanë dhe më gjerë, ne mund të identifikojmë masa të tjera shtesë, të cilat do të nxisin formalizimin e ekonomisë dhe reduktimin e përdorimit të parasë fizike në ekonomi.

Dëshiroj ta përfundoj fjalën time, duke shprehur edhe një herë angazhimin e plotë të Bankës së Shqipërisë për të mbështetur çdo zhvillim të nevojshëm, me qëllim arritjen e objektivave të synuar.



Gjej rastin të përgëzoj Shoqatën Shqiptare të Bankave për punën e palodhur dhe të kahershme të saj, duke nxitur dhe mbështetur çdo projekt, iniciativë ose nevojë të evidentuar nga tregu dhe më gjerë! Përkushtimi dhe profesionalizimi juaj ka kontribuar në mënyrë mjaft efektive, në përmbushjen e rolit të ndërmjetësit midis palëve, duke shërbyer njëkohësisht edhe si katalizator për të promovuar arritjen e objektivave të synuar.

Jam i bindur se edhe punimet e këtij forumi do të rezultojnë mjaft frytdhënëse në këto drejtime dhe çështje me mjaft rëndësi.

*Faleminderit!*



## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË CEREMONINË E PROMOVIMIT TË LIBRIT: “DREJT NJË KRIZE TË RE”**

**- 5 korrik 2022 -**

Jam shumë i kënaqur që mbaj në duar këtë libër me vlerë - të tretin në serinë e vëllimeve bashkëpunime të autorëve – të shkruar nga dy profesorë të nderuar, miq të mi, Profesor Angjeli dhe Profesor Civici. Përmes këtij vëllimi, ata ndajnë mendime, vlerësime, reflektime, pyetje dhe sugjerime mbi krizat e njëpasnjëshme dhe shumëplanëshe me të cilat po përballemi.

E vlerësoj këtë libër gjithashtu si një botim të hershëm në nivel global, në reagim të kësaj “krize të tretë”, siç e quajmë autorët.

Libri diskuton një listë të gjatë çështjesh dhe sfidash me të cilat përballlet ekonomia globale dhe ajo shqiptare. Përmes trajtimit të tyre, autorët sjellin para lexuesit vërtetësinë e situatës që po përjetojmë, duke ndjekur kronologjinë e krizave të njëpasnjëshme nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 te pandemia, periudha “post-covidiane” dhe së fundi kriza e nxitur nga lufta në Ukrainë. Diskutimi i kombinuar i këtyre zhvillimeve dhe efektet e tyre mbi faktorët e prodhimit dhe aktivitetit ekonomik e financiar global përbën boshtin kryesor të librit. Në këtë mënyrë, ata arrijnë të paraqesin një analizë të plotë dhe reale për ngjarjet dhe zhvillimet gjeopolitike e gjeoekonomike. Libri e jep këtë pamje të plotë, duke kryqëzuar të dhënat dhe analizën e ngjarjeve, me historinë dhe sfidat e të ardhmes. Mbi të gjitha, analiza dhe konkluzionet e këtij libri plotësohen nga një tablo e plotë dhe krahasuese e politikave ekonomike, financiare dhe monetare të nevojshme për të përballuar këto sfida.

***“Libri diskuton një listë të gjatë çështjesh dhe sfidash me të cilat përballlet ekonomia globale dhe ajo shqiptare. Përmes trajtimit të tyre, autorët sjellin para lexuesit vërtetësinë e situatës që po përjetojmë, duke ndjekur kronologjinë e krizave të njëpasnjëshme nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 te pandemia, periudha “post-covidiane” dhe së fundi kriza e nxitur nga lufta në Ukrainë.”***

Kriza e luftës, kriza e sigurisë ushqimore (ku çmimet po rriteshin në mënyrë progresive, madje edhe para sulmit rus mbi Ukrainë), kriza energjetike dhe e lëndëve të para, ngadalësimi i përgjithshëm i rritjes

ekonomike, inflacioni, si dhe së fundmi perspektiva e normave më të larta të interesit, po ndikojnë mbi një peizazh tashmë të dëmtuar rëndë nga dy vite pandemi.

Ky libër i dedikohet pikërisht ndjekjes të kësaj situatë ditë pas dite dhe javë pas jave, duke u munduar t'i japë përgjigje pyetjeve: "Çfarë do të ndodhë? Ku po shkojmë? Çfarë do të ndryshojë?".

Periodha që po kalojmë është shoqëruar me dyshime, paqartësia mbi kohëzgjatjen dhe pasojat e luftës, pasiguri, qasje të ndryshme, pyetje, paradokse dhe dilema, të gjitha këto të ekspozuara dhe të analizuar me aq profesionalizëm nga autorët në këtë libër.

Situatës globale, autorët i vënë përballë situatën në Shqipëri, duke vënë në dukje që asnjë ekonomi në nivel evropian, por dhe botëror, nuk u kursye dhe nuk mund të kursehet nga kjo luftë dhe sfidat gjeopolitike që e përcaktojnë atë.

Analiza projektohet në ekonominë shqiptare për të vlerësuar efektet e mundshme negative mbi çmimet dhe aktivitetin ekonomik. Sfida aktuale me të cilën po përballlet ekonomia shqiptare, si pasojë e rritjes së shpejtë të çmimeve të energjisë, të ushqimeve dhe të produkteve bazë në tregjet botërore, ka shtrenjtuar kostot e jetesës së familjeve dhe ka rritur kostot e prodhimit të bizneseve.

Po ashtu, paqartësia mbi kohëzgjatjen dhe pasojat e luftës në Ukrainë, ka shtuar pasiguritë në tregjet financiare dhe ka krijuar pengesa të reja në zinxhirët e furnizimit. Prandaj, kjo goditje që ka filluar të transmetohet në ekonominë shqiptare kërkon një reagim të shpejtë, të efektshëm dhe të gjithanshëm të autoriteteve publike, në një situatë me shumë të panjohura dhe me ndryshime të thella ekonomike, politike dhe sociale.

***"Komunikimi ynë transparent i ka shërbyer qartësisë të publikut mbi kahun e veprimit të politikës monetare dhe ka ndihmuar në kontrollin e pritjeve për inflacionin në tregjet financiare."***

Vërej me kënaqësi se sugjerimet e dhëna për politikën ekonomike e financiare, në rastin e Shqipërisë, janë në përputhje me orientimin aktual të autoriteteve shqiptare. Gjej rastin t'i falënderoj autorët për vlerësimin që i kanë bërë politikës tonë monetare kur shprehen se: "Një ndihmë e vyer në këtë drejtim vjen edhe nga politika monetare e kujdesshme e Bankës së Shqipërisë, që po zbaton një politikë të matur të rritjes së (normës) së

interesave ..., dhe është kujdesur për një stabilitet në kurset e këmbimit të monedhave ndërkombëtare. Kjo pengon ndikimin e stagflacionit (të Eurozonës) në ekonominë shqiptare.”

Siç konstatohet nga autorët, Banka e Shqipërisë është në monitorim të vazhdueshëm të situatës. Fokusi i politikave tona ekonomike e financiare është i orientuar drejt ruajtjes së stabilitetit të çmimeve, si një parakusht për stabilitetin financiar të vendit dhe për rritje të qëndrueshme e afatgjatë, si dhe në ndihmën ndaj shtresave më në nevojë. Ndodhur përballë një situatë me një rritje të shpejtë të inflacionit, jo vetëm në Shqipëri, por kudo në botë, Banka e Shqipërisë, në përgjigje të saj, ndërmoi një hap të parë drejt normalizimit të politikës monetare në muajin mars, duke rritur me 0.5 pikë përqindjeje normën bazë të interesit.

Në të njëjtën kohë, kemi sinjalizuar vullnetin dhe gatishmërinë tonë për të ndërmarrë çdo masë monetare të nevojshme për të shmangur transmetimin e kësaj goditjeje në pritje për inflacion të lartë në të ardhmen. Komunikimi ynë transparent i ka shërbyer qartësisë së publikut mbi kahun e veprimit të politikës monetare dhe ka ndihmuar në kontrollin e pritjeve për inflacionin në tregjet financiare.

Në përgjigje të këtyre masave, të duhurat në kohën e duhur, si dhe vazhdimin e monitorimit dhe përshtatshmërisë së qëndrimit të politikës monetare, analizat tona gjykojnë se ekonomia shqiptare ka premisa të mjaftueshme për t'i rezistuar goditjes dhe për të shmangur recesionin.

Megjithatë, vazhdojmë të ndodhemi përballë rrethanave të paparashikuara, ku është e vështirë të përcaktosh kohën kur kjo situatë do të marrë fund. Pasiguria pasqyrohet dhe në parashikimet tona, megjithatë kjo nuk do të thotë që të mos bëjmë asgjë. Përkundrazi, Banka e Shqipërisë po bën më të mirën e mundshme, duke monitoruar në vazhdimësi – ashtu siç kanë bërë edhe autorët gjatë “rrugëtimit” të këtij libri, ditë pas dite, javë pas javë - implikimet e përhapjes së krizës në ekonomi, ecurinë e tregjeve financiare, si dhe efektivitetin e masave të marra. Banka e Shqipërisë është e gatshme të përdorë të gjitha instrumentet që ka në dispozicion, për t'i zbutur efektet e kësaj krize jo vetëm mbi stabilitetin e çmimeve, por edhe mbi stabilitetin financiar dhe aktivitetin ekonomik.

Ashtu sikurse theksojnë dhe autorët Angjeli e Civici, sfidat që na presin janë tepër serioze dhe atyre u duhet kushtuar vëmendja e duhur. Këtu nuk e kam fjalën veç për sfidat aktuale, por dhe për ato të reja që përvijohen

në horizont, si digjitalizimi dhe inovacioni financiar. Me të drejtë, këtyre dy faktorëve autorët i kanë dedikuar një seksion të tërë të librit.

Sfida të tjera që shpalosen para nesh janë edhe ngrohja globale, plakja e popullsisë apo ndryshimi i modelit të biznesit, si pasojë e tensioneve gjeopolitike. Ju garantoj se Banka e Shqipërisë i ka përfshirë këto sfida në fokusin e politikave afatmesme e afatgjata institucionale, duke kryer studime për t'i kuptuar më mirë ato dhe implikimet e tyre në ekonomi e sistemin financiar.

***“... Banka e Shqipërisë i ka përfshirë sfidat e reja si ngrohja globale, plakja e popullsisë apo ndryshimi i modelit të biznesit, në fokusin e politikave afatmesme e afatgjata institucionale.”***

Përballimi i tyre kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, ku të gjithë aktorët publikë, operatorët e sektorit privat, organizatat ndërkombëtare, organizatat joqeveritare dhe akademikët, të bashkëpunojnë, duke marrë vendimet e duhura, në kohën e duhur dhe në mënyrë sa më të koordinuar.

Duke mos dashur të zgjatem më tej, dua ta mbyll fjalën time duke shprehur besimin e plotë që, nëse secili nga ne do të bëjë më të mirën, përballimi i kësaj goditjeje do të jetë brenda mundësive tona, dhe prej saj do të dalim më të fortë dhe më të përgatitur për goditje të ngjashme në të ardhmen.

Ju falënderoj dhe një herë që më dhatë mundësinë të shpreh mendimet mbi një libër që përbën një lexim të domosdoshëm për intelektualët, ekonomistët, por edhe studentët. Ai hap një dritare njohurie për të kuptuar se ku po shkojmë, çfarë do të ndodhë me ekonominë e Shqipërisë dhe të mbarë botës në vitet e ardhshme.

***Ju faleminderit!***

## **FJALA E GVERNATORIT SEJKO NË SAMITIN E VENDEVE TË RAJONIT ME TEMË: “POLITIKA MONETARE NË NJË MJEDIS INFLACIONI”, BEČIĆI, MAL I ZI - 2 tetor 2022 -**

### **1. RËNDËSIA DHE ROLI I BANKAVE QENDRORE NË RRETHANAT E REJA TË KRIJUARA**

Pas më shumë se një dekade përpjekjesh për të sjellë inflacionin në objektiv, sot e gjejmë veten në një situatë tërësisht të ndryshme. Inflacioni ka kërcyer mjaft mbi objektiv, perspektivat e rritjes ekonomike janë dobësuar, dhe ndjeshmëritë financiare janë në rritje - përfshirë nivelet e larta të borxhit publik. Inflacioni është në krye të të gjitha shqetësimeve tona. Pandemia dhe lufta në Ukrainë po shkaktojnë mungesa të konsiderueshme të furnizimit, ndërkohë që kërkesa pas COVID-19 është ende e lartë. Ajo çfarë nisi si fenomen kalimtar, po rezulton të jetë më e gjërë dhe më qëndrueshme, duke rritur gjasat që inflacioni i lartë aktual të kthehet në ankorim të pritjeve tona. Mendoj se ruajtja e stabilitetit të çmimeve do të jetë sfida e vetme më e madhe për ekonominë dhe shoqëritë gjatë muajve në vijim.

Roli i bankave qendrore është kyç në këtë mjedis të krijuar. Si autoritete monetare, ato mund dhe duhet të kontrollojnë inflacionin, të ankorojnë pritjet për inflacionin dhe të shmangin spiralen çmim-pagë. Ato duhet të tregohen proaktive, për të shmangur humbjen e besimit: çdo ankorim i pritjeve për inflacionin do të shkaktojë më shumë goditje ndaj ekonomisë. Përvoja e viteve 1970 (kulmimi i çmimeve të naftës për shkak të veprimeve të OPEC) është një kujtesë e fortë e dëmit ekonomik të shkaktuar nga lënia jashtë vëmendjes të inflacionit.

Megjithatë, që prej asaj kohe, kuadri institucional i bankave qendrore ka ecur para: në tërësi, bankat qendrore sot janë institucione të pavarura dhe të përgjegjshme, me mandat të qartë për të kontrolluar inflacionin. Kështu, në përputhje me parimet bazë të politikës së shënjestrimit të inflacionit - besueshmëri dhe proaktivitet - Banka e Shqipërisë veprimi menjëherë për të ankoruar pritjet e inflacionit. Ne rritëm normën bazë të interesit, me rreth 125 pikë bazë, në 1.75%, ndërsa i komunikuam tregut qëllimin tonë për të vazhduar më tej me këtë trajektore. I kemi shtuar një

dimension tjetër fleksibiliteti orientimit të tregut mbi të ardhmen e politikës monetare, nëpërmjet kushtëzimit të normalizimit të ardhshëm të politikës monetare - si në lidhje me shpejtësinë edhe shkallën e këtij normalizimi - sipas të dhënave të disponueshme. Për shkak të pasigurisë së lartë dhe kostove të lidhura me vendimet tona, mendoj se ky fleksibilitet është i nevojshëm për të shmangur gabime të tepruara të politikës.

***“Ndërsa të gjitha bankat qendrore në botë po përballen me kërcënimin e inflacionit të lartë, për rajonin tonë, sfida është më e vështirë, duke pasur parasysh historinë tonë të shkurtër me institucione demokratike dhe regjime të besueshme të politikave të ndjekura.”***

Ndërsa të gjitha bankat qendrore në botë po përballen me kërcënimin e inflacionit të lartë, për rajonin tonë sfida është më e vështirë, duke pasur parasysh historinë tonë të shkurtër me institucione demokratike dhe regjime të besueshme të politikave të ndjekura. Megjithatë, ashtu si në krizat e kaluara, besoj se ne do të mund të ngrihem në lartësinë e sfidës.

Ne mund të anorojmë në mënyrë efektive pritjet për inflacionin duke i komunikuar qartë vendimet tona, duke u mbështetur në një kuadër të besueshëm të politikës monetare dhe duke mbrojtur pavarësinë tonë. Kështu, do të mund të zvogëlojmë shkallën e shtrëngimit të politikës që nevojitet për të sjellë inflacionin në objektivat tona.

## **2. ARRITJA DHE KUFIZIMET E MASAVE TË POLITIKËS MONETARE NË LEHTËSIMIN E INFLACIONIT PA GJENERUAR PASOJA NEGATIVE NË RITJEN EKONOMIKE**

Politika monetare nuk mund të ndikojë çmimet e larta të mallrave dhe nuk mund të trajtojë mungesat e furnizimit. Si rrjedhim, inflacioni i lartë do të jetë me ne për një kohë të gjatë. Politika monetare mund të sigurojë që kushtet monetare të jenë në përputhje me objektivin e inflacionit, që pritjet inflacioniste të çmimeve të mbeten të ankoruara - dhe që mungesat e furnizimit të zbusin rëndësën e tyre mbi çmime. Kështu, me shumë gjasa inflacioni do të nisë të kthehet në objektiv. Që kjo të ndodhë, politika monetare duhet të përgjigjet duke rritur normën bazë të interesit. Kur?; Sa do të rritet?; Me çfarë ritmi?; dhe Për sa kohë?; këto janë të gjitha pyetje me vend. Përgjigjet për këto pyetje do të përcaktojnë koston e rezultatit të vendimeve tona. Qëllimi ynë është të ofrojmë një ulje të butë të tij - të ulim inflacionin pa kufizuar rritjen ekonomike, ose pa shkaktuar rritje të papunësisë. Megjithatë, nuk duhet të ketë asnjë keqinterpretim



se normalizimi i politikës monetare do të zvogëlojë kërkesën dhe me mjaft mundësi edhe rritjen ekonomike.

Cilat janë perspektivat në Shqipëri?

Parashikimet tona tregojnë se kemi një mundësi të mirë për ulje të butë të inflacionit, domethënë ta sjellim inflacionin në objektiv duke shmangur recensionin. Megjithatë, kjo mundësi po ngushtohet me çdo përditësim pasues të ekonomisë së BE-së. Sipas skenarit tonë bazë, parashikimet tregojnë që rritja ekonomike të mbetet në territor pozitiv dhe inflacioni të ulet gradualisht, ndërsa mungesat globale të zgjidhen hap pas hapi dhe një politikë monetare më e shtrënguar të gjejë veten e saj të pasqyruar në ekonomi. Ne parashikojmë rritje graduale të normës bazë të interesit, e cila do të vijojë duke arritur nivelin e saj neutral brenda dy viteve. Kjo do të thotë, se ka një rrugë të gjatë përpara se politika monetare të kthehet në kufizuese për rritjen ekonomike dhe punësimin.

***“Parashikimet tona tregojnë se kemi një mundësi të mirë për ulje të butë të inflacionit, domethënë të sjellim inflacionin në objektiv duke shmangur recensionin.”***

Për më tepër, janë disa faktorë, të cilët duhet të na ndihmojnë ndërsa lundrojmë në këtë ngushticë.

Së pari, qëndrueshmëria e fundit ekonomike dhe tregu dinamik i punës në Shqipëri ofrojnë inerci në afatin e shkurtër. Së dyti, sektori bankar është i shëndetshëm dhe i qëndrueshëm ndaj goditjeve. Kështu që, oferta për kredi mbetet e paprekur. Së treti, fillimi në kohën e duhur i procesit të normalizimit po i siguron tregjet mbi angazhimin e pakushtëzuar të bankës qendrore në lidhje me stabilitetin e çmimeve. Pritjet për inflacionin afatmesëm në Shqipëri mbeten në përputhje me objektivin e inflacionit.

Nga ana tjetër, ekzistojnë rreziqe të konsiderueshme që do ta bënin më të vështirë punën për të transmetuar një ulje të butë të inflacionit në Shqipëri. Së pari, mjedisi i huaj sa vjen dhe bëhet më sfidues, ndërsa kriza e energjisë po përshkallëzohet. Së dyti, shfaqja e mundshme e spiraleve çmim-paga në kurriz të tregjeve të shtrënguar të punës, do të mund të kërkojë rritje në kohë më të shpejtë dhe më të larta të normës bazë të interesit.

***“Bankat qendrore nuk mund të sigurojnë të vetme rritjen ekonomike, duke mbajtur një qëndrim lehtësues të politikës monetare në të gjitha kushtet. Reformat strukturore janë promotorët dhe vendimtarë të rritjes dhe mirëqenies ekonomike.”***

Për ta mbyllur, do të doja të theksoja se bankat qendrore nuk mund të sigurojnë të vetme rritjen ekonomike, duke mbajtur një qëndrim lehtësues të politikës monetare. Reformat strukturore janë promotore dhe vendimtare të rritjes dhe mirëqenies ekonomike.

### **3. A ËSHTË PËRFUNDIMISHT E SHKUAR KOHA KUR PARAJA ISHTE E LIRË DHE NORMAT E INTERESIT TË ULËTA?**

Në mjedisin aktual me inflacion të lartë dhe normalizim të politikës monetare, në vitet në vijim duhet të presim të kemi norma më të larta interesit. Por, për t'i dhënë një përgjigje pjesës së dytë të pyetjes - a janë përfundimisht të shkuara normat e ulëta të interesit - na duhet të krijojmë një mendim për dy parime të rëndësishëm të kuadrit të politikës monetare: norma natyrore (apo ekuilibër) e interesit dhe Kurba Philips (PC).

Gjatë dekadave të fundit, ka mbizotëruar mendimi se Kurba Philips po sheshohej dhe normat natyrore kishin rënë në mënyrë të konsiderueshme, për shkak të: rritjes së produktivitetit më një tendencë më të ulët; një shoqërie në plakje; dhe kursimeve me tepri. Ky mendim ka gjetur terren si në ekonominë e zhvilluar dhe në ato në zhvillim, mbështetur në kërkime të cilat tregojnë të njëjtën sjellje dhe në Shqipëri.

Konfigurimi ekonomik - normë natyrore më e ulët dhe Kurba Philips më e sheshuar - kanë ndikime të ndryshme në politikën monetare gjatë periudhës afatmesme:

- Së pari, ndërsa mjedisi me norma të ulëta interesit i dekadës së kaluar me të vërtetë mund të jetë diçka e së shkuarës, nuk duhet të presim së shpejti një kthim të qëndrueshëm në mjedis me normë të lartë interesit siç ndodhi në periudhën 2000 deri në 2010.

***“Ndërsa mjedisi me norma të ulëta interesit i dekadës së kaluar me të vërtetë mund të jetë diçka e së shkuarës, nuk duhet të presim së shpejti një kthim të qëndrueshëm në mjedis me normë të lartë interesit siç ndodhi në periudhën 2000 deri në 2010.”***

- Së dyti, politika monetare duhet të reagojë më me forcë për të arritur të njëjtat rezultate, pasi një Kurbë Philips më e sheshtë do të thotë më pak ndjeshmëri të ekonomisë ndaj normave të interesit.

Por a janë këto tendenca strukturore - normë natyrore më e ulët dhe Kurbë Philips më e sheshtë – të ndikuara nga pandemia dhe lufta? Sot, si asnjëherë tjetër, nuk ka një përgjigje të prerë për këto pyetje.

Tendencat aktuale të ngrohjes globale, ndërprerjet e mundshme të zinxhirëve të furnizimit dhe tensionet gjeopolitike mund të formojnë një mjedis të ri ekonomik. Por ky do të jetë subjekt i kërkimeve dhe vrojtimeve empirike të ardhshme.

E fundit dhe më e rëndësishmja, mendoj se sektori publik dhe ai privat duhet të përgatiten për kosto më të larta të shërbimit të borxhit për të ardhmen e parashikueshme.

#### **4. A MUNDËT BANKAT QENDRORE TË RAJONIT TË VIJOJNË TË NDJEKIN QËNDRIMET E REZERVËS FEDERALE DHE TË BANKËS QENDRORE EVROPIANE?**

Pjesa më e madhe e vendeve të rajonit, përfshirë Shqipërinë, janë të lidhura ekonomikisht me Eurozonën dhe financiarisht janë të ekspozuara ndaj saj. Ciklet tona ekonomike janë të sinkronizuara me ato të Eurozonës në shkallë të lartë dhe sistemet tona financiare janë të euroizuara në mënyrë të konsiderueshme. Për më tepër, sistemet tona bankare përfshijnë banka që kontrollohen nga grupe bankare në BE, ndonëse prania e tyre ka ardhur në rënie vitet e fundit. Kjo na ekspozon ndaj politikave makroprudenciale të Eurozonës dhe ndaj oreksit për rrezik në të gjithë sektorin bankar të BE-së.

Përkundrejt kësaj panorame, qëndrimi i politikës monetare të BQE-së është më i përshtatshmi për ekonominë tona. Qëndrimi i saj ka ndikim më të lartë dhe më të drejtpërdrejtë në kushtet tona monetare dhe në sistemet tona financiare. Nga ana tjetër, politika monetare e FED-it ka më pak ndikim tek ne. Ndikimi i Fed-it transmetohet kryesisht nga kanale jo të drejtpërdrejta, të tilla si çmimet e naftës dhe kushtet e përgjithshme financiare globale.

Qëndrimi aktual i BQE-së është në linjë me ciklin e politikës monetare në gjithë rajonin, ndonëse dikush mund të thotë se është disi pas në reagimin e saj krahasuar me banka të tjera të mëdha qendrore. Në përgjithësi, ciklet e sinkronizuara të politikës monetare ndihmojnë për të ulur luhatjen makroekonomike, kur përballen me goditje të përbashkëta. Për më tepër, duke u përpjekur për të ulur inflacionin në Eurozonë, normalizimi i politikës monetare të BQE-së do të lehtësojë presionet e çmimeve të huaja, si në Shqipëri ashtu edhe në rajon. Duke ndarë të njëjtin qëndrim me BQE-në, na ofrohet ajo shkallë lirie për të ndjekur procesin tonë të normalizimit të politikës monetare, duke ulur kështu gjasat për luhatje

të konsiderueshme dhe të papritura të kursit të këmbimit për shkak të ndryshimeve të normës së interesit.

## 5. NJË NORMË KËMBIMI E QËNDRUESHME NË KOHË TË PAQËNDRUESHME - SPIRANCË NË STUHI

Banka e Shqipërisë ndjek regjimin e shënjestrimit të inflacionit dhe zbaton një regjim të lirë të kursit të këmbimit. Si një ekonomi e vogël, me një nivel relativisht të lartë euroizimi dhe me një sistem financiar të zhvilluar si sistemi ynë, regjimi i kursit të këmbimit ka ndihmuar në mbajtjen e një pjese të barrës, sidomos në kohë krize. Një shembull demonstrues është Kriza Globale Financiare, kur kursi i këmbimit u nënçmua në përgjigje të përkeqësimit të llogarisë korrente, duke shërbyer kështu si absorbues i goditjes dhe duke lehtësuar përshtatjen e ekonomisë.

***“Kur u përballëm me pandeminë dhe tashmë me luftën në Ukrainë, fleksibiliteti i kursit të këmbimit bëri që monedha jonë “Lek” të reflektojë zhvillimin ekonomik specifik të vendit tonë dhe besimin në rritje të qytetarëve tanë në monedhën tonë kombëtare.”***

Në atë kohë, kur u përballëm me pandeminë dhe tashmë me luftën në Ukrainë, fleksibiliteti i kursit të këmbimit bëri që monedha jonë “Lek” të reflektojë zhvillimin ekonomik specifik të vendit tonë dhe besimin në rritje të qytetarëve tanë në monedhën kombëtare. Më lejoni t’i shtjelloj pak më gjatë këto dy episode.

Gjatë dy goditjeve të fundit - nga pandemia dhe lufta në Ukrainë - mbiçmimi i Lekut u udhëhoq nga një kërkesë e fuqishme për turizëm, së pari nga vendet e rajonit, si dhe nga IHD-të e dërgesat e emigrantëve, të dyja në rritje. Përveç përmirësimit të sektorit të jashtëm të ekonomisë - dhe burimet e tij financiare të shëndosha, kryesisht IHD-të - reagimet psikologjike të tregut ndaj goditjeve po bëhen më të kontrolluara me kalimin e kohës. Kjo tregon se tregu ka arritur një pjekuri dhe konsolidim më të lartë duke pasur një besim në rritje në monedhën vendase.

Kursi i këmbimit në Shqipëri me të vërtetë ka qenë një spirancë e qëndrueshme në këto kohëra të turbullta, duke na kursyer shumë shqetësime nëpërmjet mosshumëfishimit të rreziqeve ndaj stabilitetit financiar, ndërsa në të njëjtën kohë ka mbrojtur disi inflacionin e brendshëm nga presionet e çmimeve të huaja. Shqipëria nuk është e mbiekspozuar ndaj flukseve hyrëse afatshkurta të kapitalit. Megjithatë, duhet të mbetemi të kujdesshëm që shtrëngimi global i politikës monetare

do të ndikojë fluksin e kapitalit të huaj. Çdo episod i madh i flukseve dalëse të kapitalit në ekonomitë tona do të pasqyrohet në kurse këmbimi më të dobëta dhe do të përkeqësonte parashikimin për inflacionin. Kështu, ne duhet të jemi të vëmendshëm ndaj shfaqjes së këtij fenomeni dhe të jemi gati për të përdorur çdo dhe të gjitha instrumentet e disponueshme për të zbutur ndikimin e tyre të mundshëm.

***“Përveç përmirësimit të sektorit të jashtëm të ekonomisë - dhe burimet e tij financiare të shëndosha, kryesisht IHD-të - reagimet psikologjike të tregut ndaj goditjeve po bëhen më të kontrolluara me kalimin e kohës.”***

## **6. EFEKTET E POLITIKËS FISKALE ZGJERUESE**

Ndjekja e një politike fiskale zgjeruese, në këtë moment, do të ishte si t'i hidhje benzinë zjarrit. Një politikë e tillë, nëpërmjet nxitjes së kërkesës dhe shqetësimeve në rritje për besueshmërinë fiskale - për shkak të niveleve të larta historike të borxhit dhe nevojës për konsolidim - do të rriste edhe më shumë nivelet tashmë të larta të inflacionit. Gjithashtu, do të kërkonte një shtërngim të mëtejshëm të politikës monetare me ndikime negative në të gjithë sektorin privat.

Kështu, do të ishte larg të qenurit kombinimi më i mirë i mundshëm i politikave për ekonomitë tona. Këshilla jonë për politikën fiskale ka qenë që të japë mbështetje të përkohshme dhe të shënjestruar për shtresat më në nevojë, pa rritur deficitin buxhetor. Subvencionet duhet të jenë të përkohshme dhe të synuara për individë me të ardhura më të ulëta, të cilët janë goditur më rëndë nga inflacioni, dhe të synojë ofrimin e vazhduar të shërbimeve publike bazë si dhe infrastrukturën kyçe të sektorit privat dhe atij publik. Nga ana tjetër, të kërkojë shkurtim të shpenzimeve jo parësore – veçanërisht në fushën e investimeve të sektorit publik. Kjo përqsasje do të sigurojë se mbështetja e ofruar është ajo e duhura dhe efektive, ndërsa do të kufizonte efektet e saj në buxhetin e qeverisë dhe në inflacion.

Qeveria shqiptare ka marrë një sërë masash për të zbutur efektet e çmimeve të rritura në buxhetet e familjeve. Nga ana tjetër, qeveria po vijon me konsolidimin fiskal. Në këtë drejtim shifrat e deficitit fiskal dhe të borxhit janë në rënie.

Për ta përmbledhur, mendoj se kombinimi i politikave, sot duhet të ketë në thelb: një normalizim të politikës monetare dhe asaj fiskale kombinuar

me mbështetje fiskale të përkohshme. Gjithashtu, do të sillnin përfitim reformat strukturore që kanë për qëllim zhvillimin më tej të potencialit të rritjes së ekonomisë dhe mbështetjen e qëndrueshmërisë së saj.


## **7. STABILITETI I SISTEMIT BANKAR NË RAJON - MËSIMET E NXJERRA NGA KRIZA E 2008/2009**

Spektori ynë bankar u përforcua pas reformave të marra pas Krizës Financiare Globale. U ndërmorën një sërë reformash dhe u bë një përpjekje e madhe për të përmirësuar shëndetin e sektorit bankar. Përpjekjet përfshinë:

- Një plan gjithëpërfshirës për të përmirësuar mjedisin kreditues dhe për të reduktuar kreditë me probleme, i cili dha rezultat në kufizimin e rrezikut të kredisë. Norma e kredive me probleme rezultoi në nivelin 5.3%.
- Zvogëlimin e numrit të bankave dhe konsolidimin e sistemit bankar, duke nxitur bashkimet dhe përthithjet brenda sistemit, çka rriti efikasitetin dhe konkurrueshmërinë në sistemin bankar. Rezultatet e këtij procesi kanë qenë tejet pozitive dhe janë reflektuar në konkurrueshmëri të lartë dhe rritje të ekuilibruar të kredisë.
- Një paketë masash për të nxitur përdorimin e monedhës kombëtare në aktivitetin financiar. Efektet deri më tani janë shpresëdhënëse. Struktura monetare e huadhënies ka arritur një nivel thuajse të barabartë mes lekut dhe monedhës së huaj, nga një normë 3/1 në favor të monedhës së huaj pesë vite më parë.
- Përafrimin e kornizës rregullatore me standardet e SEBQ-së.
- Dialogun e vazhdueshëm me tregun, duke i sjellë ata më afër dhe gjetjen e zgjidhjeve për sfidat me të cilat përballen bankat teksa përpiqen të përmbushin rolin e tyre si ndërmjetësues në ekonomi.

Për pasojë, treguesit e shëndetit të sektorit bankar në fillim të pandemisë ishin të fortë, për sa i përket likuiditetit, përfitueshmërisë, kapitalizimit dhe standardeve operacionale. Pandemia e testoi me ashpërsi rezistencën e tij; një test që sistemi ynë bankar e përballoi mjaft mirë. Përgjithësisht, ai e kreu rolin e tij në përthithjen e goditjeve. Përgjatë gjithë krizës, sektori bankar mbështeti ekonominë me kredi dhe likuiditet. Gjithashtu është e rëndësishme të përmendim se ai mori përsipër një pjesë të konsiderueshme të kostos së pandemisë, duke mundur një moratorium të detyrueshëm, edhe pse të përkohshëm, për pagesën e kredisë, si edhe ristrukturimin vullnetar të kredisë. Kjo është mirëpritur si diçka e re në krahasim me të shkuarën, ku - në përgjithësi - sektorët bankarë në të gjithë rajonin kishin tendencë të ktheheshin në nxitës të goditjeve.

Grafik 38. Tregues të përfitueshmërisë dhe shpenzimeve të sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Disa nga mësimet që nxorëm janë:

- rëndësia që ka rregulli i kujdesshëm, i bashkërenduar dhe kundërciklik për të forcuar stabilitetin financiar;
- rëndësia që kanë rjetet e sigurisë financiare për të ruajtur besueshmërinë e sistemit dhe për të zvogëluar rreziqet sistemike;
- rëndësia që ka bashkëveprimi në nivel vendor dhe ndërkombëtar për të shmangur arbitraritetin rregullator dhe pasojat negative; si edhe
- rëndësia që ka qeverisja e duhur dhe praktikat e përshtatshme të administrimit të rrezikut mes bankave dhe ndërmjetësuesve të tjerë financiarë.

Edhe pse ekspozimi ynë direkt ndaj Ukrainës dhe Ruisë është tepër i ulët, mjedisi i ri - që karakterizohet nga inflacion i lartë, norma të larta interesi dhe pasiguri e madhe - do të jetë tepër sfidues. Qëndrueshmëria e sistemit bankar do të testohet sërish. Ne do të jemi tepër të vëmendshëm për të kapur në kohë dhe për të adresuar dobësitë që shfaqen sipas rastit.

## 8. PARANDALIMI DHE KUFIZIMI I SHTIMIT TË KREDIVE ME RREZIK NË NJË NIVEL TË PRANUESHËM NË KUSHTE TË PAQARTA

Shërbimi më i mirë që mund t'i bëjmë këtij objektiv është së pari, të ruajmë stabilitetin monetar dhe financiar, dhe së dyti, të sigurohemi që ndikimi negativ që ka inflacioni i lartë dhe reagimi i politikës tonë monetare në rritjen ekonomike, të jetë sa më minimal.

Padyshim që nëse arrijmë ta sjellim inflacionin në objektiv në një hark kohor të arsyeshëm dhe duke pasur një ndikim sa më të vogël në aktivitetin ekonomik, nuk do të ketë arsye që normat e kredive me probleme të kenë shpërthime madhore.

Në këtë pikë, duhet të shmangim çdo përsiatje për t'u përfshirë në ristrukturime të kredisë ose moratoriume mbi kredinë, si ato që u ndërmorën gjatë pandemisë. Këto veprime do të vendosnin në vështirësi fitimin e sektorit tonë bankar dhe do të krijonin kanosje morale dhe rreziqe afatgjata për kredinë.

## 9. PËRPARËSITË E POLITIKËS MONETARE NË PERIU DHËN AFATMESME DHE AFATGJATË

***“Tre sfidat me të cilat po përballet politika monetare në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme:***

- të përcaktohet momenti dhe ritmi i saktë i shtrëngimit të politikës monetare;***
- të kemi një konsensus të gjerë mbi përshtatshmërinë e kursit tonë të politikës monetare;***
- të jemi syhapur ndaj ndikimit të mundshëm negativ që mund të ketë qëndrimi ynë i shtrënguar i politikës monetare.”***

Në periudhën afatshkurtër, prioriteti ynë është ruajtja e stabilitetit monetar dhe financiar. Kjo përkthehet në uljen e inflacionit në kohë dhe në mënyrë të qëndrueshme, teksa kostot në aktivitetin ekonomik dhe në bilancet e sektorit bankar kufizohen sa më shumë të mundet. Për të arritur këtë, kërkohet një ndërveprim barazpeshues delikat mes objektivash kundërshtues gjatë një periudhe të lartë pasigurie.

Dëshiroj të nënvizoj tre sfidat me të cilat po përballet politika monetare në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme.

- E para, të përcaktohet momenti dhe ritmi i saktë i shtrëngimit të politikës monetare. Kjo është thelbësore veçanërisht duke marrë parasysh ndikimin e kundërt që do të ushtrojnë kushtet financiare më të shtrënguara në kërkesën agregate, dhe, mundësisht, në cilësinë e aktiveve të sektorit bankar. Çdo gabim mund të kushtojë, qoftë nëse politika monetare është tepër e shtrënguar qoftë nëse është tepër e lehtësuar. Duke pasur parasysh nivelin e lartë të pasigurisë, është mjaft e rëndësishme të tregojmë kujdes dhe të përditësojmë vazhdimisht kushtet makroekonomike, për të rregulluar ritmin e shtrëngimit sipas rastit. Teksa politika monetare nuk duhet të jetë burim pasigurie, ajo nuk mund të vendoset as në vetëdrejtim.
- E dyta, duhet të kemi një konsensus të gjerë mbi përshtatshmërinë e



kursit tonë të politikës monetare. Duhet ta kemi të qartë që inflacioni i pakontrolluar është një rrezik më i madh ndaj ekonomisë se sa kushtet financiare përkohësisht të shtrënguara. Publiku i gjerë duhet të jetë në anën tonë, ashtu si edhe sektori publik dhe ai financiar. Sa më e lartë të jetë shkalla e pranimit të qëndrimit tonë të politikës monetare, aq më efikas është mekanizmi i transmetimit. Kjo arrihet veçse me anë të një dialogu të kujdesshëm me të gjithë aktorët e ekonomisë.

- E treta, duhet të jemi syhapur ndaj ndikimit të mundshëm negativ që mund të ketë qëndrimi ynë i shtrënguar i politikës monetare. Nga njëra anë, cilësia e aktiveve të sektorit bankar mund të përkeqësohet, kryesisht përmes kanalit të rrezikut të normës së interesit. Të pasurit e amortizatorëve të fortë të kapitalit do të thotë se bankat janë në pozicion shumë më të mirë për të përballuar goditjet se sa ishin gjatë Krizës Financiare Globale. Megjithatë, ne do të vazhdojmë të garantojmë aftësinë e bankave për t'i rezistuar goditjeve përmes përpjekjeve tona mbikëqyrëse të vazhdueshme. Nga ana tjetër, kostot financiare të sektorit bankar do të rriten, çka do të ndikonte buxhetet publike në të ardhmen e parashikueshme. Qeveria duhet të ketë dijeni për këtë.

Në periudhën afatmesme, teksa mbetemi të përkushtuar për të mundësuar stabilitetin e çmimeve, Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të përditësojë dhe perfeksionojë mjetet e politikës monetare, duke përfshirë transparencën dhe komunikimin, që të jemi më të mirëpërgatitur për të ardhmen, si edhe do ndihmojë që tregjet tona të brendshme financiare, të cilët luajnë rol të rëndësishëm për mbarëvajtjen efektive të politikës monetare, të përparojnë.

## **10. STIMULIMI I RITJES SË AKTIVITETIT KREDITUES PA CENUAR STABILITETIN E SISTEMIT BANKAR**

Rritja e kredisë është e lartë në Shqipëri. Aktualisht, ajo po zgjerohet me 13.8% në terma vjetorë. Përveç rritjes, kreditimi ka shfaqur disa cilësi pozitive, të cilat dua t'i përmend këtu.

- E para, kreditimi bankar është me bazë të gjerë, duke i shërbyer si bizneseve ashtu edhe individëve, për investime dhe qëllime shpenzimesh aktuale. Veçanërisht gjatë pandemisë, ka qenë instrument i domosdoshëm në sigurimin e likuiditetit të sektorit të ndërmarrjeve dhe ka ndihmuar në financimin dhe në avancimin gradual të investimeve private dhe konsumit.
- E dyta, kreditimi në lekë është rritur me një ritëm të qëndrueshëm, duke bërë që struktura e portofolit të kredisë të vendoset sërish në


ekuilibër. Në të vërtetë, kredia në lek dhe në monedhë të huaj është pothuajse e njëjtë. Ky ekuilibër i rikthyer është një zhvillim pozitiv që rrit efikasitetin e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare dhe ul rrezikun e kursit të këmbimit.

- E treta, norma e kredive me probleme është në rënie, çka sugjeron se cilësia e kreditimit është në përmirësim.

Falë edhe reformave - zgjidhjes së çështjes së kredive me probleme, deeuroizimit - dhe mbikëqyrjes sonë të vazhdueshme, bankat kanë bërë përmirësime të ndjeshme në vitet e fundit, duke rritur raportet e tyre të kapitalit dhe duke pastruar bilanci. Për më tepër, konsolidimi i sektorit bankar ka krijuar kushtet për të rritur konkurrueshmërinë dhe efikasitetin dhe për të zhblokuar potencialin kreditor. Rrjedhimisht, oferta e kredisë nuk duhet të preket, duke mbështetur zgjerimin e konsumit dhe të investimeve në vazhdimësi.


**Grafik 39.**

*Kredia për sektorin privat ka shtuar norma të larta rritjeje, ku përmirësimi i normave të rritjes së kredisë në monedhë të huaj ka kompensuar ngadalësimin e asaj në lekë*



*Shënime: Të dhënat përfaqësojnë ndryshimet vjetore (%) të kredisë të pastruar nga lëvizjet e kursit dhe nxjerrjet nga bilanci. Burimi: Banka e Shqipërisë.*

*Rritja e shpejtë e kredisë është mbështetur nga zgjerimi i kredisë për bizneset për të mbuluar nevojat për likuiditet*



*Shënime: Të dhënat përfaqësojnë ndryshimin vjetor të KSP dhe kontributet e kredisë sipas qëllimit të përdorimit. Burimi: Banka e Shqipërisë.*

Megjithatë, nuk ka vend për murrje, sepse bankat janë ende duke vepruar në një mjedis kërkues. Perspektiva ekonomike nuk është optimiste dhe politika monetare po normalizohet. Në këtë kontekst, mendoj se cilësia e kredisë meriton vëmendje të shtuar.

Ne do të vazhdojmë të monitorojmë me kujdes implikimet e mundshme negative të situatës në bilanci të sektorit bankar, duke ndjekur në mënyrë aktive rregulla të kujdesit dhe duke vijuar përmirësimet strukturore në sektorin bankar.

## **11. POLITIKAT MONETARE DHE FISKALE ME TË NJËJIN MISION - DY ANËT E SË NJËJTËS MONEDHË**

Ndodhur përballë një goditjeje tjetër, politika monetare dhe fiskale duhet sërish të përafrohen për të mbrojtur qytetarët nga kostot ekonomike dhe sociale që shkaktohen nga ndryshimet e papritura të kushteve ekonomike. Megjithatë, duhet të vepohet ndryshe kësaj radhe: politika monetare duhet të normalizohet për të luftuar inflacionin, ndërsa ajo fiskale duhet të lehtësojë rritjen ekonomike, përmes masave të shënjestuara dhe të përkohshme.

Diskutuam gjerësisht përse ndjekja e një politike fiskale zgjeruese nuk është e dëshirueshme. Këtë dëshiroj ta shoh nga një këndvështrim tjetër, i cili është i përshtatshëm të paktën për rastin e Shqipërisë.

Në rrethanat aktuale, një nxitje fiskale e përgjithshme duhet të shmanget për dy arsye:

- E para, edhe pse po rrisim normën bazë të interesit, norma reale e interesit - e korigjuar nga inflacioni - është negative. Sipas projekteve tona, ajo do të mbetet e ulët dhe poshtë normës neutrale në dy vitet e ardhshme, duke dëshmuar se politika monetare do ta mbështesë ekonominë.
- E dyta, me nivelet tejet të larta të kredisë, vetë politika fiskale është në udhëkryq, duke u përpjekur të gjejë ekuilibrin e saktë mes nevojës për të rikthyer qëndrueshmërinë e kreditimit dhe nevojës së popullsisë për t'u mbrojtur ndaj kostove në rritje të jetesës. E përsëris, këshilla jonë ndaj qeverisë ka qenë: të sigurojë masat që janë të përkohshme dhe të shënjestuara për shtresat më të ndjeshme të shoqërisë; t'i japë sërish përparësi shpenzimeve në investime me produktivitet më të lartë; dhe të përdorë të gjitha të ardhurat - që gjenerohen nga fitimet tepër të larta si pasojë e çmimeve të rritura - për të reduktuar kredinë.

Në horizontin afatmesëm, qeveria shqiptare është e përkushtuar ndaj një politike fiskale konsoliduese, në mënyrë që borxhi publik të ndjekë një trajektore rënëse, dhe amortizatorët e politikës të vihen sërish në punë dhe të rritet besueshmëria. Kjo e fundit është me rëndësi për praninë e Shqipërisë në tregjet financiare ndërkombëtare, si aktualisht ashtu edhe në të ardhmen, ashtu edhe për zbatimin e politikës monetare. Ne e mbështesim këtë kurs veprimi. Në të njëjtën kohë, mjedisi sfidues kërkon një përkushtim ndaj nxitjes së politikave strukturore.

## 12. SFIDAT E REJA TË BANKAVE QENDRORE

***“Kriptovalutat, mega të dhënat dhe zhvillimet Fintech po sfidojnë modelet tradicionale të veprimtarisë së ndërmjetësimit financiar, sidomos bankat, duke e ndërlikuar më tej panoramën financiare për rregullatorët financiarë.”***

Ekonomia globale po përjeton ndryshime të shpejta strukturore, si pasojë e një llojshmërie faktorësh. Nga njëra anë, zhvillimet teknologjike kanë sjellë një revolucion në tregjet financiare.

Kriptovalutat, mega të dhënat dhe zhvillimet Fintech po sfidojnë modelet tradicionale të veprimtarisë së ndërmjetësimit financiar, sidomos bankat, duke e ndërlikuar më tej panoramën financiare për rregullatorët financiarë. Nga ana tjetër, tendencat e ngrohjes globale, plakja e popullsisë dhe prapësimi i mundshëm i globalizimit, do të sjellë më tepër luhatshmëri, rritje më të ulët, dhe do të rrisë kostot njëherë e përgjithmonë.

Këto tendenca janë sfida komplekse për bankat qendrore, duke përfshirë bankat qendrore të rajonit tonë.

## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË KONFERENCËN VJETORE TË BANKËS SË SHQIPËRISË**

- 27 tetor 2022 -

*E nderuar zj. Ministre,  
I nderuar z. Monastriotis,  
Të nderuar pjesëmarrës,*

Është kënaqësi për mua të hap punimet e konferencës së 16-të vjetore të Bankës së Shqipërisë, të organizuar në bashkëpunim me Shkollën e Londrës për Shkenca Ekonomike dhe Politike (LSE). Jam i bindur se, ashtu si dhe në vitet e mëparshme, kjo konferencë do të na ndihmojë të kuptojmë më mirë origjinën dhe kompleksitetin e sfidave me të cilat po përballemi, si dhe të identifikojmë politikat e duhura për adresimin e tyre. Në këtë drejtim, më lejoni të konstatoj se niveli i lartë i ekspertizës së folësve dhe gama e gjerë e eksperiencës së të ftuarve, ofrojnë një garanci solide për suksesin e saj.

Tema e përzgjedhur këtë vit është rritja e shpejtë e inflacionit në ambientin global dhe problematika që ky inflacion sjell për politikëbërësit, në nivel makro dhe mikroekonomik. Megjithatë, si institucione profesionale dhe largpamëse, detyra e bankave qendrore është të mos lejojnë që agjenda e ditës të eklipsojë trajtimin e problemeve të së ardhmes. Për këtë arsye, kjo konferencë nuk do të lerë jashtë vëmendjes as sfidat në rritje që imponojnë mbi ne ndryshimet e vrullshme strukturore në ekonomi, në shoqëri dhe në ambientin fizik që na rrethon.

Si Guvernator i Bankës së Shqipërisë, në këtë fjalë hapëse, dëshiroj të ndaj me ju vizionin tonë mbi temat e parashtruara, duke u përqendruar te ecuria e inflacionit dhe masat tona për respektimin e objektivit të stabilitetit të çmimeve dhe duke përmendur shkurtimisht sfidat afatgjata të zhvillimit.

*Të nderuar pjesëmarrës,*

Organizimi nga një bankë qendrore i një konference të fokusuar mbi inflacionin,

***“Organizimi nga një bankë qendrore i një konference të fokusuar mbi inflacionin, mund të duket gjëja më normale, e megjithatë, për një praktikant të fushës, kthimi i sinkronizuar i vëmendjes së bankave qendrore drejt identifikimit të masave të nevojshme dhe gjetjes së instrumenteve më efektive për reduktimin e inflacionit, është një moment historik.”***

mund të duket gjëja më normale, e megjithatë, për një praktikant të fushës, kthimi i sinkronizuar i vëmendjes së bankave qendrore drejt identifikimit të masave të nevojshme dhe gjetjes së instrumenteve më efektive për reduktimin e inflacionit, është një moment historik.

Për më shumë se tre dekada, ekonomia dhe tregjet financiare botërore janë karakterizuar nga rritje relativisht e qëndrueshme ekonomike, inflacion i ulët dhe kushte të favorshme financimi. Ndonëse krizat financiare nuk kanë munguar, qofshin këto lokale, rajonale apo globale, stabiliteti ekonomik dhe monetar është marrë si i mirëqenë në vendet e zhvilluara dhe ka qenë një realitet gjithnjë e më i prekshëm për vendet në zhvillim. Ky realitet emërtoi dhe një periudhë të historisë së ekonomisë, të quajtur Moderacioni i Madh.

Konsolidimi i stabilitetit ekonomik dhe monetar ka pasur dy nxitës të fuqishëm historikë: nga njëra anë, globalizimi i tregjeve të produkteve, integrimi në zinxhirët e prodhimit të vendeve në zhvillim të Azisë dhe të Evropës Lindore, si dhe ulja e tensioneve gjeopolitike, sollën një rritje të ofertës agregate botërore, duke nxitur rritjen ekonomike dhe duke mbajtur të ulëta kostot e prodhimit; nga ana tjetër, kristalizimi i një konsensusi ekonomik e politik mbi rolin e bankave qendrore, rritja e pavarësisë institucionale e operacionale të tyre, si dhe fokusi mbi stabilitetin e çmimeve si objektivi primar i politikës monetare, ofruan një mekanizëm eficient dhe të besueshëm për kontrollin e inflacionit dhe zbutjen e cikleve të biznesit.

***“Rritja e stabilitetit monetar dhe e besueshmërisë së bankave qendrore, i mundësoi ekonomisë botërore të absorbojë një stimul të paprecedentë monetar në periudhën e krizës financiare globale dhe në periudhën e pandemisë.”***

Rritja e stabilitetit monetar dhe e besueshmërisë së bankave qendrore, i mundësoi ekonomisë botërore të absorbojë një stimul të paprecedentë monetar në periudhën e krizës financiare globale dhe në periudhën e pandemisë. Bankat qendrore ulën në nivele minimale historike kostot e financimit, duke i çuar në disa raste dhe në territor negativ, si dhe rritën me shpejtësi bilancet e tyre.

Stimuli monetar rezultoi vendimtar në amortizimin e pasojave të krizës dhe në krijimin e parakushteve për rimëkëmbje ekonomike. Ai u shoqërua me rritje të borxhit publik e privat, por nuk u përkthye në inflacion të lartë, duke ilustruar edhe njëherë përfitimet e Moderacionit të Madh.

Fatkeqësisht, agresioni ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës ka sjellë para nesh një realitet të ri. Tensioni gjeopolitik që pasoi konfliktin solli probleme masive dhe të papritura në zinxhirët botërorë të furnizimit me produkte sensitive, si ushqime, lëndë bazë e energji, dhe rritje të shpejtë të pasigurisë në tregjet botërore. Kjo goditje përko me rikuperimin e shpejtë të kërkesës agregate në periudhën post-pandemike dhe u pasqyrua në rritjen e shpejtë të inflacionit botëror gjatë vitit 2022. Tashmë, pjesa më e madhe e vendeve të zhvilluara dhe në zhvillim po përballen me nivele inflacioni të paprecedenta prej disa dekadash.

As Shqipëria nuk bën përjashtim nga ky realitet. Inflacioni shënoi rritje të shpejtë gjatë vitit 2022, duke arritur nivelin 8% në tremujorin e tretë – nivel ky më i larti i regjistruar që prej vitit 1998. Ndonëse inflacioni në Shqipëri paraqitet i ulët, si në kontekstin rajonal dhe në atë evropian, duke pasqyruar ecurinë e fortë dhe të qëndrueshme të kursit të këmbimit dhe çmimet e rregulluara të energjisë elektrike për familjet, baza e tij ka ardhur në rritje e zgjerim. Tashmë, pjesa më e madhe e artikujve të shportës shfaqin një normë inflacioni mbi objektivin tonë prej 3%. Po ashtu, artikujt e shportës me normë të lartë apo në rritje inflacioni nuk janë më vetëm mallra e shërbime me origjinë importi, por edhe produkte, të cilat pjesën më të madhe të vlerës së shtuar e gjenerojnë në vend.

Identifikimi i reagimit të duhur ndaj kësaj goditjeje përbën një sfidë madhore për qeveritë, për bankat qendrore, për tregjet e ndërmjetësit financiarë, por edhe për bizneset dhe familjet.

- Për qeveritë, tensioni ekonomik dhe social që inflacioni i lartë sjell mbi shtresat më të varfra të shoqërisë dhe segmentet më të brishta të ekonomisë, artikullohet në kërkesa të shtuara për mbështetje fiskale. Megjithatë, plotësimi i këtyre kërkesave bëhet problematik, për sa kohë financat publike janë në presionin e pasigurisë për të ardhmen dhe të kostove të rritura të financimit të borxhit.
- Për bankat qendrore, trajtimi i goditjeve të ofertës me origjinë të huaj paraqet një dilemë jo të vogël, për faktin se këto goditje kanë ndikim të kahut të kundërt mbi aktivitetin ekonomik dhe nivelin e çmimeve. Në çdo rast, politika monetare mbetet e ndërgjegjshme për balancën delikate që ekziston midis respektimit të objektivit primar të kontrollit të inflacionit me respektimin e objektivit dytësor të zbutjes së luhatjeve ekonomike.
- Për tregjet dhe ndërmjetësit financiarë, nivelet e larta të inflacionit tentojnë të shoqërohen me rritje të pasigurisë, duke sjellë nevojën e

një rivlerësimi të ekspozimit ndaj rrezikut dhe rishikimi të strategjive të tyre të zhvillimit.

- Së fundi, për bizneset dhe familjet, inflacioni i lartë përbën një sfidë korrente për kostot e jetesës dhe të biznesit, por dhe një sfidë afatgjatë mbi planet e tyre financiare dhe të biznesit.

Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë e ka identifikuar nivelin e lartë të inflacionit si rrezikun primar për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit, për rritjen e mirëqenies shoqërore dhe për kohezionin social. Për këtë arsye, ne kemi ndërmarrë një normalizim gradual, por të vendosur, të qëndrimit të politikës monetare. Banka e Shqipërisë ka rritur katër herë normën bazë të interesit gjatë vitit 2022, duke e sjellë atë nga niveli minimal historik prej 0.5% në nivelin aktual prej 2.25%. Në këndvështrimin tonë, ky normalizim është një masë e domosdoshme për ruajtjen e ekuilibrave ekonomikë dhe financiarë të vendit. Ai synon të krijojë kushte më të përshtatshme monetare për respektimin e mandatit tonë ligjor të stabilitetit të çmimeve dhe për kthimin e inflacionit në objektiv brenda një horizonti kohor dyvjeçar, duke minimizuar në të njëjtën kohë luhatjet afatmesme dhe afatgjata në aktivitetin ekonomik.

Kjo vendimmarrje është motivuar nga tre konsiderata të rëndësishme, të cilat – në gjykimin tonë – ofrojnë një kuadër konsistent analize për përcaktimin e kahut të reagimit të politikës monetare.

Së pari, presionet inflacioniste në vend paraqiten të forta dhe të qëndrueshme. Ndonëse këto presione burojnë – në masën më të madhe – nga goditje të huaja të ofertës, ato kanë filluar të transmetohen tashmë në strukturën e kostove të ekonomisë shqiptare dhe në pritjet për inflacion të agjentëve ekonomikë. Ky konstatim është në sinkron të plotë me evoluimin e mendimit të thujtë gjithë bankave qendrore dhe mbart konsensusin e analistëve ekonomikë.

Qëndrueshmëria e presioneve inflacioniste është nxitur nga kohëzgjatja dhe intensiteti i goditjes së ofertës së huaj, nga kërkesa relativisht e qëndrueshme për mallra e shërbime në vend, por edhe nga reduktimi i kapaciteteve të pashfrytëzuara në tregun e punës dhe të kapitalit. Kjo e fundit është shoqëruar me rritje të shpejtë të punësimit dhe të pagave në ekonominë shqiptare, duke lehtësuar transmetimin e goditjeve të mëtejshme të ofertës.

Për këtë arsye, ekonomia shqiptare rrezikon të përjetojë një periudhë të gjatë me inflacion të lartë, në mungesë të reagimit të politikës monetare.



Së dyti, inflacioni i lartë dhe i qëndrueshëm sjell – në mënyrë të pakontestueshme – pasoja negative për zhvillimin ekonomik e social, pasoja të cilat tentojnë të jenë më të mëdha për vendet në zhvillim si Shqipëria. Një nga ironitë e mëdha të suksesit të politikave të stabilizimit, është se shpesh agjentët ekonomikë harrojnë motivimin dhe përfitimet e këtyre politikave. Për këtë arsye, më lejoni të shpenzoj pak kohë në rifreskimin e kujtesës sonë të përbashkët mbi efektet negative të inflacionit.

Në këndvështrimin ekonomik, teoria dhe praktika botërore dëshmojnë se inflacioni i lartë redukton nivelin dhe rrit luhatjet e rritjes ekonomike në afatin e gjatë. Efekti negativ i inflacionit buron nga rritja e pasigurisë dhe shpërndarja joeficiente e burimeve financiare dhe njerëzore në ekonomi, si pasojë e reduktimit të aftësisë sinjalizuese të çmimeve të tregut. Këto pasoja përforcohen më tej nga rritja e vëmendjes së bizneseve dhe familjeve ndaj mbrojtjes financiare, në kurriz të investimeve afatgjata në aktive fizike, si dhe nga rritja e kostove reale të financimit, në pasqyrim të reduktimit të kursimeve financiare.

***“... teoria dhe praktika botërore dëshmojnë se inflacioni i lartë redukton nivelin dhe rrit luhatjet e rritjes ekonomike në afatin e gjatë. Efekti negativ i inflacionit buron nga rritja e pasigurisë dhe shpërndarja joeficiente e burimeve financiare dhe njerëzore në ekonomi, si pasojë e reduktimit të aftësisë sinjalizuese të çmimeve të tregut.”***

Në këndvështrimin social, teoria dhe praktika botërore dëshmojnë se inflacioni i lartë rrit pabarazinë sociale, duke prekur më shumë shtresat me të ardhura të pakta, si dhe mund të dëmtojë konsensusin politik dhe vetë institucionet demokratike të një shteti.

Në kontekstin e vendeve në zhvillim, inflacioni i lartë ka një ndikim shtesë negativ në stabilitetin financiar, duke dëmtuar besimin e publikut në monedhën kombëtare dhe duke goditur, potencialisht, edhe besimin e tij në institucionet financiare.

Nisur nga sa më sipër, qëndrueshmëria e presioneve inflacioniste dhe dëmet afatgjata të inflacionit ofrojnë, në vetvete, premisa të mjaftueshme për një reagim të politikës monetare. Megjithatë, vendimmarrja jonë në këtë drejtim është motivuar edhe nga një konsideratë e tretë.

Normalizimi i qëndrimit të politikës monetare nuk do të shoqërohet me pasoja të panevojshme negative për ekonominë shqiptare dhe stabilitetin e saj monetar e financiar. Projektionet tona sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet në afatin e mesëm dhe të gjatë. Po ashtu, rezultatet e simulimeve tona sugjerojnë se sistemi bankar ka një shkallë të kënaqshme rezistence, edhe ndaj goditjeve relativisht ekstreme ekonomike dhe financiare. Në mënyrë metaforike, ne hyjmë në këtë betejë të bindur se kura jonë do të shërojë sëmundjen, por – sado e hidhur dhe e pakëndshme – nuk do të dëmtojë pacientin.

Kjo bindje bazohet në analiza të plota, të vazhdueshme dhe të kujdesshme, konkluzionet kryesore të të cilave po i radhis në vijim.

Së pari, ekonomia shqiptare vjen në këtë përballje me një inerci pozitive zhvillimi. Aktiviteti ekonomik në vend shënoi një rimëkëmbje të shpejtë gjatë vitit të shkuar dhe gjysmës së parë të këtij viti. Burimet e rritjes shfaqen të gjera, të bazuara si në kërkesën e brendshme dhe në atë të jashtme. Bilancet financiare të bizneseve dhe familjeve janë relativisht të shëndetshme, ndërsa tregu i punës mbetet dinamik, i karakterizuar nga rritje e qëndrueshme e punësimit dhe pagave. Në këtë kontekst, ndonëse ngadalësimi i ritmit në të ardhmen e afërt është diçka normale, rritja ekonomike pritet të mbetet në territor pozitiv, ndërsa recesioni shfaqet si rrezik material vetëm në skenarë ekstremë të zhvillimeve në ambientin e huaj.

Së dyti, në ndryshim nga eksperiencat e mëparshme të përballjes me goditje, stabiliteti financiar i vendit paraqitet i konsoliduar. Tregjet financiare janë relativisht të qeta, pavarësisht luhatjeve të moderuara në segmente të caktuara të tij. Sektori bankar është likuid, i mirëkapitalizuar dhe fitimprurës. Ndërkohë që besimi i publikut në të dhe në monedhën kombëtare mbetet në nivele tejet të larta. Së fundi dhe po aq e

rëndësishme, borxhi publik mbetet nën kontroll dhe hapat konkrete të qeverisë për konsolidim fiskal ofrojnë një mbështetje më shumë për qëndrueshmërinë e tij.

***“Qëndrimi i politikës sonë monetare do të vijojë të mbetet stimulus, gjatë gjithë procesit të normalizimit. Ky normalizim nënkupton një reduktim të intensitetit të stimullit monetar, por jo ndryshim të natyrës stimuluese të kësaj politike.”***

Duke qëndruar në këtë linjë, dëshiroj të evidentoj se reformat e vazhdueshme që Banka e Shqipërisë dhe autoritetet shqiptare kanë ndërmarrë në fushën financiare kanë dhënë frytet e tyre. Më konkretisht, konsolidimi i sektorit ka prodhuar një

industri bankare më të shëndetshme dhe konkurruese. Përmirësimi i ambientit të kreditit ka gjeneruar një përfaqje më pozitive nga bankat në kredidhënie, duke i shndërruar ato në një mbështetës të besueshëm me fonde për bizneset dhe familjet shqiptare. Po ashtu, rrjetet e sigurisë financiare janë forcuar më tej, nëpërmjet: përmirësimit të koordinimit të institucioneve përgjegjëse; fuqizimit të rolit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave; si dhe adoptimit nga Banka e Shqipërisë të funksionit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe krijimit të fondit special përkatës. Në të njëjtën kohë, mbikëqyrja dhe rregullimi i kujdesshëm i sektorit bankar kanë sjellë një administrim më të mirë të rrezikut, duke reduktuar vulnerabilitetet e tij ndaj goditjeve të papritura. Së fundi, përmirësimi i infrastrukturës së pagesave dhe rritja e edukimit financiar kanë zgjeruar vëmendjen dhe pjesëmarrjen e publikut në sektorin financiar.

Së treti, gjej me vend të theksoj se qëndrimi i politikës sonë monetare do të vijojë të mbetet stimulues, gjatë gjithë procesit të normalizimit. Ky normalizim nënkupton një reduktim të intensitetit të stimullit monetar, por jo ndryshim të natyrës stimuluese të kësaj politike. Në fakt, skenari ynë bazë nuk parashikon (ende) adoptimin e një qëndrimi shtrëngues të politikës monetare, por rishikimi i qëndrimit të politikës monetare synon të ofrojë një balancë më të mirë të rreziqeve në ekonomi.

### *Të nderuar pjesëmarrës,*

Kuadri analitik i Bankës së Shqipërisë, të cilin e parashtrova më lart - vlerësimi i intensitetit dhe i qëndrueshmërisë së presioneve inflacioniste, identifikimi i rreziqeve dhe vlerësimi i balancës së tyre, si dhe vlerësimi i kostos dhe pasojave të ndërhyrjes - ofron një udhëzues konsistent për vendimmarrje.

Duke iu kthyer edhe njëherë kontekstit historik, mendoj se detyra jonë si autoritete monetare është të ruajmë të pacenuar besimin e publikut në vullnetin dhe aftësinë e bankave qendrore për të ruajtur stabilitetin e çmimeve. Rikonfirmimi i këtij vullneti dhe kësaj aftësie do të ruajë të pacenuar një nga dy premizat kryesore të suksesit që kanë pasur politikat ekonomike gjatë periudhës së Moderacionit të Madh. Ndonëse premizat e tjera të tij - globalizimi, integrimi dhe ulja e rrezikut gjeopolitik - nuk janë në kontrollin tonë, stabiliteti i çmimeve dhe besueshmëria e bankave qendrore është një stafetë, të cilën e kemi marrë nga brezat paraardhës dhe duhet ta çojmë më tej.

***“... mendoj se detyra jonë si autoritete monetare është të ruajmë të pacenuar besimin e publikut në vullnetin dhe aftësinë e bankave qendrore për të ruajtur stabilitetin e çmimeve.”***

Në mbyllje, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë i ka kushtuar dhe i kushton vëmendje të madhe edhe sfidave afatgjata strukturore që kemi përpara. Tashmë është e qartë se analizat dhe projeksionet tona, e për rrjedhojë edhe politikat tona, nuk mund të jenë të plota e të sakta pa një vlerësim të plotë të rolit të ndryshimeve klimatike, të trendeve demografike, si plakja e popullsisë dhe emigracioni, si dhe të ndikimit të inovacionit teknologjik e financiar në ekonomi.

Të gjitha këto tema jam i bindur se do të trajtohen në gjerësi dhe thellësi në këtë konferencë.

Duke ju uruar mirëseardhjen, ju ftoj të angazhohemi në një diskutim sa më të plotë e sa më të sinqertë!

***Ju faleminderit!***

## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË MBLEDHJEN VIII TË KOMITETIT KOMBËTAR TË SISTEMEVE TË PAGESAVE** - 9 nëntor 2022 -

*E nderuar zj. Ministre,  
Të nderuar pjesëmarrës,*

Është një kënaqësi e veçantë të hap këtë mbledhje të 8-të të Komitetit Kombëtar të Sistemit të Pagesave, që fatmirësisht zhvillohet me pjesëmarrje fizike, çka tregon se tashmë disa sfida janë tejkaluara. Njëkohësisht të tjera sfida janë gjeneruar, duke ushtruar një presion të shtuar të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë në punën e përbashkët disavjeçare për nxitjen e përfshirjes financiare dhe përdorimin e pagesave elektronike në ekonominë shqiptare.

Megjithatë, pavarësisht problematikave të krijuara nga pandemia, Banka e Shqipërisë ka intensifikuar përpjekjet në këtë drejtim. Në rolin e autoritetit monetar, rregullator e mbikëqyrës, Banka e vlerëson përfshirjen financiare dhe edukimin financiar si dy objektiva strategjike mjaft të rëndësishëm për stabilitetin monetar e financiar, formalizmin e ekonomisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj.


***“Në rolin e autoritetit monetar, rregullator e mbikëqyrës, Banka i vlerëson përfshirjen financiare dhe edukimin financiar si dy objektiva strategjike mjaft të rëndësishëm për stabilitetin monetar e financiar, formalizmin e ekonomisë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të saj.”***

Në këtë kuadër, duket se masat e marra deri më tani kanë reflektuar zhvillime mjaft pozitive në treg, duke bërë të mundur përbushjen e objektivave sasiorë të synuar pothuajse në gjysmën e rrugëtimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël. Konkretisht, në vitin 2021 është arritur një nivel i përdorimit të pagesave elektronike prej 12.5 pagesash për frymë, duke tejkaluara edhe objektivin e synuar të Strategjisë prej 10 pagesash deri në fund të vitit 2023, ndërkohë që, në vitin 2022, vlerësohet se kjo shifër do të arrij nivelin 16 pagesa për frymë.

Tashmë mund të themi që pagesat me kartë dhe ato *home banking* gjithnjë e më shumë po bëhen pjesë e përditshmërisë së shqiptarëve, ndërkohë që dhe nga pikëpamja e përfshirjes financiare zhvillimet

duken mjaft inkurajuese. Konkretisht: volumet e pagesave me kartë janë rritur ndjeshëm, sidomos gjatë pesëvjeçarit të fundit (2018-2022), duke shënuar një trend mesatar rritës prej rreth 40% në vit; si dhe është shënuar një rritje e konsiderueshme me 78% e numrit të terminaleve POS gjatë së njëjtës periudhe. Këta tregues janë dëshmi e rritjes së përdorimit të instrumenteve elektronike nga konsumatorët, gjë që ndikon pozitivisht edhe në formalizimin e ekonomisë. Gjithashtu, nga të dhënat e disponuara sa i takon volumit të transaksioneve homebanking për këtë 9-mujor, rezulton se është shënuar një rritje prej 22%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, duke vijuar trendin rritës të shfaqur ndër vite.

**Grafik 40. Ecuria e instrumenteve të pagesave në numër dhe në vlerë (gjashtëmujorët I të 2018-2022)**



Falë të dhënave nga Regjistri Kombëtar i Llogarive, Banka e Shqipërisë disponon një pamje më të saktë dhe lehtësisht të përditësueshme mbi përfshirjen financiare të popullsisë. Këto të dhëna diktojnë se shqiptarët kanë një nivel relativisht të kënaqshëm të përfshirjes financiare, ku pothuajse 69% e popullsisë zotëron një llogari. Objektiv i ynë fillimisht ishte arritja e një niveli të përfshirjes financiare të popullsisë në masën 70%, por vlerësojmë se në periudhën afatshkurtër ky nivel do të tejkalohet, duke shënuar përafërsisht të njëjtën me vendet e Ballkanit dhe ato të Bashkimit Evropian.

Ky optimizëm bazohet në një sërë faktorësh dhe analizash. Më konkretisht, pavarësisht se në komunikimet tona publike ne kemi

përmendur arritjen e objektivave të shumicës së masave të parashikuara në strategji, ato janë ende duke u materializuar në treg dhe efektet e tyre të pritura do të reflektohen në tregues të matshëm në vitin 2023 dhe në vijim. E thënë më thjeshtë, arritjet e deritanishme në terma të përfshirjes financiare dhe të përdorimit të pagesave elektronike janë deri diku reagim ndaj mesazheve tona, ndërkohë që efektet reale dhe domethënëse të strategjisë do të paraqiten të plota në periudhën afatshkurtër e afatmesme.

Më konkretisht, ne vlerësojmë se ligji “Për shërbimet e pagesave” vërtet përbën shtyllën kryesore të nxitjes së inovacionit dhe të konkurrencës, gjë që mund të vihet re edhe në interesin e shtuar të subjekteve që kërkojnë të hynë në këtë segment të tregut, por materializimi i plotë i tij do të ndodhë me operacionalizimin e open-banking. Në këtë drejtim, e vlerësojmë të nevojshme të theksojmë se angazhimi i bankave dhe jobankave duhet të jetë maksimal, në mënyrë që këto infrastruktura dhe shërbimet përkatëse të realizohen brenda afateve të përcaktuara nga Banka e Shqipërisë, gjithmonë duke ofruar siguri maksimale. Siguria në komunikim dhe në ndërveprim është jo vetëm e nevojshme, por edhe e domosdoshme, në kushtet e komunikimit të hapur që imponon *open-banking*, si dhe në kuadër të rreziqeve të shtuara në sferën e sigurisë kibernetike, me të cilat po përballemi së fundmi. Kjo ka qenë edhe arsyeja kryesore për të cilën Banka e Shqipërisë ka qenë e kujdesshme si në vendosjen e standardeve të rregullimit të mirëpërcaktuara dhe gjerësisht të provuara nga vendet e Bashkimit Evropian, ashtu edhe në krijimin e hapësirave të nevojshme kohore që do të mundësonin një zbatim sa më efikas dhe të sigurt për të gjithë aktorët e tregut.

Megjithatë, krahas këtyre zhvillimeve ligjore e rregullative, Banka ka ndërmarrë edhe një sërë masash të tjera, si krijimi dhe operimi i sistemit AIPS-EURO për pagesat ndërbankare në Euro brenda vendit. Tashmë shqiptarët, në përditshmërinë e tyre, po ndjejnë efektet e këtij sistemi, i cili ka bërë të mundur shmangien e radhëve të gjata nëpër sportelet e bankave për kryerjen e pagesave në euro nga njëra bankë në tjetrën, dhe uljen e komisioneve të larta të aplikuara nga transferimi nëpërmjet bankave korrespondente.

Krijimi i këtij sistemi, së bashku me diferencimin e komisioneve për pagesat elektronike të procesuara në të, duket se ka qenë mjaft efektiv. Më në detaje, nga janari deri në fund të muajit tetor të këtij viti, nëpërmjet sistemit AIPS EURO, janë procesuar rreth 120 mijë pagesa dhe rezultojnë se, për këtë periudhë, konsumatorëve dhe bizneseve shqiptare t’u jenë

kursyer përafërsisht 10 milionë euro. Në këtë këndvështrim, mund të thuhet se projekti ka efekte të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në mirëqenien individuale të klientit, të bankës, si dhe të ekonomisë në tërësi.

Banka e Shqipërisë vlerëson gjithashtu se rregullimi i debitimit direkt ndërbankar nxit më tej krijimin e një tregu sa më efikas, duke ofruar një larmishmëri shërbimesh dhe instrumentesh pagese, të cilat plotësojnë nevojat e përditshme të qytetarëve.

***“Nga janari deri në fund të muajit tetor të këtij viti, nëpërmjet sistemit AIPS EURO, janë procesuar rreth 120 mijë pagesa dhe rezulton se, për këtë periudhë, konsumatorëve dhe bizneseve shqiptare i’u jenë kursyer përafërsisht 10 milionë euro.”***

Në këtë drejtim, vlen të theksohet se që prej muajit maj, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, AKSH-i dhe sistemi bankar po bashkëpunojnë ngushtë, me qëllim krijimin e të gjitha alternativave të mundshme për kryerjen e pagesave në distancë, nëpërmjet mjeteve elektronike.

Ne vlerësojmë se arritja e një qëllimi të tillë është shumë domethënëse në nxitjen e përfshirjes financiare, edukimit dhe familjarizimit të publikut me përdorimin e pagesave elektronike. Në këtë drejtim, ne kemi besimin e plotë se, bazuar edhe në eksperiencat e vendeve të tjera, dixhitalizimi i pagesave të qeverisë përbën një nga levat më të fuqishme për arritjen e synimeve të Strategjisë Kombëtare të Pagesave me Vlerë të Vogël. Po ashtu, edhe bashkërendimi i përpjekjeve në këtë drejtim mund të konsiderohet si hapi i parë drejt një game të gjerë masash, të cilat mund të merren në të ardhmen.

Një masë tjetër e rëndësishme që po ndërmerret është edhe hartimi dhe zbatimi i projektligjit “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, i cili do të transpozojë direktivën përkatëse të Bashkimit Evropian. Ky projektligj synon të krijojë lehtësira nga pikëpamja e kostove të mbartura në hapjen e llogarive bankare dhe përdorimit të saj për pagesa nga ana e atij segmenti të popullsisë që nuk është i përfshirë financiarisht ose ka akses të limituar. Projektligji parashikon njëkohësisht edhe ofrimin e llogarisë bazike, pa komisione, për kategori të caktuara të popullsisë si pensionistët, studentët dhe personat që përfitojnë ndihma ekonomike.

Me qëllim mbështetjen e zhvillimeve të tregut, Banka e Shqipërisë po punon gjithashtu edhe në drejtim të përmirësimit të sistemeve të pagesave për prezantimin e standardeve të reja të komunikimit dhe shërbimeve, të cilat ndihmojnë në adresimin e nevojave infrastrukturore



për zbatimin e strategjisë. Gjithashtu, së bashku me aktorët e tregut, ne do të intensivikojmë përpjekjet për realizimin e projektit Instant Payment.

Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, në kuadër të materializimit sa më efikas të masave të analizuar në këtë strategji dhe më gjerë, po punohet për krijimin dhe zbatimin e një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar. Në vlerësimin tonë, përfshirja dhe edukimi financiar janë dy komponentë tërësisht të ndërlidhur me arritje të ndërsjella, dhe, siç e përmenda dhe më parë, ata përbëjnë objektiva strategjike për Bankën e Shqipërisë.

Dëshiroj të përfundoj fjalën time duke falënderuar veçanërisht Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sistemin bankar, si dhe të gjithë aktorët e tregut për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe bashkërendimin e përpjekjeve, çka bëri të mundur realizimin e deritanishëm të kësaj reforme. Gjithashtu, dëshiroj të theksoj se është e nevojshme të vijojmë me të njëjtin intensitet dhe seriozitet përmbushjen e masave të mbetura të kësaj strategjie.

***“... në kuadër të materializimit sa më efikas të masave të analizuar në këtë strategji dhe më gjerë, po punohet për krijimin dhe zbatimin e një Strategjie Kombëtare për Edukimin Financiar.”***

*Ju uroj një aktivitet sa më të frytshëm e konstruktiv!*



## **FJALA PËRSHËNDETËSE E GUVERNATORIT SEJKO NË ASAMBLENË E PËRGJITHSHME TË DHOMËS AMERIKANE TË TREGTISË - 17 nëntor 2022 -**

*I nderuar zoti President i Dhomës Amerikane të Tregtisë,  
E nderuar zonja Ministre,  
E nderuar zonja Ambasadore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës,  
Të nderuar zonja dhe zotërinj,*

E prita me kënaqësi ftesën tuaj për të marrë pjesë në takimin e Asamblesë së Përgjithshme të Dhomës Amerikane të Tregtisë. Po ashtu, vlerësoj mundësinë që më jepni, për ta përshëndetur këtë Asamble dhe për të ndarë me ju disa opinione mbi stadin aktual dhe perspektivat e zhvillimit ekonomik të vendit.

Përpara se të filloj, më lejoni të shpreh konsideratën time për Dhomën Amerikane të Tregtisë, e cila numëron mbi 200 kompani anëtare dhe përbën një nga komunitetet më të rëndësishme të biznesit në Shqipëri. Nëpërmjet aktiviteteve trajnuese, promovimit të Shqipërisë si destinacion biznesi, si dhe përfshirjes aktive në diskutimet mbi politikat e zhvillimit, ajo kontribuon në përmirësimin e klimës dhe modelit të biznesit, në tërheqjen e investimeve të huaja, si dhe në forcimin e lidhjeve ekonomike midis Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Shqipërisë.

Ky bashkëpunim është akoma më i rëndësishëm sot, kur bizneset në të dy anët e oqeanit po përballen me sfida komplekse dhe të paprecedenta. Pas dy vitesh nën kthetrat e pandemisë, ne e gjejmë veten përballë një realiteti të ri ekonomik, të shkaktuar nga konflikti ushtarak në Ukrainë. Përtej humbjes së pazëvendësueshme të jetëve njerëzore, ky konflikt solli pasoja në tregjet globale të mallrave dhe në zinxhirët globalë të furnizimit. Si rezultat, inflacioni dhe pasiguria përjetuan një rritje të shpejtë anembanë globit, me kosto të mëdha për shtresat në nevojë dhe me pasoja negative për rritjen globale.

***“Si një ekonomi e vogël dhe e hapur, Shqipëria nuk mund ta izolojë veten nga këto ngjarje madhore. Rritja e çmimeve në tregjet globale solli një rritje progresive të inflacionit në vend, i cili kulmoi në 8.3% në muajin tetor.”***

Si një ekonomi e vogël dhe e hapur, Shqipëria nuk mund ta izolojë veten nga këto ngjarje madhore. Rritja e çmimeve në tregjet globale solli një rritje progresive të inflacionit në vend, i cili kulmoi në 8.3% në muajin tetor. Në gjykimin tonë, ky inflacion i lartë është sfida kryesore e politikave ekonomike dhe e operatorëve të sektorit privat.

Të gjithë i njohim dëmet që sjell inflacioni i lartë mbi familjet, bizneset dhe ekonominë. Ai redukton fuqinë blerëse të të ardhurave tona, zhvlerëson kursimet, shton pasigurinë për të ardhmen dhe zbeh rolin informues të çmimeve në ekonomi. Kjo rrit koston financiare dhe dëmton aftësinë e biznesit dhe të familjeve për të marrë vendime të mirinformuara për konsum, kursim dhe investime në të ardhmen.

Nisur nga sa më sipër, prioriteti i Bankës së Shqipërisë është kthimi i inflacionit në objektiv në një kohë sa më të shkurtër. Për këtë arsye, ne kemi ndërmarrë një cikël normalizues të qëndrimit të politikës monetare, duke rritur normën bazë të interesit nga niveli 0.5% në nivelin 2.75% gjatë vitit 2022. Ky normalizim synon të vendosë një ekuilibër më të mirë midis kërkesës dhe ofertës për mallra e shërbime për to, duke ofruar stimujt e duhur për stabilitetin monetar e financiar të vendit. Sikundër e kemi theksuar në vazhdimësi, ky stabilitet mbetet një parakusht i pazëvendësueshëm jo vetëm për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të ekonomisë, por edhe për mirëqenien e barazinë sociale.

***“Ndonëse ritmi i rritjes do të ngadalësohet disi në afatin e shkurtër, stabilizimi i ambientit monetar dhe reduktimi i pasigurisë do t’i hapin rrugë një rritjeje më të shpejtë ekonomike në afatin e mesëm e të gjatë.”***

Duke parë nga e ardhmja, projeksionet e skenarit tonë bazë sugjerojnë se inflacioni do të reduktohet gjatë vitit 2023 dhe do të kthehet në objektivin tonë prej 3% në vitin 2024. Po ashtu, këto parashikime sugjerojnë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet gjatë viteve në vazhdim. Ndonëse ritmi i rritjes do të ngadalësohet disi në afatin e shkurtër, stabilizimi i ambientit monetar dhe reduktimi i pasigurisë do t’i hapin rrugë një rritjeje më të shpejtë ekonomike në afatin e

mesëm e të gjatë. Së fundi, por po aq e rëndësishme, parashikimet tona sugjerojnë se tregjet financiare do të vazhdojnë të jenë të qeta, kursi i këmbimit relativisht i qëndrueshëm dhe shëndeti i ndërmjetësve financiarë, përfshirë dhe sektorin bankar, i pacenuar.

Më lejoni të theksoj se kjo prognozë ekonomike pasqyron, në radhë të parë, shëndetin e sektorit privat të ekonomisë shqiptare. Ky sektor ka bërë

një progres të admirueshëm gjatë viteve të fundit, në drejtim të gjetjes së tregjeve të reja, të rritjes së eficiencës operacionale, të përmirësimit të shëndetit financiar, si dhe të rritjes së vizionit të tij strategjik. Dëshmia më e mirë e këtij progresi ishte rimëkëmbja e shpejtë që përjetoi ekonomia shqiptare pas goditjes së pandemisë. Besoj se ato cilësi që ndihmuan sektorin privat në atë periudhë: kujdesi për punëmarrësit, bashkëpunimi midis bizneseve, si në planin horizontal dhe atë vertikal, ndarja e drejtë e kostove në të gjithë zinxhirin e prodhimit, si dhe fleksibiliteti operacional e financiar, do të jenë elemente të rëndësishme në përballimin e inflacionit të lartë.

Paralelisht me të, jam i bindur se sektori bankar do të vazhdojë të mbështesë financiarisht biznesin, duke orientuar fondet drejt projekteve rentabël dhe sektorëve më produktivë.

Së fundi, detyra jonë prioritare si vendimmarrës publikë, është të marrim masat e duhura për të mos lejuar që goditja e ofertës të shkaktojë pasoja afatgjata në shëndetin e ekonomisë shqiptare. Në këtë kontekst, më lejoni t'ju siguroj se Banka e Shqipërisë do të vazhdojë të jetë tërësisht e përkushtuar për të garantuar stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar të vendit.

### *Të nderuar pjesëmarrës,*

Ndërsa goditjet e njëpasnjëshme kanë marrë – me të drejtë – kohën dhe vëmendjen tonë, dëshiroj ta mbyll fjalën time duke theksuar se si politikëbërësit ashtu edhe operatorët e sektorit privat nuk duhet të harrojnë se reformat strukturore janë një instrument i pazëvendësueshëm për rritjen e potencialit prodhues të vendit dhe rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimeve “Made in Albania”.

***“Detyra jonë prioritare si vendimmarrës publikë, është të marrim masat e duhura për të mos lejuar që goditja e ofertës të shkaktojë pasoja afatgjata në shëndetin e ekonomisë shqiptare.”***

Këto reforma marrin një rëndësi të madhe ndërsa hedhim hapa përpara në rrugën tonë të integritit me Bashkimin Evropian.

*Duke i uruar Asamblesë punime të mbara,*

*Ju faleminderit!*



## **FJALA E GUVERNATORIT SEJKO NË WORKSHOP-IN XVI TË KËRKIMEVE EKONOMIKE NË EVROPËN JUGLINDORE TË ORGANIZUAR NGA BANKA E SHQIPËRISË - 5 dhjetor 2022 -**

*E nderuar Shkëlqesi Ambasadore Huber,  
Të nderuar të ftuar dhe folës nga akademia, bankat qendrore dhe  
institucionet kërkimore,  
Të nderuar pjesëmarrës,*

Në emër të Bankës së Shqipërisë ju uroj mirëseardhjen në Workshop-in XVI të Kërkimit Ekonomik për Evropën Juglindore (EJL). Kënaqësia është më e madhe pasi, siç shpresuam vitin e kaluar, pas dy viteve organizimi online, i jemi rikthyer atij tradicional, me prani fizike, ndonëse vetëm pjesërisht.

Një mësim që nxorëm dhe përvetësuam nga pandemia ishte si të veprimet në një mjedis virtual dhe të sigurohemi që të gjithë pjesëmarrësit të mund të angazhohen plotësisht në punimet e këtij aktiviteti - qoftë me prani fizike apo duke na u bashkuar online.

Përfitoj nga rasti të shpreh vlerësimin tim për përkushtimin tuaj të vazhdueshëm dhe kontributin e çmuar që secili prej jush jep në mbajtjen dhe zhvillimin e punimeve të këtij seminari. Jam me të vërtetë mirënjohës që kjo nismë e nisur 16 vite më parë, ka përparuar dhe ka fituar të tilla dimensione, duke forcuar dhe zgjeruar ndër vite bashkëpunimin midis bankierëve qendrorë, akademikëve dhe politikëbërësve, jo vetëm brenda rajonit të EJL-së, por dhe nga e gjithë bota.

***“Workshopi i Kërkimeve,  
i nisur 16 vite më parë,  
ka përparuar dhe ka fituar  
të tilla dimensione, duke  
forcuar dhe zgjeruar ndër  
vite bashkëpunimin midis  
bankierëve qendrorë,  
akademikëve dhe  
politikëbërësve, jo vetëm  
brenda rajonit të EJL-së, por  
dhe nga e gjithë bota.”***

Kërkimi ekonomik në Bankën e Shqipërisë, ashtu si në shumë banka qendrore prestigjioze, mbart një rol të rëndësishëm në aktivitetin e përgjithshëm të saj, duke ofruar mbështetje të vazhdueshme në proceset

e hartimit dhe të zbatimit të politikës monetare, nëpërmjet instrumenteve empirikë të rinj dhe të sofistikuar, të cilët përdoren në kryerjen e analizave dhe të parashikimeve të politikave. Kërkimet e një cilësie të lartë rrisin besueshmërinë e bankës qendrore ndërsa përmirësojnë dhe cilësinë e politikave të saj.

Kryefjala e këtij aktiviteti është prezantimi dhe diskutimi i projekteve kërkimore aktuale të kryera në Bankën e Shqipërisë gjatë vitit, së bashku me hulumtimet e zhvilluara në bankat e tjera qendrore, në universitete të spikatura shqiptare dhe ndërkombëtare, apo dhe në institucione të ndryshme financiare. Pra, ky takim përfaqëson një mundësi të shkëlqyer për të marrë mendime dhe informacione të reja nga kolegë në institucionet homologe, që punojnë për të njëjtat tema dhe përballen me të njëjtat sfida si ne. Jam i sigurt se ky workshop do të shërbejë për të kuptuar më mirë origjinën dhe kompleksitetin e sfidave me të cilat po përballemi dhe për të hartuar politikatat e duhura për trajtimin e tyre.

***“Ky workshop zhvillohet në një moment veçanërisht të vështirë: ndërsa ende përballemi me ndërlikimet e tërheqjes graduale të politikave të zbatuara gjatë pandemisë, janë shfaqur rreziqe të reja, të cilat janë vendosur menjëherë në qendër të vëmendjes sonë.”***

Gjatë viteve, workshopi ynë ka ndryshuar dhe evoluar në mënyra të ndryshme, ashtu si sfidat dhe situatat e reja që ne hasim. Sivjet, ai zhvillohet në një moment veçanërisht të vështirë: ndërsa ende përballemi me ndërlikimet e tërheqjes graduale të politikave të zbatuara gjatë pandemisë, janë shfaqur rreziqe të reja, të cilat janë vendosur menjëherë në qendër të vëmendjes sonë.

Pavarësisht ekspozimit të drejtpërdrejtë të kufizuar të Shqipërisë ndaj Rusisë apo Ukrainës, skenari makroekonomik ndryshoi pothuajse brenda ditës, pas nisjes së luftës në Ukrainë.

Sot, Shqipëria përballlet me sfidën e rritjes së çmimeve ndërkombëtare të energjisë dhe produkteve bazë në tregjet ndërkombëtare, shtyrë të kushteve financiare te partnerët kryesorë dhe në tregjet globale, të cilat me gjasa do të vazhdojnë dhe do të shoqërohen me ngadalësimin ekonomik në Evropë. Në tetor, inflacioni shënoi 8.3%, duke vazhduar të përbëjë kërcënimin kryesor ndaj stabilitetit makroekonomik, si dhe ndaj rritjes së qëndrueshme e afatgjatë të Shqipërisë.

Në këto rrethana, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një proces normalizimi gradual të politikës monetare, duke siguruar që shpejtësia



e normalizimit do të kthejë inflacionin në objektiv, brenda një periudhe kohore të arsyeshme dhe me kosto sa më të ulëta për aktivitetin ekonomik. Mbiçmimi i monedhës sonë ndaj asaj evropiane ka ndihmuar në përpjekjet tona për të kontrolluar dhe përmbajtur inflacionin. Gjatë vitit 2022, monedha jonë, Leku, është mbiçmuar mesatarisht me 2.5% ndaj monedhës Euro, falë të ardhurave të konsiderueshme të gjeneruara nga turizmi, IHD-të e larta, dhe primet e përmbajtura të rrezikut.

Konvergjenca e ciklit të politikës sonë monetare me atë të Eurozonës e forcoi më tej këtë mbiçmim. Paralelisht, çmimi i rregulluar i energjisë për familjet shqiptare ka ndihmuar në përthithjen e presioneve të huaja. Ky përfundim është i dokumentuar qartë në punimet hulumtuese të mëparshme dhe ato më të fundit të kryera nga ekspertët tanë, në të dy departamentet - atë të Kërkimeve dhe të Politikës Monetare - ashtu dhe nga modelet ekonometrike që mbështesin politikën tonë monetare.

Presionet e huaja të çmimeve të mbështetura nga kërkesa e brendshme e qëndrueshme tashmë po ushqejnë inflacionin e mallrave dhe të shërbimeve të prodhuara në vend, po rrisin kostot e prodhimit, dhe më e rëndësishmja, pritjet për inflacionin. Kjo është e dukshme në tregun e punës, në normën e shfrytëzimit të kapaciteteve dhe në tregjet e kapitalit, të cilat duken se i kanë inkorporuar tashmë këto pritje në vendimmarrjen e tyre.

Studimet e shumta të kryera në fushën e politikës monetare kanë dokumentuar rrezikun real që mbart inflacioni i lartë e i qëndrueshëm si dhe pritshmëritë inflacioniste për ekonominë dhe familjet. Gjithashtu, ato tregojnë se pa një përgjigje të fortë dhe të vendosur të politikës monetare, pritjet për inflacionin ndikojnë në ecurinë e ardhshme të tij, duke çuar në rritje të pasigurisë, sinjale jo të duhura për çmimet, shpërndarje joefektive të burimeve, rënie të rritjes ekonomike dhe në luhatshmëri afatgjatë të lartë.

Përvoja jonë, hulumtimet dhe analizat e fundit tregojnë se në rrethanat aktuale, e vetmja përgjigje që mund të japë banka qendrore është të ndjekë një politikë të rritjes së normës bazë të interesit, duke forcuar kështu angazhimin e saj për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve. Ky kurs veprimi do të krijojë kushtet e nevojshme monetare për të kontrolluar inflacionin dhe pritjet për të, si dhe do ta ndihmojë atë të kthehet në objektiv brenda një horizonti kohor të arsyeshëm.

Angazhimi ynë për stabilitetin e çmimeve ka për qëllim të ruajë fuqinë blerëse të të ardhurave të familjeve dhe të kursimeve të individëve; të

ruajë stabilitetin financiar dhe të krijojë kushte optimale të kredisë; të ndihmojë sektorin privat që të zhvillojë veprimtari të besueshme dhe plane të qëndrueshme investimi.

Më e rëndësishmja, projeksionet tona, të cilat përfitojnë nga të njëjtat modele dhe analiza të kërkimit, sugjerojnë se raundi aktual i rritjeve të normës bazë të interesit nuk do të çojë ekonominë në recension. Ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet në horizontin afatmesëm. Në këtë drejtim, rritja aktuale e normës bazë të interesit, e cila ka për qëllim të ruajë stabilitetin e çmimeve dhe të ankorojë pritjet për inflacionin, është njëkohësisht një masë për të mbrojtur jo vetëm ekonominë, por edhe sektorin privat e individët nga efektet negative të tij. Kjo është veçanërisht e vërtetë dhe e rëndësishme për shtresat e popullsisë me të ardhura të ulëta, të cilat janë goditur më shumë nga efektet negative të inflacionit të lartë e të qëndrueshëm.

Megjithatë, publiku i gjerë duhet të kuptojë se parashikimi për të ardhmen është objekt i një pasigurie të lartë. Mekanizmat e amplifikimit, mund të vijnë nga kanale të shumëfishta, për shkak të ndërveprimeve të ngushta brenda sistemit financiar global. Me kënaqësi vë re se të gjitha këto çështje do të diskutohen në thellësi gjatë punimeve të këtij workshop-i. Në fakt, agjenda është mjaft e pasur dhe mbulon një gamë të gjerë temash kërkimore, lidhur me: politikën monetare dhe atë fiskale; stabilitetin financiar; koordinimin e politikave; vlerësimin dhe administrimin e rreziqeve nëpërmjet politikave makroprudenciale; dinamikat e çmimeve dhe presionet inflacioniste në rritje, të cilat po përjetojnë në të gjithë botën; si dhe sfidat që ato sjellin për politikëbërësit, si në këndvështrimin makroekonomik dhe në atë mikro.

Të gjithë presim me entuziazëm të dëgjojmë mendimin dhe analizën e folësve rreth kohëzgjatjes dhe intensitetit të këtyre presioneve dhe mbi çdo implikim të mundshëm në politikën monetare. Për më shumë, ky workshop do të ofrojë një mundësi të shkëlqyer për të marrë informacione të reja nga kërkimi akademik.

Duke parë nga e ardhmja, përtej ngjarjeve dramatike që po përjetojmë aktualisht, teknologjia dhe kalimi në një ekonomi me zero emetime neto të gazrave, do të vijojnë t'i japin formë evolimit të tregjeve si dhe ofruesve tradicionalë apo të rinj të shërbimeve financiare.

Për këtë arsye, përveç çështjeve tradicionale të politikës monetare dhe bankingut qendror, një vëmendje e veçantë i kushtohet edhe:

ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve të lidhura me to, si dhe financave të gjelbra, të cilat janë kthyer në "lajtmotiv" të komunikimeve të shumë bankave qendrore dhe institucioneve evropiane e ndërkombëtare; digjitalizimit të shërbimeve financiare dhe përmirësimeve teknologjike, si dhe implikimeve të tyre në objektivat e bankës qendrore.

Jam i bindur se, materialet studimore mbi këto tema "të nxehta" do të ofrojnë udhëzime se si t'u përfaqësi problemeve të imponuara nga zhvillimet ekonomike të kohëve të fundit. Për më tepër, bashkëpunimi i ngushtë në këtë drejtim do të jetë mjaft i dobishëm, edhe sepse fusha të tilla janë ende objekt i kërkimeve të thelluara.

Më lejoni të shtoj se muajt në vijim do të jenë sfidues për shoqëritë tona, ndërsa vitet në vijim do të mund të sjellin transformime thelbësore strukturore. Trajtimi i sfidave kryesore përballë ekonomisë shqiptare, të tilla si: inflacioni; kriza energjetike etj. imponojnë detyrime shtesë që kërkojnë angazhim për adresimin e tyre dhe për pasojë politika të tjera veprimi, për t'u marrë parasysh nga autoritetet. Ndërkohë që përvoja jonë në zbatimin e politikave dhe instrumenteve ekzistuese dhe të reja të politikës monetare sa vjen e rritet, në këto kushte të vështira dhe gjithnjë në ndryshim po shfaqen dhe rreziqe të reja. Forume diskutimi dhe kërkimi, të tilla si ky workshop, ku shkëmbehen idetë dhe përvojat më të fundit midis akademikëve dhe politikëbërësve, do të jenë gjithnjë e më të rëndësishme. Zbatimi i gjetjeve dhe konkluzioneve të hulumtimeve në hartimin praktik të politikës i jep kërkimit vlerën dhe kuptimin e tij të vërtetë, në të mirë të bankës qendrore dhe të shoqërisë.

***"Trajtimi i sfidave kryesore përballë ekonomisë shqiptare, të tilla si: inflacioni; kriza energjetike etj. imponojnë detyrime shtesë që kërkojnë angazhim për adresimin e tyre dhe për pasojë politika të tjera veprimi, për t'u marrë parasysh nga autoritetet."***

Para se ta përfundoj këtë fjalë, dëshiroj të falënderoj Qeverinë Zvicerane dhe Sekretariatit Zviceran të Shtetit për Çështjet Ekonomike (SECO) për mbështetjen e vazhdueshme të veprimtarisë kërkimore në Bankën e Shqipërisë. Ne bashkëpunojmë prej 10 vitesh për të ngritur dhe përmirësuar punën kërkimore sipas standardeve më të mira ndërkombëtare dhe për ta bërë atë praktike dhe të dobishme në kontekstin e bankës qendrore. Modelet tona dhe një pjesë e konsiderueshme e projekteve kërkimore janë zhvilluar në bashkëpunim apo me asistencën teknike të SECO-s, si pjesë e Programit të Asistencës Dypalëshe për ngritjen e kapaciteteve të bankave qendrore (BCC).

Ky projekt udhëhoqi, rishikoi dhe vlerësoi projektet kërkimore të ndërmarra nga stafi ynë, dhe dha një kontribut thelbësor në besueshmërinë, reputacionin dhe prestigjin e Workshop-it tonë të Kërkimeve në EJL. Bashkëpunimi ynë ka qenë me të vërtetë produktiv dhe shumë i dobishëm, jo vetëm për zhvillimin e veprimtarisë kërkimore dhe të parashikimit, bazuar në metodologjitë bashkëkohore të analizës së politikës, por gjithashtu është i rëndësishëm për zbatimin në fushat e politikës monetare, stabilitetit financiar dhe të analizës së çështjeve që lidhen me ndryshimet demografike dhe ato klimatike. Për më shumë, bashkëpunimi ynë i suksesshëm me Sekretariatën e Shtetit për Çështjet Ekonomike shtrihet në fushat e sistemeve të pagesave dhe të edukimit financiar.

Shkëlqesia juaj Ambasadore Huber, ju jemi mirënjohës për mbështetjen tuaj mjaft entuziaste për zbatimin e suksesshëm të projekteve tona aktuale. Shpresoj të kemi mundësi të tjera për të vijuar bashkëpunimin tonë të frytshëm edhe në të ardhmen.

Në fund, më lejoni ta mbyll fjalën time duke falënderuar folësit, diskutantët, drejtuesit e sesioneve dhe stafin e Bankës së Shqipërisë për kohën dhe përpjekjet dedikuar këtij aktiviteti të rëndësishëm.

Ju ftoj të merrni pjesë në mënyrë aktive dhe të zhvilloni një debat energjik e frytdhënës. Sinqerisht, besoj se diskutimet dhe komentet konstruktive, të cilat sigurisht do të zhvillohen gjatë seminarit, do të kontribuojnë në forcimin e bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet hulumtuesve, si dhe midis institucioneve.

## **FJALA E GUVERNATORIT NË MBRËMJEN E VITIT TË RI TË SHOQATËS SHQIPTARE TË BANKAVE - 15 dhjetor 2022 -**

*I nderuar Kryetar i Shoqatës Shqiptare të Bankave,  
Të nderuar pjesëmarrës,*

Ashtu si çdo vit, e pres me shumë kënaqësi këtë moment takimi me industrinë bankare, ku së bashku bëjmë bilancin e arritjeve dhe përpjekjeve tona gjatë vitit që kaloi, ndajmë eksperiencat më të mira, si dhe rivendosim prioritetet për vitin që na pret.

Më lejoni të ndalem fillimisht në situatën e përgjithshme ekonomike të vendit.

Ecuria e ekonomisë shqiptare, gjatë vitit 2022, u shënua nga rritja e shpejtë e çmimeve dhe e inflacionit në tregjet botërore, pas agresionit ushtarak të Rusisë ndaj Ukrainës. Kjo goditje oferte solli një sfidë tjetër madhore për ekonominë shqiptare, duke diktuar nevojën e rishikimit të politikave ekonomike publike dhe të planeve të biznesit të sektorit privat dhe të industrisë bankare.

Më lejoni të theksoj se kjo goditje e radhës e gjeti ekonominë shqiptare në pozita të shëndosha ekonomike, në vijim të rikuperimit të shpejtë të pasojave të pandemisë gjatë vitit 2021. Po ashtu, ajo e gjeti stabilitetin monetar e financiar të vendit të konsoliduar. Ky stabilitet pasqyrohet në bilancet e shëndosha financiare të vendit, në konsolidimin e besimit ndaj sektorit bankar, si dhe në reduktimin e primeve të rrezikut. Gjithashtu, ai ankorohet në eksperiencën pozitive që, ne si institucione publike dhe ju si sektor financiar, kemi akumuluar në përbalimin e goditjeve të tilla.

***“Goditja e radhës e gjeti ekonominë shqiptare në pozita të shëndosha ekonomike, në vijim të rikuperimit të shpejtë të pasojave të pandemisë gjatë vitit 2021. Po ashtu, ajo e gjeti stabilitetin monetar e financiar të vendit të konsoliduar.”***

Më lejoni të theksoj se normalizimi i qëndrimit të politikës monetare që ne kemi ndërmarrë, ka krijuar premisa për kontrollin e inflacionit dhe ruajtjen e stabilitetit ekonomik dhe financiar të vendit. Po ashtu,

dëshiroj të përshëndes rolin pozitiv që industria bankare ka pasur gjatë vitit 2022, duke ruajtur një përqsasje pozitive ndaj kreditimit të sektorit privat dhe duke marrë masat e nevojshme për administrimin e rreziqeve të shtuara në bilancet tuaja.

Jam i bindur se këto masa, si dhe të tjera që mund të na duhet të marrim në këtë frymë, do t'i hapin rrugë kthimit të shpejtë të situatës në normalitet. Ndonëse rreziqet mbeten të pranishme, projeksionet tona sugjerojnë se inflacioni do të kthehet në objektiv gjatë gjysmës së parë të vitit 2024 dhe se ekonomia shqiptare do të vijojë të ruajë ritme pozitive të rritjes ekonomike gjatë kësaj periudhe.


Si aktorë të rëndësishëm në jetën ekonomike e financiare të vendit, më lejoni të risjell në vëmendjen tuaj se vendimmarrja jonë duhet të jetë largpamëse e kurajoze. Perspektivat e rritjes ekonomike të vendit mbeten të padiskutueshme në afatin e mesëm e të gjatë. Ato kanë mundësuar zgjerimin e vazhdueshëm të ekonomisë dhe të sektorit bankar e financiar gjatë viteve të fundit, si dhe duhet të ushqejnë besimin tuaj në ekonominë shqiptare në të ardhmen. Këto perspektiva do të përfitojnë më tej nga anëtarësimi i vendit në Bashkimin Evropian dhe agjenda e reformave strukturore. Për këtë arsye, ju ftoj të gjithëve të bëhemi avokatë të këtyre proceseve. Po ashtu, ju ftoj të ruani përqsajen tuaj pozitive në zgjerimin e financimit për ekonominë shqiptare, si dhe në rritjen sasiore e cilësore të produkteve bankare.

### *Të nderuar pjesëmarrës,*

Edhe ky vit rezervoi për sektorin bankar disa goditje të papritura (konflikti në Ukrainë, luhatjet në tregjet e instrumenteve financiare dhe së fundi rritja e normave të interesit). Të gjitha këto goditje kanë ndikuar në nivelin e përfitueshmërisë së sistemit bankar, i cili, megjithatë, rikonfirmoi edhe një herë qëndrueshmërinë dhe sigurinë që i ofron depozituesve dhe investitorëve.

Gjatë vitit 2022, veprimtaria e sektorit bankar shënoi një rritje të kujdesshme në të gjithë treguesit, me mbi 6% rritje të totalit të aktivitetit dhe nivele të ngjashme rritjeje për zërat kryesorë. Kjo rritje është mbështetur masivisht nga fondet e depozituesve individë, të cilët preferuan valutën si instrumentin parësor të kursimeve të tyre.

Grafik 41. Ecuria e aktivitet dhe pasivitet në valutë (majtas) dhe efekti i kursit të këmbimit në kundërvlerën në lekë të zërave kryesorë të aktivitet dhe pasivitet në valutë (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Oferta e bollshme e valutës u pasqyrua në mënyrën e financimit të portofolit të kredisë, si dhe në rritjen e investimeve në tituj në valutë.


Niveli i kredive me probleme u reduktua edhe këtë vit me rreth 2 mld lekë, duke forcuar qëndrueshmërinë e këtij trendi tashmë disavjeçar. Ky tregues u reduktua më tej, nga 5.68% në 5%.

Në ndryshim nga vitet e tjera, portfoli i instrumenteve financiare këtë vit ka kontribuar negativisht në nivelin e përgjithshëm të përfitueshmërisë së sistemit bankar. Rritja e normave të interesit dhe pasiguritë e krijuara nga konflikti në Ukrainë i kanë dhënë goditje të njëpasnjëshme vlerës së tregut të këtyre portofoleve. Bankat e përballuan me sukses valën e parë të këtyre goditjeve, duke mbetur në terren pozitiv sa i përket fitimit neto në nivel sistemi dhe në nivele individuale. Ndërkohë, gradualisht po merren masat për trajtimin e duhur të portofoleve të investimeve, në përputhje me kushtet e krijuara.

Niveli i kapitalizimit të sistemit bankar vijoi të rritet edhe këtë vit, nga 18.53% në 19.26%, duke reflektuar edhe rritjen e kërkesave

regullatore për rezervat makroprudenciale dhe rezervat për ndërhyrje të jashtëzakonshme (MREL). Të dy këto elemente kanë rritur qëndrueshmërinë dhe sigurinë e sistemit bankar.

Grafik 42. Teprica e kapitalit për sektorin bankar dhe shtesat makroprudenciale të kapitalit sipas grupeve të bankave, dhjetor 2022



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Konsolidimi i mëtijshëm i sistemit bankar u materializua këtë vit me blerjen, e më pas bashkimin e Bankës OTP me Bankën Alpha. Ky zhvillim sjell një tjetër lojtar të rëndësishëm në grupin e bankave të mëdha që zotërojnë mbi 70% të tregut, dhe pritet të kontribuojë pozitivisht në drejtim të konkurrencës dhe thellimit të tregut.

**“... është e nevojshme të vijohet me të njëjtin intensitet edhe për realizimin e projekteve si open-banking, instant payment dhe kalimin në standardet e komunikimit ISO 20022, të cilat do të digjitalizojnë dhe modernizojnë tregun në tërësinë e tij dhe do të krijojnë potencial në integrimin me tregjet e Bashkimit Evropian.”**

Zhvilleme mjaft pozitive kemi pasur edhe në segmentin e pagesave dhe infrastrukturës mbështetëse për procesimin e tyre gjatë këtij viti, masa këto të ndërmarra në kuadër të strategjisë kombëtare të pagesave me vlerë të vogël. Sistemi AIPS Euro tashmë është një realitet i prekshëm, përfitimet e të cilit po i ndiejnë jo vetëm klientët tuaj, konsumatorët dhe bizneset, por dhe vetë ju. Bazuar në statistikat e disponueshme, ne e vërejmë se transaksionet ndërbankare në euro brenda vendit janë

rritur ndjeshëm. Kjo nënkupton se ky sistem po kontribuon në reduktimin e kostove dhe kohës së nevojshme për administrimin e parasë fizike



në sportelet e bankave nga pagesat në arkë që kryheshin më parë, për shkak të komisioneve tepër të larta që aplikoheshin nga procesimi përmes bankave korrespondente.

Zhvillime mjaft pozitive ka pasur edhe në zgjerimin e përdorimit të pagesave elektronike, ku bazuar në përlogaritje paraprake të Bankës së Shqipërisë për vitin 2022, shqiptarët kanë kryer mesatarisht 16 pagesa elektronike në vit, duke tejkaluar kështu ndjeshëm objektivin tonë prej 12 pagesash. Këto arritje, sigurisht, reflektojnë edhe masat e marra nga ju, nëpërmjet zgjerimit të ndjeshëm të infrastrukturës dhe shërbimeve të nevojshme në këtë drejtim.

Por pavarësisht këtyre zhvillimeve, është e nevojshme të vijohet me të njëjtin intensitet edhe për realizimin e projekteve si open-banking, instant payment dhe kalimin në standardet e komunikimit ISO 20022, të cilat do të digjitalizojnë dhe modernizojnë tregun në tërësinë e tij dhe do të krijojnë potencial në integrimin me tregjet e Bashkimit Evropian. Së fundi, por jo më pak e rëndësishme, duhet të intensifikojmë dhe zgjerojmë më tej bashkëpunimin në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Edukimit Financiar, një mekanizëm ky thelbësor për maksimizimin e efekteve të pritshme nga masat e marra deri më tani në kuadër të digjitalizimit dhe përfshirjes financiare.

### ***Të nderuar drejtues të sistemit bankar,***

Pavarësisht sfidave dhe vështirësive që ka evokuar rritja e inflacionit gjatë këtij viti, parashikimet për rritjen e ekonomisë shqiptare mbeten pozitive. Megjithatë, përballimi i këtyre sfidave kërkon një përgjigje të koordinuar dhe të parametrizuar me kujdes, jo vetëm nga instrumentet e politikës monetare, por edhe nga një bashkëpunim efektiv dhe largpamës i të gjithë aktorëve të tregut.

Më lejoni të përmend disa nga sfidat kryesore që parashikohen për vitin që vjen.

Së pari, rritja e inflacionit dhe rritja e normave të interesit për të balancuar ndikimin e tij, si dhe efektet përkatëse që përcillen në sektorin ekonomik e financiar nga ky ndërveprim, kanë qenë kryefjala e të gjitha takimeve dhe forumeve të kohëve të fundit me partnerët dhe homologët vendas dhe ndërkombëtarë. Struktura e portofoleve të riçmueshme të kredive që mbizotëron në sistemin tonë bankar, ka bërë të mundur që bankat të fillojnë ta transferojnë këtë efekt tek kredimarrësit, ndërkohë që pesha

relativisht e lartë e llogarive pa interes në kahun e pasivit ka lejuar rritjen e marzheve të interesit, të paktën përkohësisht.

Por rritja e kostos së kredive mbart rrezikun e rritjes së kredive me probleme në të ardhmen, për sa kohë që aftësia paguese e kredimarrësve nuk është rritur në mënyrë proporcionale me rritjen e çmimeve. Zhvillimi i aftësive për të parashikuar dhe vlerësuar objektivisht kapacitetin pagues të klientëve ekzistues, pa u joshur nga fitime të shpejta afatshkurtra që mund të dëmtojnë një marrëdhënie afatgjatë të krijuar tashmë, do të jetë një nga sfidat kryesore për bankat gjatë vitit të ardhshëm.

Së dyti, edhe gjatë vitit 2023, në përputhje me parashikimet rregullative dhe programin përkatës të aplikimit gradual, do të vijojnë të rriten kërkesat për kapital (shtesat makroprudenciale dhe kërkesat për instrumente të kapitalit rregullator dhe detyrimeve të pranuar). Zbatimi i këtyre kërkesave, përtej përafrimit të kuadrit tonë rregullator me atë të BE-së, siguron jo vetëm një qëndrueshmëri më të lartë të sistemit bankar ndaj goditjeve të përmendura më sipër, por edhe vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve financiare, tashmë të integruara në jetën e përditshme të qytetarëve dhe bizneseve. Konsolidimi i sistemit bankar dhe rritja e numrit të bankave me peshë të lartë në sistem e bën imperativ trajtimin e diferencuar të tyre për të zbutur rreziqet sistemike dhe efektet mbi paratë e taksapaguesve, në rast të krizave të mundshme në të ardhmen.

***“Konsolidimi i sistemit bankar dhe rritja e numrit të bankave me peshë të lartë në sistem e bën imperativ trajtimin e diferencuar të tyre për të zbutur rreziqet sistemike dhe efektet mbi paratë e taksapaguesve, në rast të krizave të mundshme në të ardhmen.”***

Së fundi, më lejoni t’ju siguroj se Banka e Shqipërisë, në ushtrimin e funksionit të saj si mbikëqyrës dhe rregullator, do të vijojë të jetë mbështetësi dhe partneri juaj, si në ditë të mira dhe në ditë të vështira, duke ofruar transparencë, bashkëpunim dhe vlerësim objektiv të kërkesave dhe propozimeve tuaja, në çdo vendimmarrje.

*Ju uroj një vit të mbarë dhe të suksesshëm në çdo drejtim!*

## **FJALA E GUVERNATORIT TË BANKËS SË SHQIPËRISË, Z. GENT SEJKO, NË TAKIMIN ME GAZETARË, ANALISTË DHE DREJTUES TË MEDIAS - 20 dhjetor 2022 -**

*Të nderuar analistë dhe gazetarë,  
Të nderuar studentë,  
Të nderuar pjesëmarrës,*

Ndjehem tepër i nderuar dhe i privilegjuar që sot, në hollin historik të Bankës së Shqipërisë, pres përfaqësuesit e medias dhe studentë të talentuar, të cilët guxuan të konkurronin për Çmimin e Guvernatorit për Diplomën më të Mirë.

Vitin e kaluar, në takimin që zhvilluam së bashku, u shpreha se pas një periudhe 3-vjeçare të pazakontë, shpresonim që viti 2022 – atëherë ende para nesh - të ishte ndryshe, më i gjallë dhe më optimist. Një vit më pas, në mbyllje të tij, mund të themi se ai rezultoi shumë sfidues, kryesisht si pasojë e goditjes së madhe që pësuan çmimet e lëndëve të para, e veçanërisht ato të energjisë, naftës dhe gazit. E nxitur kryesisht nga shpërthimi i konfliktit Rusi-Ukrainë, rritja e çmimeve ka gjeneruar presione të forta inflacioniste në mbarë botën, duke vënë në vështirësi konsumin dhe rritjen ekonomike në rang global.

Me këto sfida përballet edhe Shqipëria. Në nëntor, inflacioni shënoi 7.9% - pak më i ulët se muaji paraardhës, por gjithsesi një vlerë e lartë që përbën kërcënimin kryesor ndaj stabilitetit makroekonomik, si dhe ndaj rritjes së qëndrueshme e afatgjatë të Shqipërisë. Dua të nënvizoj se sipas parashikimeve më të fundit të Bankës së Shqipërisë, inflacioni pritet të reduktohet progresivisht gjatë vitit 2023 dhe të kthehet në objektiv në mesin e vitit 2024.

Ambienti me presione të shtuara inflacioniste, na detyroi të ndërmarrim një proces gradual normalizimi të politikës monetare, duke synuar kthimin e inflacionit në objektiv, brenda një periudhe kohore të arsyeshme dhe me kosto sa më të ulëta për aktivitetin ekonomik.

E megjithatë, rritja ekonomike e vendit pritet të mbetet në territor pozitiv, dhe do të vijojë të ushqehet nga bilancet e shëndosha të bizneseve

***“Një garanci më shumë në zgjerimin e aktivitetit ekonomik përbën edhe gjendja e shëndetshme e sektorit bankar. Bilancet financiare të shëndosha dhe likuide të këtij sektori japin garanci se ai do të vijojë të mbështesë me fonde, bizneset dhe familjet shqiptare, duke ndihmuar si zgjerimin e konsumit dhe të investimeve ashtu edhe mbulimin e nevojave të përkohshme për likuiditet.”***

dhe familjeve, nga zgjerimi i mëtejshëm i eksporteve shqiptare, si dhe nga ulja e pasigurisë në përgjigje të reduktimit të pritur të inflacionit.

Një garanci më shumë në zgjerimin e aktivitetit ekonomik përbën edhe gjendja e shëndetshme e sektorit bankar. Bilancet financiare të shëndosha dhe likuide të këtij sektori japin garanci se ai do të vijojë të mbështesë me fonde, bizneset dhe familjet shqiptare, duke ndihmuar si zgjerimin e konsumit dhe të investimeve ashtu edhe mbulimin e

nevojave të përkohshme për likuiditet.

Siç e kam përmendur dhe më parë, një faktor i rëndësishëm në arritjen e objektivave tanë për një ambient të qëndrueshëm ekonomik e financiar, është dhe mbulimi e përcjellja me objektivitet dhe vërtetësi e lajmit tek publiku. Nga ky këndvështrim, me kënaqësi konstatoj se mbulimi mediatik i zhvillimeve ekonomike dhe financiare në vend dhe jashtë tij ka qenë në përputhje të plotë me pritshmërinë tonë. Për këtë arsye, dëshiroj t’ju falënderoj për profesionalizmin dhe integritetin që keni demonstruar përgjatë gjithë vitit 2022.

***“Dinamika e zhvillimeve aktuale në ekonominë globale na detyron që të dy ne si palë, Banka e Shqipërisë nga njëra anë dhe media nga ana tjetër, të jemi më të përgjegjshëm dhe më të përkushtuar në informimin e publikut në kohë, me vërtetësi dhe në gjuhën e duhur.”***

Dëshiroj të theksoj se jemi plotësisht të hapur për të dëgjuar opinionet dhe sugjerimet tuaja për ta thelluar më tej bashkëpunimin mes nesh në të ardhmen. Dinamika e zhvillimeve aktuale në ekonominë globale na detyron që të dy ne si palë, Banka e Shqipërisë nga njëra anë dhe media nga ana tjetër, të jemi më të përgjegjshëm dhe më të përkushtuar në informimin e publikut në kohë, me vërtetësi dhe në gjuhën e duhur.

Shpresoj që bashkëpunimi ynë në të mirë të interesit publik të vazhdojë të ruajë të njëjtin model edhe gjatë vitit 2023. Njësoj si në të kaluarën, në institucionin tonë do të gjeni një partner luajal, transparent dhe të gatshëm për të dhënë informacion dhe sqarimet e nevojshme. Politikat dhe vendimet tona, efektet që ato mund të shkaktojnë, si dhe situata që

karakterizon shëndetin financiar të sistemit bankar dhe sektorit financiar në tërësi do të jenë në qendër të komunikimit tonë të vazhdueshëm.

Të nderuar pjesëmarrës,

Edukimi financiar dhe puna kërkimore janë vazhdimisht në fokus të aktivitetit të Bankës së Shqipërisë. Ato na ndihmojnë për hartimin, zbatimin dhe përçimin me sukses të politikave dhe vendimmarrjes, në funksion të ruajtjes së stabilitetit të çmimeve dhe atij financiar të vendit. Edukimi dhe kërkimi shkencor zhvillohen jo vetëm si nevojë për njohjen e fenomeneve ekonomike, por edhe si domosdoshmëri për rritjen e kredibilitetit të Bankës së Shqipërisë dhe zgjerimin e komunikimit me ekonominë, tregun financiar dhe me publikun. Në një kuptim më të gjerë, studimi, njohja dhe mirinterpretimi i fenomeneve ekonomike e financiare janë parakusht për sigurimin e prosperitetit ekonomiko-social të vendit dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Universitetet dhe akademia luajnë një rol të rëndësishëm në të dyja këto fusha. Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë ndjek me vëmendje dhe mbështet kërkimin shkencor dhe aktivitetin e studentëve shqiptarë që studiojnë pranë universiteteve dhe institucioneve të tjera akademike, brenda e jashtë vendit. Në këtë kuadër, dua që së bashku të vazhdojmë një traditë të çmuar të Bankës së Shqipërisë, ceremoninë e shpalljes së fituesve të Çmimit të Guvernatorit për Diplomën më të Mirë.

Prej 16 vitesh, Banka e Shqipërisë përzgjedh dhe çmon punimet shkencore të përgatitura nga studentë shqiptarë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit. Konstatoj me kënaqësi se gjatë këtyre viteve, fokusi i tematikave të trajtuara nga studentët udhëhiqet nga problematikat reale të ekonomisë. Punimet ndjekin evolimin e nevojave, fenomeneve ekonomike, financiare e atyre sociale që shqetësojnë autoritetet, biznesin dhe shoqërinë. Njëkohësisht, përcaktimi i

***“Edukimi dhe kërkimi shkencor zhvillohen jo vetëm si nevojë për njohjen e fenomeneve ekonomike, por edhe si domosdoshmëri për rritjen e kredibilitetit të Bankës së Shqipërisë dhe zgjerimin e komunikimit me ekonominë, tregun financiar dhe me publikun.”***

***“Prej 16 vitesh, Banka e Shqipërisë përzgjedh dhe çmon punimet shkencore të përgatitura nga studentë shqiptarë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit. Konstatoj me kënaqësi se gjatë këtyre viteve, fokusi i tematikave të trajtuara nga studentët udhëhiqet nga problematikat reale të ekonomisë.”***

hipotezave, përzgjedhja e zbatimi i metodologjive të aplikuara zhvillohet në përputhje me praktikat më të mira të kërkimit shkencor bashkëkohor. Kjo i bën analizat dhe hulumtimet e studimeve të vlefshme e profesionale.

Në konkursin e këtij viti janë paraqitur një sërë aplikimesh - kryesisht tema masteri - që trajtojnë tematika dhe fenomene bashkëkohore në fushën e ekonomisë dhe financës. Studimet lidhen drejtpërsëdrejti apo në mënyrë indirekte me aktivitetin e bankës qendrore. Disa nga temat interesante ku fokusohen këto studime janë:

- efektet e politikave të bilancit të bankës qendrore në tregun e obligacioneve të korporatave;
- efektet e kredisë dhe zgjerimi i produkteve bankare;
- ndikimi i çmimit të pasurive të patundshme në ekonomi; dhe
- multiplikatorët e shpenzimeve qeveritare dhe konsumit, si dhe ndikimi i tyre në ekonomi.

Vërejmë me kënaqësi se temat e paraqitura përmbushin karakteristikat e një pune të mirëfilltë kërkimore shkencore, duke adresuar saktë hipotezat, si dhe vërtetimin e tyre bazuar në aplikimin e metodologjive bashkëkohore të kërkimit, si dhe duke shfrytëzuar në mënyrë të saktë dhe të strukturuar gjithë informacionin statistikor. Si rrjedhim, nxjerrja e konkluzioneve dhe implikimet për vendimmarrësit argumentohen dhe mbështeten mbi një punë rigorozë për investigimin e fenomeneve të ndryshme ekonomike e financiare.

Pas shqyrtimit të temave të paraqitura, Komisioni i Vlerësimit ka marrë një vendim unanim për fituesit e tre vendeve të para të "Çmimit të Guvernatorit për Diplomën më të Mirë" për vitin 2022. Përpara se të vijojmë me shpalljen e tyre, dëshiroj të përgëzoj e të falënderoj të gjithë pjesëmarrësit në garë për angazhimin e tyre, idetë, metodat e përdorura dhe konkluzionet e bazuara në metodologjitë e sakta. Materialet e paraqitura ishin shumë të mira dhe Komisioni i Vlerësimit e pati të vështirë të përzgjedhë fituesit. Megjithatë, tre temat që do të prezantohen në vijim, dallojnë nga pjesa tjetër e studimeve, si për rëndësinë dhe koherencën e tematikës, ashtu edhe për trajtimin e plotë të metodologjisë, aplikimin e përshkrimin rigoroz të metodave të vlerësimit, si dhe gjetjet interesante. Uroj fituesit dhe i inkurajoj ata dhe të gjithë pjesëmarrësit në konkurs që ta ruajnë e ta zhvillojnë përgjatë gjithë karrierës së tyre profesionale, pasionin dhe përkushtimin e treguar në këto punime dinjitoze!



# MONITOR

E PERJAVSHME VITI i XXII i BOTIMIT NR. 3 (1015) - 17 JANAR 2022 - 24 JANAR 2022 Çmimi 500 lekë • 4 EURO

BIZNES • EKONOMI • TREG

 [www.monitor.al](http://www.monitor.al)

financë

**Të paguash me kartë, pse është ende e vështirë?**

Faqe 18

industri

**Tekstilet e këpucët "mbyten" nga kërkesat**

Faqe 24

tendencë

**Turizmi, "motor" që po nxit profesione të reja**

Faqe 30

# RIMËKËMBJA PAS PANDEMISË

## RECETAT E GUVERNATORIT TË BSH, GENT SEJKO





---

# KAPITULLI VI

## INTERVISTA

---

- *Intervistë e Governorit Sejko për revistën "Monitor", 17 janar 2022*



## INTERVISTË E GUVERNATORIT SEJKO PËR REVISTËN "MONITOR"


- 17 janar 2022 -

*Pyetje: Zoti Guvernator, në vlerësimin tuaj, sa do të jetë rritja e vitit të kaluar 2021 dhe cilat janë pritshmëritë për treguesin e rritjes për vitin 2022?*

Sikundër e kemi thënë në komunikimet tona publike, Banka e Shqipërisë e konsideron vitin 2021 si vit të rimëkëmbjes ekonomike.

Pandemia dhe masat e marra për kontrollin e saj gjatë vitit 2020 prodhuan një recesion të thellë ekonomik, të vlerësuar rreth nivelit 4%. Ky recesion preku thuajse të gjithë sektorët e ekonomisë. Në nivel mikro, ai u ndje nga pothuajse çdo qelizë ekonomike e shoqërisë, biznes apo familje, në formën e të ardhurave të munguara, të konsumit të reduktuar apo të vështirësive të tjera financiare. Fatmirësisht, përgjigjja e bizneseve dhe familjeve tona demonstroi se ato kishin fleksibilitet operacional, si dhe bilance relativisht solide. Edhe përgjigjja e autoriteteve rezultoi e suksesshme. Ajo arriti të mbrojtë ekonominë nga pasojat më negative të goditjes - falimentime masive biznesesh dhe rritje të qëndrueshme të papunësisë - duke ruajtur ekuilibrat ekonomikë dhe stabilitetin monetar e financiar të vendit. Këta dy faktorë siguruan premiset e rimëkëmbjes gjatë vitit 2021.

Grafik 43. PBB sektoriale (indeks 2019T3=100)



Burimi: BSanka e Shqipërisë.

Reduktimi i masave kufizuese, rifillimi i qarkullimit të njerëzve dhe mallrave, si dhe vijimi i stimulit ekonomik, gjeneruan norma të shpejta rritjeje gjatë vitit 2021. Sipas INSTAT-it, ekonomia shqiptare ka shënuar një rritje me 10.4% gjatë nëntë muajve të parë. Projektionet tona sugjerojnë se viti 2021 do të mbyllet me një normë rritjeje rreth nivelit 8.5-9%. Kjo rritje, në mënyrë të natyrshme, ka një efekt të fortë nga baza e ulët krahasuese, si pasojë e kufizimeve “artificiale” të vendosura mbi aktivitetin ekonomik gjatë vitit të kaluar.

Megjithatë, analizat tona tregojnë se rimëkëmbja ka shkuar përtej efektit bazë. Për ilustrim, pothuajse të gjithë sektorët e ekonomisë kanë tejkaluar nivelet përkatëse të aktivitetit të regjistruar përpara tërmeteve të vitit 2019 dhe pandemisë. E njëjta dukuri vërehet, po ashtu, në: (i) elementet e kërkesës agregate - konsumin privat, investimet dhe eksportet; (ii) treguesit e punësimit dhe të normës së papunësisë, të cilët qëndrojnë pranë niveleve të parakrizës; si dhe, (iii) në rritjen e shpejtë të pagave gjatë tremujorit të tretë.

Në këto rrethana, ne kemi konstatuar se rimëkëmbja ekonomike është me bazë të gjerë dhe se faktorët mbështetës të saj paraqiten relativisht solidë. Kjo na inkurajon të mendojmë se ekonomia shqiptare do të vijojë të rritet edhe gjatë vitit 2022 e në vazhdim, ndonëse norma e rritjes pritet të reduktohet disi dhe të kthehet në linjë me faktorët themelorë të saj: me shkallën e rritjes së popullsisë në moshë pune, me shkallën e akumulimit të kapitalit dhe me normat e rritjes së produktivitetit.

Duke parashtruar sa më sipër, më duhet të theksoj se ne jemi të ndërgjegjshëm mbi rreziqet që kërcënojnë ekonominë gjatë vitit në vazhdim. Rritja e çmimeve në tregjet botërore do të devijojë një pjesë të fuqisë blerëse të ekonomisë shqiptare drejt përballimit të faturës së rritur të importeve. Po ashtu, përhapja e varianteve të reja të virusit SARSCoV2 vijon të mbetet një burim rreziqesh dhe pasigurie. Me informacionin që disponojmë aktualisht, këta faktorë pritet të kenë një efekt marxhinal në rritje dhe kalimtar në çmime, duke mos e shmangur ekonominë nga rruga e rimëkëmbjes dhe politikat ekonomike nga kursi i tyre. Megjithatë, rreziqet ekzistojnë dhe për këtë duhet të jemi të ndërgjegjshëm të gjithë.


***Pyetje: Cilat do të jenë burimet e rritjes dhe si do të ndikojë pandemia COVID-19?***

Duke gjykuar mbi premisat aktuale, rritja ekonomike gjatë vitit 2022 pritet të ketë një bazë të gjerë.

Në terma të kërkesës agregate, ne presim zgjerim të mëtejshëm të konsumit privat, të mbështetur nga rritja e punësimit dhe e pagave, si dhe nga kushtet e favorshme të financimit. Po ashtu, presim zgjerim të investimeve, si pasojë e ciklit pozitiv në të cilin gjendet sektori privat dhe e vijimit të një plani ambicioz shpenzimesh publike. Së fundi, ne presim zgjerim të mëtejshëm të eksporteve të mallrave e shërbimeve, duke faktorizuar këtu si koniunkturën e favorshme të çmimeve në tregjet ndërkombëtare për një sërë kategorish të eksporteve tona, ashtu dhe interesin në rritje për Shqipërinë si destinacion turizmi, dhe përmirësimin e infrastrukturës në vend.

Në terma të sektorëve të ekonomisë, ne vlerësojmë se zgjerimi i kërkesës për mallra e shërbime do të mundësojë rritjen e pothuajse të gjithë sektorëve kryesorë të ekonomisë, megjithëse disa prej tyre do të detyrohen të përballeshin me një faturë të rritur kostosh për produktet bazë dhe ato energjetike.

Grafik 44. Komponentë të kërkesës (indeks 2019T3=100)



Burimi: BSH.

Kjo tablo do të vazhdojë të ushqehet nga një kombinim politikash monetare e fiskale stimuluese gjatë vitit 2022. Megjithatë, konsolidimi i faktorëve të rimëkëmbjes dhe kthimi i ekonomisë në ekuilibër nënkupton dhe nevojën për reduktimin gradual të stimujve, në interes të ruajtjes së ekuilibrave dhe të rikrijimit të hapësirës për reagim në të ardhmen.


Normalizimi i politikës fiskale është tashmë në proces, me miratimin e buxhetit të vitit 2022, i cili parashikon një korrektim të kursit fiskal. Ai do të plotësohet dhe me normalizimin gradual të qëndrimit të politikës monetare gjatë horizontit afatmesëm. Në çdo rast, dëshiroj të theksoj se politika jonë monetare do të synojë të mbështesë procesin e rimëkëmbjes dhe rritjen ekonomike, por pa kompromentuar objektivin tonë të inflacionit prej 3%.

***Pyetje: Si i vlerësoni rreziqet nga tregu i brendshëm dhe faktorët e jashtëm në 2022-shin, në raport me vitin e kaluar?***

Në një kuptim të përgjithshëm, mendoj se çdo politikëbërës në fushën e ekonomisë do të preferonte pozicionin ku ndodhemi tani, në raport me atë ku ndodheshim një vit më parë.

Po ta hedhim vështrimin prapa në kohë, do të shohim se Shqipëria dhe bota ishin duke u përballur me kulmin e valës së dytë të pandemisë në fillim të vitit 2021, ndërkohë që si kohëzgjatja e mëtejshme ashtu dhe ndikimi i saj mbi ekonominë dhe stabilitetin monetar e financiar, ishin ende burime të forta pasigurie. Tashmë, falë prezantimit dhe lëvritimit të vaksinave, mendoj se ne arrijmë të shohim një dritë në fund të tunelit në terma të emergjencës shëndetësore. Në të njëjtën linjë, disa nga treguesit kryesorë të stabilitetit monetar e financiar: stabiliteti i çmimeve, normat e interesit, kursi i këmbimit, treguesit e kredive me probleme, gjendja e likuiditetit dhe fluksi i kredisë, shfaqen në nivele të mira apo të pranueshme. Të gjitha këto dinamika ishin të panjohura të mëdha në fillim të vitit të shkuar.

**Grafik 45. Kursi i këmbimit euro/lek**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Megjithatë, kjo nuk do të thotë se sfidat që kemi përpara janë të vogla.

Së pari, tendenca e rritjes së shpejtë të inflacionit në vend dhe në botë duket se ushqehet – në masën më të madhe – nga faktorë të ofertës, të cilët pritet të kenë një efekt kalimtar. Këtu gjej me vend të theksoj se cilësimi “kalimtar” nënkupton një efekt që nuk i detyron bizneset dhe familjet të ndryshojnë sjellje apo të rishikojnë planet e tyre të konsumit e të biznesit, pra një efekt i cili nuk gjeneron pasoja të mëtejshme në çmime apo në aktivitetin ekonomik. Megjithatë, vëmendja e autoriteteve publike duhet të jetë e lartë, për sa kohë dhe pasiguria mbetet e lartë. Monitorimi i kujdesshëm i zhvillimeve ekonomike dhe monetare do të mundësojë marrjen e vendimeve të duhura në kohën e duhur, për të mos lejuar që këto goditje oferte të nxjerrin ekonominë nga shinat e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të ekuilibrave monetarë e financiarë.

Së dyti, ndonëse në rënie, pandemia mbetet ende një shqetësim i pranishëm në sjelljen dhe vendimmarrjen tonë të përditshme. Shfaqja e varianteve të reja të virusit, potencialisht rezistente ndaj vaksinave, mbetet një rrezik i largët dhe i paneglizhueshëm nga vendimmarrësit.

Së treti, në planin global, pasojat e pandemisë, stimuli fiskal dhe injektimet masive të likuiditetit, janë pasqyruar në nivele të larta të borxhit publik dhe privat. Shëndeti i bilanceve të sektorit privat, në momentin e reduktimit të stimujve ekonomikë, është potencialisht një burim rreziku, i cili duhet monitoruar me sukses nga autoritetet.

Gjithsesi, pavarësisht rreziqeve dhe në linjë me skenarin tonë bazë, dëshiroj të theksoj se, për momentin, shpejtësia e rimëkëmbjes, gjerësia e burimeve të saj, si dhe stadi i ekuilibrave ekonomikë dhe financiarë të vendit na bëjnë optimistë për të ardhmen.

***Pyetje: Inflacioni mesatar gjatë vitit 2021 ishte 2% sipas INSTAT-it. Nëse treguesi vijon të rritet përtej nivelit 3% në vitin 2022, a do të ndryshojë kursi i politikës monetare në drejtim të rritjes së normave të interesit?***

Banka e Shqipërisë ka si objektiv primar ligjor të punës së saj stabilitetin e çmimeve, të nënkuptuar si një nivel inflacioni prej 3%. Ky angazhim është në fokus të politikës sonë monetare dhe diçka për të cilën ne nuk bëjmë kompromis.


Në lidhje me ecurinë e inflacionit, gjykimi ynë është se trendi rritës i tij pasqyron ndërveprimin e dy faktorëve.

- Nga njëra anë, rritja e kërkesës agregate dhe procesi i rimëkëmbjes kanë sjellë një rritje graduale, por të dallueshme, të punësimit, të pagave dhe të inflacionit bazë. Në përgjigje të këtij trendi, ne kemi konstatuar se inflacioni është në një rrugë të qëndrueshme konvergimi drejt objektivit dhe se ky objektiv pritet të arrihet në gjysmën e dytë të vitit 2022. Po ashtu, në përgjigje të tij, ne kemi komunikuar se qëndrimi i politikës monetare do të duhet të fillojë rrugën graduale drejt normalizimit gjatë vitit 2022. Ndonëse ky gjykim është i kushtëzuar nga shpejtësia dhe qëndrueshmëria e rimëkëmbjes, për momentin ai është ende i vlefshëm.
- Nga ana tjetër, gjatë gjysmës së dytë të vitit të shkuar e sidomos në tremujorin e katërt, ne jemi përballur me rritje të shpejta të çmimeve të ushqimeve, të artikujve bazë, të kostove të transportit dhe të produkteve energjetike, në tregjet ndërkombëtare. Këto zhvillime janë pasqyruar edhe në tregun vendas, duke e sjellë inflacionin në nivelin 3.7% në muajin dhjetor. Informacioni që disponojmë sugjeron se tregjet do të normalizohen gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti dhe se efekti i goditjeve të huaja në inflacionin shqiptar do të jetë kalimtar. Kjo na shtyn të gjykojmë, për momentin, se politika jonë monetare nuk duhet të reagojë ndaj tyre.

Megjithatë, sikundër e thashë, ne po monitorojmë me kujdes situatën dhe, nëse konstatojmë se goditjet e ofertës kanë një ndikim më të fortë apo më të gjatë në kohë se pritjet tona aktuale, atëherë kjo mund ta na shtyjë në një normalizim më të shpejtë të qëndrimit të politikës monetare.



Grafik 46. Inflacioni vjetor (%)



Burimi: BSH.


**Pyetje:** Banka e Shqipërisë është duke zbatuar një strategji për sistemet e pagesave. Ju lutem na thoni nëse po zgjerohet përfshirja e qytetarëve në shërbimet bankare dhe me çfarë kostosh?

Strategjia Kombëtare e Pagesave me Vlerë të Vogël (2018-2023) synon zgjerimin e shkallës së përfshirjes financiare të popullsisë nga pikëpamja e pagesave, duke e konsideruar si hapin e parë dhe të rëndësishëm në këtë drejtim, nëpërmjet dy objektivave të matshëm:

- rritjes së numrit të popullsisë në moshë madhore që zotëron një llogari pagese (duke synuar rritjen e këtij treguesi në masën 70% në vitin 2023, nga 40% që ishte në vitin 2014); dhe,
- përdorimit të llogarive të pagesës në një mënyrë më efektive, nëpërmjet instrumenteve elektronike të pagesave, të cilat rezultojnë më pak të kushtueshme për përdoruesin dhe ekonominë në tërësi, duke parashikuar një rritje të numrit aktual të pagesave jo me para fizike (cash) për frymë me 130% (duke e çuar në 10 pagesa për frymë deri në fund të vitit 2023, nga 4.3 pagesa për frymë që ishte në fund të vitit 2016).

Vlen të përmendet se, në mes të rrugëtimit drejt përmbushjes së këtij plani veprimi, mund të thuhet se janë realizuar më shumë se 70% e masave të parashikuara dhe efektet e materializuara deri tani në treg kanë bërë të mundur përmbushjen pothuajse të plotë të objektivave që në vitin 2021. Bazuar në këto zhvillime, si dhe në pritjet për efektivitetin shtesë të masave të marra deri më tani dhe në vijim, ne jemi mjaft optimistë për tejkalimin e objektivave tanë.

**Grafik 47. Ecuria e numrit të instrumenteve të pagesave elektronike dhe në formë letër në vite (majtas) dhe numri i pagesave për frymë (+15 vjeç) në vite (djathtas)**



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Masat e ndërmarra deri më tani, të cilat vlerësohet të kenë një efekt të rëndësishëm në treg, janë ligji “Për shërbimet e pagesave” dhe projektligji “Për llogarinë e pagesave me shërbime bazike”, së bashku me projektregulloren “Mbi transparencën për tarifatat e lidhura me llogarinë e pagesës dhe mbi shërbimin e transferimit të llogarive të pagesës”. Këto akte ligjore e rregullatore do të kontribuojnë në ridimensionimin e veprimtarisë aktuale të institucioneve financiare jobanka, të cilat ofrojnë shërbime pagesash dhe transfertash, duke nxitur konkurrencën në treg dhe duke promovuar inovacionin.

Gjithashtu, ndikim të rëndësishëm ka edhe në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit, që bëhet akoma edhe më domethënëse për një treg me edukim dhe përfshirje financiare të cunguar. Një efekt të drejtpërdrejtë në nxitjen e përfshirjes financiare do të ketë edhe prezantimi i një produkti si llogaria bazike, e cila nuk mbart ose mbart kosto minimale, për personat të cilët vlerësohet se nuk kanë asnjë qasje në institucionet bankare, duke synuar kështu përmbushjen e plotë dhe tejkalimin e objektivit kryesor të Strategjisë Kombëtare për Pagesat me Vlerë të Vogël (2018-2023), atë të nxitjes së përfshirjes financiare të popullsisë.

Nga pikëpamja e zhvillimeve infrastrukturore vlen të përmendet operacionalizimi i skemës ndër-Ofruesish të Shërbimeve të Pagesave për “Debitimin Direkt”, e cila mundëson që kompanitë utilitare të përdorin vetëm një llogari pagese për të mbledhur detyrimet e klientëve të tyre në të gjithë tregun, me qëllim një administrim më efikas të likuiditetit, si dhe krijon fleksibilitet për klientët, duke mundësuar përdorimin e instrumentit, pavarësisht nëse banka apo institucioni financiar jobankë ka marrëveshje me kompaninë utilitare në të cilën klienti dëshiron të kryejë pagesa.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm është dhe operacionalizimi i sistemit AIPS EURO për shlyerjen e pagesave në Euro brenda vendit për klientët e bankave. Kjo platformë, e cila do të jetë funksionale duke filluar nga data 24 janar e këtij viti, ka për qëllim t’u mundësojë qytetarëve shqiptarë kryerjen e pagesave në Euro brenda vendit me kosto shumë më të ulët dhe brenda një afati kohor shumë më të shkurtër nga procesi aktual i kryer nëpërmjet bankave korrespondente. Gjithashtu, ky projekt vlerësohet të ketë efekte pozitive edhe nga pikëpamja e administrimit të parasë fizike Euro nga ana e bankave.

***Pyetje: Sistemi bankar në vend ka hyrë në një fazë konsolidimi vitet e fundit. A ka vend për zhvillime të mëtejshme në këtë drejtim?***

Gjate 2-3 viteve të fundit patëm një konsolidim të sektorit bankar. Nga 16 banka që operonin në vitin 2015, këtë vit do të kemi 11 të tilla, më të mëdha dhe me më shumë potencial për të mbështetur ekonominë e vendit. Praktikisht, sot kemi 5 banka të mëdha, të cilat zotërojnë secila mbi 10% të tregut bankar, nga të cila 3 janë banka evropiane.

Tabelë 4. Struktura e pronësisë së bankave, numri i bankave (fund i periudhës)

	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Bankat në Shqipëri, prej të cilave:	16	16	16	14	12	12	12
I. Me kapital privat me shumicën e pronësisë <sup>1</sup> të huaj	13	13	13	11	8	8	8
• nga vendet e BE-së	9	9	9	7	6	6	6 <sup>2</sup>
• nga Turqia	1	1	1	1	1	1	1 <sup>3</sup>
• nga një institucion financiar ndërkombëtar (Arabia Saudite)	1	1	1	1	1	1	1 <sup>4</sup>
II. Me kapital privat me shumicën e pronësisë vendase	3	3	3	3	4	4	4 <sup>5</sup>

Burimi: Banka e Shqipërisë.

- <sup>1</sup> "Shumicë" është në çdo rast shumica e thjeshtë e 50% të votave plus 1 votë.  
<sup>2</sup> Bankat me origjinë të kapitalit nga vendet e BE-së në fund të vitit 2021 janë nga: Italia (Banka Intesa Sanpaolo Albania), Austria (Banka Raiffeisen), Gjermania (Banka Procredit), Hungaria (Banka OTP Albania), Greqia (Banka Alpha Albania), Bullgaria (Banka e Parë e Investimeve, Albania).  
<sup>3</sup> Banka Kombëtare Tregtare.  
<sup>4</sup> Banka e Bashkuar e Shqipërisë.  
<sup>5</sup> Bankat me shumicë kapitali vendas, në fund të vitit 2021, janë: Banka Union, Banka Credins, Banka Amerikane e Investimeve dhe Banka Tirana.

Procesi i konsolidimit të sistemit u realizua i qetë, pa shqetësime për klientët e tij dhe pa asnjë deformim të tregut. Treguesit financiarë të të gjitha bankave të përfshira në procesin e përthithjes erdhën në përmirësim, si në drejtim të treguesve të qëndrueshmërisë ashtu edhe në drejtim të rritjes së nivelit të biznesit.


Në gjykimin tim, procesi i konsolidimit nuk ka qenë dhe nuk duhet fokusuar në numrin e bankave, por në krijimin e institucioneve bankare eficiente, të shëndetshme dhe konkurruese, të afta e të gatshme për t'iu përgjigjur nevojave të tregut, si në drejtim të gamës së shërbimeve që ofrojnë ashtu dhe në drejtim të kostove të tyre.

Sektori bankar aktualisht është në një fazë ku aktorët më të rëndësishëm janë pozicionuar në treg, kanë ndërtuar strategjitë e tyre dhe janë duke u përpjekur për të arritur objektivat e tyre, duke u përballur me konkurrencën në rritje.

***Pyetje: Treguesi i kredive me probleme është ulur në mënyrë sistematike, por rritja e kreditimit në disa sektorë, të tillë si ndërtimi, a e rrit ekspozimin e sistemit ndaj rreziqeve, veçanërisht NPL-ve?***

Pasi arriti një nivel maksimal prej 25% në fillim të vitit 2015, treguesi i kredive me probleme ka ardhur në rënie të vazhdueshme në periudhën vijuese, duke zbritur në minimumin prej 5.65% në fund të vitit 2021.

Grafik 48. Raporti i kredive me probleme dhe mbulimi me provigjione



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Rënia e vazhdueshme e raportit të kredive me probleme është rezultat i masave të marra nga Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me aktorë të tjerë publikë dhe industrinë bankare. Këto masa kanë synuar adresimin e stokut të trashëguar të kredive me probleme, përmirësimin e rregulloreve dhe procedurave me synim reduktimin e kredive të reja me probleme, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të ecurisë së portofolit të kredive.

Masat e marra kanë qenë si të natyrës juridiko-ligjore ashtu edhe institucionale. Banka e Shqipërisë rriti ndërgjegjësimin e strukturave shtetërore dhe private në lidhje me rëndësinë e këtij treguesi, si pengesë e zhvillimit të biznesit të bankave në përgjithësi, dhe e rritjes së kreditimit në veçanti. Plani Kombëtar i masave i hartuar nga një grup i përbashkët pune mes Bankës së Shqipërisë dhe institucioneve të tjera publike e private, përcaktoi një sërë ndryshimesh ligjore e rregullore. Rishikimi i kuadrit ligjor në këto vite ka ndihmuar bankat në administrimin e problematikave të portofolit të tyre, duke zgjidhur ngërçe ligjore apo edhe interpretime juridike.

Masat e natyrës rregullore e prudenciale kanë ofruar mundësinë për adresimin e problematikave të brendshme të bankave nëpërmjet ristrukturimeve më efektive të brendshme apo edhe largimin nga bilanci të huave të humbura me pamundësi pagimi. Ndërkohë, ne punuam për përmirësimin e bazës rregullore, proceseve e procedurave që kryejnë vlerësimin dhe administrimin e rrezikut në veprimtarinë bankare, duke frenuar fluksin e kredive të reja me probleme.


Ndonëse gjatë këtyre viteve kemi kaluar ngjarje si kriza e sistemit financiar në Greqi, konsolidimi i sistemit bankar apo edhe pandemia e dy viteve të fundit, bankat kanë vijuar të përmirësojnë cilësinë e portofoleve, si edhe të rrisin nivelin e veprimitarinë e tyre. Pavarësisht kësaj, Banka e Shqipërisë monitoron dhe sigurohet në mënyrë të vazhdueshme që ato të kenë infrastrukturën e nevojshme për të përballuar rreziqet e mundshme.

***Pyetje: Përdorimi i tepërt i valutës në ekonomi, jo rrallë edhe si mjet pagese, mbetet një nga burimet e rëndësishme të rrezikut financiar dhe ndikon në uljen e efektivitetit të politikave ekonomike dhe financiare, çfarë mjetesh shtesë mund të ndërmerren për ta ulur përdorimin e saj?***

Banka e Shqipërisë e ka identifikuar me kohë shkallën e lartë të përdorimit të valutës në transaksione ekonomike apo financiare, si një burim rreziku dhe ineficience në ekonomi.

- Burim rreziku sepse mbajtja – në mënyrë të vullnetshme apo të pavullnetshme – e pozicioneve të hapura në bilancet e bizneseve dhe të familjeve, rrit rrezikun që sjellin luhatjet e kursit të këmbimit në shëndetin e tyre financiar. Për aq sa është e mundur, aktiviteti ekonomik dhe financiar i çdo biznesi apo familjeje duhet të bëhet, në maksimumin e mundshëm, në një monedhë të vetme. Në mënyrë të natyrshme, kjo monedhë duhet të jetë monedha jonë kombëtare, Leku.
- Burim ineficience sepse niveli i lartë i përdorimit të valutës redukton efektivitetin e politikës sonë monetare, duke i mohuar ekonomisë efektivitetin e plotë të një prej instrumenteve kryesore që ka për përballimin e goditjeve. Po ashtu, burim ineficience sepse kthimi mbi kursimet në valutë për familjet është më i ulët në krahasim me atë që mund të merrnin nga kursimet në Lek, pasi normat rregullatore të likuiditetit për sektorin bankar mund të ishin më të ulëta, dhe pasi vendi humb një burim të ardhurash nga qarkullimi i një monedhe të huaj.

Grafik 49. Treguesit kryesorë për monitorimin e nivelit të përdorimit të valutës në sektorin bankar shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Në përgjigje të këtij konstatimi, Banka e Shqipërisë ka ndërmarrë një paketë masash për nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare në aktivitetin financiar. Efektet e kësaj pakete janë deri tani inkurajuese. Struktura valutore e kredimit ka arritur pothuajse paritetin midis Lekut dhe valutës, nga një raport 3/1 në favor të valutës para pesë vitesh. Në të njëjtën kohë, këto masa kanë shmangur një devijim të fortë në favor të valutës të kursimeve financiare, duke i bërë në të njëjtën kohë më të shëndosha bilancet valutore të bankave.

Megjithatë, sikundër e thatë dhe ju, Banka e Shqipërisë nuk mund ta përmbushë e vetme këtë objektiv. Së pari, mendoj se të gjithë duhet të bëjmë më shumë për të shpjeguar në publik rreziqet që ka huamarrja në valutë për bizneset të cilat i kanë të ardhurat në Lek, apo për të shpjeguar avantazhet afatgjata që ofron për një investitor ruajtja e kursimeve në monedhën kombëtare. Së dyti, në sferën e aktivitetit të saj, qeveria duhet të shohë mundësinë e reduktimit të hapësirave ligjore apo rregullatore që fillimisht inkurajojnë e më pas mundësojnë përdorimin e valutës si mjet transaksionesh.

Në këtë drejtim, Banka e Shqipërisë ka qenë dhe mbetet e angazhuar të japë kontributin e saj, si në formën e konsulencës ashtu dhe të masave shtesë, nëse do të gjykohen të nevojshme.

*Pyetje: Banka e Shqipërisë ka nxjerrë serinë e re të kartëmonedhave dhe midis saj edhe prerjen më të re, atë 10 mijë Lekë. Çfarë pritet me hedhjen në treg të kësaj serie? Pse u mor ky vendim kur tendenca është për reduktimin e ekonomisë së cash-it?*

Pas një pune 5-vjeçare, Banka e Shqipërisë realizoi një seri të re të kartëmonedhave, të përberë nga 6 të tilla: 200, 500, 1000, 2000, 5000, dhe 10 000 Lekë. Seria e re vjen për publikun dhe operatorët ekonomikë pas 25 vjetësh nga prezantimi në vitin 1996 i serisë së mëparshme.

Seria e re ruan të njëjten tematikë, por të riformatuar, me ngjyra dhe dizajn të përmirësuar, në madhësi më të përshtatshme (të reduktuar), dhe – ajo çka është kryesorja – me elemente sigurie tepër të avancuara. Teknologjia e përdorur për prodhimin e tyre përfaqëson teknologjinë më të fundit me të cilën janë prodhuar kartëmonedhat e vendeve perëndimore.

Duke filluar nga muaji korrik 2021, Banka e Shqipërisë ka hedhur në qarkullim kartëmonedhën 10 000 lekë, si kartëmonedha me vlerën më të lartë. Shtypja dhe hedhja në qarkullim e saj, pasqyron stadin e zhvillimit ekonomik të vendit si dhe nevojën e përshtatjes së strukturës së kartëmonedhave me evoluimin e strukturës së çmimeve dhe pagave.







Prezantimi dhe hedhja e saj në qarkullim ka sjellë rritjen e efikasitetit të parasë së gatshme, duke ndihmuar strukturën e monedhës në qarkullim, duke ulur kostot e prodhimit, të magazinimit dhe të shpërndarjes, si dhe duke ndihmuar në krijimin dhe administrimin e një stoku strategjik më të përshtatshëm për të përballuar raste të rritjeve të paparashikuara të kërkesës së tregut për para fizike.

Periodha më shumë se gjashtëmujore e hedhjes në treg të kësaj kartëmonedhe, tregoi më së miri nevojën për të në strukturën e monedhës kombëtare, duke konfirmuar konkluzionet e studimeve tona.

Pavarësisht zhvillimit të mjeteve të tjera të pagesës, si ato elektronike, paraja në qarkullim dhe transaksionet me para cash vijojnë të mbeten të larta. Reduktimi i tyre është një proces që kërkon kohë dhe që duhet të paraprihet nga reduktimi i ekonomisë informale, si dhe të shoqërohet me përmirësimin e sistemit elektronik të pagesave dhe rritjen e edukatës financiare në përdorimin e tyre.

***Pyetje: Ka një trend global që po udhëhiqet nga bankat për të kanalizuar burimet financiare drejt ekonomisë së gjelbër dhe të qëndrueshme. A kanë nisur në Shqipëri këto përpjekje dhe çfarë hapësirash ka për to?***

Frenimi i ngrohjes globale apo i ndryshimeve klimatike, është një nga sfidat më të mëdha të njerëzimit. Adresimi i saj kërkon ndërgjegjësim dhe përpjekje të koordinuara nga të gjitha vendet, por këtu – në mënyrë të natyrshme – rolin primar duhet ta luajnë vendet e zhvilluara e të industrializuara. Kjo, së pari, sepse këto vende kanë dhe ndikimin më të madh në ngrohjen globale dhe, së dyti, sepse ato disponojnë më shumë

resurse financiare për përballimin e kostove të transformimit teknologjik dhe social.

Shqipëria, për specifikat e saj ku spikat prodhimi i energjisë nga burime hidrike apo të rinovueshme, është një ndër vendet me gjurmën më të vogël në emetimin global të dioksidit të karbonit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet ta mbajmë parasysh këtë fenomen në politikat tona të zhvillimit. Ne jemi konsumatorë të pasojave të ngrohjes globale, si në drejtim të luhatshmërisë në rritje të klimës ashtu dhe në drejtim të erozionit natyror që vjen nga rritja e nivelit të deteve. Po ashtu, politikat rregullatore, në nivel evropian dhe botëror, kanë filluar të bëhen gjithnjë e më diskriminuese ndaj produkteve të cilat mbështeten në procese joeficiente energjetike apo të cilat kanë ndikim të lartë ambiental. Shkëputja e vëmendjes nga këto trende do ta vendoste ekonominë tonë në një disavantazh konkurrues.

Në këtë kontekst, gjej me vend të theksoj se sektori ynë bankar ka dhënë një kontribut jo të vogël në financimin e hidrocentraleve dhe ka një interes në rritje për projekte të energjisë së rinovueshme. Ne do të monitorojmë ecurinë e këtij procesi, duke synuar të stimulojmë orientimin e fondeve financiare në këtë drejtim, pa cenuar efektivitetin e procesit të ndërmjetësimit financiar dhe shëndetin e bilancit të bankave.

Së fundi, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë, në Strategjinë e saj Afatmesme të Zhvillimit për periudhën 2022-2024, është angazhuar të ndërmarrë studime konkrete për të vlerësuar ndikimin potencial që ndryshimet klimatike mund të kenë në mjedisin ekonomik dhe financiar të vendit, për t'i paraprirë marrjes në kohë të masave, nëse do të jetë e nevojshme.

***Pyetje: Shqipëria vijon përpjekjet me synim integrimin në BE. Në kontekstin e politikave monetare, çfarë është arritur deri më tani dhe çfarë duhet të përmirësohet?***

Raportet e Komisionit Evropian, por dhe analizat tona të brendshme, evidentojnë se sektori bankar dhe sistemi financiar janë ndër sektorët pararojë në procesin e integrimit evropian.

Më lejoni të theksoj se vendi ynë është mjaft afër plotësimit të kriteve nominale të konvergencës, sikundër janë parashtruar në Traktatin e Maastrichtit, të cilat i referohen stabilitetit të çmimeve, qëndrueshmërisë së kursit të këmbimit të monedhës kombëtare kundrejt Euros dhe nivelit

të normave afatgjata të interesit. Përtej tyre, kuadri ligjor dhe rregullator i politikës monetare, i mbikëqyrjes dhe i rregullimit të sektorit bankar, si dhe i infrastrukturës së sistemit të pagesave, janë në një proces gradual konvergjence me *Acquis Communautaire*. Në veçanti, politika jonë monetare plotëson disa nga kriteret esenciale të kërkuara nga legjislati i Bashkimit Evropian, ku spikat fokusi primar mbi stabilitetin e çmimeve, hartimi dhe zbatimi në mënyrë të pavarur të politikës monetare, si dhe operacionalizimi i kësaj të fundit tërësisht me instrumente të tregut të lirë.

Megjithatë, Banka e Shqipërisë është e ndërgjegjshme për hendeqet që ekzistojnë ende në këtë drejtim, të cilat kërkojnë ndërhyrje të mëtejshme në kuadrin ligjor, dhe do të jenë pjesë integrale e punës sonë në procesin e negociatave për anëtarësim.

Deri më tani, Banka e Shqipërisë ka përbushur në një shkallë të kënaqshme angazhimet që rrjedhin nga Plani Kombëtar i Integritimit të Vendit. Ne kemi një pjesëmarrje aktive në takimet me Nënkomitetet përkatëse të BE-së, drejtojmë grupe ndërinstitucionale pune për përafrimin e dy kapitujve të *Acquis*, dhe jemi pjesë e grupeve të tjera të punës për adoptimin e pesë kapitujve të tjerë, duke përfshirë dhe atë të Kriterit Ekonomik.

***Pyetje: Ekspansioni fiskal i qeverisë e ka çuar borxhin publik në nivele të larta historike, në një kohë që burimet për uljen e tij janë të kufizuara. Çfarë i sugjeroni autoriteteve fiskale në drejtim të administrimit të fondeve publike?***

Pozicioni i Bankës së Shqipërisë ndaj politikës fiskale dhe nivelit të borxhit publik ka qenë i qartë.

Ne e kemi mbështetur nevojën për stimul fiskal në kulmin e goditjes nga pandemia, duke konsideruar atë një instrument të domosdoshëm për shmangien e pasojave afatgjata negative në ekonomi. Në linjë me rritjen e qëndrueshmërisë së rimëkëmbjes ekonomike, kemi theksuar nevojën e reduktimit gradual të këtij stimuli dhe rifokusimin e politikës fiskale drejt uljes së borxhit dhe konsolidimit të financave publike. Rritja e borxhit publik gjatë krizës është një fenomen i gjithanshëm botëror; Shqipëria nuk bën përjashtim nga kjo dhe as nuk renditet ndër vendet me rritjen më të lartë të borxhit publik. Kjo është e evidentuar dhe nga agjencitë e renditjes së rrezikut të borxhit publik, të cilat e kanë lënë të pandryshuar vlerësimin e tyre mbi borxhin shqiptar.

Megjithatë, është fakt se Shqipëria është një ndër vendet me nivel më të lartë të borxhit publik në rajon, dhe kjo është një ndër dobësitë primare të shëndetit tonë financiar. Në këtë kontekst, ne gjykojmë se – në mungesë të goditjeve të tjera të krahasueshme me pandeminë – vëmendja e financave publike duhet të kthehet drejt uljes së borxhit, në nivele të tilla që minimizojnë ndikimin e luhatjeve të tregjeve financiare në shëndetin e financave publike dhe rrisin hapësirën e reagimit të politikës fiskale në të ardhmen. Adoptimi i një angazhimi ligjor për arritjen dhe ruajtjen – duke filluar nga viti 2023 – të një balance primare fiskale pozitive është një hap i duhur në këtë drejtim. Në këtë kontekst, këshilla jonë është që ky konsolidim të bazohet më tepër në rritjen e qëndrueshme të të ardhurave publike, nëpërmjet adoptimit dhe zbatimit të strategjisë afatmesme të të ardhurave publike, dhe më pak në reduktimin e investimeve publike.

Në një kontekst më afatgjatë, ne kemi theksuar nevojën e adoptimit të një procesi formal të vlerësimit të eficiencës së investimeve publike dhe të përdorimit me prioritet të fondeve për financimin e tyre, duke përfshirë në këtë proces dhe programet e partneritetit publik e privat.

Mendoj se pozicioni ynë është i qartë dhe se këshillat tona – të cilat janë në linjë dhe me ato të partnerëve ndërkombëtarë – formojnë një kuadër të mirë për rritjen e qëndrueshmërisë dhe efektivitetit të financave publike.

***Pyetje: Ekonomia shqiptare ka mbetur në kurthin e produktivitetit të ulët. Cili është sugjerimi i Bankës së Shqipërisë për modelin ekonomik që duhet ndjekur, në mënyrë që të rritet vlera e shtuar në ekonomi?***

Në gjykimin tim, modeli ekonomik i Shqipërisë ka ardhur drejt përmirësimit gjatë dekadave të fundit.

Kjo shihet tek diversifikimi i burimeve të rritjes dhe i strukturës prodhuese, e cila tashmë përfshin sektorë me potencial zhvillimi – si eksportet, industria, turizmi - por edhe tek zhvillimi i sistemit financiar, i cili ka shtuar gamën e shërbimeve dhe produkteve financiare, në përgjigje të kërkesave nga ekonomia reale.

Me gjithë përmirësimin e arritur, unë mendoj se rritja e qëndrueshme dhe konvergjenca ekonomike me vendet e Bashkimit Evropian, kërkon fuqizimin e burimeve të rritjes dhe adresimin e dobësive strukturore, nëpërmjet ndërmarrjes së reformave të gjithanshme. Këto të fundit duhet të synojnë sofistikimin e strukturës së ekonomisë dhe ndryshimin

e ambientit ligjor e institucional që përcakton nivelin dhe kompozimin e investimeve në vend.

Disa prej prioriteteve të aksionit tonë të përbashkët në këtë drejtim duhet të jenë reformat, të cilat synojnë:

- përmirësimin e klimës së biznesit, me fokus të veçantë në të drejtën e pronësisë, në shkallën e respektimit të kontratave dhe në rritjen e shpejtësisë dhe eficiencës së gjyqësorit;
- rritjen e eficiencës e të produktivitetit, ndër të tjera nëpërmjet: (i) mbështetjes e incentivimit të ekonomisë së dijes, investimeve të mëtejshme në arsim dhe shëndetësi, si dhe forcimit të lidhjeve midis institucioneve akademike dhe tregut të punës, (ii) reduktimit të informalitetit e të korrupsionit, si dhe, (iii) promovimit të konkurrencës midis dhe brenda sektorëve;
- vijimin e punës për adoptimin e standardeve të Bashkimit Evropian, pavarësisht shpejtësisë së progresit të procesit formal të integritimit, si dhe rritjen e integritimit rajonal;
- përmirësimin e mëtejshëm të infrastrukturës publike, si në formën e saj fizike ashtu dhe në atë digjitale, si dhe integrimin e saj në infrastrukturën rajonale dhe më gjerë; si dhe,
- zgjerimin dhe sofistikimin e mëtejshëm të sistemit financiar.

Unë besoj se progresi në këto drejtime do të rriste nivelin e potencialit të ekonomisë shqiptare dhe konkurrueshmërinë e saj.

***Pyetje: Cilat janë prioritetet e Bankës së Shqipërisë në periudhën afatshkurtër dhe afatmesme? Si po përshtatet banka jonë qendrore me normalitetin e ri të krijuar pas pandemisë?***

Në radhë të parë, më lejoni të theksoj se Banka e Shqipërisë ka qenë dhe do të mbetet e fokusuar në pëmbushjen e detyrave të saj ligjore, të cilat i referohen: së pari, ruajtjes së stabilitetit të çmimeve; së dyti, mbikëqyrjes e rregullimit bankar për krijimin e një sektori bankar të sigurt dhe eficient; dhe, së fundi, pëmbushjes së një sërë detyrash dhe angazhimesh institucionale, të cilat prekin pothuaj të gjitha sferat e veprimtarisë së tregjeve financiare në veçanti dhe aktivitetit ekonomik në tërësi.

Më lejoni të jem disi më specifik.

Në drejtim të stabilitetit të çmimeve, mendoj se goditjet e forta me të cilat po përballlemi duhen adresuar me kujdes. Ndonëse politika monetare

e Bankës së Shqipërisë nuk do të bëjë kompromis me përmbushjen e objektivit të stabilitetit të çmimeve, ne do të kujdesemi të faktorizojmë në vendimmarrjen tonë dhe nevojën e mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike. Në fushën e mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar, fokusi i punës sonë do të jetë njehsimi i plotë i kuadrit tonë rregullator me standardet e Bashkimit Evropian, promovimi i një mjedisi konkurrues, por të mirëmonitoruar, në fushën e veprimtarisë bankare.

Në vizionin tim, sektori bankar duhet të mbetet një promotor i zhvillimit ekonomik dhe progresit social, por dhe një vektor i rëndësishëm i integritimit të vendit në Bashkimin Evropian. Në fushën e sistemit financiar, sfida e Bankës së Shqipërisë duhet të jetë zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës së pagesave, zhvillimi i mëtejshëm i të gjitha segmenteve të tregut monetar, si dhe rritja e shkallës së përfshirjes dhe edukimit financiar të publikut.

Në një aspekt më strategjik, një prioritet i rëndësishëm i punës sonë do të jetë mbështetja e procesit të integritimit evropian. Çelja e negociatave, si hap paraprak i procesit të anëtarësimit, do të kërkojë një investim të rëndësishëm vëmendjeje dhe resursesh njerëzore. Megjithatë, në vizionin tim dhe të institucionit që unë drejtoj, procesi i integritimit evropian duhet parë si investimi më i rëndësishëm që mund të bëjmë për të ardhmen tonë dhe të brezave që do të na pasojë.

***“Banka e Shqipërisë i ka të gjitha mundësitë të shndërrohet në një institucion model, të pajisur me standardet më të mira të bankikut qendror dhe të sistemit evropian të bankave qendrore. Kjo qasje duhet të informojë çdo vendimmarrjeje të Bankës së Shqipërisë, si dhe çdo përpjekje për zhvillimin e brendshëm institucional.”***

Po ashtu, një sfidë e së ardhmes mbetet promovimi i një konkurrence të ndershme e të drejtë midis segmenteve të ndryshme të tregut financiar, duke nënkuptuar harmonizimin e kuadrit rregullator dhe të praktikave mbikëqyrëse të të gjitha segmenteve të këtij tregu. Së fundi, një ambicie e jona e përhershme ka qenë dhe mbetet adoptimi i standardeve më të mira të fushës, në drejtim të transparencës dhe të komunikimit. Ky prioritet do të promovojë një kuptim më të gjerë e më të saktë të politikave dhe nismave tona, duke ndikuar direkt në rritjen e shanseve të suksesit të tyre. Sa i takon pandemisë, mendoj se eksperiencia që përftuam gjatë saj do të na shërbejnë për rishikimin e një pjese të proceseve të punës, kryesisht në drejtim të rritjes së fleksibilitetit që duhet të kenë procedurat tona operacionale.

Në mbyllje, dëshiroj të theksoj se Banka e Shqipërisë i ka të gjitha mundësitë të shndërrohet në një institucion model, të pajisur me standardet më të mira të bankingut qendror dhe të sistemit evropian të bankave qendrore. Kjo qasje duhet të informojë çdo vendimmarrjeje të Bankës së Shqipërisë, si dhe çdo përpjekje për zhvillimin e brendshëm institucional.

# FOTO GALERI / PHOTO GALLERY

*Governatori Sejko në aktivitetin "Kreditimi dhe Financimi i Bujqësisë Shqiptare", 26 janar 2022/  
Governor Sejko attends "Lending to and funding the Albanian agriculture sector" activity - 26 January 2022*



*Governatori Sejko me Ministren e Financave dhe Ekonomisë, zj. Delina, Ibrahimaj, 1 mars 2022/  
Governor Sejko with the Minister of Finance and Economy, Ms Delina Ibrahimaj-1 March 2022*





*Governatori Sejko në takim Ambasadorin e Austrisë në Shqipëri, Sh.T.Z. Christian Steiner, 3 mars 2022/  
Governor Sejko with H.E. Ambassador of the Republic of Austria in Albania, Mr Christian Steiner - 3 March 2022*



*Governatori Sejko në takim me përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar, 7 mars 2022/  
Governor Sejko meets representatives of the International Monetary Fund - 7 March 2022*



*Guvernatori Sejko në Ceremoninë Krenmtuese të Javës së Parasë, 24 mars 2022/  
Governor Sejko: Opening ceremony of the Money Week - 24 March 2022*



*Guvernatori Sejko me delegacionin e Bankës Botërore, 25 mars 2022/  
Governor Sejko receives the World Bank Delegation - 25 March 2022*



*Governatori Sejko me delegacionin e Parlamentit të Mbretërisë së Bashkuar, 31 mars 2022/  
Governor Sejko with the delegation of the United Kingdom Parliament - 31 March 2022*



*Governatori Sejko në takim me Ambasadorin e OSBE-së në Shqipëri, SH.T.Z. Vincenzo Del Monaco, 1 prill 2022/  
Governor Sejko with H.E. Ambassador of the OSCE Presence in Albania, Mr Vincenzo Del Monaco - 1 April 2022*



*Governatori Sejko në takim me përfaqësuesit e Bankës Botërore, 4 prill 2022/*  
*Governor Sejko meets the World Bank representatives - 4 April 2022*



*Governatori Sejko në Prezantimin e Raportit të Tranzicionit të BERZH 2021-2022, 5 prill 2022/*  
*Governor Sejko: The launching of the EBRD Transition Report 2021-2022 - 5 April 2022*



*Gubernuratori Sejko në Ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes së huasë për programin e BERZH-it për mbështetjen e Agrobiznesit dhe Turizmit në vend (AATSF) midis BERZH-it dhe ProCredit Bank Albania, 11 prill 2022/  
Governor Sejko: The signing Ceremony of the Memorandum of Understanding of the EBRD with ProCredit Bank Albania under the Albanian Agribusiness and Tourism Support Facility (AATSF) - 11 April 2022*



*Gubernuratori në takim me Ambasadorën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë, SH.S.Zj. Yuri Kim, 15 prill 2022  
Governor Sejko receives the Ambassador of the United States of America in Albania, H.E. Ms Yuri Kim - 15 April 2022*



*Governatori në takim me Ambasadoren e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Shqipërisë, SH.S.Zj. Yuri Kim, 15 prill 2022/  
Governor Sejko receives the Ambassador of the United States of America in Albania, H.E. Ms Yuri Kim - 15 April 2022*



*Governatori Sejko në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, 21-24 prill 2022/  
Governor Sejko attends IMF and WBG Spring meetings 2022, 21-24 April 2022*



*Guvernatori Sejko në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, 21-24 prill 2022/  
Governor Sejko attends IMF and WBG Spring meetings 2022, 21-24 April 2022*



*Guvernatori Sejko në Mbledhjet e Pranverës të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, 21-24 prill 2022/  
Governor Sejko attends IMF and WBG Spring meetings 2022, 21-24 April 2022*



*Guvernatori Sejko në konferencën e 8-të të Kërkimeve, të organizuar nga Banka Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Banka Evropiane e Investimeve, 29 prill 2022/*  
Governor Sejko attends the 8th Research Conference, organised by the National Bank of the Republic of North Macedonia and The European Bank for Investments - 29 April 2022



*Guvernatori Sejko në takim e organizuar nga Kryeministri Rama me bankat tregtare, me fokus digjitalizimin e shërbimeve bankare, 6 maj 2022/*  
Governor Sejko attends the meeting organised by the Prime Minister Rama with commercial banks on digitalisation in banking - 6 May 2022





*Guvernatori Sejko në takim me Drejtorin e Operacioneve pranë Sekretariatit të Shtetit Zviceran për Çështjet Ekonomike, z. Martin Saladin, 13 maj 2022/  
Governor Sejko meets the Director of Operations of the Swiss Secretary of State for Economic Affairs, Mr Martin Saladin - 13 May 2022*



*Guvernatori Sejko në ceremoninë e organizuar nga Crimson Finance Fund Albania, 18 maj 2022/  
Governor Sejko: The ceremony organised by Crimson Finance Fund Albania - 18 May 2022*



*Gubernatori Sejko në takim përmblyllës me përfaqësuesit e Misionit të Fondit Monetar Ndërkombëtar, 19 maj 2022/*  
*Governor Sejko meets representatives of the International Monetary Fund Mission - 19 May 2022*



*Gubernatori Sejko në konferencën e organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Banka Botërore dhe Ambasada e Zvicrës në Shqipëri, me temë "Diversifikimi i sistemit financiar nëpërmjet reformave të tregut të kapitalit", 19 maj 2022/*  
*Governor Sejko attends the International Conference on "Diversifying the financial system through capital market reforms", organised by the Financial Supervision Authority, the World Bank and the Swiss Embassy in Albania - 19 May 2022*



*Gubernurit Sejko në Forumin për vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore, të organizuar nga "Euromoney", 24-25 maj 2022/  
Governor Sejko attends the Central and Eastern European Forum organised by Euromoney, 24-25 May 2022*



*Gubernurit Sejko merr kryesimin e Bordit Drejtues të Center of Excellence in Finance (CEF) Lubjanë, Slloveni, 8 qershor 2022/  
Governor Sejko: Succeeding Chair of the CEF Governing Board, Ljubljana, Slovenia - 8 June 2022*



Gubernur Sejko në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare të organizuar nga Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, 11 qershor 2022/  
Governor Sejko: International Scientific Conference organised by the Faculty of Economics, University of Tirana - 11 June 2022



Gubernur Sejko në Forumin "Digjitalizimi kundrejt parasë fizike" të organizuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, 14 qershor 2022/  
Governor Sejko: "Digitalization vs Cash" Forum, organised by the Albanian Association of Banks - 14 June 2022



*Gubernatori Sejko gjatë prezantimit të Raportit Vjetor të Bankës së Shqipërisë për vitin 2021 në Kuvendin e Shqipërisë, 16 qershor 2022/  
Governor Sejko presents the Annual Report 2021 of the Bank of Albania to the Assembly of the Republic of Albania - 16 June 2022*



*Gubernatori Sejko në ceremoninë e promovimit të librit: "Drejt një krize të re", 5 korrik 2022/  
Governor Sejko: Promotion ceremony of the book: "Towards a new crisis" - 5 July 2022*



*Gubernatori Sejko në takim me Ambasadorin e ri të Mbretërisë së Spanjës në Shqipëri, SH.T.Z. Álvaro Renedo Zalba, 13 korrik 2022/  
Governor Sejko receives H.E. Mr. Álvaro Renedo Zalba, New Ambassador of Spain in Albania - 13 July 2022*



*Gubernatori Sejko në takim me Zëvendësdirjtorin e Përgjithshëm të FMN-së, z. Bo Li, 19 shtator 2022/  
Governor Sejko meets the IMF's Deputy Managing Director, Mr Bo Li - 19 September 2022*



Guvernatori Sejko në takim me Zëvendës-presidentin e BERZH-it, z. Mark Bowman, 20 shtator 2022/  
Governor Sejko meets the EBRD's Vice President, Mr Mark Bowman - 20 September 2022



Guvernatori Sejko në konferencën me temë “A është rikthyer inflacioni dhe në cilën formë?”, mbajtur në Gjenevë, 22-23 shtator 2022/  
Governor Sejko attends the Conference on “Is inflation back, and in which form?”, in Geneva, 22-23 September 2022



*Guvernatori Sejko në takim me përfaqësuesit e Fondit Monetar Ndërkombëtar, 27 shtator 2022/  
Governor Sejko meets representatives of the International Monetary Fund - 27 September 2022*



*Guvernatori Sejko në samitin e vendeve të rajonit me temë "Politika monetare në një mjedis inflacioni", Bečići, Mal i Zi, 1 tetor 2022/  
Governor Sejko attends the regional summit on "Monetary policy in an inflationary environment", Bečići, Montenegro' - 1 October 2022*





*Gubernuratori Sejko vlerësohet me “Çmimin e Mirënjohjes” nga Fakulteti i Ekonomisë, Biznesit dhe Zhvillimit, Universiteti Europian i Tiranës, 6 tetor 2022/*  
Governor Sejko receives the “Appreciation Award” given by the Faculty of Economics, Business and Development, European University of Tirana — 6 October 2022



*Gubernuratori Sejko gjatë zhvillimit të Mbledhjeve Vjetore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe Bankës Botërore, 12-16 tetor 2022/*  
Governor Sejko: The 2022 Annual Meetings of the International Monetary Fund and the world Bank Group, 12-16 October 2022



*Gubernatori Sejko në takim me Ambasadoren e re të Zvicrës, Sh.S.Zj. Ruth Huber, 24 tetor 2022/*  
Governor Sejko receives the new appointed Swiss Ambassador, H.E. Ms Ruth Huber - 24 October 2022



*Gubernatori Sejko në Konferencën Vjetore të Bankës së Shqipërisë, 27 tetor 2022/*  
Governor Sejko: Annual Conference of the Bank of Albania - 27 October 2022



*Gubernatori Sejko gjatë prezantimit të opinionit të Bankës së Shqipërisë për projektbuxhetin 2023, 4 nëntor 2022*  
Governor Sejko presents BoA's opinion on 2023 draft budget - 4 November 2022



*Gubernatori Sejko në mbledhjen VIII të Komitetit Kombëtar të Sistemeve të Pagesave, 9 nëntor 2022/*  
Governor Sejko: Eighth Meeting of the National Payment Systems Committee - 9 November 2022



*Gubernatori Sejko në Asamblenë e Përgjithshme të Dhomës Amerikane të Tregtisë, 17 nëntor 2022/*  
Governor Sejko attends the General Assembly of the American Chamber of Commerce - 17 November 2022



*Gubernatori Sejko në konferencën e Bankës Kombëtare të Austrisë, për Integrimin Ekonomik Evropian 2022, 21 nëntor 2022/*  
Governor Sejko: Conference on European Economic Integration 2022, organised by Oesterreichische Nationalbank - 21 November 2022



*Gubernatori Sejko në Workshop-in XVI të Kërkimeve Ekonomike në Evropën Juglindore të organizuar nga Banka e Shqipërisë, 5 dhjetor 2022/*  
Governor Sejko: 16th SEE Economic Research Workshop - 5 December 2022



*Gubernatori në Mbrëmjen e Vitit të Ri të Shoqatës Shqiptare të Bankave, 15 dhjetor 2022/*  
Governor Sejko at the year - end event organised by the Albanian Association of Banks - 15 December 2022



*Gubernuratori i Bankës së Shqipërisë z. Gent Sejko në takim me gazetarë, analistë dhe drejtues të medias, 20 dhjetor 2022 /  
Governor Sejko: The end-of-year meeting with media representatives - 20 December 22*



*Gubernuratori Sejko gjatë aktivitetit “Çmimi i Gubernuratorit për Diplomën më të Mirë për vitin 2022”, 20 dhjetor 2022 /  
Governor Sejko with the competition winners of the “Governor’s Award for the Best Diploma Thesis 2022” - 20 December 2022*





